



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA  
SHQIPTARE” SHA DURRËS**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I  
PËRPUTHSHMËRISË,  
NË HEKURUDHA SHQIPTARE SHA.**

**Tiranë, korrik, 2023**

## **PËRMBAJTJA**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
1- Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2- Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3
3- Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	11
II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit) .....	12
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	15
2.1 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.....	16
2.2 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.....	36
2.3 Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit; Hartimi shqyrtimi, miratimi dhe zbatimi i programit ekonomik- financiar. Ndjekja dhe realizimi i treguesve ekonomik – financiar në qendër dhe në njësitë e varësisë.....	41
2.4 Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit:.....	62
a- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës, bankës në lekë dhe në valutë, blerjet e vogla për periudhën objekt auditimi (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj). .....	62
b- Nxjerrja e bilancit kontabël në afat, plotësimi i pasqyrave financiare sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe.....	68
4/d Mbajtja e evidencës kontabël në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e varësisë, analiza e debitorëve , kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore etj., ndaj buxhetit të shtetit.....	68
c- Mbi administrimin e pronës shtetërore dhe zbatimi i dispozitave për dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare.....	87
2.5 Mbi organizimin e strukturës organizative, dhëninën e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.	92
2.6 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.....	98
2.7 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të MFK si dhe Auditit të Brendshëm.....	187
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	195

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

### 1- Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar në operacione financiare, por jo vetëm. Janë audituar shpenzime për personelin dhe paga për një periudhë 3 vjeçare, pagesat e realizuara për këshillin mbikëqyrës, të ardhurat e realizuara, si dhe realizimi i shpenzimeve, procedura prokurimi. Janë konstatuar mangësi në lidhje me largimet e paligjshme të punonjëve nga puna, mangësi në lidhje me zbatimin e procedurave të prokurimit dhe zbatimin e kontratave përkatëse.

### 2- Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Gjeja nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar gjithsej:</p> <p><b>A.</b> 36 masa organizative: janë pranuar 35 prej tyre, ose 97.3%, nga të cilat, 14 masa janë zbatuar plotësisht (40%), 3 masa janë në proces zbatimi (8.6%), 14 masa nuk janë zbatuar (40%), 4 masa zbatuar pjesërisht (11.4%).</p> <p><b>B.</b> 5 masa për shpërbllim dëmi: nga të cilat, 2 masa janë zbatuar plotësisht (40%), 3 masa nuk janë zbatuar (60%).</p> <p><b>C.</b> 1 masë për eliminimin e efekteve të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, e cila nuk është zbatuar.</p> <p><b>D.</b> 2 masa disiplinore rekomanduar gjithsej, të cilat janë zbatuar.</p>	17 - 39	E mesme	Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të zbatuara pjesërisht, të pa zbatuara.
2	<p>Në “Hekurudha Shqiptare” SHA, konstatohet një planifikim dhe realizim jo i duhur i programit ekonomik, fakt që flet për planifikim jo të saktë dhe mos rishikim të programit fillestar. Performanca e treguesve ekonomikofinanciar që lidhen me realizimin e buxhetit faktik të shoqërisë, nuk është e kënaqshme dhe ka vend të përmirësohet, pasi për çdo lekë të shpenzuar, sipas viteve objekt auditimi është përfituar një e ardhur: 2019 prej 0.89 lekë, 2020 prej 0.79 leke, 2021 prej 0.94 lekë dhe për vitin</p>	43 – 66	E lartë	Nga ana e organeve drejtuese të bëhet një analizë e detajuar e investimeve kapitale dhe shpenzimeve, etj., të planifikuara për t'u realizuar gjatë vitit dhe të merren veprimet e nevojshme që këto projekte të realizohen sipas programit.

	<p>2022 një e ardhur prej 0,99 lekë. Raporti i detyrimeve afat shkurtër/kapitalit për vitin 2019, paraqitet 1.5 % , për vitin 2020 paraqitet 1.22%, për vitin 2021 paraqitet 1.31% dhe për 2022 në 1.45%. “Hekurudha Shqiptare” SHA, ka riskun e gjendjes së pamjaftueshme të likuiditeteve. Në qoftë se shoqëria do të llogariste penalitetin e hekurudhave të huaja si dhe nuk do të çelej subvencion nga buxheti i shtetit, do të çonte në rezultat negativ akoma më të lartë për vitet ushtrimore. Duke zbritur nga pasqyrat financiare subvencionin si e ardhur, raporti të ardhura/shpenzime do të ndryshojë duke thelluar në mënyre të ndjeshme rezultatin financiar (humbje). Veprimet sa më sipër janë jo në përputhje me ligjet nr.115/ 2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ndryshuar; nr.137/ 16.11.20, “Për buxhetin e vitit 2021”, ndryshuar; nr.88/ 18.12.19, “Për buxhetin e vitit 2020”, ndryshuar; nr.99/ 2018, “Për buxhetin e vitit 2019” si dhe UMFE nr.9, datë 20.03.18, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.</p>			
3	<p>Ecuria e treguesve ekonomiko-financiare për vitet e fundit 2019, 2020, 2021 dhe 2022, pasqyron një krize likuiditeti HSH sha, si dhe ka detyrime të prapambetura ndaj të tretëve si kredi afatshkurtër e afatgjatë, për principial dhe interesa, fatura për blerje etj., në vlerën 3,870,023 mijë lekë (totali i detyrimeve afatshkurtra 1.096.943 mijë lekë + totali i detyrimeve afatgjata 2.773.080 mijë lekë). Në opinionin e grupit të auditimit Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sh.a Durrës, është në gjendje falimentimi. MIE dhe MFE, e kanë përdorur subveconin si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë HSH sha.</p> <p>Veprimet sa më sipër janë jo në përputhje me ligjet për buxhetin e viteve përkatëse pasi Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), Dega e Thesarit Durrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar), me veprimet apo mosveprimet e tyre, kanë krijuar një situatë konfuzë dhe të paqartë për alokimin dhe përdorimin e subvencionit nga Hekurudha Shqiptare, duke i krijuar kësaj shoqërie mundësinë që ta përdor këtë subvencion për paga dhe sigurime shoqërore), duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare Sh.a Durrës, pasi Shoqëria aktualisht ndodhet</p>	72 -91	E lartë	<p>Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës, ti kërkojnë në rrugë institucionale Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e monitoruesit dhe hartimit të politikave, që të ndërmarrin veprime urgjente ligjore, për korrigjimin e menjëreshëm të veprimtarisë së kësaj shoqërie, dhe konkretisht për subvencionin, të përputhen kërkesat e ligjeve me kushtet dhe specifikat në të cilat ndodhet kjo shoqëri.</p>

	përpara një krize të mprehtë likuiditeti.			
4	<p>Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2022, huatë afatgjata dhe detyrimet e tjera afatgjata paraqiten në vlerën 1,438,887 mijë lekë, kjo bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit nr. 37, në fuqi. Objektivi i SNK 37 është të sigurojë se janë zbatuar kriteret e duhura të njohjes dhe bazat e matjes për provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara. Në këtë shumë, Shoqëria nuk ka përfshirë shumat për interesa dhe kamatëvonesa të arritura sipas marrëveshjeve të huave. Shoqëria ka njohur në vitin 2000 provizionet afatgjata në vlerën 237,250 mijë lekë, që lidhen drejtpërdrejt me detyrimet e mundshme të huave dhe detyrimeve. Me shkresën nr. 48 prot., datë 19.01.2023, HSH sha, i është drejtuar MFEsë, për të krijuar kushtet e nevojshme për likuidimin e borxheve të huaja. Duke marrë në konsideratë shumën e penaliteteve të pa llogaritura, pretendimet e hekurudhave të huaja dhe kostot potenciale për zgjidhjen e marrëveshjeve, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë mbi shumën e nevojshme të provizioneve shtesë që duhet të krijohen dhe efektet që kjo do të kishte në pasqyrat financiare. Shoqëria nuk ka pasur një politikë koherente të njohjes së provizioneve për borxhet e këqija dhe të dyshimta. Mungesa e një rregulloreje për provizione si dhe mungesa e një analize për vjetërsinë dhe vlerësimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta, mund të këtë ndikim në rritjen e rrezikut për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, dhe marrjen e vendimeve të gabuara lidhur me to. Kjo ka ndodhur pasi Këshilli Mbikëqyrës nuk ka ndërmarrë hapa konkret për hartimin e një Rregulloreje të tillë. Sa më sipër rezulton se Shoqëria është e rriskuar për të gjeneruar efekte financiare.</p>	72 -91	E lartë	<p>Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë duhet të ndërmerren veprimet e nevojshme për hartimin e një rregulloreje për trajtimin e provizioneve dhe borxheve të këqija të bazuar në politika të qarta dhe në harmoni me Standardet e kontabilitetit.</p>
5	<p>Gjendja debitore dhe kreditore është shumë e rënduar për HSH sha, pavarësisht se nga organet drejtuese të saj është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre. Konkretisht gjendja debitore për vitin 2022 është në vlerën 594,825,000 lekë. Peshën kryesore të llogarive të arkëtueshme, e mbajnë aktivet korrente në vlerën 369,000,000 lekë ose 67 %. Pjesë tjetër e cila është e rëndësishme është TVSH me saldo debitore, në vlerën 36,129,000 lekë. Vlera prej 64,754,408 lekësh (llog 441) është TVSH e rikonstruktimit të linjës Durrës-Tiranë, e cila është likuiduar në vitin 2023 nga Dega Thesarit. Ndërsa në llogarinë 4671, e cila është në vlerën 68,464,784 lekë, janë detyrime të cilat nuk</p>	72 -91	E lartë	<p>Organet Drejtuese të Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” Durrës, (Administratori, Këshilli Mbikëqyrës, Asambleja e Përgjithshme) të marrin masa për analizimin, shqyrtimin dhe reduktimin e humbjeve të shoqërisë.</p>

	mbliken prej vitesh dhe janë te ndjekura nga sektori juridik. Në llogarinë 411, të arkëtueshme, e cila ka vlerën 15,966,000 lekë, janë të viteve të fundit dhe mendohet se do jenë të arkëtueshme nga Njësia Biznes Mallit dhe Njësia e Menaxhimit të Infrastrukturës.			
6	Mbajtja e llogarive të aktiveve jashtë kontabilitetit është në shumën 2,441,739,656 lekë, në të cilat paraqiten vlera e aktiveve afatgjata materiale që priten t'i transferohen Bashkive Tiranë, Mirditë, Klos, Laç, Elbasan dhe Durrës procedurë e cila ka mbetur përgjysmë. Si rrjedhojë, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë efektin që do të kishin patur në pasqyrën e performancës, si edhe në pozicionin financiar nëse kjo procedurë e nisur nuk do të realizohet.	72 -91	E lartë	Shoqëria të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të vlerës 2,441,739,656 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me aktivet afatgjata materiale të cilat janë në proces transferimi ndaj Bashkive Tiranë, Mirditë, Klos, Laç, Elbasan dhe Durrës, në zbatim të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.
7	Të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, me përjashtim të 4 prej tyre, nuk janë regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, (Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme).	72 -91	E lartë	Nga Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sha, të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Durrës, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet.
8	Nga auditimi në terren lidhur me punimet e kryera, sipas kontratës së lidhur midis kontraktorit “E. B&B” SHPK & “V.-E” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 984/2 prot., datë 18.11.2019, objekt “Punime për mbrojtjen e linjës”, grupi i auditimit, nuk mundi të verifikonte disa zëra punimesh, konkretisht, në km 75 +050, L=35 ml, perigoni Lushnje-Fier, pasi hasi në vështirësi për të evidentuar me saktësi segmentet e deklaruara (km) nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, si segmente që duheshin riparuar. Mungonin gurët kilometrikë e si rezultat nuk ishte e mundur të evidentohet saktësisht nëse punimet ishin kryer në segmentet/kilometrat e deklaruara nga “Hekurudha Shqiptare” SHA. U konstatuan mangësi të theksuara të sinjalistikës hekurudhore si ajo që nevojitet për makinistët e trenave por edhe sinjalistika e domosdoshme për këmbësorët ose automjetet që kalojnë kryqëzimet hekurudhore. Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA nuk është marrë asnjë masë për saktësimin e gjatësive kilometrike të linjave hekurudhore shqiptare, duke vështirësuar kryerjen e verifikimeve në terren, lidhur me investimet e deklaruara për kilometrat respektiv.	164 - 203	E lartë	Nga HSH SHA, Durrës, të merren masa për vendosjen e sinjalistikës hekurudhore me qëllim garantimin e sigurisë në trafikun hekurudhor dhe vendosjen e gurëve kilometrikë të paktën për çdo 100 km gjatësi të linjës hekurudhore me qëllim lehtësimin e kryerjes së verifikimeve në të ardhmen të zërave të punimeve për rikonstruksionet e segmenteve të ndryshëm të linjës hekurudhore.
9	Në procedurat e prokurimit publik të kryera nga AK, për periudhën objekt auditimi, pothuajse në të gjitha procedurat e audituara, nga ana e APP është dhënë asistencë teknike për kërkesat e veçanta për kualifikim, bazuar në ligjin nr.	164 - 203	E lartë	AK, HSH sha, të marrë masa që hartimi i kritereve teknike për kualifikim të kryhet nga specialisti i fushës së njësisë së prokurimit ose nga struktura të posaçme, Njësia e

	<p>9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 13, “Agjencia e Prokurimit Publik” dhe ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 23 “Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik”. Pavarësisht se rekomandimet e dhëna nga APP janë zbatuar sipas shtojcave të modifikimit të DST-ve, kjo ka sjellë shtyrjen e afatit të procedurës së prokurimit.</p> <p>Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën objekt auditimi rezultoi se, në përbërjen e njësisë së prokurimit nuk ka specialistë të fushës, por ato janë me profesion jurist dhe vetëm në tre raste është inxhinier elektrik, por që nuk është i fushës konkrete.</p>				Infrastrukturës.
11	Nga auditimi rezulton se projektet nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat përgjegjës për realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.	164 - 203		E lartë	Nga Administratori i shoqërisë të merren masa për të operuar vetëm me projekteve të zbatimit të hartuara nga projektues, të pajisur me licencat përkatëse.
12	Nuk ka të dhëna në këtë dokument mbi çmimet bazë të kontratave të mëparshme të vetë AK. Ky komision nuk liston asnjë çmim të kontratave të mëparshme për të lënë gjurmë auditimi, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, ku citohet se: “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës”.	164 - 203		E lartë	AK, HSH sha, të marrë masa të argumentojë përlllogaritjen e fondit limit sipas detyrës së caktuar nga titullari. Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit të mos tejkalojë kompetencat e caktuara, duke përcaktuar fondet për mbikëqyrje e kolaudim nga përlllogaritja e fondit limit të procedurës së urdhëruar.
13	Nga auditimi i procedurave të prokurimit kryesisht për blerje traversa druri apo rikonstrukcione të linjave rezultoi se në specifikimet teknike: Ky komision ka hartuar specifikimet teknike, në të cilat rezulton se nuk ka përcaktuar llojin e standardit të KE në fuqi si dhe në specifikimet teknike është kërkuar certifikatë cilësie e prodhuesit, pa përcaktuar numrin e saj, certifikatë garancie të prodhuesit pa përcaktuar afatin e garancisë së traversave.	164 - 203		E lartë	AK, “Hekurudha Shqiptare” SHA, të marrë masa të arsyetohet në mënyrë të drejtë domosdoshmërinë e kryerjes së procedurës së prokurimit. dhe hartimi i specifikimeve teknike të jetë në përputhje me objektin e kontratës.
14	Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit publik në të gjitha rastet rezultoi se preventivat nuk shoqërohen me analizë teknike të çmimeve.	164 - 203		E lartë	AK, Hekurudha Shqiptare sha, të marrë masa që të hartojë preventiva, ku çmimet e reja që nuk përfshihen në manualin teknik të çmimeve të bëhen me analizë, duke u bërë pjesë e dosjes së procedurës së prokurimit.
15	Nga auditimi i kontratës së lidhur me objekt “Punime për mbrojtjen e linjës”, midis BOE “E”. SHPK & “V” SHPK dhe HSH SHA, me nr. 984/2 prot., datë 18.11.2019, me afat 90 ditë kalendarike nga dita e dhënies së lejes së sheshit të ndërtimit, me vlerë 21,338,017 lekë me	161 - 167		E lartë	Nga HSH SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 62,415.36 lekë, nga kontraktori “E”. SHPK & “V” SHPK,

	TVSH, rezultoi se nuk është ekzekutuar zëri nr.5, An-9, “Mbushje me zhavorr mbrapa murit”, me vlerë 285,994.8 lekë me TVSH, për segmentin hekurudhor Rrogozhinë-Lushnje, km 74+850 deri km 75+000 dhe km 75+700 deri 75+765. Si rezultat, vlera totale e punimeve të pa kryera është 285,994.8 lekë, veprim jo në përputhje me kontratën e lidhur.			si vlerë që i përket penaltetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 984/2 prot., datë 18.11.2019. Nga HSH SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 285,994.8 lekë, nga kontraktori “E” SHPK & “V” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar dhe likuiduar por të pa kryer nga kontraktori sipas kontratës nr. 984/2 Prot., datë 18.11.2019.
16	Nga auditimi i kontratës së lidhur me objekt “Rikonstruksioni i Linjës Budull - Gjorëm”, midis “E” SHPK dhe HSH SHA, me nr. 52/5 prot., datë 02.07.2021, me afat 3 muaj kalendarikë duke filluar nga data e lidhjes së kontratës, me vlerë 9,724,178 lekë me TVSH, rezultoi se: Vlera e penaltetit për 40 ditë vonesë që duhet mbajtur nga OE “E” SHPK për kryerje punimesh me vlerë 720,000 lekë, është: $4/1000 * 40 * 720,000 = 115,200$ lekë.	167 - 174	E lartë	Nga Hekurudha Shqiptare SHA, Durrës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 115,200 lekë, nga kontraktori “E” SHPK, si vlerë që i përket penaltetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 52/5 prot., datë 02.07.2021.
17	Nga auditimi në terren lidhur me punimet e kryera, sipas kontratës midis OE “E” SHPK dhe HSH SHA, me nr. 52/5 Prot., datë 02.07.2021 dhe objekt “Rikonstruksioni i Linjës Budull-Gjorëm”, u konstatuan diferenca në zëra punimesh të pa ekzekutuara por të situacionuara dhe faturuara. Në situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 3575 orë pune për vendosjen e 672 m <sup>3</sup> traversa betoni. Në fakt janë vendosur 73 m <sup>3</sup> traversa betoni dhe respektivisht për këtë vëllim, nevojiten $(73*3575)/672=388$ orë pune. Vlera totale e punimeve të pa kryera është 6,362,304 lekë.	167 - 174	E lartë	Nga Hekurudha Shqiptare SHA, Durrës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 6,362,304 lekë, nga OE “E” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer nga kontraktori, sipas kontratës nr. 52/5 prot., datë 02.07.2021.
18	Nga auditimi i zbatimit të kontratës të lidhur me objekt “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Shkozet-Kavajë”, midis “E” SHPK dhe HSH SHA, me nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021, me afat 3 muaj kalendarik nga dita e nënshkrimit të kontratës midis palëve, me vlerë 8,879,149.92 lekë me TVSH, rezultoi se: Vlera e penaltetit për 4 ditë vonesë që duhet mbajtur nga OE “E” SHPK për kryerje punimesh me vlerë 494,854.2 lekë, është: $4/1000 * 4 * 494,854.2 = 123,714$ lekë.	176 - 181	E lartë	Nga HSH SHA, Durrës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 123,714 lekë, nga OE “E” SHPK, si vlerë që i përket penaltetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021.
19	Nga auditimi i zbatimit të kontratës të lidhur me objekt “Riparime vepra arti”, midis “Rr” SHPK dhe HSH SHA, me nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021, me afat 45 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës midis palëve dhe	181 - 184	E lartë	Nga HSH SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 2,307,754 lekë, nga



	me vlerë 9,231,016 lekë me TVSH, rezultoi se: Vlera e penaltetit që i duhej mbajtur kontraktorit “Rr” SHPK, për 35 ditë vonesë kryerje punimesh, është: $4/1000 * 35 * 9,231,016 = 1,292,342$ lekë. Meqenëse kjo vlerë është më pak se 25% e vlerës totale, atëherë aplikohet formula $25% * 9,231,016 = 2,307,754$ lekë.			kontraktori “Rr” SHPK, si vlerë që i përket penaltetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021.
20	Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Riparim vepra arti (mbrojtja e urës hekurudhore të Rrogozhinës)” midis BOE “M. L” SHPK & “V.K” SHPK & “E K” SHPK & “N.G” SHPK dhe HSH SHA, me nr.110/4 Prot., datë 03.11.2022, me afat 45 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit nga AK të kontratës dhe vlerë 37,799,726.4 lekë me TVSH, nga verifikimi në terren, u konstatua se ky zë punimesh nuk është ekzekutuar, për më tepër që punimet kanë përfunduar afro 3 muaj më parë dhe duhej të ishte evidente sipërfaqja e rrafshuar e skarpatave të lumit. Sa më sipër, vlera në total e punimeve të pakryera është 1,528,170 lekë.	194 - 200	E lartë	Nga HSH SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 1,528,170 lekë, nga kontraktori “M L” SHPK & “V.K” SHPK & “E .K” SHPK & “N.G” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer nga kontraktori, bazuar në kontratën nr.110/4 Prot., datë 03.11.2022.
21	Nga auditimi i kontratës së lidhur midis OE “Z” SHPK dhe HSH SHA, me nr.501/2 Prot., datë 24.06.2019, me objekt “Rinovim agregatesh për lokomotiva”, me afat 60 ditë kalendarike ose me datë përfundimi datën 22.08.2019, dhe me vlerë 11,208,000 lekë me TVSH, rezultoi se: NJSHML, nuk ka kryer procedurat e duhura ligjore për marrjen në dorëzim të shërbimeve duke vepruar në kundërshtim me nenin 7 “Inspektimet dhe Testimet”, pika 7.2 e këtij neni. Në gjykim të grupit të auditimit, vlera e investuar prej 11,208,000 lekë, përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.	181 - 221	E lartë	Këshilli Mbikëqyrës i HSH SHA, të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive të Strukturave Drejtuese, lidhur me kryerjen e procedurave të prokurimit pa argumentuar më parë nevojat reale të shoqërisë duke sjellë pasoja negative financiare për buxhetin e shtetit. Strukturat Drejtuese të shoqërisë, të marrin masa që në të ardhmen, përpara zhvillimit të një procedure prokurimi, të argumentohet dhe dokumentohet nevoja reale që ka institucioni dhe në vijim të kryhet prokurimi për mallra, shërbime apo punime, konform ligjeve dhe rregullave në fuqi.
22	Për periudhën objekt auditimi, si rezultat i largimeve nga puna pa shkaqe të arsyeshme, Hekurudha Shqiptare SHA, është penalizuar me vlerën prej 2,371,590 lekë. Pavarësisht ndjekjes në të gjitha shkallët e gjykimit dhe kontestimeve nga HSH SHA të vendimeve të gjykatave, për dëmshpërblimet si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës konstatohet se vendimet në shumicën e rasteve janë në favor të punonjësve të larguar. Në vitin 2022, janë marrë 4 vendime të formës së prerë me vlerë totale dëmshpërblimi për punonjësit e larguar padrejtësisht në 2,371,590 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar në dëm të buxhetit të shtetit dhe në të ardhmen shkakton rëndim të situatës financiare duke cenuar zhvillimin normal të aktivitetit ekonomiko-financiar të	101 - 113	E lartë	Këshilli Mbikëqyrës i Hekurudhës Shqiptare SHA, të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive lidhur me largimet e padrejta nga puna të punonjësve nga Strukturat Drejtuese. Strukturat Drejtuese të shoqërisë dhe Dega e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për rekrutimin e punonjësve bazuar në kërkesat e vendit të punës, me qëllim shmangien e efekteve negative financiare që shkaktohen nga dëmshpërblimi si pasojë e vendimeve gjyqësore.

	HSH SHA			
23	<p>Nga verifikimi i kryer në regjistrin e borxhit publik të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “Regjistri i Garancive Shtetërore”, rezultoi për llogari të “Hekurudha Shqiptare” SHA. është kredia italiane, (Artigiancassa, Itali), për projektin “Rehabilitimi i Hekurudhës së Durrësit, me datë nënshkrimi 08.05.1995, shuma e kredisë në vlerën 3,098,741.39 euro, me datë fillimi 17.01.2008, datë mbarimi 17.07.2025. Shoqëria kryen rakordimet e duhura me departamenti përkatës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për sqarimin e situatës debitoare. Në lidhje me kredinë italiane shoqëria dispononte planin e amortizimit të kredisë si dhe ka marrë njoftime periodike nga B. që funksionon si bankë ndërmjetëse në lidhje me detyrimet, por megjithëse nuk ka paguar këstet e principalit dhe interesat duhet të krijonte një llogari provizioni për këto këste dhe interesa të cilat janë paguar nga llogaria e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Këto vlera të likuiduara nga ana e MFE janë të kontabilizuara si detyrim në llog.4672/2.</p> <p>Vlera e cila llogaritet deri në fund të periudhës ushtrimore 2022 është në shumën 2.657.170,76 Euro ose në vlerën 303,529,000 lekë. Situata e vështirë ekonomike e shoqërisë është thelluar akoma më shumë në vitet e fundit duke e bërë të pamundur kthimin e detyrimit duke lënë këtë barrë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Vlera prej 2,657,170.76 euro është efekt financiar negativ për “Hekurudha Shqiptare” SHA.</p>	75 -101	E lartë	<p>Nisur nga gjendja e rëndë financiare dhe situata përpara ndarjes së shoqërisë HSH sha, HSH sha në bashkëpunim me MFE në cilësinë e aksionarit të vetëm dhe që ka shlyer detyrimet e kësaj kredie që nga viti 2008, të marrin masat e duhura për sistemimin e detyrimit nga pasqyrat financiare të HSH sha ne likuiduesin e kësaj kredie.</p>
24	<p>HSH SHA, për vitet periudhën objekt auditimi, ka paguar gjoba në lidhje me kryerjen me vonesë të pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pagesa përmbarues privat detyrime të cilat kanë lindur si rrjedhojë e mos likuidimit në afatet e përcaktuara në kontratat e lidhura me sipërmarrësit, pagesa tatimi në burim etj. Për periudhën e auditimit, shuma e paguar nga ana e Shoqërisë është 30,787,598 shumë e cila është efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.</p>	68 – 75	E lartë	<p>Shoqëria HSH SHA, të marrë masat e nevojshme që në ta ardhmen të eliminojë efektet financiare negative. Shoqëria duhet të marrë në konsideratë që mos shlyerja në kohë e detyrimeve të ndryshme ndaj punonjësve si (derdhja e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat personale etj.) si dhe zgjidhja e kontratave me të tretët në gjykatë do të rëndonte akoma më shumë financat e shoqërisë.</p>

### 3- Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.

#### **Opinion i auditimit**

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e aktivitetit, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti **Hekurudha Shqiptare sha, Durrës**, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), u evidentuan në përgjithësi zbatimi tyre, por në disa raste u konstatuan devijimeve nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur justifikojnë dhënien e një **“Opinionin e kualifikuar”**<sup>1</sup>, e shprehur kjo në bazën për opinion.

#### **Baza për dhënie të opinionit:**

Baza për dhënien e opinionit të përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare janë ISSAI 41001<sup>2</sup> dhe ISSAI 42002 Nga auditimi i përputhshmërisë, për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet buxheti (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në SHA “Hekurudha Shqiptare” Durrës, gjatë auditimit janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në zbatimin e kontratave të punimeve me pasojë dëm ekonomik në shumën 10,785,552 lekë si dhe efekte negative financiare për shoqërinë në shumën 44,367,188 lekë dhe 2,675,170.76 euro.

Bazuar në auditimin e kryer, kemi konstatuar se përveç rasteve të mosrespektimit apo mospërputhjeve të shënuara në paragrafin Bazat për Opinionin e Kualifikuar, veprimtaria e SHA “Hekurudha Shqiptare” Durrës është në përputhje, me të gjitha aspektet materiale.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të “Hekurudha Shqiptare” sha, Durrës:**

Strukturat drejtuese të “Hekurudha Shqiptare” sha, Durrës, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi material apo anomalie që mund të ekzistojë.

<sup>1</sup> Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, në llogaritë vjetore apo transaksionet e tjera financiare.

<sup>22</sup> ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.

## II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 126/1, datë 20.02.2023, dhe shtesës së programit të auditimit nr. 126/2, datë 12.04.2023 nga data 20.02.2023 deri më datë 12.05.2023, në Shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” Sha Durrës për periudhën nga data 01.06.2019 deri më datë 31.12.2022, u krye auditimi “Përputhshmërisë” me përbërje:

1. L.B., Përgjegjës grupi;
2. A.T., Auditues;
3. G. P., Auditues;
4. Q M., Auditues.

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

**Objekti i auditimit:** Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH, është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, termave dhe kushteve, në përputhje me ligjin e buxhetit të shtetit, me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kornizës ligjore të prokurimit publik, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së Shoqërisë. Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës*, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar, siç kërkohet në aktet ligjore. Gjithashtu, raporti i auditimit ka për qëllim *promovimin e përgjegjshmërisë*, ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

**Qëllimi:** Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik, duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

**Identifikimi i çështjes:** Shoqëria duhet të ketë organizimin e duhur, për të funksionuar duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet.

**Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar** lidhur me çështjen nën auditim: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficientë. Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Drejtimi dhe Administrimi i Shoqërisë realizohet nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës vëzhgon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga Administratori i Shoqërisë. Administratori i Shoqërisë ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të Shoqërisë dhe kryhen të gjitha veprimet e Administrimit të Shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i Hekurudhës Shqiptare sha. është transporti i mallrave dhe i udhëtarëve si dhe dhënia me qira. Aktiviteti i Hekurudhës Shqiptare administrohet nga Drejtoria Qendrore, në përbërje të së cilës janë katër njësi Biznesi të ndara administrativisht dhe financiarisht midis tyre:

Njësia e biznesit të transportit hekurudhor të Mallit; Njësia e biznesit të transportit hekurudhor të Udhëtarëve; Njësia e biznesit të menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore; Njësia e biznesit të mirëmbajtjes të mjeteve Lëvizëse (lokomotiva dhe vagonë).

**Përgjegjësitë e audituesve:** Audituesit e KLSH janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikes me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

**Kriteret e vlerësimit:**

Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr.8417 datë 21.10.1998, “Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;

Ligji nr.9317, datë 18.11.2004, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr.8306, datë 14.03.1998, “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”;

Ligji nr.9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;

Ligji nr.10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve;

Ligji nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës, i ndryshuar;

Ligji nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”;

Ligji nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.8402, datë, 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar;

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

Ligji nr.9154, datë 26.11.2003, “Për arkivat”;

Ligji nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar;

Ligji nr.9720, datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar;

Ligji nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr.8510, datë 15.07.1999, “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar”;

Ligji nr.44/2015 datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik.

**Standardet e auditimit:** Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti Përfundimtar i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme.

· ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik; ISSAI 400-Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë; ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; ISSAI 1500 (ISA 500).

· Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;

· Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”;

·si dhe në praktikat më të mira të fushës.

**Metodat e auditimit:** Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare“ Sha, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar me akt konstatimet, akt verifikime dhe komente të subjektit të audituar, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij dokumenti.

**Dokumentimi i rezultateve të auditimit:** Është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI),për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Projekti dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

#### 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” Sha është shoqëri anonime me kapital 100 % shtetëror, me aksionar të vetëm Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe supervizohet nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës. Organizmi dhe funksionimi i Shoqërisë është në zbatim të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Kodit hekurudhor dhe Statutit të Shoqërisë.

- Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është transporti i udhëtarëve dhe mallrave, ngarkim, shkarkim dhe shërbime të tjera hekurudhore. Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e Shoqërive të reja, si edhe pjesëmarrjen në kapitalin e Shoqërive të tjera jashtë vendit.

<b>Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës sipas viteve objekt auditimi</b>			
<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>
T. B.	T.B.	E.M.	E. M.
K. M.	K. M.	G. L.	B. N.
E. M.	E. M.	B. N.	K. R.
Th. Xh	Th.Xh.	K. R.	S.B.
E T.	E.T.	S. B.	K. H.
Th. P.	Th. P.	S. B.	K. N.
<b>Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë</b>			
A. D.	A. D.	A. D.	G. L.
<b>Numri mesatar i punonjësve</b>			
971	947	936	<u>826</u>
<b>Kapitali themeltar (i nënshkruar) në mijë lekë</b>			
48.379.982	48.379.982	<u>47.450.830</u>	47.450.830
<b>Aksione me vlerë nominale 1 aksion i barabartë me</b>			
1,000 lekë	1,000 lekë	1,000 lekë	1,000 lekë

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është përputhshmëria e operacioneve financiare të subjektit për periudhën nga 01.06.2019 deri më datë 31.12.2022.

Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar shpenzime për investime, shpenzimet operative, shpërblimet dhe pagat, programimi ekonomik dhe realizimi i tij, alokimi dhe përdorimi i subvencioneve, pasqyrat financiare etj. Është audituar vendimmarrja e organeve drejtuese, si dhe menaxhimi financiar dhe kontrolli.

## 2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.

### 2.1 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Nga auditimi i ushtruar në HSH sha, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH<sup>së</sup>, dërguar me shkresën nr. 415/7 prot., datë 13.11.2019, konstatohet se:

-Nga auditimi i zbatimit të afatit 20 ditor, për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH<sup>së</sup> dhe zbatimit të afatit 6 mujor për raportimin e ecures së zbatimit të rekomandime rezultoi se, nga ana e HSH sha, nuk është respektuar afati 20 ditor i kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, dhe afati 6 mujor për informim të KLSH<sup>së</sup>, në zbatim përkatësisht të nenit 15 germa “j”, dhe nenit 30të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar gjithsej:

**A. 36 masa organizative:** nga të cilat, **14** masa janë zbatuar plotësisht, **3** masa janë në proces zbatimi, **14** masa nuk janë zbatuar, **4** masa zbatuar pjesërisht dhe **1** masë pa pranuar.

**B. 5 masa për shpërblim dëmi:** nga të cilat, **2** masa janë zbatuar plotësisht, **3** masa nuk janë zbatuar.

**C. 1 masë për eliminimin e efekteve të konstatuara në administrimin e fondeve publike** dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, e cila nuk është zbatuar.

**D. 2 masa disiplinore** rekomanduar gjithsej, të cilat janë zbatuar.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 126/1 prot., datë 20.02.2023, u krye auditim në Hekurudha Shqiptare Sha Durrës, mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH<sup>së</sup>, të dërguar në HSH sha me shkresën nr. 210/7 prot., datë 19.09.2019.

<b>1.Titulli i Gjetjes:</b>	Mos zbatimi i plotë rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH <sup>së</sup> .
<b>Situata:</b>	<p>Në shkresën nr. 415/7 prot., datë 13.11.2019, të Kontrollit të Lartë të Shtetit, “Hekurudha Shqiptare” SHA, i janë lënë për zbatim 36 masa organizative, 5 masa për shpërblim dëmi, 1 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike, për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike si dhe 2 masa disiplinore.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar gjithsej:</p> <p>A. 36 masa organizative: janë pranuar 35 prej tyre, ose 97.3%, nga të cilat, 14 masa janë zbatuar plotësisht (40%), 3 masa janë në proces zbatimi (8.6%), 14 masa nuk janë zbatuar (40%), 4 masa zbatuar pjesërisht (11.4%).</p> <p>B. 5 masa për shpërblim dëmi: nga të cilat, 2 masa janë zbatuar plotësisht (40%), 3 masa nuk janë zbatuar (60%).</p> <p>C. 1 masë për eliminimin e efekteve të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, e cila nuk është zbatuar.</p>



<b>Kriteri:</b>	D. 2 masa disiplinore rekomanduar gjithsej, të cilat janë zbatuar. Moszbatimi i masave të rekomanduara nga KLSH në auditimin e mëparshëm është jo në përputhje me ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", duke sjellë mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për "Hekurudha Shqiptare" SHA.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Ligji 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për Shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" Sh.a Durrës.
<b>Shkaku:</b>	Mos korrektesë e plotë institucionale e në zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi.
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm
<b>Rekomandime:</b>	Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të zbatuara pjesërisht, të pa zbatuara.

Konkretisht janë në proces zbatimi, zbatuar pjesërisht, pa zbatuar dhe pa pranuar sa më poshtë vijon:

#### **A. Masa organizative:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e kanë përdorur subvencionim si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë "Hekurudha Shqiptare" sh.a Durrës.

Ecuria e treguesve ekonomik-financiare për vitet e fundit 2016, 2017 dhe 2018 dhe realizimi i pritshëm për vitin 2019, pasqyron qartazi një krizë të mprehtë likuiditeti të Shoqërisë "Hekurudha Shqiptare". Përveç krizës, Shoqëria mbart detyrime të prapambetura ndaj të tretëve si kredi afatshkurtër e afatgjatë, për principial dhe interesa, fatura për blerje etj., në vlerën 1,895,812 mijë lekë .

Në opinionin e grupit të auditimit Shoqëria "Hekurudha Shqiptare" Sh.A Durrës, jo vetëm është në krizë të mprehtë likuiditeti, por është plotësisht e falimentuar.

Më date 31.05.2019, datë në të cilën përfundon periudha e auditimit, kjo shoqëri ka në sekuestro konservative në bankat : R.B. (7 numra llogarie), A. Bankë (4 numra llogarie) me të njëjtët urdhra sekuestro, B. K. T. (11 numra llogarie) me të njëjtët urdhra sekuestro, B. C. (4 numra llogarie) me të njëjtët urdhra sekuestro, P.C.B. ( 1 numër llogarie), F. (2 numër llogarie), A.B. (2 numër llogarie), U.B. (2 numër llogarie), T. B.(1 numër llogarie), I. S.P. (5 numra llogarie) V. B. (1 numër llogarie), S. G. (2 numër llogarie), në total operojnë me 42 numra llogarie me urdhra sekuestro nr.11 në vlerën totale 44,938,145 lekë .

Referuar sa më sipër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e kanë përdorur subvencionin si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë "Hekurudha Shqiptare" sh.a Durrës.

Përveç sa më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, Shoqërisë "Hekurudha Shqiptare" sh.a, Durrës nuk i është dhënë vëmendja e duhur në investime shtetërore, që s' duhet t'i mungonin si e vetmja shoqëri në Republikën e Shqipërisë me objekt transportin kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtareve, ashtu siç i jepen infrastrukturës automobilistike.

Për ndryshimin e destinacionit të subvencionit, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr.1313/12 prot., datë 20.06.2018, ka çuar për ndjekje penale për përdorimin e subvencionit për vitin 2017, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, dhe pas hetimit dhe kalimit në shkallët e gjyqësorit Gjykata e Apelit Durrës, ka vendosur ndryshimin e vendimit penal nr. (11-2019-1312)309 datë 06.03.2019 të Gjykatës ë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe **pranimin e kërkesës për pushimin e çështjes penale** nr.1119, të vitit 2018, të Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Durrës. Vendimi është shpallur datë 15.05.2019.

Në opinionin e grupit të auditimit emërtimi “Rrjet hekurudhor i subvencionuar” është në kundërshtim me pikën 58 të nenit 5 të ligjit nr.142/2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” përcaktohet përkufizimi i rrjetit hekurudhor konkretisht: “*Rrjet*” janë linjat, stacionet, terminallet dhe të gjitha llojet e pajisjeve fikse, të nevojshme për të siguruar funksionimin e sigurt dhe të pandërprerë të sistemit hekurudhor.” Pra rrjeti nuk është veprimtari (subjekt) por objekt.

Referuar sa më sipër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), Dega e Thesarit Durrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar), me veprimet apo mosveprimet e tyre, kanë krijuar një situatë konfuze dhe të paqartë për alokimin dhe përdorimin e subvencionit nga Hekurudha Shqiptare, duke i krijuar kësaj shoqërie mundësinë që ta përdor këtë subvencion për paga dhe sigurime shoqërore), duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi të akorduar po nga vet Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

**Rekomandimi 1.1:** Që të mundësohet funksionimi i Shoqërisë dhe të mos krijohen probleme sociale me punonjësit, Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës, ti kërkojnë në rrugë institucionale Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e monitoruesit dhe hartimit të politikave, që të ndërmarrin veprime urgjente ligjore, për korrigjimin e menjëhershëm të veprimtarisë së kësaj shoqërie, dhe konkretisht për subvencionin, të përputhen kërkesat e ligjeve me kushtet dhe specifikat në të cilat ndodhet kjo shoqëri. Shoqëria aktualisht ndodhet përpara një krize të mprehtë likuiditeti dhe që, thjeshtë të vazhdojnë punë (të mos falimentoj), do të duhet ndihmë urgjente shtetërore shtesë.

**a-** Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës, t’i kërkojnë në rrugë institucionale Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e monitoruesit dhe hartimit të politikave, që të ndërmarrin veprime ligjore, për korrigjimin e menjëhershëm të veprimtarisë së kësaj shoqërie, dhe konkretisht për subvencionin, të përputhen kërkesat e ligjeve me kushtet dhe specifikat në të cilat ndodhet kjo shoqëri.

**b-** Organet drejtuese të shoqërisë duhet analizojnë dhe të vlerësojnë arsyet e produktivitetit të ulët të veprimtarisë, efektin e çdo arsyeje të identifikuar, përfshirë një analizë e strukturës së flotës hekurudhore krahasuar me kërkesat e tregut duke përcaktuar numrin e lokomotivave dhe vagonëve të nevojshëm për nivelet koherente të aktivitetit.

**c-** Organet drejtuese të shoqërisë duhet të marrin masa për uljen e personelit. Duhet përcaktuar një politikë e qartë e shkurtimit vjetor të personelit gjatë tre-pesë viteve të ardhshme, me plan dhe afate të qarta për arritjen e niveleve mesatare të produktivitetit të personelit, si ato të hekurudhave fqinje, si Mali i Zi, Serbia Maqedonia, Kosova etj.. Kjo politikë duhet bazuar në një parashikim të kujdesshëm të nevojave e cili do të kërkojë përditësim të rregullt.

**d-** Ndarja e qartë e llogarive të njësisë së biznesit të mallit, njësisë së biznesit të udhëtarëve, njësisë së biznesit të menaxhimit të infrastrukturës dhe njësisë së shërbimit të mjeteve lëvizëse, duke u dhënë mundësi njësisve ta llogarisin produktivitetin e personelit në bazë të formulave

specifike për secilin aktivitet duke ofruar informacion më të saktë për vlerësimin e rezultateve të secilës njësi.

e-Transportuesit hekurudhor privatë të vihen në kushte të barabarta përsa i përket licensimit, çertifikatave të nevojshme sipas përcaktimeve ligjore, kapacitetit të mjeteve (lokomotiva dhe vagon), si gjendjes teknike të tyre duke u pajisur me dëshmitë përkatëse.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Me shkresën nr. 702/33 prot., datë 22.01.2020, Administratori i Shoqërisë i është drejtuar të gjithë njësite të shërbimeve dhe biznesit në lidhje me zbatimin e planit të masave mbi rekomandimet e lëna nga KLSH.

**Pika c** është zbatuar pasi nga organet drejtuese të shoqërisë janë marrë masa për uljen e personelit dhe me vendimin nr.2, datë 10.05.2022 janë miratuar ndryshimet e strukturave, duke ndryshuar numrin e fuqisë punëtore nga 992 me shkresën e datës 27.05.2022 bëhen 659 punonjës, pikat e tjera të lëna nga rekomandimet e KLSH-së nuk janë zbatuar.

#### **Statusi i rekomandimit: Zbatuar pjesërisht**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në shkresën nr.1313/11 prot., datë 18.06.2018 dhe vendimin nr. 50, datë 17.06.2018 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës i janë lënë për zbatim 23 masa organizative, 9 masa për shpërblim dëmi, 5 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike, për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike si dhe 16 masa disiplinore.

Nga 23 masa organizative të lëna për zbatim, janë pranuar 100% e tyre. Nga masat e rekomanduara 5 (21.7% ) janë zbatuar plotësisht dhe 18 ( 78.3%) janë në proces zbatimi.

Nga 9 masa për shpërblim dëmi, masa 4.1 dhe 4.2, janë revokuar nga Kryetari i KLSH me shkresën nr.1313/15 prot., datë 01.08.2018. Nga masat për shpërblim dëmi të rekomanduara, 2 masa (22.2%) në vlerën 14,223,134 lekë konsiderohen të zbatuara plotësisht, pasi çështjet janë pushuar nga Gjykata e Apelit Durrës, 5 masat e tjera në vlerën 8,473,988 lekë janë në proces zbatimi.

Nga 5 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike në vlerën 1,474,183,493 lekë, 2 masa (40%) në vlerën 1,230,000,000 lekë konsiderohen të zbatuara plotësisht, pasi çështjet janë pushuar nga Gjykata e Apelit Durrës, ndërsa 3 masa (60 %) në vlerën 1,474,183,493 lekë janë në proces zbatimi.

Nga 16 masa disiplinore të rekomanduara gjithsej, janë pranuar të gjitha dhe janë zbatuar plotësisht 100%.

Mos zbatimi i rekomandimeve sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c dhe ka shkaktuar mungesë eficientë në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për Shoqërinë Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës, si pasojë e mos korrektesës institucionale të organeve drejtuese të shoqërisë në zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi.

**Rekomandimi 2.1:** Nga Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimet kanë rezultuar të pazbatuara, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

**Qëndrimi i grupit të auditimit.** Nga verifikimet e kryera rezultoi se 13 masa janë të pa zbatuara dhe 3 janë në proces zbatimi.

#### **Statusi i rekomandimit: Proces zbatimi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Mos zbatim i rekomandimeve të KLSH, si dhe krijim provizione në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe aktet rregullatore në funksion të tyre, ardhur nga

diziformimi që i është bërë Administratorit të Shoqërisë dhe Këshillit Mbikëqyrës nga Sh.Xh., me detyrë Shef i Sektorit Juridik dhe nga A.H., me detyrë drejtues i njësisë ekonomike, për krijimin e provigjoneve për debitorët pa shpresë arkëtimi”, në vlerën 44,321,985 lekë. Konkretisht:

Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.21, datë 201.12.2018 dhe vendimi i Administratorit të Shoqërisë nr.14, datë 05.11.2018, për krijimin e provigjoneve të debitorëve pa shpresë arkëtimi, të trashëguar deri më 31.12.2017, është marrë mbi bazën e informacionit pa numër protokolli, datë 11.10.2018 i firmosur nga Sh. Xh., me detyrë shef i Sektorit Juridik dhe nga A.H., me detyrë drejtues i Njësisë Ekonomike.

Ky informacion është diziformues dhe i pa vërtetë (i rrem) për sa i përket: Zbatimit të procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës 24,280,462 lekë nga Kompania “K. G.”, Gjermani dhe Shoqëria “S. S.”, Shpk Durrës për arkëtimin e vlerës 20,041,523 lekë nga personi fizik jo tregtar Xh.Gj.

**Rekomandimi 3.2:** Nga Administratori i shoqërisë të ngrihet grup pune për të llogaritur **kamatat ligjore të arrira** që prej datës së fillimit të vonesës së debitorëve Xh.Gj **në vlerën 20,041,523 lekë** dhe kompania “K. G.”, Gjermani dhe “S S.”, shpk Durrës në vlerën **vlerën 24,280,462 lekë**, ndaj Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” Sh.a, në zbatim të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 450, vendimit unifikues të kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë 932/2000, të interpretuar me vendimin unifikues nr.40, datë 12.04.2002 (vendimi unifikues 40/2002), për të cilat Sh.Xh., me detyrë shef i Sektorit Juridik dhe A.H., me detyrë drejtues i Njësisë Ekonomike, duhet ti kishin llogaritur dhe dhënë informacion Administratorit të Shoqërisë dhe Këshillit Mbikëqyrës.

**Qëndrimi i grupit të auditimit.** NJSHML në lidhje me krijimin e provigjonit të subjektit Xh.Gj., kompania “K.G.”, Gjermani, “S.S.”, shpk, Durrës, theksojmë se veprimet kontabël janë kryer në llogarinë e HSH sha, por nuk janë kryer veprimet e vlerave të kamatave ligjore.

#### **Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**4. Gjetje nga auditimi:** Mos zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore nga transportuesit hekurudhor privat dhe shtetëror që operojnë në rrjetin hekurudhor në pronësi të Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a, si dhe mos mbikëqyrje e sigurt dhe efikase e Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor të kësaj veprimtarie. Konkretisht:

Për periudhën objekt auditimi në rrjetin hekurudhor pronë e Shoqërisë “Hekurudhës Shqiptare” sh.a, kanë ushtruar aktivitetin e tyre transportuesit hekurudhor: “B.C.”, shpk, A., Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sh.a si dhe po bëhet gati të filloj operatori “A”.

**Transportuesi hekurudhor “B. C.”, shpk:** Transportuesi hekurudhor “B.C.”, shpk i pajisur me leje veprimtarie të përkohshme nr.1 datë 18.07.2016 dhënë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Kjo leje nuk ka të përcaktuar afatin e vlefshmërisë, si dhe nuk ka të përcaktuar segmentin hekurudhor ku do të ushtrohet veprimtaria për mallra. Kjo leje nuk ndodhet e publikuar në QKB, “Në licencat e lëshuara jashtë QKB”.

Ky transportues hekurudhor nuk është i pajisur me licencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit), duke **ushtruar aktivitet të paligjshëm për një vit e pesë muaj (viti 2018-31.05.2019)**, pasi edhe pse, ligji nr.142/2016 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë”, ka hyrë në fuqi në Janar të vitit 2018, ende ky operator është i pa pajisur me licencë, veprim në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 ‘Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë’, ligjin nr.10081, datë 23.02.2009, ‘Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo ndërmjet Qendrës Kombëtare të

Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta' të ndryshuar, të VKM nr.657, datë 31.10.2018 "Për përcaktimin e autoritetit licencues hekurudhor" të Urdhrit të Ministrit nr.847, datë 07.12.2018 "Mbi procedurën e miratimit të licencave, nëpërmjet QKB" në veprimtarinë e nënkategorisë VII.6.1, Rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 "Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore" botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011.

-Vazhdimi i veprimtarisë së këtij transportuesi, mund të cenojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit, të plotësimit të standardeve dhe të kushteve teknike, pasi ky transportues;

- është i pa pajisur me certifikatë sigurie dhe autorizim sigurie nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, veprim në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 datë 22.12.2016 "Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë", neni 65 dhe 66 dhe rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot MIE) nr.2638, datë 10.06.2011 "Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore" botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011.

-për mjetet tërheqëse (lokomotivat) dhe të tërhequra (vagon hekurudhor) për gjendjen teknike të tyre nuk disponohet (është i pa pajisur) certifikatë riparimi (shërbimi) me afat vlefshmërie për të ushtruar veprimtarinë objekt të licencës, nga kompani riparuese e licencuar. Kjo certifikatë duhet të ishte e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Dokumentacioni i paraqitur nga kompania 16 F.dhe M., nuk konsiderohen dokumente të vlefshme për të vërtetuar gjendjen teknike të tyre për tu pranuar në transport hekurudhor.

Ky operator, ka paraqitur deklaratë nga Kompania 16 February Podgoricë me nr.50-54/572, datë 01.06.2016 për 21vagona dhe 2 lokomotiva, ku ndër të tjera në pikën 4 shprehet në mënyrë eksplicite se "*Riparimet e lokomotivave dhe shërbimet e tjera periodike janë kryer në ofiçinën e Kombinatit të Aluminit Podgoricë, ndërsa riparimi i fundit kapital i tyre është kryer gjithashtu në ofiçinën e kombinatit në vitin 2010*". Bëhet fjalë për lokomotiva të vitit 1987.

Pika 5 e kësaj deklarate shpreh në mënyrë eksplicite se: "*Riparimet e 21 vagonëve dhe shërbimet e tjera periodike janë kryer në ofiçinën e Kombinatit të Aluminit Podgoricë, ndërsa riparimet kapitale të sistemit kryesor të frenimit dhe shkarkimit janë bërë në vitin 2008 në ofiçinën G. REVOM d.o.o dobosnica në Bosnjë dhe Hercegovinë*". Bëhet fjalë për vagonë të TIPIT EAMO prodhuar në vitin 1976 në fabrikën Kaliningrad në Bashkimin e Republikave Sovjetike. Pra ky operator ka përfituar këtë leje të veprimtarisë për kryerjen e shërbimeve të transportit hekurudhor në Hekurudhën Shqiptare me vagon mbi 40 vite, si dhe për mjetet tërheqëse (lokomotivat) dhe të tërhequra (vagon hekurudhor) për gjendjen teknike të tyre nuk disponohet (është i pa pajisur) certifikatë riparimi (shërbimi) me afat vlefshmërie për të ushtruar veprimtarinë objekt të licencës, nga kompani riparuese e licencuar. Kjo certifikatë duhet të ishte e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Referuar inspektimeve që kjo drejtori ka kryer si dhe dokumentacionit të paraqitur nga Shoqëria "Hekurudha Shqiptare" sh.a, dhe nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, konstatohet se ky operator ka kryer dëmtime në rrjetin hekurudhor shqiptar në 3 raste me dëm të vlerësuar material në **vlerën 3,228,427 lekë**, për të cilat Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, është shprehur me vendimin nr.8, datë 18.04.2018, nr.9, datë 06.09.2018 dhe nr.11, datë 19.11.2018, vendime në të cilat nga kjo drejtori është ngarkuar me përgjegjësi operatori B., ndërsa dëmi është përcaktuar nga Shoqëria "Hekurudha Shqiptare" sh.a, Durrës respektivisht në vlerat 936,742 lekë, 987,368 lekë dhe 1,304,317 lekë.

**Transportuesi Hekurudhor Albametal:** Transportuesi Hekurudhor "A", i pajisur me licencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit) me nr.L..... datë

26.12.2018, pa afat, në segmentin hekurudhor Bajz- Durrës dhe Durrës-Elbasan me objekt transport i mallrave. Kjo leje është dhënë në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë” neni 18,19, 20,21 dhe rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore”, botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011, pasi nuk disponon mjetet tërheqëse (lokomotivat). Me kërkesë nr.48 prot., datë 19.07.2019 drejtuar B. B., Ministre e MIE, A. D., Ministre e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a, dhe A. D. me detyrë Administrator i shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a, ky operator ka kërkuar që të ushtrojë aktivitet të veprimtarisë transportuese hekurudhore në rrjetin hekurudhor shqiptar, pasi këtij operatori i është refuzuar kryerja e këtij aktiviteti, nga mos dhënia me qira e mjeteve tërheqëse, lokomotivave.

Ndërmjet këtij operatori dhe Shoqërisë “Hekurudhës Shqiptare” sh.a, nuk ka një kontratë të lidhur mes dy palëve për transportin në hekurudhë të mallrave në segmentin hekurudhor Bajz-Durrës dhe Durrës-Elbasan referuar licencës së dhënë.

Po nga ky operator, nuk disponohet (është i pa pajisur), certifikatë sigurie, veprim në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë”, neni 65 dhe rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhor”, botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011. Theksojmë se çertifikata e sigurisë, lëshohet nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor bazuar në aktet ligjore, nënligjore dhe rregulloret në fuqi (referenca neni 65 i Kodit Hekurudhor).

Për mjetet e tërhequra (vagon hekurudhor) ky operator ka paraqitur kontratë qiraje me kompaninë N. N. S. më datë 11 tetor 2018 për 15 vagonë të cilët për gjendjen teknike të tyre nuk është paraqitur certifikatë riparimi (shërbimi) me afat vlefshmërie për të ushtuar veprimtarinë objekt të licencës, nga kompani riparuese e licencuar. Kjo certifikatë duhet të jetë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Me procesverbal të datës 12.06.2019. të mbajtur nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor Durrës, është kryer kontrolli i gjendjes teknike të vagonëve në gjendje statike. Në këtë procesverbal është lënë detyrë që 14 vagonët duhet të testohen edhe në gjendje lëvizëse.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk mund të provohet/vërtetohet se këto vagonë plotësojnë standardet e lëvizjes pa rrezik në rrjetin hekurudhor Shqiptar.

**Transportuesi hekurudhor A.:** Operatori A., i pajisur me licencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit) me nr. LN-6425-12-2018 datë 26.12.2018, pa afat, në segmentin Fier-Vlorë, Fier-Ballsh me objekt transport i mallrave dhe udhëtareve. Kjo licencë është dhënë në kundërshtim me ligjin nr.142/2016 datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës të Shqipërisë” neni 18,19, 20,21 dhe rregulloren e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë) nr.2638, datë 10.06.2011 “Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore” botuar në fletoren zyrtare nr.96 datë 20.07.2011, pasi:

Për 23 mjete tërheqëse vagonë ky operator, ka kontratë qiramarrje nr.39018 lidhur datë 26.02.2019 me kompaninë G. R.A. për 23 vagonë të tipit GATX 1465 cisternë për transport të naftës bruto, ky dokument është i fotokopjuar e noterizuar nga noter A. M., me vulë të njomë por pa vulë të thatë, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë nr.6291, datë 17.8.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 4 ku është shprehur në mënyrë

eksplicite se "Çdo njësi e vërtetuar që i jepet të tretit, lidhet me vulë të njomë me një njësi të dokumentit me nënshkrim të vërtetuar, nënshkruhet, vuloset me vulën e thatë pranë emrit të noterit dhe me vulën e njomë mbi pullat e taksës në vlerën përkatëse të tyre."

Për mos zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore nga transportuesit hekurudhor privat që operojnë në rrjetin hekurudhor në pronësi të Shoqërisë "Hekurudha Shqiptare" sh.a, me risk të lart se vazhdimi i veprimtarisë mund të cenojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit, të plotësimit të standardeve dhe të kushteve teknike, që vjen nga mos mbikëqyrja e sigurt dhe efikase e Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor të kësaj veprimtarie, ngarkohet me përgjegjësi A.A., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor.

**Rekomandimi 4.1:** Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të zbatohen procedurat ligjore për pezullimin e lejes së veprimtarisë të përkohshme nr.1 datë 18.07.2016 për transportuesin hekurudhor "B.C.," shpk dhënë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, pasi ende ky operator është i pa pajisur me licencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit), duke ushtruar aktivitet të paligjshëm për një vit e pesë muaj (viti 2018-31.05.2019) dhe vazhdimi i veprimtarisë pa certifikatë sigurie dhe autorizim sigurie mund të cenojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit.** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk e ka pranuar rekomandimin e KLSH-së pa dhënë asnjë arsye.

**Statusi rekomandimit: Pa pranuar**

**Rekomandimi 4.2:** Shoqëria "Hekurudha Shqiptare" Sh.a të pezullojë lidhjen e kontratës për përdorimin e vijës hekurudhore për vitin 2020 me transportuesin hekurudhor "B.C.," shpk, deri në pajisjen e tij me licencë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit), si dhe pajisjen me certifikatë sigurie dhe autorizim sigurie nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në shkresën me nr.383/1 prot datë 11.06.2020 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, drejtuar Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor është dërguar një kopje e kontratës së lidhur ndërmjet HSH sha dhe transportuesit hekurudhor "B.", si dhe kontratën e lidhur me nr. 254/1, datë 25.02.2020, në kundërshtim me rekomandimet e KLSH, fakt ky që tregon se nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga HSH sha.

**Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**5. Gjetje nga auditimi:** Në 2 procedura prokurimi për vlerën 22,330 mijë lekë, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë shoqëria, si dhe manualet teknike në fuqi, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59, pika 2.

- Për 7 procedura prokurimi për vlerën 63,946 mijë lekë, në urdhrat e prokurimit nuk janë përcaktuar emrat e njësisë së prokurimit, por është cilësuar, ngarkohet njësia e prokurimit pranë Hekurudhës Shqiptare sh.a Durrës, për zbatimin e këtij urdhri, në kundërshtim me VKM nr.914 date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 60 "Urdhri i prokurimit".

- Për 4 procedura prokurimi për vlerën 46,713 mijë lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

- Në 3 procedura prokurimi për vlerën 40,047 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar, ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

- Në 3 raste për vlerën 34,169 mijë lekë, anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 73, pika 2. Në opinionin e grupit të auditimit, arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

- Në 3 raste për vlerën 1,790,556 lekë është krijuar dëm ekonomik, nga zbatimi i kontratave për punë publike dhe i mallrave, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: “1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”, Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

**Rekomandimi 5.1:** Për mbrojtur interesat publike, duke siguruar se fondet publike shpenzohen në mënyrë të duhur, të besueshme dhe efikase, me konkurrencë dhe transparencë në prokurimet publike, si dhe për të siguruar, që të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike të trajtohen në mënyrë të drejtë, nga zyra, ose personat e ngarkuar nga Administratori i Shoqërisë:

- Përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si një operacion mjaftë i vështirë dhe në të njëjtën kohë mjaftë i rëndësishëm, për shkak se zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, do të varet përkatësisht nga përcaktimi i kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike. Pikërisht për këtë arsye, duhet zbatuar me rigorozitet legjislacioni i posaçëm për këtë procedurë specifike, kjo edhe për të mënjnauar shmangien nga rregullat e prokurimit nëpërmjet ndarjes apo pjesëtimit të vlerës së kontratave të prokurimit publik.

- Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë. Kërkesat/specifikimet teknike duhet të jenë të shkruara në mënyrë të tillë që të argumentohet nevoja që dikton vendosjen e këtyre kriterëve, duke parandaluar në këtë mënyrë para përzgjedhjen paraprake të kandidatit fitues, në zbatim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik.

- Nga titullari i Autoritetit Kontraktor, ose zyrtari i deleguar prej Tij, për çdo procedurë, urdhrat e prokurimit të përcaktojnë specifikisht emrat e njësisë së prokurimit.

- Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të



operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.

- Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

**Qëndrimi i grupit të auditimit.** Nga auditimi i kryer rezulton se vijojnë të njëjta problematika.

#### **Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga analizimi i dokumenteve ligjore me të cilët është rregulluar veprimtaria e Këshillit Mbikëqyrës të “Hekurudhës Shqiptare” sh.a, Durrës për periudhën objekt auditimi u konstatua se ato nuk janë të harmonizuara dhe të bashkërenduara nga pikëpamja juridike, konkretisht përsa i përket mbledhjes së këshillit, zgjedhjes së kryetarit dhe zv/kryetarit dhe shpërblimit të këshillit.

Në statut neni 9 përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zv/kryetar ndërsa në udhëzim nr.318 datë 08.04.2009 të Ministrit të ish-METE, i cili ka qenë në fuqi për periudhën objekt auditimi, kryetari i këshillit zgjidhet me propozim të Ministrit, neni 10.1 i statutit të shoqërisë përcakton se Këshilli Mbikëqyrës mblidhet sa herë e kërkon interesi i shoqërisë, por jo më pak se 2 herë në vit, ndërsa në VKM nr.642 datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore”, i ndryshuar, pika 8, dhe VKM nr.570, datë 03.10.2018 pika 9, përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës mblidhet jo më pak se katër herë në vit dhe i raporton për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë, institucionit administrativ të linjës dhe përfaqësuesit të pronarit, për pronën shtetërore, jo më pak se 4 (katër) herë në vit, neni 12 i statutit për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës bazohet në VKM nr.642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore” i ndryshuar, i cili aktualisht është i shfuqizuar dhe statuti duhet t’i referohet VKM nr.570 datë 03.10.2018 në nenin 11. Pika 4 të statutit, nuk ka një rregullore të organizimit dhe funksionimit të veprimtarisë së këshillit.

-Statuti i shoqërisë neni 8.2 përcakton se kohëzgjatja e anëtarëve të KM është tre vjet me të drejtë rizgjedhjeje, nga auditimi u konstatua se dy prej anëtarëve të këshillit e kanë mbaruar afatin 3 vjeçar por, nuk ka asnjë shkresë nga Ministria për rizgjedhjen e tyre, konkretisht K. M., emëruar në datë 01.07.2015 dhe Th. Xh., emëruar në 01.07.2016. Gjithashtu edhe A.Sh., anëtarë tjetër i Këshillit Mbikëqyrës ka paraqitur dorëheqjen gjatë fazës së auditimit nga grupi në subjekt, situatë kjo e cila ndikon në kuorumin e organit kolegjal.

-Këshilli Mbikëqyrës nuk ka zgjedhur zv/kryetarin, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr.318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreut II, pika 5 (i cili ka qenë në fuqi për periudhën objekt auditimi) dhe statutit të shoqërisë neni 9 pika 9.1, ku përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zv/kryetar. Sipas statutit nenit 9.3 dhe 10.1, këshilli mblidhet me kërkesë të kryetarit ose në mungesë të tij të zv/kryetarit. Zgjedhja e zv/ kryetarit do të ishte me rëndësi për mos pengimin e punës në raste kur për arsye të ndryshme mungon kryetari dhe mbledhja e këshillit nuk ka si të thirret dhe si të drejtohen diskutimet ose edhe në rastet kur kryetari pengon zhvillimin e saj.

**Rekomandime 6.1:** Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës/ kryetari të njoftojë Ministrinë e Financave dhe të kërkojë zgjidhjen sa më të shpejtë të situatës së krijuar në organin kolegjal të shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a dhe më pas të zgjedh

ndërmjet anëtarëve të tij dhe një zv/kryetar në mënyrë që të vazhdojë funksionimi normal i tij duke e kthyer në gjendje të ligjshme dhe duke shmangur pengimin e punës në rastet kur nuk mund të jetë kryetari.

**Qëndrimi i grupit të auditimit.** Nga verifikimet e kryera rekomandimi i lëna nga KLSH-ja nuk është zbatuar.

**Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**Rekomandimi 6.2:** Këshilli Mbikëqyrës (KM) i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës të marrë masa për implementimin dhe harmonizimin e të gjitha ndryshimeve të bazës ligjore për funksionimin e këshillave mbikëqyrës të shoqërive aksionare me statutin e shoqërisë, si dhe të hartojë një rregullore për funksionimin e tij me qëllim mbarëvajtjen e punës duke përcaktuar qartë detyrat funksionale të këshillit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit.** Nga verifikimet e kryera rekomandimi i lëna nga KLSH-ja nuk është zbatuar.

**Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**7. Gjetje nga auditimi:** Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.12 datë 04.12.2017 është emëruar Administrator i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a, A.D., Emërimi i Administratorit të shoqërisë është bërë sipas propozimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.17516 prot., datë 04.12.2017. Nga auditimi u konstatua se Këshilli Mbikëqyrës nuk ka lidhur kontratë me Administratorin e “Hekurudha Shqiptare” sh.a , veprim në kundërshtim me nenin 21, pika 4, të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe statutin e shoqërisë neni 11, pika i, ku përcaktohet se me emërimin e administratorit të shoqërisë, këshilli lidh kontratë me të për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë.

**Rekomandimi 7.1:** Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës të marrë masa për të rregulluar marrëdhënien juridike të punës me administratorin e shoqërisë duke lidhur kontratë me të për periudhën e mbetur të emërimit, me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve mbështetur në interesat e ligjshëm të shoqërisë.

**Qëndrimi i grupit të auditimit.** Nga verifikimet e kryera nga ana jonë rekomandimet e lëna nga KLSH-ja nuk janë zbatuar.

**Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**9. Gjetje nga auditimi.** Në Hekurudhën Shqiptare sh.a konstatohet një planifikim dhe realizim jo i duhur i programit ekonomik. Qëllimi i programit ekonomik në përgjithësi është arritja e synimeve të Shoqërisë sipas prioriteteve të saj. Për vitin 2018 sipas analizave të treguesve të buxhetit, realizimi i të ardhurave në raport me planin e të ardhurave, është në masën 93.2 %. Përkundër angazhimit të kësaj shoqërie, për uljen e shpenzimeve dhe rritjen e të ardhurave, performanca e treguesve ekonomik-financiar që lidhen me realizimin e buxhetit faktik të shoqërisë, nuk është aspak e kënaqshme dhe ka vend të përmirësohet. Në Shoqërinë Hekurudha Shqiptare sh.a për çdo lekë të shpenzuar në vitin 2017 është përfutur një e ardhur prej 0.69 lekë, në vitin 2018 për çdo lekë të shpenzuar është përfutur një e ardhur prej 0.58 leke. Për vitin 2019 për pesëmujorin e parë të vitit për çdo lekë të shpenzuar është përfutur një e ardhur prej 0.53 lekë. Pra siç vërehet për vitin 2018 ka një ulje 0.11 lekë nga viti paraardhës 2017, ndërsa për pesëmujorin e parë të vitit 2019 ka një zvogëlim me 0.05 lekë nga viti 2018. Risku bazë para të cilit ndodhet Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a është risku i gjendjes të pamjaftueshme të likuiditeteve. Një kompani me aftësi pagueuse është ajo që zotëron më shumë se sa u detyrohet të tjerëve, me vlerë neto pozitive e borxh të menaxhueshëm. Raporti i detyrimeve afat

shkurtër/kapitalit për vitin 2018, paraqitet 1.4 % (1.148.514 mijë detyrime /81.895.037 mijë lekë) me tendencë rritje për vitin 2019. Në qoftë se shoqëria do të llogariste penalitetin e hekurudhave të huaja si dhe nuk do të çelej subvecion nga buxheti i shtetit për vitin 2016, 2017, 2018 dhe për vitin 2019 në vlerat respektive 390.000 mijë lekë, 400.000 mijë lekë, 400.000 mijë lekë, do të çonte në rezultat negativ akoma më të lartë për vitet ushtrimore. Duke zbritur nga pasqyrat financiare subvencionin si e ardhur, raporti të ardhura/shpenzime do të ndryshojë duke thelluar në mënyrë të ndjeshme rezultatin financiar (humbje).

**Rekomandimi 9.1:** Nga ana e organeve drejtuese duhet të bëhet një analizë e detajuar e investimeve kapitale dhe shpenzimeve, etj të planifikuara për tu realizuar gjatë vitit dhe të merren veprimet e nevojshme që këto projekte të realizohen sipas programit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga ana e organeve drejtuese nuk është kryer asnjë analizë e investimeve kapitale dhe shpenzimeve.

#### **Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**10. Gjetje nga auditimi:** Niveli i pagave për vitin 2018 është miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.1, datë 02.02.2018, ku niveli i pagave është grupuar në tre nivele nga një deri në shtatë vjet, shtatë deri në dhjetë vjet dhe mbi pesëmbëdhjetë vjet por, *ky nivel nuk është miratuar nga Ministra e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit (aksionerit të vetëm).* E njëjta situatë ka vazhduar edhe në vitin 2019, ku me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.7, datë 08.05.2019, janë miratuar tabelat e pagave për punonjësit e Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës paraqitur nga Administratori i Shoqërisë, duke filluar nga data 01.05.2019. Veprim ky në kundërshtim me ligjin nr.10405 datë 24/03/2011, neni 6, pika 1 dhe pika 2 gërma a, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “*Për ndërmarrjet shtetërore veprimtaria e të cilave është me humbje ose që subvencionohen nga shteti, Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit përkatës dhe të Ministrit të Financave, miraton me akte të veçanta nivelin e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të tyre*”. Mos miratimi i nivelit të pagave për vitin 2018 dhe 2019 nga Ministra e Financave dhe Ekonomisë ngarkon me përgjegjësi Këshillin Mbikëqyrës dhe në veçanti P.Sh., anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për periudhën nga 01.01.2018-01.03.2018, B.A. anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për periudhën 01.03.2019-31.05.2019, si përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Theksojmë se Ministria e Financave dhe Ekonomisë është aksioneri i vetëm (Pronari) i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës.

Mos miratimi i nivelit të pagave për vitin 2018 dhe 2019 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ngarkon me përgjegjësi Këshillin Mbikëqyrës dhe në veçanti T.B., në cilësinë e kryetares së Këshillit Mbikëqyrës për periudhën 21.03.2018-31.05.2019, si përfaqësuese e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila është në detyrën e drejtorit të Drejtorisë së Partneritetit Publik Privat në këtë Ministri. Theksojmë se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për Shoqërinë “Hekurudha Shqiptare”, është Ministria e Linjës që monitoron në mënyrë të vazhdueshme këtë shoqëri.

**Rekomandime 10.1:** Nga organet drejtuese të shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës të ri kërkohet miratimi i nivelit të pagave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria Ekonomisë dhe Financës.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Administratori i Shoqërisë HSH sha, ka nxjerrë urdhrin nr.39 prot., datë 25.02.2020, për studimin e pagave, me Vendimin nr.7, datë 01.12.2022, është dërguar edhe relacioni “Për rritjen e pagave” Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë me nr.1034/2 prot datë 01.12.2022, por nuk është miratuar nga MIE.

#### **Statusi i rekomandimit: Në proces**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi në zbatimin e strukturës organizative, në marrëdhëniet e punës dhe në dhënien e pagave dhe shpërblimeve është konstatuar se punonjësit e larguar nga puna kanë hapur procese gjyqësore ligjore për të cilat janë marrë 11 vendime të formës së prerë në vitet 2018, 5-mujori 2019 me vlerë të efektit negativ financiar në shumën 10,953,875 lekë. Ndërsa 20 çështje të tjera janë në proces dhe vazhdojnë shkallët e gjykimit, fakt i cili riskon ta rëndojë akoma më tej situatën financiare të shoqërisë në të ardhmen nqs këto procese do të fitohen nga ish-punonjësit.

**Rekomandimi 13.1:** Për çështje gjyqësore të hapura në vitet e kaluara me punonjës të larguar, për të cilat konfirmohet se janë çështje të humbura Administratori i shoqërisë dhe Këshilli Mbikëqyrës të njohë provizionet për të gjitha vendimet gjyqësore si ngjarje detyruese të ndodhur para datës së raportimit, për të cilat është e nevojshme që ajo të krijojë një detyrim ligjor ose konstruktiv për shoqërinë dhe nuk ka asnjë alternativë tjetër për shmangien e këtij detyrimi, përveç shlyerjes së tij (Referenca ligjore SKK6).

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Për të gjitha veprimet e formës së prerë të dhëna nga gjykatat, janë duke u likuiduar detyrimet edhe pse HSH sha është në vështirësi likuiditeti, për punonjësit e larguar janë lidhur marrëveshje për shlyerjen e detyrimit.

#### **Statusi i rekomandimit: Në proces zbatimi**

**14. Gjetje nga auditimi:** Shpenzimet e shoqërisë janë rënduar nga vendimet gjyqësore, si pasojë e mos likuidimeve në kohë të faturave ndaj kreditorëve në 1 rast për vlerën 1,655,413 lekë, si dhe për s'kualifikim të padrejtë në një procedurë prokurimi në vlerën 3,988,638 lekë në vitin 2012, i marr në zbatim të KPP. Shoqëria ka paguar penalitete për mos likuidim në kohë të faturës (detyrimeve), ndaj operatorit ekonomik "S.", i cili e ka fituar këtë të drejtë me Vendim Gjykatë të Rrethit Gjyqësor Durrës nr.111, datë 29.01.2018 ku shuma e interesave ligjorë është 1,655,413 lekë.

Po me Vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr.946, datë 26.05.2015, shoqëria është penalizuar në vlerën 3,988,638 lekë për s'kualifikim të padrejtë në një procedurë prokurimi të kryer në vitin 2012, me fond limit 35,000,000 lekë, në të cilën Operatori ekonomik "S.", Shpk., është shpallur fitues në fazën e parë të vlerësimit të ofertave. Më pas është bërë ankesë nga operatori "Z.", në KPP, i cili e ka s'kualifikuar padrejtësisht OE "S.", duke shpallur fitues "Z." Ky vendim i KPP-së, është ankimuar nga operatori "S.", më pas në shkallët e tjera të Gjykimit, i cili ka fituar një dëmshpërblim në shumën 3,988,638 lekë për s'kualifikim të padrejtë.

**Rekomandimi 14.1:** Nga Administratori i shoqërisë dhe njësia ekonomike, të merren masat që faturat e kreditorëve të likuidohen mbi bazën e kriterit të maturimit kronologjik, duke i trajtuar të gjithë kreditorët në mënyrë të drejtë, duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

**Qëndrimi i grupit të auditimit.:** Nga mungesa e fondeve që ka HSH sha, detyrimet vazhdojnë të jenë në vlera të konsiderueshme.

#### **Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**18. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, huatë afatgjata dhe huat e tjera afatgjata paraqiten në vlerën 1,258,197 mijë lekë. Në këtë shumë Shoqëria nuk ka përfshirë shumat për interesa dhe kamatëvonesa të arritura sipas marrëveshjeve të huave. Siç përmendet në shënimin nr.11, Shoqëria ka njohur në vitin 2000 provizionet afatgjata në vlerën 237,250 mijë lekë, që lidhen drejtpërdrejt me detyrimet e mundshme të huave dhe detyrimeve. Për më tepër, në lidhje me detyrimin ndaj hekurudhave të huaja, bazuar në shkresën me numër protokollit 505 të paraqitur nga shoqëria, pretendimet aktuale nga hekurudhat e huaja përveç shumës së principalit, janë 1,140,580 mijë lekë. Duke marrë në konsideratë shumën e penaliteteve të pallogaritura, pretendimet e hekurudhave të huaja dhe kostot potenciale për

zgjdhjen e marrëveshjeve, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë mbi shumën e nevojshme të provizioneve shtesë që duhet të krijohen dhe efektet që kjo do të kishte në pasqyrat financiare. Kjo ka ardhur si pasojë e mungesës një rregulloreje për provizione si dhe mungesa e një analize për vjetërsinë dhe vlerësimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta, çka mund të ketë ndikim në rritjen e rrezikut për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, dhe marrjen e vendimeve të gabuara lidhur me to.

**Rekomandimi 18.1:** Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë duhet të ndërmerren veprimet e nevojshme për hartimin e një rregulloreje për trajtimin e provizioneve dhe borxheve të këqija të bazuar në politika të qarta dhe në harmoni me Standardet e kontabilitetit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë nuk kanë marrë asnjë masë për hartimin e një rregulloreje për trajtimin e provizioneve dhe borxheve të këqija bazuar në standardet e kontabilitetit.

#### **Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**19. Gjetje nga auditimi:** Gjendja debitore dhe kreditore është në shifra shqetësuese për Shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës. Megjithatë nga organet drejtuese të saj nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre.

Konkretisht gjendja debitore për vitin 2018 është në vlerën 382,798,300 lekë. Peshën kryesore të llogarive të arkëtueshme, në masën 34% për vitin 2018, e zënë kërkesat e arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit në vlerën 47,823,005 lekë dhe Tvsh me saldo debitore në vlerën 53,242,511 lekë. Nga verifikimi i llogarisë 411000 në kontabilitet për vitin 2018, kjo gjendje paraqitet në vlerën 47,823,005 lekë. Ndërsa gjendja kreditore është në vlerën 1,148,514,060 lekë. Duke iu referuar të ardhurave dhe shpenzimeve, gjendja debitore zë 18 % të të ardhurave për vitin 2017 dhe 18% për vitin 2018, ndërsa gjendja kreditore zë 32% të shpenzimeve për vitin 2017 dhe 55% për vitin 2018.

**Rekomandimi 19.1:** Organet Drejtuese të Shoqërisë HSH sha (Administratori, Këshilli Mbikëqyrës, Asambleja e Përgjithshme) të marrin masa për analizimin, shqyrtimin dhe reduktimin e humbjeve të shoqërisë.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë nuk kanë ndërmarrë asnjë masë për analizimin, shqyrtimin dhe reduktimin e humbjeve të shoqërisë.

#### **Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**21. Gjetje nga auditimi:** Hekurudha Shqiptare sh.a, në sistemin kontabël që përdor përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarive të njësisive ekonomike nuk përdor bartësit informatikë duke shfaqur rritje të riskut të gabimeve si dhe të vështirësive për monitorim të sistemit, mungesën e të dhënave financiare në kohë reale për t’u reflektuar në vendim-marrjen e organeve drejtuese të shoqërisë.

**Rekomandimi 21.1:** Nga ana e shoqërisë të merren masa që në sistemin e saj kontabël, evidence mbështetëse, dokumentet bazë, dokumentet plotësues dhe regjistrat kontabël, të implementojë bartësit informatikë që janë autorizuar nga organet përkatëse, të shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pa-manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në zbatim të shkresës nr. 702/33 prot., datë 22.01.2020, pika 7, të Njesisë Ekonomike, njësitë e HSH sha, janë urdhëruar që deri në vendosjen e **programit informatik** të aplikojnë me korrektësi dhe saktësi programin Excel pa programet e posaçme ekonomike të rekomanduara nga KLSH<sup>ja</sup>.

#### **Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**23. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, aktivet afatgjata materiale paraqiten në vlerën 84,156,200 mijë lekë (2017: 84,941,444 mijë lekë), Shoqëria ka zgjedhur modelin e rivlerësimit për të matur vlerën e aktiveve të veta. Aktivet afatgjata materiale, sipas politikave kontabël mbeten me vlerën e drejtë duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. SKK 5 “Aktive Afatgjata Materiale dhe jo materiale” kërkon që nëse një kompani zgjedh modelin e rivlerësimit për matjen e aktiveve me vlerën e drejtë, atëherë rivlerësimi i aktiveve duhet të kryhet rregullisht, në mënyrë që vlera kontabël të mos ndryshojë materialisht nga vlera që do të rezultonte nëse vlerësimi i AAM-ve do të kryhej në datën e raportimit. Rivlerësimi më i fundit i aktiveve të shoqërisë daton në vitin 2013; 5 vjet më parë dhe normat e amortizimit të aplikuara nga shoqëria gjatë 2018 janë ato të miratuara me vendimin e këshillit mbikëqyrës nr. 24, datë 18.12.2006 të 11 viteve më parë. SKK 5 kërkon kryerjen e një testi zhvlerësimi në datën e mbylljes së bilancit për aktivet që tregojnë shenja të rënies së vlerës, e cila nuk është kryer nga shoqëria. Grupi i auditimit nuk ka qenë në gjendje të përcaktojë efektet që ky vlerësim do të kishte në pasqyrat financiare. Aktualisht Shoqëria është në proces rivlerësimi të aktiveve, kjo sipas vendimit të Asamblesë së Aksionarit me nr.120 datë 11.10.2018. Sipas kontratës së lidhur me grupin e eksperteve të miratuar për këtë qëllim, procedura e rivlerësimit pritet të përfundojë brenda vitit 2019. Veprime në mospërputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nr.5 “Aktive Afatgjata Materiale dhe jo materiale”, Ligjin nr.33/2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, i ndryshuar.

**Rekomandimi 23.1:** Nga Shoqëria të merren masa që pasuritë e patundshme troje dhe ndërtesa të mbështeten plotësisht në dokumente pronësie, duke sjellë në këtë mënyrë, paraqitje të plotë dhe të saktë të vlerës së trullit në pasqyrat financiare.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Aktualisht HSH sha, është duke përgatitur fillimin e kësaj procedure për krijimin dhe sigurimin e fondit si dhe ka filluar korrespondenca me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Durrës. Në PBA 2023-2024 është planifikuar që do të kryhet kjo procedurë me qëllim regjistrimin e pasurisë.

**Statusi i rekomandimit: Zbatuar pjesërisht**

**24. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi u konstatua se nga Shoqëria “Hekurudha Shqiptare ” sh.a Durrës, asetet nuk janë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

**Rekomandimi 24.1:** Nga Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, në zbatim të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Ka filluar korrespondenca me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Durrës, zë i cila është parashikuar dhe në PBA 2023-2025, dërguar me shkresën nr.560/1, prot datë 30.12.2022. Gjatë kësaj kohe HSH sha, ka realizuar regjistrimin e pasurive të paluajtshme në 4 prona me certifikatat:

- me nr.115074, ZK nr. 8514, Durrës, lloji i pasurisë ndërtesë;
- me nr. 115073; ZK nr. 8514, Durrës lloji pasurisë garazh;
- me nr.1982083, ZK nr. 8518, Durrës, lloji pasurisë trull;
- me nr. 1827456 ZK nr. 8518, Durrës, lloji pronës ndërtesë.

**Statusi i rekomandimit: Zbatuar pjesërisht**

**25. Gjetje nga auditimi:** Menaxhimi financiar dhe kontrolli, kanë të bëjë me forcimin e performancës së shoqërisë që të marrë vendime më të mira, të jap shërbime më të mira dhe të japë vlerë më të mirë për paranë. Për të arritur këtë, MFK synon që menaxhmenti i kësaj

Shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas planit të biznesit.

Kontrollet mbi të ardhurat në përgjithësi janë korrekte dhe janë zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve, kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë.

Dobësitë e identifikuar në fushën e shpenzimeve kanë të bëjnë me regjistrimin e shpenzimeve jo në përputhje me legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollit dhe kontabilitetin, pranimin me dokumentacion justifikues jo të plotë, si psh harxhimin e karburantit për shkak të makinerive të vjetra apo kujdesit jo të duhur nga personeli, procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave, dëmshpërblimet nga zgjidhjet e pa arsyeshme të kontratave të punësimit, transportit të mallrave dhe mungesën e një rregulloreje për provizione etj.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, nuk ka ndërmarr *aktivitete shitesë* për të forcuar kontrollet në raportimin menaxherial, llogaridhënie dhe menaxhim të rrezikut, pasi.

- Gjurmët e auditimit nuk janë hartuar, miratuar dhe arkivuar nga çdo njësi biznesi.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik, funksionon në nivel Drejtorie, por jo për çdo njësi biznesi, si dhe regjistri i riskut nuk është hartuar nga çdo njësi biznesi.

- Struktura organizative ka nevojë për përmirësim. Sektorët nuk janë organizuar në përputhje me natyrën e punës edhe efektivitetin e saj. Ka struktura të tepërta që duhet të suprimohen.

-Motivimi në punë nuk është bërë sipas shkallës së vështirësisë së pozicionit të punës dhe kontributit të secilit punonjës.

-Niveli i pagave nuk është miratuar nga Ministria Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e ministrisë pronare, dhe janar-maj 2019 me vendimin nr.7 datë 08/05/2019 i cili përsëri nuk është miratuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e pronarit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10405 datë 24/03/2011, neni 6, pika 2 gërma a.

-Kontabiliteti i njësisë mbahet në mënyrë manuale dhe nuk është përfshirë në mbajtjen e evidencës kontabël në programe financiare elektronike. Organizimi i një sistemi të tillë pengon përdorimin e informacionit në kohën e duhur për çështje të vendimmarrjes dhe gjurmës së auditimit, si dhe nga ana tjetër rrit riskun e gabimeve gjatë mbartjes në regjistra fizike.

-Regjistrat themeltarë të aktiveve nuk janë hartuar nga çdo njësi.

**Rekomandimi 25.1:** Për forcimin e performancës së shoqërisë, duke siguruar se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas planit të biznesit, që menaxhmenti i kësaj Shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të marr masa për:

- Funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik si në nivel të Drejtorie, ashtu edhe për çdo njësi biznesi.

-Të hartuar, regjistrin e riskut nga çdo njësi biznesi, si dhe miratuar dhe arshivuar gjurmët e auditimit nga çdo njësi biznesi.

- Përmirësim e strukturës organizative, ku sektorët të organizohen në përputhje me natyrën e punës edhe efektivitetin e saj, të suprimohen strukturat e tepërta, si dhe klasifikimi i punonjësve, përveçese të lidhet ngushtësisht me detyrat që i ngarkohen secilit të emëruar sipas pozicionit

përkatës, por dhe me masën e shpërblimit, pasi ky është dhe qëllimi i klasifikimit, pasi pozicioni i punës përbën një shërbim ose punë që kryhet kundrejt pagës së merituar.

- Shpenzimet e karburantit të mos administrohen nga NjBU, por të krijohet një strukturë e veçantë nën varësinë e Njësisë Ekonomike, e cila të merret me llogaritjen e nevojave për karburant, ndjekjen e kontratës, magazinimin, shpërndarjen, zberthimin e grafikut të lëvizjes dhe dokumentimin e tij, kontrollin e konsumit sipas normativave etj.

- Të rishikohet niveli i pagës së sektorit të Auditit të Brendshëm, duke e konsideruar si niveli më i lartë i specialistëve dhe të shpërblehet në pagë si i tillë për vetë natyrën dhe vështirësinë e punës që bëjnë. Ky sektor auditon punën e Drejtuesve të Njësisë, shefave të sektorëve etj, por pagesa e tyre është shumë më e ulët se paga e personave që auditojnë.

-Regjistrat themeltarë të aktiveve duhet të hartohen nga çdo njësi, si dhe të merren masa për marrjen në dorëzim, inventarizimin dhe daljen nga përdorimi të aktiveve.

**Qëndrimi i grupit të auditimit** : Regjistri i Riskut dhe plani i masave është realizuar nga të gjitha njësitë e HSH sha si dhe është përcjellë zyrtarisht në MIE, regjistrat e aktiveve elektronikisht dhe fizikisht janë hartuar dhe përditësohen periodikisht. Gjithashtu është dërguar zyrtarisht në MIE me shkresën me nr.39/2 prot, datë 10.02.2020, është bërë përmirësimi i strukturës organizative ku sektorët organizohen në përputhje me natyrën e punës, ligjit për ndarjen e HSH dhe efektivitetin e saj, me Vendimin nr.2, datë 10.02.2022, të Administratorit të Shoqërisë dhe Vendimit nr.4, datë 27.02.2022 të KM është bërë ristrukturimi i Shoqërisë.

#### **Statusi i rekomandimit: Zbatuar pjesërisht**

**27. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatuar mos likuidimi në kohë i detyrimeve për kohë qëndrimin e vagonëve të huaja, i cili është bërë një problem shqetësues dhe me pasoja për Hekurudhën Shqiptare. Në këtë vlerë nuk janë përfshirë penaltetet për mos likuidim në kohë të detyrimeve që Hekurudha Shqiptare, ka ndaj hekurudhave të tjera, për përdorimin e vagonëve. Janë kontabilizuar vetëm principliali mbi bazën e urdhrave të çdo muaji nga drejtori i njësisë dhe jo penaltetet.

- Konkretisht deri më 31.12.2018 detyrimi i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës. ndaj hekurudhave të huaja është në vlerën 1,772,902 euro ose 218,811,510 lekë me penaltetet 265,114 euro. Deri më 30.05.2019 detyrimi i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a ndaj hekurudhave të huaja është në vlerën 1,787,982.7 euro ose 220,686,808 lekë me penaltetet 211,431 euro.

- UIC (Internation+al union of railëays) dhe SK (serbia cargon) kanë organizuar në 18/09/2018 forumet e debitorëve/kreditorëve, për të cilat janë kërkuar borxhet e hekurudhave të Byroja e borxheve (Beograd Serbi).

Ministria përgjegjëse merr përsipër administrimin e borxhit sipas Neni 12, pika 4 i ligjit 142 datë 22/12/2016 “Kodi Hekurudhor”. Në referencë me nenin 12.4 të ligjit të sipërpërmendur, Ministria përgjegjëse për transportet merr përsipër rregullimin dhe administrimin e të gjitha borxheve të akumuluar në sistemin hekurudhor shqiptar (të përlllogaritur) deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji. Për këtë qëllim, Hekurudha Shqiptare ka dorëzuar bilancet (31.12.2017) në formë zyrtare pranë Ministrisë përgjegjëse për Infrastrukturën dhe Energjinë, duke përfshirë çështjet e transportit hekurudhor dhe pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si aksionare e vetme e kësaj shoqërie. Deri më datë 31.07.2019, datë në të cilin përfundoj auditimi, borxhet ndaj hekurudha të huaja rëndojnë mbi hekurudhën shqiptare (janë në kontabilitetin e kësaj shoqërie). Nuk ka asnjë veprim konkret, nga Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë.

**Rekomandimi 27.1:** Nga organet drejtuese të shoqërisë ti kërkohej Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit (aksionarit), si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë



(Ministria monitoruese dhe e hartimit të politikave), rregullimin dhe administrimin e vlerës 1,787.982.7 euro ose 220.686.808 lekë me penalitetet 211,431 euro që përfaqëson detyrimin që Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës ka ndaj Hekurudhave të Huaja, në zbatim të nenit 12, pika 4 i ligjit 142 datë 22/12/2016 “Kodi Hekurudhor”.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** HSH sha është në bisedime me hekurudhat e huaja për rregullimin e mosmarrëveshjeve për detyrimet me to, por akoma nuk është zgjidhur administrimi i vlerës 1,787.982.7 euro ose 220.686.808 lekë me penalitetet 211,431 euro që përfaqëson detyrimin që Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës ka ndaj Hekurudhave të Huaja, në zbatim të nenit 12, pika 4 i ligjit 142 datë 22/12/2016 “Kodi Hekurudhor”.me shkresën nr 592 datë 10.06.2020 Administratori i Shoqërisë HSH, vë në dijeni Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë për detyrimet e hekurudhës shqiptarë ndaj hekurudhave te huaja.

#### **Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**28. Gjetje nga auditimi:** Përkthimi në gjuhën shqipe i marrëveshjes RIV (Rregullore mbi shkëmbimin reciprok të vagonëve), dhe kodet UIC (Unioni Ndërkombëtar Hekurudhor) është bërë pjesërisht nga punonjësit e Hekurudhës Shqiptare. Përsa i përket llogaritjes së kamatëvonesave, deri në 31.07.2019 datë në të cilën përfundon auditimi, nuk është bërë e qartë nga punonjësit mënyra e llogaritjes. Përfshirja në kontabilitet ka ndikuar direkt në rezultatin financiar, duke krijuar vështirësi në përcaktimin e detyrimeve financiare ndërmjet Hekurudhës Shqiptare ndaj hekurudhave të huaja, sipas procedurave të parashikuara në RIV.

**Rekomandimi 28.1:** Të merren masa nga Sektori i Marketingut dhe specialisti i marrëdhënieve me jashtë, për kompletimin e dokumentacionit të transportit ndërkombëtar të mallrave, me aktet e rregullores RIV (Rregullore mbi shkëmbimin reciprok të vagonëve), dhe kodet UIC (Unioni Ndërkombëtar Hekurudhor) të përkthyer në gjuhën shqipe, në mënyrë që të kryhen veprimet financiare dhe kontabël, dhe tu vihet në dispozicion punonjësve që merren me zbatimin e këtyre kërkesave ligjore, rregullimin dhe administrimin e vlerës 1,787.982.7 euro ose 220.686.808 lekë me penalitetet 211,431 euro që përfaqëson detyrimin që Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës ka ndaj Hekurudhave të Huaja, në zbatim të nenit 12, pika 4 i ligjit 142 datë 22/12/2016 “Kodi Hekurudhor”.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Ky rekomandim nuk është zbatuar pasi Shoqëria Hekurudha Shqiptare Sha ka mungesë fondesh.

#### **Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**29. Gjetje nga auditimi:** Përgjithësisht kontratat e lidhura me transportuesit hekurudhor nuk janë plotësuar me të gjitha gjenalitet konformë kodit civil dhe librit tarifor (Ato nuk kanë të përcaktuar afatin, sasinë, distancë dhe tarifën).

Për vitin 2018 për transportin e mallrave nga Nj.M.B janë lidhur 9 kontrata. Konkretisht:

1. Kontrata me P., lidhur me 27/09/2018 sasia 500 ton, në të cilin nuk është përcaktuar distancë dhe tarifë.
2. Kontrata me A., lidhur me 01/03/2019, nuk përcakton afat, për sasinë 100 ton në të cilin nuk është përcaktuar distancë dhe tarifë.
3. Kontrata me M. K., lidhur më 21/05/2018 nuk përcakton afat për sasinë 12000 ton.
4. Kontrata me A., lidhur më 19/01/018 sasia 20.000 kg nuk përcakton distancë dhe tarifën për ton/km.
5. Kontrata me K., lidhur më 22/02/2018 për sasinë 40,000 ton, nuk përcakton tarifë transporti. Më datë 02/05/2018 është amenduar.
6. Kontrata me M., lidhur më datë 18/01/2018 sasia 80,000-100,000 ton, nuk përcakton tarifë me afat deri më 31/12/2018 (kjo kompani është tërhequr ka prishur në mënyrë të njëanshme kontratën, por nuk është aplikuar penalitet, pasi kontrata nuk e ka të përcaktuar penalitet).
7. Kontrata me P., lidhur më 25/01/2018 me afat deri më 31/12/2018 sasia 10.000-15.000, nuk ka përcaktuar distancë dhe tarifë (nuk ka të bashkëngjitur librin tarifor).
8. Kontrata me M., lidhur më 12/01/2018, nuk ka të

përcaktuar afat, sasi, distancë dhe tarifë. 9. Kontrata me 16., lidhur më 12/12/018 me afat 31/12/2018 pa përcaktuar sasi, distancë dhe tarifë.

Për vitin 2019 janë lidhur 3 kontrata me M., data e lidhjes së kontratës 15/01/019, sasia 80,000-100,000 ton, por pa bashkëngjitur tarifatat sipas librit tarifor, me M., datë e lidhjes së kontratës 01/02/2019 pa sasi dhe distancë dhe me 16., datë e lidhjes së kontratës 02/03/2019 sasia 30,000-70,000 ton, pa përcaktuar destinacionin.

**Rekomandimi 29.1:** Nga Administratori i shoqërisë të merret masat që kontratat me transportuesit hekurudhor për përdorimin e rrjetit hekurudhor të maksimizojnë jo vetëm zbatimin e tarifave në fuqi, por dhe të mos cenohet qëndrueshmëria dhe aftësia konkurruese e transportit hekurudhor të mallrave.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nuk është marrë asnjë masë nga ana e Hekurudhës Shqiptare në lidhje me rekomandimin e mësipërm.

#### **Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

V. Realizimi i rekomandimeve për **zhdëmtimin e dëmeve ekonomike**, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar.

**B. Masa për shpërblim dëmi: Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë propozuar 5 (pesë) masa për shpërblim dëmi nga të cilat 2 janë zbatuar dhe 3 janë pa zbatuar, përkatësisht:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Riparim traseje hekurudhore nga rrëshqitjet në km 138+200 deri në km 138+800, perigoni Bajzë-Hani i Hotit”, nga Shoqëria “G. M.”, ShPK Ballsh, është përfituar padrejtësisht vlera 531,744 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me punime të likuiduara por të pa kryera. Konkretisht në preventiv specifikohet se materiali mbushës është material shkëmbor çakëll ndërsa në specifikime teknike flitet për material mbushës zhavorr lumi. Nga konstatimi në terren u verifikua se materiali i hedhur në vend është zhavorr lumi i papastër i përzier me rërë, material i cili nuk i përmbush kërkesat për qëndrueshmëri të skarpatës dhe të filtrimit ujit. Çmimi i ofertës fituese për këtë zë punimesh është 600 lekë ndërkohë që zhavorri i lumit sipas manualit të çmimeve në VKM nr. 629 datë 15.07.2015 është 316 lekë.

Gjatë verifikimit të punimeve në terren u konstatua se materiali mbushës nuk është hedhur gjatë gjithë gjatësisë sipas kilometrave të përcaktuar në projekt por vetëm në një zonë rreth 15m të gjatë në një skarpat afërsisht 10m të lartë. Nga verifikimi është konstatuar se materiali që është hedhur përbën volumn prej 180 m<sup>3</sup> dhe vlerën 108,000 lekë pa TVSH, ndërkohë që sasia 220m<sup>3</sup> në vlerën 132,000 lekë pa TVSH ose 158 400 me TVSH është zë punimesh i pakryer. Transporti i materialit mbushës për shkak të topografisë së terrenit në këtë pikë është kryer me tren me vagonë vetëshkarkues V.S të cilët kanë një vëllim prej 30 m<sup>3</sup>. Nga përlllogaritjet rezulton se janë hedhur vetëm 6 vagonë me material mbushës.

Materiali që është hedhur në terren që përbën vëllimin 180 m<sup>3</sup> është zhavorr lumi dhe jo çakëll dhe duhet konsiderohet me çmimin 316 lekë pra duhet të përbente vlerën 56,880 lekë ndërkohë që kontraktori është paguar me vlerën 600 lekë ( 180\*600 =108,000 lekë) diferenca 51,120 pa TVSH ose 61,344 me TVSH lekë përbën dëm ekonomik.

Gjithashtu është konstatuar se nuk janë kryer gjurmime për heqjen e materialit të dobët sipas projektit por materiali mbushës është hedhur direkt mbi skarpat. 250m<sup>3</sup> gjurmime në vlerën 150,000 pa TVSh ose 180,000 me TVSH janë punime të pakryera për të cilat kontraktori është paguar. Gjithashtu në zonën e punimeve janë transportuar vetëm 180m<sup>3</sup> material dhe jo 400m<sup>3</sup> pra vlera e transportimit të materialit është 90,000 lekë dhe diferenca 110,000 pa TVSH ose

132,000 me TVSH është zë punimi i pakryer (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 në faqet 63-95, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Të kërkohe në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, *arkëtimi i vlerës 531,744 lekë*, nga Shoqëria “G.M.”, ShPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara gjatë zbatimit të kontratës "Riparim traseje hekurudhore nga rrëshqitjet në km 138+200 deri në km 138+800, perigonmi Bajzë-Hani i Hotit vlerë e cila për Shoqërinë “Hekurudhën Shqiptare” sh.a, Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

**Qëndrimi i grupit të auditimit.** Nga ana e HSH sha, me shkresën nr. 79/5 prot., datë 27.01.2020 është kërkuar arkëtimi i shumës 531,744 lekë nga Shoqëria “G.M.”, ShPK”. Aktualisht është në proces gjyqësor HSH sha, me Shoqërinë “G.M.”, sh.p.k në shkallën e dytë të procesit të gjykimit.

#### **Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**4. Gjetje nga auditimi:** Dëmtim të rrjetit Hekurudhor Shqiptar në *vlerën 3,228,427 lekë*, risk i lart se vazhdimi i veprimtarisë mund të cenojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit, të plotësimit të standardeve dhe të kushteve teknike nga transportuesi hekurudhor “B.C.”, shpk. Referuar inspektimeve që kjo drejtori ka kryer si dhe dokumentacionit të paraqitur nga Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” dhe nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, konstatohet se ky operator ka kryer dëmtime në rrjetin hekurudhor shqiptar në 3 raste me dëm të vlerësuar material në *vlerën 3,228,427 lekë*, për të cilat Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor, është shprehur me vendimin nr.8, datë 18.04.2018, nr.9, datë 06.09.2018 dhe nr.11, datë 19.11.2018, vendime në të cilat nga kjo drejtori është ngarkuar me përgjegjësi transportuesi hekurudhor “B. C.”, ShPK, ndërsa dëmi është përcaktuar nga Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” respektivisht në vlerat 936,742 lekë, 987,368 lekë dhe 1,304,317 lekë.

**Rekomandimi 4.1:** Të kërkohe në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 3,228,427 lekë nga Shoqëria “B. C.”, ShPK. Kjo vlerë ka të bëjë me dëmtim të rrjetit hekurudhor gjatë ushtrimit të aktivitetit. Vlera *3,228,427 lekë* përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” dhe Buxhetin e Shtetit. Në rast mos likuidimi të aplikohen sanksionet përkatëse bazuar në kontratën e nënshkruar me këtë transportues hekurudhor.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** HSH sha me shkresën 79/4 prot., datë 27.01.2020 i është drejtuar shoqërisë “B.C.”, ShPK, për arkëtimin në llogari të HSH sha për dëmin e shkaktuar me vlerë 3,228,427 lekë, brenda datës 07.02.2020. Me shkresën numër 386 prot., datë 05.06.2020 është bërë kërkesë padi duke ju drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ku është kërkuar shpërblimi i dëmit. Aktualisht është në proces gjyqësor.

#### **Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**5. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” është penalizuar në dy raste në vlerën 3,068,020 lekë nga mos kryerja e ankimimit brenda afateve të përcaktuar në ligj në Gjykatën e Apelit konkretisht me përfitues L. G., në bazë të vendimit civil nr.1263 datë 08.09.2016 dhe akt marrëveshjes nr.873/16 datë 16.11.2016 në vlerën 1,914,720 lekë, si dhe B.Gj., në vlerën 1,153,300 lekë, veprim në kundërshtim ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i procedurës Civile|, i ndryshuar, nenet 442, vijues, 444, 452 vijues.

**Rekomandimi 5.1:** Nga Këshilli Mbikëqyrës të shqyrtohet vlera 3,068,020 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me penalizimin në dy raste të shoqërisë nga mos kryerja e ankimimit brenda afateve të përcaktuar në ligj në Gjykatën e Apelit konkretisht me përfitues L. G. në bazë të vendimit civil nr.1263 datë 08.09.2016 dhe akt marrëveshjes nr.873/16 datë 16.11.2016, në shumën totale të

likuidimit në vlerën 1,914,720 lekë, si dhe B.Gj. në shumën totale 1,153,300 lekë. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës, pasi kjo vlerë për Shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” Sha dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet në zbatim të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik”.

**Qëndrimi i grupit të auditimit.** Nga ana e Hekurudhës Shqiptare Sha Durrës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

**VI. Realizimi i rekomandimeve për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike për shkak të parregullsive dhe paligjshmërisë të konstatuara në administrimin e fondeve publike** sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë propozuar 1 (një) masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike për shkak të parregullsive dhe paligjshmërisë të konstatuara në administrimin e fondeve publike përkatësisht:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi në zbatimin e strukturës organizative, në marrëdhëniet e punës dhe në dhënien e pagave dhe shpërblimeve është konstatuar se punonjësit e larguar nga puna kanë hapur procese gjyqësore ligjore për të cilat janë marrë 11 vendime të formës së prerë në vitet 2018-5-mujori 2019 me vlerë të **efektit negativ financiar në shumën 10,953,875 lekë**. Ndërsa 20 çështje të tjera janë në proces dhe vazhdojnë shkallët e gjyqimit e cila riskon ta rëndojë akoma më tej situatën financiare të shoqërisë në të ardhmen.

**Rekomandimi 1.1:** Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a, Durrës, duhet të shqyrtojë efektin financiar në vlerën totale **10,953,875 lekë**, i cili ka ardhur si pasojë e zgjidhjes së pa arsyeshme të kontratës së punësimit të punonjësve.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga ana e HSh sha, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Statusi i rekomandimit: Pa zbatuar**

## 2.2 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Për auditimin e kësaj pike të Programit të Auditimit, Grupi i auditimit është bazuar në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe ligjeve/rregullave specifike të institucionit që auditohet. Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës sipas viteve objekt auditimi është:

Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës sipas viteve objekt auditimi			
2019	2020	2021	2022
T. B.	T. B.	E.M.	E. M.
K.M.	K.M.	G.L	B N.
E.M	E.M	B. N.	K.R.
Th.Xh.	Th.Xh.	K. R.	S.B.
E. T.	E. T.	S.B.	K .H.
Th .P.	Th .P.	S.B.	K.N.

### **Vendime të Këshillit Mbikëqyrës viti 2019:**

- Vendimi nr. 7, datë 08.05.2019, “Të miratojë tabelat e pagave për punonjësit e Hekurudha Shqiptare SHA, paraqitur nga VKM.. Tabelat e pagave janë hartuar në përputhje me Strukturën Organizative 2019 si rezultat i rritjes së pagës minimale në shkallë vendi në nivelin 26,000 lekë.
- Vendimi nr.8, datë 08.05.2019, “Të miratojë në parim një shtesë në Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të shoqërisë, duke shtuar në atë ekzistuesen të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë, funksionet e K/Inxhinierit të Shoqërisë HSH SHA. Ky propozim miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës duke shtuar këtë emërtesë.
- Vendimi nr.9, datë 06.06.2019, “1. Amendimin e pikës nr.1 të Vendimit nr.16 datë 18.10.2018 të Këshillit Mbikëqyrës si më poshtë: “Miratimin në parim të dhënies me qira për një periudhë 20 vjet, të një sipërfaqe totale prej 4800 m<sup>2</sup> në Stacionin Hekurudhor Librazhd e përbërë nga:  
(i)Pasuria nr .1/82 truall me sipërfaqe totale 554 m<sup>2</sup> nga e cila 34 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimore dhe 520 m<sup>2</sup> sipërfaqe funksionale pasuri në administrim të shoqërisë HSH SHA.  
(ii) Pasuria nr. 1/83 truall i lirë me sipërfaqe 4246 m<sup>2</sup> në administrim të Shoqërisë HSH SHA. Në brendësi të pasurisë 1/83 ndodhet pasuria 1/288 e cila nuk përfshihet në sipërfaqen prej 4246 m<sup>2</sup> dhe nuk është subjekt i dhënies me qira. Ky propozim miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës përveç, Pasurisë 1/83 truall i lirë me sipërfaqe 4246 m<sup>2</sup> në administrim të Shoqërisë HSH SHA, e cila nuk jepet me qira pasi nuk përfshihet në sipërfaqen 4246 m<sup>2</sup>.
- Vendim nr.10, datë 23.07.2019, “1. Të miratojë Pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018 si dhe raportin e auditimit të ekspertëve kontabël të autorizuar”.
- Vendim nr.10, datë 23.07.2019, “2. Të përcjellë në MFE raportin e auditimit të ekspertëve kontabël dhe pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018 sipas ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- Vendimi nr.11, datë 01.10.2019, “Të miratojë raportin mbi veprimtarinë e shoqërisë për 6-mujorin e parë të vitit 2019”.
- Vendimi nr.12, datë 01.10.2019, “Miratim në parim për dhënien me qira të ish Oficinës lokomotivave me nr. pasurie 5/10/ND, 85/8, sip.1405 m<sup>2</sup> prej 10 vitesh. Në kontratë të vendoset një klauzole e cila të parashikojë zgjidhjen e kontratës pa penalitet për entin pronar shtetëror nëse një investim i mundshëm në HSH SHA, kërkon përdorimin e oficinës së lokomotivave për nevojat e saj. Pasi nga Hekurudha Shqiptare është kërkuar afati 20 vjeçar për dhënien me qira, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të japi me qira për 10 vite me klauzolën e cila duhet të parashikojë zgjidhjen kontratës pa penalitete për Entin pronar nëse ky i fundit e kërkon përdorimin e këtij objekti për nevojat e veta.
- Vendimi nr. 13, datë 13.11.2019, “Të miratojë planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2020 dhe planin strategjik 2020-2022”.
- Vendimi nr. 14, datë 13.11.2019, “Të miratojë dhënien me qira të ambienteve apo objekteve të mëposhtme në Njësinë e Biznesit Menaxhimit të Infrastrukturës. Miratohet Vendimi nr. 14 datë 13.11.2019 për dhënie me qira të ambienteve të NJBMI sipas listës së paraqitur nga Administratori i Shoqërisë.
- Vendimi nr. 15, datë 13.11.2019, “Të miratojë në parim nxjerrjen jashtë përdorimit të 67 vagonëve të Njësisë Biznesit të Mallit, 8 vagonë të Njësisë Biznesit Udhëtarë, automjete, shina në inventar të Njësisë Biznesit Mallit, Udhëtarit, Infrastrukturës. Pasi u verifikua dokumentacioni nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës u miratua me Vendim Nr. 15 datë 13.11.2019 në parim nxjerrjen jashtë përdorimit të 67 vagonë malli 8 vagonë udhëtare, automjete, shina në inventar të Njësisë Biznesit Mallit, Udhëtarit, Infrastrukturës.

-Vendim nr. 16, datë 19.12.2019, “Të miratoj projekt programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2020 të shoqërisë me treguesit e tyre. Programi i zhvillimit ekonomik nga Drejtuesit e Shoqërisë u miratua me Vendim nr. 16 datë 19.12.2019 nga Këshilli Mbikëqyrës.

#### **Vendime Këshillit Mbikëqyrës viti 2020:**

-Vendimi nr.1, datë 15.07.2020, “Të miratojë raportin mbi veprimtarinë e shoqërisë 2019. Pas relatimit të materialeve nga Drejtuesit e Hekurudhës Shqiptare SHA”, duke lënë si detyrë Administratorit të Shoqërisë të marrë masat e nevojshme për zbatimin e objektivave të programuara për periudhën në vazhdim.

-Vendimi nr.2, datë 15.07.2020, “Pika nr.1 e Vendimit nr.12, datë 01.10.2019, të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, ndryshohet si më poshtë, Miratim në parim të dhënies me qira të ish oficinës lokomotivave me sipërfaqe 1405 m<sup>2</sup> me nr. pasurie 5/10/ND kad.8518 sip. funksionale 6958 m<sup>2</sup>, me nr. pas.5/122 kad.8518 për një periudhë kohore prej 10 vitesh në kontratën e qirasë të vendoset një klauzolë e cila të parashikojë zgjidhjen e kontratës pa penalitet për entin pronar shtetëror nëse një investim i mundshëm në HSH SHA, kërkon përdorimin e ish oficinës së lokomotivave për nevojat e veta.

-Vendimi nr.3, datë 03.09.2020, “Të miratojë pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2019 si edhe raportin e auditimit të eksperteve kontabël të autorizuar. Të përcjell në MFE raportin e auditimit viti ushtrimor 2019.”.

-Vendimi nr.4, datë 03.09.2020, “Të miratojë raportin mbi veprimtarinë e shoqërisë për 6 mujorin e parë të vitit 2020 paraqitur nga Administratori i Shoqërisë.

-Vendimi nr.5 datë 03.09.2020, “Të miratojë raportin mbi aktivitetin e Sektorit të AB/2019.

-Vendimi nr.6, datë 03.09.2020, “Të miratojë në parim ndryshimin e emërtesës së Njesisë së Zbatimit të Projekteve dhe P.M.I.U. në përbërje, brenda numrit të punonjësve të miratuar me parë”.

-Vendimi nr.7, datë 13.11.2020, “Të miratojë projekt programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2021 të shoqërisë me treguesit përkatës.

-Vendimi nr.8, datë 13.11.2020, “Të miratojë planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2021 dhe planin strategjik 2021-2023.

#### **Vendime Këshillit Mbikëqyrës viti 2021:**

-Vendimi nr.1, datë 27.01.2021, “Në zbatim të Vendimit nr.54 datë 05.02.2014, Kreu II, pika 1/d, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar me Vendimin nr.672, datë 09.02.2020, kreu II, pika 1/b, të miratojë dhënien me qira të ambienteve apo objekteve në Njesisë Biznesi Menaxhimit Infrastrukturës, sipas listës së paraqitur nga Administratori i Shoqërisë.

-Vendimi nr.2, datë 19.02.2021, “Të miratojë Raportin mbi aktivitetin e sektorit të auditit të brendshëm për vitin 2020”.

-Vendimi nr.3, datë 19.02.2021, “Të miratojë në parim raportin për rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale në Hekurudhën Shqiptare SHA, përgatitur nga grupi ekspertëve vlerësues”.

-Vendimi nr.4, datë 19.04.2021, “Të miratojë raportin mbi veprimtarinë e shoqërisë për vitin 2020 paraqitur nga Administratori i Shoqërisë”.

-Vendimi nr.5, datë 07.07.2021, “Të miratojë pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2020 si edhe raportin e auditimit të ekspertëve kontabël të autorizuar. Të përcjell në MFE raportin e auditimit të ekspertëve kontabël dhe pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2020 sipas ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

-Vendimi nr.6, datë 01.10.2021, “Të miratojë raportin mbi veprimtarinë e shoqërisë për 6 mujorin e parë të vitit 2021 paraqitur nga Administratori i Shoqërisë”.

-Vendimi nr.7, datë 04.11.2021, “Zgjedhjen në detyrën e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës, të Shoqërisë Hekurudha Shqiptare SHA, Znj. E. M.

### **Vendime Këshillit Mbikëqyrës viti 2022:**

-Vendim nr. 1, datë 16.02.2022, “Të miratoj Raportin mbi aktivitetin e Sektorit të AB për vitin 2021.

-Vendim nr. 2, datë 02.03.2022, “Të miratoj projekt programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2022 të shoqërisë me treguesit e mëposhtëm”.

-Vendim nr. 3, datë 27.05.2022, “Të miratoj projekt programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2022 të shoqërisë sipas treguesve bashkëlidhur Vendimit të administratorit të Shoqërisë”.

-Vendim nr. 4, datë 27.05.2022, “Të miratojë ndryshimet në Strukturat Organizative të Shoqërisë, shoqëruar me skemën organizative të saj”.

-Vendim nr. 5, datë 27.05.2022, “Të miratojë në parim nxjerrjen jashtë përdorimit të 70 vagonë të Njesisë Biznesit të Mallit, 3 lokomotiva, makineri e pajisje mjete transporti, linja të dyta dhe të treta të Njesisë së Biznesit të Mallit, Njesisë Shërbimit Mjeteve Lëvizëse, Njesisë Biznesit Menaxhimit Infrastrukturës Hekurudhore”.

-Vendim nr. 6, datë 27.05.2022, “Të miratojë në parim nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të ndryshme (shinat e linjave të dyta, shinave të para ndërruese) të Njesisë Biznesit Menaxhimit Infrastrukturës që preken nga zbatimi i projektit Durrës-Tiranë-Rinas”.

-Vendim nr.7, datë 27.05.2022, “Të miratojë Raportin Mbi veprimtarinë e shoqërisë për vitin 2021 paraqitur nga Administratori i Shoqërisë”.

-Vendim Qarkullues nr. 8, datë 27.07.2022, “Të miratojë Pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2021 si edhe raportin e auditimit të ekspertëve kontabël të autorizuar”.

-Vendim Qarkullues nr. 9, datë 27.07.2022, “Të miratojë raportin mbi veprimtarinë ekonomike të shoqërisë për 6 mujorin e parë 2022 paraqitur nga Administratori i Shoqërisë”.

-Vendim Qarkullues nr. 10, datë 25.08.2022, “Miratimin në parim për dhënin me qira të 26 vagonëve të mallit për një periudhë një vjeçare, në zbatim të V.K.M nr.54, datë 05.02.2014, pika 6, germa a, por me të drejtë ri përsëritje çdo vit gjithashtu për përllogaritjen e vlerës së qirasë për çdo vagonë malli është kryer sipas Vendimit nr.54 datë 05.02.2014, i ndryshuar, kapitulli 3, pika 5 tarifa dhe vlera dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteoze.

-Vendim nr. 11, datë 04.11.2022, “Të miratojë Planin vjetor të AB për vitin 2023 dhe planin strategjik për 2023-2025”.

-Vendim nr. 12, datë 23.12.2022, “Të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të Njesisë së Biznesit e Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, të përgatitura nga HSH, së bashku me relacionin, proces-verbalet e vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi, si dhe Vendimin nr.8, datë 01.12.2022, të Administratorit të Shoqërisë, për miratimin në parim të tyre”.

-Vendim nr. 13, datë 23.12.2022, “Te miratojë një ndryshim në Strukturën Organizative përsa i takon suprimimit të pozicionit të Zv. Administratorit të Shoqërisë duke krijuar pozicionin e Drejtuesit të Zhvillimit të projekteve dhe që do të ketë në varësi Sektorin e Investimeve të brendshme dhe Sektorin e Investimeve te projekteve të huaja”.

-Vendim nr.14, datë 23.12.2022, “Të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të ndryshme një lokomotive dhe dy automjete të Njesisë Biznesit të Mallit dhe Njesisë Ekonomike”.

-Vendim nr. 15, datë 23.12.2022, “Të miratojë Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë, (e përditësuar), të përgatitur nga HSH, së bashku me Relacionin, si dhe Vendimin nr.10, datë 01.12.2022, e Administratorit të Shoqërisë, për miratimin në parim të tyre”. Në

mënyrë analitike vendimet janë në aneksin nr.2.2 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.



### **2.3 Mbi hartimin dhe zbatimimin e buxhetit; Hartimi shqyrtimi, miratimi dhe zbatimi i programit ekonomik- financiar. Ndjekja dhe realizimi i treguesve ekonomik – financiar në qendër dhe në njësitë e varësisë.**

Projekt programet e zhvillimit ekonomik për vitet 2019-2022 dhe programi ekonomik dhe financiar për vitet 2019-2022, janë hartuar mbi bazën e treguesve të vitit paraardhës dhe realizimit të pritshëm të vitit aktual. Projekt programi i çdo viti, është hartuar nga Drejtoria e Shoqërisë dhe pasi është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, është paraqitur për mendim në Ministrinë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe për miratim nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë (MFE), sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 315, datë 08.04.2009, “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror” si dhe në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" HSH sha. (në vazhdim e përmendur me simbolin “HSH”), është shoqëri anonime me kapital tërësisht shtetëror dhe që funksionon në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Statutit të Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” Sha Durrës, Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë, nr.142, datë 22.12.2016, Rregullorja për Shfrytëzimin Teknik të Hekurudhave, miratuar nga Ministria e Transportit në vitin 1985, si dhe ligji nr.7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

HSH sha, ka për qëllim transportin e mallrave dhe udhëtarëve në territorin e Republikës së Shqipërisë, e nëpërmjet stacioneve kufitare dhe për në vendet e tjera, aktivitetin e ngarkim-shkarkimit, si dhe të tjera aktivitete sa lejon Statuti i Shoqërisë.

Për hartimin e programit ekonomik, strukturat drejtuese të shoqërisë, janë mbështetur në:

-analizën e treguesve ekonomik-financiarë të realizuar në vitin e mëparshëm;

-në objektivat e zhvillimit të shoqërisë;

-në shfrytëzimin e mundësive dhe kapaciteteve të shoqërisë, etj.

**Për vitin 2019:** Me përgatitjen e programit nga HSH sha, me Vendimin nr.17, datë 22.11.2018, të miratuar nga administratori i Shoqërisë, me shkresën nr.1190, datë 22.11.2018, i është dërguar Këshillit Mbikëqyrës, të shoqëruar me relacionin e programit të zhvillimit ekonomik të vitit 2018. Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin nr.20, datë 20.12.2018, ka miratuar projekt programin e zhvillimit ekonomik të vitit 2019 dhe me shkresën nr. 31, datë 11.01.2019, ka dërguar për miratim projekt/programin ekonomik të vitit 2019 tek MIE. Me shkresën nr.31/1, datë 21.02.2019, HSH sha, ka dërguar programin e zhvillimit ekonomik në MIE me disa ndryshime. Me shkresën me nr.7810 datë 26.04.2019, MFE ka dërguar shkresë ku propozon që miratimi i projekt programit duhet të përmbajë vitin programues dhe dy vitet pasardhëse.

Mungon në dosje miratimi nga Ministrinë përkatëse të projekt/ programit ekonomik.

**Për vitin 2020:** Me përgatitjen e programit nga HSH sha, me Vendimin nr.7, datë 06.12.2019, me shkresën nr.1338/1, datë 06.12.2019, i është dërguar Këshillit Mbikëqyrës, të shoqëruar me relacionin e projekt/programit të zhvillimit ekonomik të vitit 2020. Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin nr.16, datë 19.12.2019, ka miratuar projekt programin e zhvillimit ekonomik të vitit 2020 dhe me shkresën nr.1338/1, datë 23.12.2020, ka dërguar për miratim projekt/programin ekonomik të vitit 2020 të MIE. Me shkresën nr. 1873 datë 18.02.2020, MIE ka kërkuar saktësim të të ardhurave dhe objektivat për vitet 2020-2022. Me shkresën nr.1873/2 datë 22.04.2020 është miratuar nga MIE programi ekonomik i zhvillimit 2020-2022.

**Për vitin 2021:** Mbas përgatitjes së programit nga HSH sha, me shkresën nr.1124/1, datë 06.11.2020, i është dërguar për miratim Këshillit Mbikëqyrës, sipas Vendimi nr.2, datë 05.11.2020, të shoqëruar me relacionin për programin ekonomik. Me Vendimin nr.7, datë 13.11.2020, Këshilli Mbikëqyrës, ka miratuar programin zhvillimit ekonomik. Me shkresën nr 1124/2, datë 25.11.2020 ka dërguar projekt/programi ekonomik për miratimin nga MIE dhe në vazhdim HSH sha, me shkresën nr.1124/5, datë 18.10.2021, ka kërkuar miratimin e programit prej saj. Me shkresën nr.22418 prot, datë 01.12.2020, MIE ka kërkuar hartimin e projekt programit ekonomik të Shoqërisë për vitin 2021 dhe parashikimi për vitet 2022-2024. Me shkresën nr 1124.3 datë 27.01.2021 HSH, është kërkuar miratimi i programit nga MIE. Me shkresën nr.1124/4 datë 08.07.2021, HSH ka kërkuar miratimin e programit nga MIE dhe MFE. Në shkresën me nr.1124/5, datë 18.10.2021, HSH sha, ka kërkuar sërish miratimin e programit ekonomik të saj por në dosje mungon miratimi nga ministritë përkatëse të projekt/ programit ekonomik.

**Për vitin 2022:** Pasi përgatitjes së programit ekonomik nga HSH sha, me shkresën nr.851/6, datë 01.11.2021, është dërguar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës, bashkëlidhur dhe relacioni për zhvillimin ekonomik të shoqëruar me Vendimin nr.2, datë 29.10.2021, të Administratorit. Vendimi i miratimit të programit ekonomik nga Këshillit Mbikëqyrës është me nr.2, datë 02.03.2022 dhe me shkresën me nr. 244/1, datë 18.03.2022, është dërguar projekt programi ekonomik për miratim në MIE dhe MFE. Me shkresën nr.244/2 prot, datë 27.05.2022, është ridërguar projekt/programi për vitin 2022 si dhe për vitet 2023 dhe 2024. Me shkresën nr.9801 prot, datë 24.06.2022, është miratuar programi i zhvillimit ekonomik nga MFE dhe me shkresën nr.2562/2 prot, datë 10.06.2022 është miratuar projekt programi nga MIE.

Nga auditimi i kësaj pikë rezultuan:

## **2. Titulli i Gjetjes: Planifikim dhe realizim jo i duhur i programit ekonomik**

### **Situata:**

Në “Hekurudha Shqiptare” SHA, konstatohet një planifikim dhe realizim jo i duhur i programit ekonomik, fakt që flet për planifikim jo të saktë dhe mos rishikim të programit fillestar. Performanca e treguesve ekonomiko-financiar që lidhen me realizimin e buxhetit faktik të shoqërisë, nuk është e kënaqshme dhe ka vend të përmirësohet, pasi për çdo lekë të shpenzuar, sipas viteve objekt auditimi është përfituar një e ardhur: 2019 prej 0.89 lekë, 2020 prej 0.79 leke, 2021 prej 0.94 lekë dhe për vitin 2022 një e ardhur prej 0,99 lekë. Raporti i detyrimeve afat shkurtër/kapitalit për vitin 2019, paraqitet 1.5 % , për vitin 2020 paraqitet 1.22%, për vitin 2021 paraqitet 1.31% dhe për 2022 në 1.45%. “Hekurudha Shqiptare” SHA, ka riskun e gjendjes së pamjaftueshme të likuiditeteve. Në qoftë se shoqëria do të llogariste penalitetin e hekurudhave të huaja si dhe nuk do të çelej subvencion nga buxheti i shtetit, do të çonte në rezultat negativ akoma më të lartë për vitet ushtrimore. Duke zbritur nga pasqyrat financiare subvencionin si e ardhur, raporti të ardhura/shpenzime do të ndryshojë duke thelluar në mënyre të ndjeshme rezultatin financiar (humbje). Veprimet sa më sipër janë jo në përputhje me ligjet nr.115/ 2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ndryshuar; nr.137/ 16.11.20, “Për buxhetin e vitit 2021”, ndryshuar; nr.88/ 18.12.19, “Për buxhetin e vitit 2020”, ndryshuar; nr.99/ 2018, “Për buxhetin e vitit 2019” si dhe UMFE nr.9, datë 20.03.18, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

<b>Kriteri:</b>	Akti Normativ nr.12, datë 29.07.2022, “Për disa ndryshime në ligjin 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ndryshuar Ligji nr.115/ 2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ndryshuar Ligji nr.137/ 16.11.20, “Për buxhetin e vitit 2021”, ndryshuar Ligji nr.88/ 18.12.19, “Për buxhetin e vitit 2020”, ndryshuar Ligji nr.99/ 2018, “Për buxhetin e vitit 2019” UMFE nr.9, datë 20.03.18, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për Shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” Sh.a Durrës.
<b>Shkaku:</b>	Analizave jo reale për realizimin e projekteve kapitale. Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi i ulët, sidomos për të ardhurat dhe investimet kapitale, çka mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të shoqërisë. Mungesa e analizës lidhur me aftësinë e shoqërisë për gjenerimin e të ardhurave.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Nga ana e organeve drejtuese të bëhet një analizë e detajuar e investimeve kapitale dhe shpenzimeve, etj., të planifikuara për t`u realizuar gjatë vitit dhe të merren veprimet e nevojshme që këto projekte të realizohen sipas programit.

### 3. Titulli i Gjetjes: Përdorimi i subvencionit si i vetmi instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a Durrës.

<b>Situata:</b>	Nga auditimi rezulton se nga ana e MFE, me shkresat përkatëse, është miratuar detajimi i planit për shpenzimet korrente, ndërkohë që emërtimi i produktit është “rrjet hekurudhor i subvencionuar”. Në opinionin e grupit të auditimit emërtimi “Rrjet hekurudhor i subvencionuar” është në kundërshtim me pikën 26, 58 dhe 63, të nenit 5, të ligjit nr.142/2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se rrjeti nuk është veprimtari por objekt. Nga auditimi i dokumentacionit, për përdorimin/ realizimin e subvencionit sipas shkresave dërguar MIE-s dhe Degës së Thesarit Durrës, subvencionit ka numër artikulli 603000 “Subvencione për transportin hekurudhor” (sipas nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik) dhe jo artikullin përkatës për të cilin është kryer shpenzimi faktik. Nga sa rezulton, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), Dega e Thesarit Durrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar), me veprimet apo mosveprimet e tyre, kanë krijuar një situatë të paqartë për alokimin dhe përdorimin e subvencionit nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, duke i krijuar kësaj shoqërie mundësinë që ta përdor këtë subvencion për paga dhe sigurime shoqërore), duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi të akorduar po nga MFE. MIE dhe MFE, e kanë përdorur subveccionin si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë HSH sha. Pas miratimit të programit ekonomik nga MFE, nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, janë përgatitur kontrata për marrëveshjen financiare shtetërore e cila i është dërguar MIE-s. Këto marrëveshje janë firmosur në mënyrë të njëanshme vetëm nga “Hekurudha Shqiptare” SHA dhe në asnjë rast nuk janë firmosur
-----------------	---

<p><b>Kriteri:</b></p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b></p> <p><b>Shkaku:</b></p> <p><b>Rëndësia: Rekomandime:</b></p>	<p>nga MIE.</p> <p>Ecuria e treguesve ekonomiko-financiare për vitet e fundit 2019, 2020, 2021 dhe 2022, pasqyron një krize likuiditeti “Hekurudha Shqiptare” SHA, si dhe ka detyrime të prapambetura ndaj të tretëve si kredi afatshkurtër e afatgjatë, për principal dhe interesa, fatura për blerje etj., në vlerën 3,870,023 mijë lekë (totali i detyrimeve afatshkurtra 1.096.943 mijë lekë + totali i detyrimeve afatgjata 2.773.080 mijë lekë). Në opinionin e grupit të auditimit “Hekurudha Shqiptare” SHA, është në gjendje falimentimi.</p> <p>Veprimet sa më sipër janë jo në përputhje me ligjet nr.115/ 2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ndryshuar; nr.137/ 16.11.20, “Për buxhetin e vitit 2021”, ndryshuar; nr.88/ 18.12.19, “Për buxhetin e vitit 2020”, ndryshuar; nr.99/ 2018, “Për buxhetin e vitit 2019” si dhe UMFE nr.9, datë 20.03.18, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.</p> <p>Ligji nr.115/ 2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ndryshuar; Ligji nr.137/ 16.11.20, “Për buxhetin e vitit 2021”, ndryshuar; Ligji nr.88/ 18.12.19, “Për buxhetin e vitit 2020”, ndryshuar; Ligji nr.99/ 2018, “Për buxhetin e vitit 2019”; UMFE nr.9, datë 20.03.18, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.</p> <p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), Dega e Thesarit Durrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar), me veprimet apo mosveprimet e tyre, kanë krijuar një situatë konfuze dhe të paqartë për alokimin dhe përdorimin e subvencionit nga Hekurudha Shqiptare, duke i krijuar kësaj shoqërie mundësinë që ta përdor këtë subvencion për paga dhe sigurime shoqërore), duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi të akorduar po nga vet Ministria e Financave dhe Ekonomisë.</p> <p>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e kanë përdor subvencionin <b>si të vetmin instrument</b> për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare Sh.a Durrës, pasi Shoqëria aktualisht ndodhet përpara një krize të mprehtë likuiditeti.</p> <p>E lartë</p> <p>Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës, ti kërkojnë në rrugë institucionale Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e monitoruesit dhe hartimit të politikave, që të ndërmarrin veprime urgjente ligjore, për korrigjimin e menjëreshëm të veprimtarisë së kësaj shoqërie, dhe konkretisht për subvencionin, të përputhen kërkesat e ligjeve me kushtet dhe specifikat në të cilat ndodhet kjo shoqëri.</p>
---	--

○ Për sa është trajtuar për këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 109/519, datë datë 04.07.2023, e protokolluar në KLSH me nr. 126/5, datë 06.07. 2023, “Mbi observacionet e Projekt Raportit” nga z/A. H., Drejtues i Njesisë Ekonomike dhe Xh.Gj., Shef i Sektorit të Programimit, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** është i njëjtë me atë të ardhur për Akt konstatimin përkatës, për të cilin është dhënë qëndrimi i audituesit të KLSH.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Rezulton që konstatimet e grupi të auditimit janë të drejta.

**Sa më poshtë janë treguesit ekonomik plan fakt dhe në përqindje për periudhën objekt auditimi:**

**Tabela nr. 1** Planifikimi dhe realizimi i treguesve ekonomik dhe i të ardhurave:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Viti 2019			Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
			Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
	Volumi i punës													
1	Ton	000 ton	164.6	107.1	65.1	180	75.2	41.8	105	75.3	71.	31.0	3.6	11.6
2	Ton/km	000 ton/km	19,443	19,181	98.7	25,883	6,773.3	26.2	18,326	5,661,4	30.9	2,700	285	10.6
3	Udhëtar	000 udhëtar	80	59.8	74.8	65	17.9	27.5	60	24	40	21.5	10.6	49.3
4	Udhëtar/km	000 udhëtar/km	3,000	2,056	68.5	2,200	592,8	26.9	2,000	812,0	40.6	780	437	56

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Tabela nr. 2** “Programi dhe realizimi i treguesve ekonomikë dhe financiar për 2019 -2022” në

*Në 000 lekë*

objekti	2019			2020			2021			2022		
	Program	Realizim	%	Program	Realizim	%	Program	Realizim	%	Program	Realizim	%
Të ardhura gjithsej	1,124,470	974,584	86.7	1,095,990	2,048,461	186,9	1,066,180	961,387	90,2	947,600	3,065,410	323,5
Shpenz. gjithsej	1,340,120	1,083,071	80.8	1,199,690	2,687,612	224	1,244,270	1,013,804	81,5	1,106,720	3,071,140	277,5
Investim e gjithsej	853,500	144,491	16.9	85,700	66,854	78,1	295,640	196,809	66,6	396,420	391,005	98,6
Numri i punon.	992	971	97.9	992	947	95.5	992	936	94.4	908	826	91
Paga mesatare mujore	30565	30235	98.9	30565	30332	99.2	34143	33984	99.5	35985	34793	96.7
Fondi i pagave	363840	352280	96.8	363840	344690	94.7	406440	381700	93.9	392090	344870	87.9

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Tabela nr. 3** “Programi dhe realizimi i të ardhurave për vitet 2019-2022”. *Në 000 lekë*

Emërtimi	2019			2020			2021			2022		
	Program	Realizim	%	Program	Realizim	%	Program	Realizim	%	Programi	Realizimi	%
Të ardhura gjithsej	1,124,470	974,584	86.7	1,095,990	2,048,461	186,9	1,066,180	961,380	90,2	947,600	3,065,410	323,5
Të ardhura pa subvenc.	397,240	270.464	68,1	378,790	232,371	61,3	372,380	186,650	50,1	268,800	295,770	110
Të ardhura të vlerës	327,230	304,120	92,9	317,200	1,416,090	446,4	293,800	374,730	127,5	288,800	2,268,640	785,5
Të ardhura nga subvenc.	400,000	400,000	100	400,000	400,000	100	400,000	400,000	100	390,000	501,000	128,5

**Në analizë sipas viteve objekt auditimi rezulton:****Viti 2019:** Të detajuar sipas zërave, të ardhurat dhe shpenzimet jepen në tabelën e mëposhtme:*Në 000lekë*

Nr.	Emërtimi	Viti 2019		Diferenca Prog./Real.	%	Realizimi 2018
		Programi	Realizimi			
<b>I.</b>	<b>Të Ardhurat</b>					
1.	Transp. Mallra	137,000	112,913	-24,087	82,4%	142,856
2.	Transp .Udhëtare	4,500	2,921	-1,579	64,9%	4,002
3.	Të tjera	582,970	458,750	-124,220	78,7%	553,089
4.	Subvencioni	400,000	400,000	0	100%	400,000
	<b>Total i të Ardhura</b>	<b>1,124,470</b>	<b>974,584</b>	<b>-149,886</b>	<b>86,7%</b>	<b>1,099,947</b>
<b>II.</b>	<b>Shpenzimet</b>					
1	Paga	363,840	352,275	-11,565	96,8%	341,389
2	Sig .shoqërore	60,760	59,339	-1,421	97,7%	57,593
3	Amortizim	513,400	417,183	-96,217	81,3%	498,559
4	Lëndë djegëse	123,700	87,198	-36,502	70,5%	102,755
5	Materiale	25,700	9,923	-15,777	38,6%	31,776
6.	Të tjera	260,330	157,153	-103,177	60,4%	214,809
	<b>Total i Shpenzimeve</b>	<b>1,347,730</b>	<b>1,083,071</b>	<b>-264,659</b>	<b>80,4%</b>	<b>1,246,881</b>
<b>III.</b>	<b>Rezultati financiar</b>	<b>-223,260</b>	<b>-108,487</b>	<b>-114,773</b>	<b>48,6 %</b>	<b>-146,934</b>

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Të ardhurat** paraqiten me diferencë negative 149.88 mln lekë, më pak se programi, kryesisht për arsye të diferencës:

*Në mln lekë*

Diferenca	Shkaku
- 24 mln lekë	Në të ardhurat nga transporti i mallrave
- 1,6 mln lekë	Në të ardhurat nga transporti udhëtarëve me shkaqet e trajtuara më lart
- 124,2	Në zërin "të ardhura të tjera" : - skrapit me 13.7 mln lekë ; - materialet me fondet e investimeve nga kryerja pjesore e daljeve nga magazina për materialet e vendosura në linja me 112.6 mln lekë të ardhurat nga diferenca e amortizimit të aseteve me 23.11 mln lekë dhe të tjera të ardhura që janë me plus 25.11 mln lekë

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Shpenzimet** paraqiten me diferencë negative 264.66 mln lekë. Në analizë të tyre përkundrejt programit, rezulton:

*Në mln lekë*

Zëri	Diferenca nga programimi	Shkaku
"Fondi pagave" /"sigurime shoqërore"	-13 mln lekë	Nga realizimi i numrit mesatar të punonjësve me 21 punonjës me pak se programi. (për periudhën që po analizojmë zë rreth 38 % të shpenzimeve të përgjithshme të Shoqërisë).
"Lëndë djegëse"	-36,5 mln lekë	Mos realizimi i vëllimit të programuar të punës në transportin e mallrave dhe udhëtarëve.
"Materiale"	-15,8 mln lekë	Për pamundësi financiare për blerje materialesh për kryerjen e riparimeve të mjeteve hekurudhore.
"Shpenzime të tjera"	-103,2 mln lekë	- Në shpenzimet për materiale nga investimi të pa realizuara në masën - 112.6 mln lekë, pasi është kryer vetëm pjesërisht dalja e tyre nga magazina për në linjë. - Shpenzimet për ujë, energji elektrike, telefon, pasuar nga shpenzime të tjera në vlera më të vogla të përealizuara me një total prej -33.45 mln lekë. - Rritjen e shpenzimeve nga penaltitetet, shpërblimet e pensionit, orë

Zëri	Diferenca nga programimi	Shkaku
		qëndrimet e vagonëve të huaj në masën +42.85 mln lekë.
“Amortizim”	-96,2 mln lekë	Mos përfshirja e vlerës së amortizimit të aseteve që i janë dhënë koncensionarit.

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Në transportin e Mallrave.** Në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e mos realizimit të treguesve të programuar të vëllimit të punës dhe të ardhurave, janë:

*Në mln lekë*

Zëri	Diferenca nga programimi	Shkaku
Transport Mallra	-24,087	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mosrealizimi i sasive të parashikuara për kompaninë K. është shkaku kryesor i mos realizimit të planifikimit .</li> <li>- nuk u bë i mundur transporti për kompaninë M. për shkaqe të kësaj të fundit.</li> <li>- Ka patur edhe mungesa e gazoilit për efekt të likuiditeteve për kryerjen e transportit të mallrave. Mos afrimi i subjekteve të ndryshme për të transportuar mallrat e tyre me hekurudhë, me pretendimin që nuk ka linja hekurudhore të përshtatshme dhe afër shesheve për shkarkimin e mallrave, apo mungesë sheshe shkarkimi.</li> </ul>

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Në transportin e udhëtarëve.**

*Në mln lekë*

Zëri	Diferenca nga programimi	Shkaku
Transport udhëtarësh	-1,579	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të ndërprerjeve të lëvizjes së trenave nga mungesa e furnizimit të lokomotivave me gazoil, si pasojë e mungesës së likuiditeteve për blerje gazoil.</li> <li>- Vonesat në zbatimin e orarit të lëvizjes së trenave (1200 të tilla)</li> <li>- Aksidentet hekurudhore me pasojë ndërprerje të lëvizjes së trenave dhe çrregullime në transportin e udhëtarëve. Gjatë 2019-s janë evidentuar 28 aksidente, nga të cilat 11 Përplasje me mjete automobilistike, 11 dalje të trenit nga shinat dhe 6 shtypje njerëzish.</li> <li>- Amortizimi i vagonëve të udhëtarëve si rrjedhojë e moskryerjes së investimeve për rinovimin e tyre Amortizimi i ambienteve të shërbimit udhëtar në pjesën më të madhe të stacioneve hekurudhore.</li> <li>- Mungesa shumëvjeçare e investimeve</li> <li>- Mjete të vjetërsuara (lokomotiva dhe vagonë).</li> </ul>

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Për vitin 2019 realizimi i investimeve në nivel objekti paraqitet.**

*Në lekë*

Emërtimi i produktit	Buxheti i programuar 2019	Realizimi
<b>Financimi i brendshëm</b>	<b>153,500,000</b>	<b>144,490,985</b>
Blerje traversa druri	29,160,000	29,160,000
Blerje pjese këmbimi dhe agregate për lokomotiva dhe vagonë	12,540,000	12,540,000
Rinovim agregatësh për lokomotiva	11,208,000	11,208,000
TVSH Hartimi i Projektit të detajuar Inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore "Vorë - Hani i Hotit (Kufi me Malin e Zi)"	20,000,000	17,299,120
Rikonstruksion i linjës hekurudhore Shkozet - Kavajë	15,000,000	13,760,017
Rikonstruksion i linjës hekurudhore Bajzë - Kufi	5,010,607	5,010,607
Rikonstruksion i reparteve dhe linjave hekurudhore të NJSHML	5,951,705	5,951,431
Rikonstruksion i godinës së NJSHML	5,646,271	5,646,238

Emërtimi i produktit	Buxheti i programuar 2019	Realizimi
Rikonstruksion i linjës Kavaje - Rrogozhine	10,252,169	9,397,608
Rikonstruksion i linjës hekurudhore Milot - Lezhë	14,713,122	14,682,572
Punime për mbrojtjen e linjës	9,448,288	5,265,554
Blerje aksesorë hekurudhore	7,080,000	7,080,000
Blerje çakëll për ballast hekurudhor	6,781,560	6,781,560
TVSH për studim fizibiliteti dhe rehabilitim i linjës Durrës-Pogradec-Lin dhe studimi i linjës me kufirin Maqedonas	708,278	708,278

Burimi i të dhënave HSH sha

**Viti 2020:** Të detajuar sipas zërave, të ardhurat dhe shpenzimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Në mln lekë

	Emërtimi	2020		Diferenca Prog./Real.	%	Realizimi Për vitin 2019
		Programi	Realizimi			
I.	Të Ardhurat					
1.	Transp. Mallra	160,070	51,542	-108,528	32	112,913
2.	Transp. Udhëtare	3,300	838	-2,462	25	2,921
3.	Të tjera	532,620	1596,810	1063,461	300	458,750
4.	Subvencioni	400,000	400,000	0	100	400,000
	<b>Total i të Ardhura</b>	<b>1,095,990</b>	<b>2,048,461</b>	<b>952,471</b>	<b>187</b>	<b>974,584</b>
II.	Shpenzimet					
1	Paga	363,840	344,697	-19,143	95%	352,275
2	Sig .shoqërore	60,760	57,898	-2,862	95%	59,339
3	Amortizim	431,400	299,135	-132,265	69%	417,183
4	Lëndë djegëse	126,500	25,584	-100,916	20%	87,198
5	Materiale	96,800	20,251	-76,549	21%	9,923
6.	Të tjera	120,390	1940,047	1819,657	1611%	157,153
	<b>Total i Shpenzimeve</b>	<b>1,199,690</b>	<b>2,687,612</b>	<b>1,487,922</b>	<b>224%</b>	<b>1,083,071</b>
III.	<b>Rezultati financiar</b>	<b>-103,700</b>	<b>-639,151</b>	<b>-535,451</b>	<b>616%</b>	<b>-108,487</b>

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Të ardhurat paraqiten me diferencë pozitive prej 952,47 mln lekë** më shumë se programi, kryesisht për arsye të rritjes me 1.064.2 mln lekë të zërit “Të tjera”:

Në mln lekë

Diferenca pozitive		Shkaku
Të tjera të ardhura të vlerës + të tjera të ardhura	1.148.9	Daljet jashtë përdorimit të vagonëve dhe linjave, kompensimet nga punonjësit për dëme, diferencat pozitive nga kurset e këmbimit dhe diferenca amortizimi.
Diferenca negative		
Zërit të tjera për skrapin	21.5	
Materialet me fonde investimesh	63.3	
Qiratë	0.7	Disa ambiente janë lëshuar nga qiramarrësi prej situatës së krijuar nga pandemia.

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Shpenzimet paraqiten me diferencë +1,487,9 mln lekë.** Në analizë të tyre përkundrejt programit, rezultojnë:

Në mln lekë

Zëri	Diferenca nga program.	Shkaku
“Fondi i pagave” & “sigurime shoqërore”	-22	Nga mosrealizimi i numrit mesatar të punonjësve me rreth 40 punonjës me pak se programi.
“Lëndë djegëse”	-100.9	Mos realizimi i vëllimit të programuar të punës në transportin e mallrave dhe udhëtarëve.



Zëri	Diferenca nga program.	Shkaku
“Materiale”	-76.5	Për pamundësi financiare për blerje materialesh për kryerjen e riparimeve të mjeteve hekurudhore.
Amortizim	-132.3	
“Shpenzime të tjera”	+1819.6	<p>1- Rritjen e shpenzimeve nga daljet jashtë përdorimi të vagonëve të mallit dhe udhëtarëve (total 67+8=75 vagonë) si dhe e linjave dytësore dhe degëzimeve të amortizuara, shpërblimet e pensionit, qiraja për Malin e Zi, rivlerësimi i aseteve në masën totale prej 1854.3 mln lekë.</p> <p>2-Shpenzimet për ujë, energji elektrike, telefon pasuar nga shpenzime të tjera në vlera më të vogla të përealizuara me një total prej -30.3 mln lekë.</p> <p>3-Shpenzimet për orë-qëndrimet e vagonëve të huaj të përealizuara në masën - 4.4 mln lekë</p>

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Në transportin e Mallrave.** Në zërin ” të ardhura të tjera”, përfshihen:

Në mln lekë

Zëri	Diferenca nga programimi	Shkaku
Transport Mallra	-108,528	<ul style="list-style-type: none"> <li>- transporti për skrap i Kompanisë ”K.”, zë 56% të totalit të volumit të punës së parashikuar; transporti i brendshëm për këtë zë përbën 32% të volumit të transportit të brendshëm të parashikuar. Mosrealizimi i sasive të parashikuara për kompaninë K., zë peshën kryesore në mosrealizimin e programit, pa anashkalluar dhe mosrealizimin e transportit të brendshëm, sidomos të cakullit në linjën Fier-Ballsh, që përbën 40% të volumit të parashikuar të transportit të brendshëm</li> <li>- Dëmtimi i urës së Ishmit nga tërmeti duke ulur kështu tarifën për transportin ndërkombëtar, pasi është shkurtuar distanca e transportit.</li> <li>- Situata ndërkombëtare e krijuar nga pandemia, që ka bllokuar transportin ndërkombëtar.</li> <li>- Mos afrimi i subjekteve të ndryshme për të transportuar mallrat e tyre me hekurudhë.</li> </ul>

Burimi i të dhënave HSH sha.

- Diferenca **pozitive këmbimi** që rrjedhin nga transaksionet në euro dhe kompensim dëmi nga punonjësit e NJBM (zhdëmtim gazoili) në një total prej 239.7 mijë lekë
- Të ardhura **nga dalja jashtë përdorimi të 67** vagonëve në vlerën 6.4 mil lekë
- Si dhe të ardhura **nga shitja e skrapit** në vlerën 18.6 mln lekë.

**Në transportin e Udhëtarëve.**

- Transporti i udhëtarëve paraqitet pothuajse inekzistent, duke pasur parasysh:
- Dëmtimin e Urës së Ishmit;
- Mungesën e karburantit për lokomotivat;
- Gjendjen e jashtëzakonshme të vendosur nga Covid-19 duke bllokuar transportin publik;
- Trenat udhëtar pothuajse nuk kanë lëvizur.

Në mln lekë

Zëri	Diferenca nga programimi	Shkaku
Transport udhëtarësh	-210.2	Mos realizimit të ndjeshëm të zërave kryesorë si: lënda djegëse (realizuar vetëm 10%) dhe taksa e hyrjes në infrastrukturë (realizuar vetëm 13%), si rezultat i mos realizimit të vëllimit të programuar të punës me të cilin këto dy zëra janë të lidhur drejtpërdrejtë, pasuar me mos realizim në vlera më të vogla dhe për shpenzimet e tjera.

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Investimet.** Në realizimin e investimeve me financim nga buxheti i shtetit, për vitin 2020, kanë ndikuar: Akti normativ nr.28, datë 02.07.2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, “Për

buxhetin e vitit 2020”, reflektuar në shkresën 5098/25, datë 28.07.2020 nga MIE si dhe ri-alokim në dhjetor 2020. Me nr.8844 prot., datë 17.12.2020, “Mbi zbatimin e aktit normativ nr 34, datë 16.12.2020”, ku bashkëlidhur është dhe plani i rishikuar për vitin 2020.

Shoqëria gjatë vitit 2020, ka pasur një situatë financiare me ndikim negativ në mbarëvajtjen e aktivitetit të saj, i thelluar edhe nga:

- dëmtimet në linjën hekurudhore prej tërmetit të nëntorit 2019;
- pandemia globale, që paralizoi ekonominë vendase me efekt të drejtpërdrejtë në transport;
- ulja me 48% e investimeve të planifikuara me buxhetin e shtetit, sipas ndryshimeve me Aktin Normativ nr.28, datë 02.07.2020, për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, reflektuar në shkresën 5098/25, datë 28.07.2020 nga MIE.

**Për vitin 2020 realizimi i investimeve paraqitet:**

*Në lekë*

Emërtimi i produktit	Buxheti i programuar 2020	Realizimi
<b>Financimi i brendshëm</b>	<b>85,700,000</b>	<b>66,856,717</b>
Rinovim agregatë për lokomotiva	6,444,000	6,444,000
Rikonstruksion i magazinave të NJSHML	7,000,000	
Rikonstruksion i linjës hekurudhore Shkodër – Hani Hotit	8,741,468	8,741,468
Rikonstruksion i linjës hekurudhore Shkozet – Kavajë (detyrim i prapambetur për financim)	1,125,000	855,121
Rik. i linjës Kavajë – Rrogozhinë (detyrim i prapambetur për financim)	858,000	857,033
Rikonstruksion i linjës hekurudhore Milot – Lezhë (detyrim i prapambetur për financim)	31,000	30,376
Punime për mbrojtjen e linjës	16,490,000	16,484,798
Blerje traversa betoni	9,544,800	9,544,800
TVSH Hartimi i Projektit të detajuar Inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore "Vorë - Hani i Hotit (Kufi me Malin e Zi)"	17,450,000	10,483,390
TVSH Supervizioni i punimeve "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Tirane dhe ndertimin e linjës së re hekurudhore për në aeroportin e Rinastit"	1,000,000	
TVSH IFRS - Standartizimi Ndërk. i Raportimit Financiar në Hekurudhat Shqiptare	300,000	
TVSH Plani I Menaxhimit të Aseteve dhe Met. e Tarifimit në Hekurudhat Shqiptare	800,000	
TVSH për hartimin e projektit të detajuar të linjës hek. terminali i transportit publik - stacioni i trenit Tirane (4 km) si zgjatim i linjës hekurudhore Durrës - Tirane	800,000	
TVSH Hartimi i Projektit të detajuar Inxh. për reh. e linjës hekurudhore Durrës Rrogozhine	13,415,732	13,415,731
TVSH Hartimi i Projektit preliminar Rrogozhine-Pogradec-Lin (Kufi me Maqedoninë e Veriut)	500,000	
Kosto Lokale Studim i Prefisibilitetit për lidhjen hekurudhore Pogradec- Greqi [Kristalopigj]	200,000	
Kosto Lokale Shërbime të transportit të mallrave që lidhin operatorët shpërndarës dhe transportues të mallrave/SCOPE	1,000,000	

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Viti 2021:** Të detajuar sipas zërave, të ardhurat dhe shpenzimet jepen në tabelën e mëposhtme:

*Në 000/lekë*

Emërtimi	Programi Për vitin 2021	Realizimi Për vitin 2021	Diferenca Prog./Real.	%	Realizimi Për vitin 2020
Të Ardhurat					
Transp. Mallra	108.610	56.563	-52.047	52,08	51.542
Transp .Udhëtare	3.000	1.149	-1.851	38,30	838
Të tjera	554.570	503.675	-50.895	90,82	1596.810

Subvencioni	400.000	400.000	0	100	400.000
<b>Total i të Ardhura</b>	<b>1.066.180</b>	<b>961.387</b>	<b>-104.793</b>	<b>90,17</b>	<b>2.048.461</b>
Shpenzimet					
Paga	406.440	381.700	-24.740	93,91	344.697
Sig .shoqërore	67.870	64.138	-3.732	94,50	57.898
Amortizim	417.400	342.357	-75.043	82,02	299.135
Lëndë djegëse	99.990	34.628	-65.362	34,63	25.584
Materiale	142.070	28.974	-113.096	20,39	20.251
Të tjera	110.490	162.007	51.517	146,62	1940.047
<b>Total i Shpenzimeve</b>	<b>1.244.260</b>	<b>1.013.804</b>	<b>-230.456</b>	<b>81,48</b>	<b>2.687.612</b>
<b>Rezultati financiar</b>	<b>-178.080</b>	<b>-52.417</b>	<b>-125.663</b>	<b>29,43</b>	<b>-639.151</b>

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Në zërin ” të ardhura të tjera”, përfshihen:** Në zërin “të ardhura të tjera” përfshihen të ardhura nga qiratë, konvertimi, skrap, materiale me fondet e investimeve, penalitetet, diferenca nga amortizimi i aseteve etj. Të ardhurat paraqiten me diferencë negative prej 104.79 mln lekë më pak se programi, kryesisht për arsye të uljes së të ardhurave në aktivitetin e transportit të mallrave dhe udhëtarë, konkretisht :

Në mln lekë

Diferenca		Shkaku
-52,05	Në të ardhurat nga transporti i mallrave	Rezultat i uljes së të ardhura në zërin e skrapit me minus 53.39 mln lekë, dhe pse ishte gati për tu realizuar një pjesë në muajin Dhjetor, materialet me fonde investimesh me minus 112.97 mln lekë, qiratë me plus 0.39 mln lekë, pasi disa ambiente janë lëshuar nga qiramarrësi prej situatës së krijuar nga pandemia, kuota pjesë e rimarrjes nga investimet me minus 2.61 mln lekë, të tjera të ardhura këmbimi valutor dhe të periudhave të kaluara rezultojnë me plus 36.75 mln lekë, si dhe të ardhura të vlerës (të mbartura ,diferenca e amortizimit) me plus 80.93 mln lekë.
-1,85	Në të ardhurat nga transporti udhëtarëve	
- 50,89	Në të ardhurat nga zëri te tjera te ardhura	-Diferenca pozitive këmbimi që rrjedhin nga transaksionet në euro dhe kompensim dëmi nga punonjësit e NJBM (zhdëmtim gazoili) në një total prej 6.571 mijë lekë. -Si dhe të ardhura nga shitja e skrapit në vlerën 13.217 mijë lekë.

Burimi i të dhënave HSH sha.

Mos realizimit të treguesve të programuar të vëllimit të punës dhe të ardhurave, janë:

- Në programin ekonomik, transporti për skrap i Kompanisë ”K.”, zë 84% të totalit të volumit të punës së parashikuar. Vetëm transporti i brendshëm për këtë zë përbën 49% të volumit të transportit të brendshëm të parashikuar. Mosrealizimi i sasive të parashikuara për kompaninë Kurum, zë peshën kryesore në mosrealizimin e programit, por edhe mosrealizimi i transportit të brendshëm, sidomos të çakullit në linjën Fier-Ballsh, që përbën 40% të volumit të parashikuar të transportit të brendshëm.

- Dëmtimi i urës së Ishmit nga tërmeti duke ulur kështu tarifën për transportin ndërkombëtar, pasi është shkurtuar distanca e transportit.

- Situata ndërkombëtare e krijuar nga pandemia, e cila bllokoi transportin ndërkombëtar.

- Mos afrimi i subjekteve të ndryshme për të transportuar mallrat e tyre me hekurudhë, me pretendimin që nuk ka linja hekurudhore të përshtatshme pranë shesheve për shkarkimin e mallrave apo dhe mungesë sheshe shkarkimi, duke marrë shkas nga vështirësitë e hasura në përpunimin e vagonëve në stacionin e Gjormit.

**Shpenzimet paraqiten me diferencë minus 230,47 mln lekë.** Në analizë të tyre përkundrejt programit, rezulton :

Zëri	Dif. nga prog.	Shkaku
“Fondi i pagave” “sigurime shoqërore”	-24.74	Nga mosrealizimi i numrit mesatar të punonjësve me rreth 55 punonjës me pak se programi.
“Lëndë djegëse”	-65.36	Mos realizimi i vëllimit të programuar të punës në transportin e mallrave dhe të udhëtarëve.
“Materiale”	-113.1	Pamundësi financiare të blerjes së materialeve për kryerjen e riparimeve të mjeteve hekurudhore me fonde të brendshme, por edhe si rezultat i realizimit të blerjeve të materialeve me fonde buxhetore në muajt e fundit të vitit.
“Shpenzime të tjera”	-51.52	- nga daljet jashtë përdorimi të aseteve me vlerë 19.06 mln lekë, shpërblimet e pensionit dhe reformës me plus 2.70 mln lekë, shpenzimet për interesa dhe këmbim valutë me plus 54.24 mln lekë, shpenzime për pagesa jashtë ndërmarrje me plus 31.28 mln lekë, shpenzime për pagesa penalitete dhe gjoba me 9.15 mln lekë. - Uljen e shpenzimeve për ujë, energji elektrike me minus 4.96 mln lekë, shpenzime telefonike me minus 2.46 mln lekë, shpenzime për udhëtim e dieta me minus 8.93 mln lekë, shpenzime për interesa dhe financiare me minus 34.66 mln lekë dhe shpenzime të tjera në vlera më të vogla të përcaktuara me një total prej -6.29 mln lekë. - Shpenzimet për orë-qëndrimet e vagonëve të huaj të përcaktuara në masën -8.15 mln lekë, ulje kjo e cila ka ardhur nga mos realizimi i volume të punës të programuara.
“Amortizim”	-75.04	Nga dalja e disa aseteve jashtë përdorimi, por edhe nga programimi jo si duhet i këtij zëri. Në lidhje me diferencën prej 75.04 milion midis Programit ekonomik dhe faktit në zërin amortizime rezulton se kjo diferencë ka ardhur si pasojë e rivlerësimit të aseteve të Hekurudhës Shqiptare sh.a. Me konkretisht projekt programi ekonomik është dorëzuar në Këshill Mbikëqyrës (shtator 2020) përpara se të vij raportit i rivlerësimit (dhjetor 2020). Me konkretisht diferencat vijnë si me poshtë për çdo njësi: NJBMIH (57.693 mln lekë), NJBM (10.793 mln lekë), NJBU (7.112 mln lekë) dhe HSH qendër (267 mijë lekë).

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Në transportin e Mallrave.** Në vështrim të dy tabelave, shihet që 54.8% e vëllimit të punës në ton dhe 54.9% e të ardhurave realizuar në vitin 2021, i përket transportit ndërkombëtar, pjesa tjetër i përket transportit të brendshëm. Këta tregues në përqindje **janë ulur krahasuar** me 6-mujorin e parë, pasi është rritur transporti i brendshëm në 6-mujorin e dytë si rezultat i kryerjes së transportit të skrapit nga Porti i Durrësit edhe pse nuk është realizuar parashikimi për këtë zë Transportit ndërkombëtar i përket dhe transporti i mallrave “të ndryshme” me 6.514 ton, ku përfshihen vaj me 5.316 ton, letër me 320 ton, llamarina me 598 ton, pasuar dhe nga mallra të tjera siç mund të përmendim pllaka etj., me sasi 280 ton. Vëllimi i përgjithshëm i punës në transportin e mallrave është realizuar me 2,751 vagonë, me ngarkesë mesatare 27.35 ton/vagon, nga të cilët 940 vagonë janë përdorur në transportin ndërkombëtar, me ngarkesë mesatare 35.49 ton/vagon.

**Në transportin e Udhëtarëve:** Të ardhurat nga transporti nuk janë realizuar me shkaqet e përmendura më lart.

Zëri	Dif. nga programimi	Shkaku
Transport udhëtarësh	-179.3	- Mos realizimit të ndjeshëm të zërave kryesorë si: lënda djegëse (realizuar vetëm 18,2%) dhe taksa e hyrjes në infrastrukturë (realizuar vetëm 22,5%), si rezultat i mos realizimit të vëllimit të programuar të punës me të cilin këto dy zëra janë të lidhur drejtpërdrejtë, pasuar me mos realizim në vlera më të vogla dhe për shpenzimet e tjera.

Burimi i të dhënave HSH sha.

### Investimet: Për vitin 2021 realizimi i investimeve paraqitet:

Emërtimi i produktit	Buxheti i programuar 2021(kontraktuar)	Realizimi
<b>A). Shuma, Financimi i brendshëm</b>	<b>123.271.015</b>	<b>67.278.297</b>
Rinovim agregatë për lokomotiva	8.278.800	8.268.000
Rikonstruksion i magazinave te NJSHML	7.021.758	7.005.071
Blerje traversa druri	36.045.734	5.074.345
Rikonstruksion i linjës hekurudhore Budull – Gjorme	9.958.895	9.932.073
Rikonstruksion i linjës hekurudhore Shkozet – Kavajë (detyrim i prapambetur për financim)	9.107.819	9.101.311
Rikonstruksion i linjës Kavaje – Rrogozhine	6.000.000	0
Rikonstruksion i linjës hekurudhore Milot – Lezhë	9.109.402	5.560.120
Punime për mbrojtjen e linjës	4.263.406	4.261.332
Blerje traversa betoni	11.159.544	11.159.544
Blerje aksesore hekurudhore	4.749.999	0
Riparim vepra arti	9.641.524	2.803.800
Punime nga vete hekurudha	5.000.000	3.269.101
Pajisje zyra për DP Hekurudha	424.800	424.800
Pajisje informatike për DP Hekurudha	418.800	418.800
Studime e projektme	1.000.000	0
Kosto lokale studim i fresibilitetit për lidhjen hekurudhore Pogradec-Greqi [Kristalopigy]	1.000.000	0
Kosto lokale promovimi i intermodalitetit dhe rilidhja hekurudhore ne rajonin Adriatik-Jon	50.000	0
TVSH shërbimi te transportit mallrave qe lidhin operoret shpërndarës dhe transportues te mallrave/SCOPE	41.534	0
<b>B). Shuma e TVSH-ve</b>	<b>168.709.510</b>	<b>128.433.101</b>
TVSH Sup. i punimeve "Rehabilitimi i linjes hek. Durrës - Tirane dhe ndërtimin e linjës se re hekurudhore për ne aeroportin e Rinasit"	95.286.630	95.286.629
TVSH Hartimi i Projektit të detajuar Inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore "Vorë - Hani i Hotit (Kufi me Malin e Zi)"	14.050.880	14.050.879
TVSH Sup. i punimeve "Rehabilitimi i linjes hek. Durrës - Tirane dhe ndërtimin e linjës se re hekurudhore për ne aeroportin e Rinasit"	20.000.000	9.766.383
TVSH Plani i Menaxhimit te Aseteve dhe Metodologjia e Tarifimit ne Hekurudhat Shqiptare	1.500.000	
TVSH Promovimi i Intermodalitetit dhe Rilidhja Hekurudhore ne Rajonin Adriatik-Jon	102.000	
TVSH studim i fresibilitetit per lidhjen hekurudhore Pogradec-Greqi [Kristalopigy]	1.720.000	
TVSH Hartimi i Projektit te detajuar Inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore Durrës Rrogozhine	14.050.000	9.329.210
TVSH Hartimi I Projektit preliminar Rrogozhine-Pogradec-Lin (Kufi me Maqedoninë e Veriut)	19.000.000	
TVSH Hartimi I Projektit preliminar Rrogozhine-Pogradec-Lin (Kufi me Maqedoninë e Veriut)	3.000.000	

Emërtimi i produktit	Buxheti i programuar 2021(kontraktuar)	Realizimi
<b>TOTALI A+B</b>	<b>291.980.525</b>	<b>196.809.241</b>

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Viti 2022:** Të detajuar sipas zërave, të ardhurat dhe shpenzimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

	Emërtimi	2022		Diferenca Prog./Real.	%	Realizimi Për vitin 2021
		Programi	Realizimi			
<b>I.</b>	<b>Të Ardhurat</b>					
1.	Transp. Mallra	22,700	2,368	-20,332	10,4	56,563
2.	Transp. Udhëtare	1,200	1,130	-70	94,2	1,149
3.	Të tjera	533,700	2560,907	+2,027,207	479,8	503,675
4.	Subvencioni	390,000	501,000	+111,000	128,5	400,000
	<b>Total i të Ardhura</b>	<b>947,600</b>	<b>3,065,400</b>	<b>+2,117,800</b>	<b>323,4</b>	<b>2,117,800</b>
<b>II.</b>	<b>Shpenzimet</b>					
1	Paga	392,090	344,875	-47,215	88	381,700
2	Sig .shoqërore	65,480	58,027	-7,453	88,6	64,138
3	Amortizim	396,680	313,166	-83,514	78,9	342,357
4	Lëndë djegëse	29,940	9,688	-20,252	32,4	34,628
5	Materiale	111,600	35,820	-75,78	32	28,974
6.	Të tjera	110,930	2309,567	2198,640	2082	162,007
	<b>Total i Shpenzimeve</b>	<b>1,106,720</b>	<b>3,071,143</b>	<b>+1,964,423</b>	<b>277</b>	<b>1,013,804</b>
<b>III.</b>	<b>Rezultati financiar</b>	<b>-159,120</b>	<b>-5,738</b>	<b>153,382</b>	<b>3,6</b>	<b>-52,417</b>

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Të ardhurat** paraqiten me diferencë pozitive prej 2.117.8 mln lekë më shumë se programi, kryesisht për arsye të rritjes së të ardhurave nga subvencioni si dhe të ardhurave të tjera të vlerës nga punimet e linjës Durrës-Tiranë dhe nxjerrja e mjeteve lëvizëse nga NJBM jashtë përdorimit.

Në mln/lekë

Diferenca +/-	Shkaku
+ 111	Të ardhurat nga subvencioni
+ 1,979.8	Në të ardhurat e tjera të vlerës (rezerva nga rivlerësimi i aseteve)
-27	Të ardhurave nga transporti i mallit dhe udhëtarit, nga qiratë, materialet me fonde investimesh, skrapi e të tjera të ardhura, ku bien në sy mosrealizimi për transportet si dhe për të ardhurat nga skrapi dhe investimet, ndërkohë që në rezultat pozitiv janë të ardhurat e tjera dhe nga qiratë.

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Shpenzimet** paraqiten me diferencë + 1,964.4 mln lekë. Në analizë të tyre përkundrejt programit, rezultojnë diferenca e shpenzimeve në zërat :

Në mln/lekë

Zëri	Dif.nga prog.	Shkaku
“Fondi i pagave” “sigurime shoqërore”	-54,6	Nga mosrealizimi për vitin 2022 të numrit mesatar të punonjësve me rreth 82 punonjës më pak se programi kjo ka ardhur nga ri-organizimi i Shoqërisë që nga data 01.10.2022 ku numri i punonjësve u reduktua në 659 në total nga 992 të tillë deri në datë 30.09.2022.
“Lëndë djegëse”	-20,25	Nga mos realizimi i vëllimit të programuar të punës në transportin e mallrave dhe të udhëtarëve.

Zëri	Dif. nga prog.	Shkaku
“Materiale”		
“shpenzime të tjera”	-2,198,64	Lidhet kryesisht me rritjen e shpenzimeve nga daljet jashtë përdorimi të aseteve si mjete lëvizëse të NJBM-së dhe asete të linjës Durrës-Tiranë.
“Amortizim”	-83,5	Nga dalja e disa aseteve j. përd., por edhe nga programimi jo si duhet i këtij zëri
Fonde investimesh	-75,78	Për pamundësi financiare të blerjes së materialeve për kryerjen e riparimeve të mjeteve hekurudhore me fonde të brendshme, por edhe si rezultat i realizimit të blerjeve të materialeve me fonde buxhetore në muajt e fundit të vitit.

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Në transportin e Mallrave:** Mosrealizimi i ndjeshëm i volumeve të planifikuara të transportit si në ton dhe në ton/km paraqitet me shumë mos realizim, konkretisht:

*Në mln lekë*

	Emërtimi	2022		Diferenca Prog./Real.	%	Realizimi Për vitin 2021
		Programi	Realizimi			
I.	<b>Të Ardhurat</b>					
1.	Transp. Mallra	22,700	2,368	-20,332	10,4	56,563

Burimi i të dhënave HSH sha.

### Shkaqet:

- Mos finalizimin e marrëveshjes për transport ndërkombëtar të skrapit, pasi palët e treta që operonin me këtë transport nuk arritën të pajiseshin, brenda afateve të nevojshme për zhvillimin e këtij transporti, me licencën përkatëse për transport mallrash të rrezikshme ;
- Transporti kombëtar (i brendshëm) nuk është planifikuar në programin e rishikuar në muajin prill 2022, pasi:
  - o zëri kryesor i tij në programin fillestar ishte transporti skrapit nga Porti i Durrësit në Elbasan, i cili nuk mund të realizohej për shkak të shkeljes së kontratës së mëparshme nga Kurum;
  - o mos arritjes në një marrëveshje të përbashkët për zgjidhjen e situatës. duhej riparuar ura e Rrogozhinës që bllokonte lëvizjen nga Jug-perëndimi drejt Durrësit.
  - o nuk mund të kryhej lëvizja gjatë segmentit Durrës-Tiranë, ku është edhe numri më i përqendruar i bizneseve.

### Realizimi i zërit “Të tjera” përbëhet nga:

1-2,952.9-ton vaj ushqimor për D.20 G. transportuar me 75 vagonë të RCH-së me ngarkesë mesatare 39.37 ton/vagon.

2- 720-ton çakëll transportuar për 16 Februar me 15 vagonë privatë me ngarkesë mesatare 48 ton/vagon.

### Për vitin 2022 realizimi i investimeve paraqitet:

*Në lekë*

Emërtimi i produktit	Buxheti i programuar 2022 (kontraktuar)	Realizimi
<b>A). Shuma, Financimi i brendshëm</b>	<b>63,041,747</b>	<b>62,603,270</b>
Rik. i linjës hek. Milot-Lezhë (prapambetur viti 2021 sit përfundimtar + mbikëqyrje + kolaudim)	3,550,000	3,545,409
Riparim vepra arti	45,914,250	45,683,808
Pajisje informatike për DP Hekurudhave	2,000,000	1,886,400
Rikonstruksion i reparteve dhe linjave hekurudhore të NJSHML	11,377,497	11,287,653
Kosto lokale shërbime të transportit të mallrave që lidhin operatorët		200,000

shpërndarës dhe transportues	200,000	
<b>B). Shuma e TVSH-ve</b>	<b>334,449,712</b>	<b>329,473,255</b>
TVSH Sup. i punimeve "Reh. i linjës hekurudhore Durrës - Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në aeroportin e Rinasit"	301,871,231	301,871,231
TVSH Hartimi i Projektit të detajuar Inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore "Vorë - Hani i Hotit (Kufi me Malin e Zi)"	2,598,481	2,598,481
TVSH Supervizioni i punimeve "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në aeroportin e Rinasit"	12,000,000	12,000,000
TVSH për hartimin e projektit të detajuar të linjës hek. terminali i trans. publik-stacioni i trenit Tiranë si zgjatim i linjës hek. Durrës-Tiranë	13,000,000	8,104,200
TVSH Zhvillimi i planit të menaxhimit mjedisor dhe social të ndërtimit (CESMP) dhe sistemeve të menaxhimit mjedisor dhe social	1,600,000	1,519,343
TVSH studim i fis.për lidhjen hek. Pogradec-Greqi [Kristalopigy]	3,210,000	3,210,000
TVSH Prom.i Intermod.dhe Rilindja Hek.e në Rajonin Adriatik-Jon	170,000	170,000
<b>Totali A+B</b>	<b>397,491,459</b>	<b>392,076,525</b>

Burimi i të dhënave HSH sha.

### **Humbja**

**Viti 2019;** Humbja e realizuar për vitin 2019, me -114.77 mln lekë më pak se humbja e programuar i dedikohet tërësisht uljes së shpenzimeve. Krahasuar me vitin 2018, ku humbja reale ka qenë në masën 146,93 mln lekë, në 2019 humbja është lehtësuar realisht me 32,16 mln lekë, lidhur kryesisht me rritjen e zërit “të ardhura të tjera” nga skrapi, materialet nga investimet, qiratë, penaltitetet etj. Humbja në 2019 në masën 108,48 mln lekë, është reduktuar me vlerën e fitimeve të pa shpërndara (të ardhura të mbartura) në masën 304.12 mln lekë, që vjen nga diferenca ndërmjet amortizimit të asetëve me vlerë të rivlerësuar me asetet me vlerë të pa rivlerësuar (vlera historike). Kjo në zbatim të standardeve kombëtare të kontabilitetit.

**Viti 2020:** Humbja e realizuar për 2020, me -535,4 mln lekë më shumë se humbja e programuar, i dedikohet mosrealizimit të të ardhurave për transportin e mallit dhe udhëtarëve si rezultat e dëmtimit të linjës hekurudhore nga tërmeti dhe situata e krijuar në rang botëror nga pandemia si dhe rritjes së ndjeshme të “shpenzimeve të tjera” nga daljet jashtë përdorimit dhe rivlerësimi.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, ku humbja ka qenë në masën 108,5 mln lekë, humbja është thelluar me 530,6 mln lekë, lidhur kryesisht me daljet jashtë përdorimit dhe diferencat nga rivlerësimi i asetëve. Rezultati financiar i Njesisë rezulton me + 238.6 mln lekë nga ndikimi i masës së subvencionit në totalin e të ardhurave të realizuara si dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të 8 vagonëve, por dhe realizimit mjaft të ulët të shpenzimeve, me shkakun e mos realizimit të vëllimit të programuar të transportit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit. Ndikim këtu ka mos realizimi i shpenzimeve të lëndës djegëse me -63 milion lekë, taksës së infrastrukturës me -128 milion lekë, shpenzimet e riparimit me -13 milion lekë dhe shpenzimet administrative me -5 milion lekë, këto si rezultat i mos realizimit të vëllimit të programuar të transportit për arsye dhe të ndërprerjes së transportit publik prej pandemisë. Rezultati financiar i Njesisë rezulton pozitiv si në 2020-n, ashtu dhe në 2019-n, si efekt i masës së subvencionit, por diferenca më e lartë në vitin 2020 ka ardhur edhe si rezultat i mosrealizimit të shpenzimeve për arsyet e përmendura më sipër.

**Viti 2021:** Humbja e realizuar për vitin 2021 me +125,66 mln lekë, pra më pak se sa humbja e programuar, i dedikohet jo vetëm mosrealizimit të shpenzimeve sipas zërave të programuar, por edhe mos realizimit të të ardhurave për transportin e mallit dhe udhëtarëve si rezultat kjo edhe i dëmtimit të linjës hekurudhore nga tërmeti si dhe situata e krijuar në rang botëror nga pandemia.



Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, ku humbja ka qenë në masën 639,15 mln lekë, humbja është reduktuar me 586,98 mln lekë, lidhur kryesisht me daljet jashtë përdorimit dhe diferencat nga rivlerësimi i asetëve ku efektet e të cilave janë përfshirë në PF të vitit 2020.

**Viti 2022;** Humbja e realizuar për vitin 2022 me -5,738 mln lekë, pra 153,382 mln lekë më pak se sa humbja e programuar, i dedikohet jo vetëm mosrealizimit të shpenzimeve për shkak të nxjerrjeve jashtë përdorimit të asetëve, por edhe mos realizimit të të ardhurave për transportin e mallit dhe udhëtarëve si rezultat kjo edhe i dëmtimit të linjës hekurudhore nga tërmeti (ura e Ishmit) dhe mos riparimit të saj por edhe nga mos-funksionimi i linjës Durrës-Tiranë prej punimeve të ri-ndërtimit të saj.

### **Mbi detyrimet debitoare dhe kreditore të Shoqërisë.**

**Për vitin 2019:** Në total vlera e detyrimeve debitoare deri më **31.12.2019**, është **65,53 mln lekë**, nga 76,2 mln lekë që ishin në të njëjtën periudhë të vitit 2018. Nga kjo vlerë, detyrimet pa shpresë arkëtimi (me konflikt), janë në vlerën 61,51 mln lekë, ndërsa vlera e detyrimeve të arkëtueshme janë në vlerën 4,2 mln lekë. Vlera e përgjithshme e detyrimeve kreditore (borxhe) deri më **31.12.2019**, është **1,939,46 mln lekë** nga 1,939,9 mln lekë që ishin në të njëjtën periudhë të vitit 2018. Në këtë vlerë, janë përfshirë detyrimet nga më emergjente me 304.7 mln/lekë.

**Për vitin 2020;** Në total vlera e detyrimeve debitoare është 67.46 mln lekë, nga 65.5 mln lekë që ishin në vitin 2019. Nga kjo vlerë, detyrimet pa shpresë arkëtimi (me konflikt), kapin vlerën 61.52 mln lekë, ndërsa vlera e detyrimeve të arkëtueshme janë në vlerën 5.94 mln lekë. Vlera e përgjithshme e detyrimeve kreditore (borxhe) deri më 31.12.2020, është 1,896,16 mln lekë nga 1.939.46 mln lekë që ishin në vitin 2019. Në këtë vlerë, janë përfshirë detyrimet nga më emergjente me vlerë 396.34 mln lekë, paraqiten analitike në tabela në total sipas viteve.

**Për vitin 2021:** Në total vlera e detyrimeve debitoare është 79,51 mln lekë, nga 67,46 mln lekë që ishin në vitin 2020. Nga kjo vlerë, detyrimet pa shpresë arkëtimi (me konflikt), kapin vlerën 61,89 mln lekë, ndërsa vlera e detyrimeve të arkëtueshme janë në vlerën 17,62 mln lekë. Shoqëria është në proces gjyqësorë për arkëtimin e shumës 13,2 mln lekë me kompaninë K.I., ndërsa vlera e mbetur për 4,42 mln lekë është e mundshme për tu arkëtuar në periudhën në vazhdim, ku nga këto vetëm 797,951,lekë janë arkëtuar. Vlera e përgjithshme e detyrimeve kreditore (borxhe) deri më 31.12.2021, është 2,010,48 mln lekë nga 1,896,16 mln lekë që ishin në vitin 2020. Në këtë vlerë, janë përfshirë detyrimet nga më emergjente me vlerë 553,30 mln lekë, paraqiten analitike në tabela në total sipas viteve.

**Për vitin 2022:** Në total vlera e detyrimeve debitoare është 84,85 mln lekë, nga 79,51 mln lekë që ishin në vitin 2021. Nga kjo vlerë, detyrimet pa shpresë arkëtimi (me konflikt), kapin vlerën 68,46 mln lekë, ndërsa vlera e detyrimeve të arkëtueshme janë në vlerën 16.39 mln lekë. Shoqëria është në proces gjyqësorë me kompaninë T. I., Durrës Sh.G., dhe me subjektin Xh. Gj., (difer.gazoil) për të arkëtuar vlerat monetare që këto subjekte i kanë Shoqërisë Hekurudhës Shqiptare. Vlera e përgjithshme e detyrimeve kreditore (borxhe) deri më 31.12.2022, është 2,002,56 mln lekë nga 2,010,48 mln lekë që ishin në vitin 2021.

Në këtë vlerë, janë përfshirë detyrimet nga më emergjente me vlerë 563,68 mln lekë, paraqiten analitike në tabela në total sipas viteve. Tabelat në total sipas viteve:

- **Të tjera detyrime (borxhe) ndaj të tretëve:**

*Në mln lekë*

	<b>Të tjera detyrime (borxhe) ndaj të tretëve :</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>
1	Detyrime ndaj furnitorëve për blerje karburante	6,4	16,85	23,70	29,17

	<b>Të tjera detyrime (borxhe) ndaj të tretëve :</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>
2	Detyrime sig. shoqërore/shëndetësore	24,4	8,2	46,39	6,78
3	Detyrime për orë qëndrime të vagonëve të huaj	221,1	236,9	238,12	225,80
4	Detyrime ndaj shoqërive private të ruajtjes të shoqërive fizike, në vitin 2018 këto detyrime kanë qenë në vlerën e 60.6 mln lekë	52,8	42	39,28	32,66
5	Detyrime fiskale TAP dhe tatim në burim		0,49	2,39	0,88
6	Detyrime për pagat e punonjësve		26,8	28,56	24,65
7	Detyrime ndaj furnitorëve për shërbime (eksp.kontabël)		33,4	54,08	60,63
8	Detyrime për interesa të orë-qëndrimeve		31,7	34,65	58,67

Burimi i të dhënave HSH sha.

- **Të tjera detyrime (borxhe) ndaj të tretëve**

*Në mln lekë*

	<b>Të tjera detyrime (borxhe) ndaj të tretëve</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>
1	Detyrime ndaj furnitorëve për mallra	20,7	2,9	3,46	3,91
2	Detyrime ndaj furnitorëve për shërbime	70,5	29,5	46,23	51,69
3	Detyrime ndaj buxhetit për qiratë e ambienteve	25,5	25,9	25,93	25,93
4	Detyrime për pagat e punonjësve (Dhjetor)	26,3			
5	Detyrime të tjera (eksp.kontabël, pension ushqimor etj.)	7,2	7,2	6,68	6,63
6	Detyrime nga parapagimet e kreditorëve	4,4	21,1	3,31	36,15
7	Detyrime fiskale TAP dhe tatim në burim	0,9			
8	Të tjera detyrime	0,6	0,6	0,52	0,13

Burimi i të dhënave HSH sha.

**Detyrimet ndaj hekurudhave të huaja:** Nga auditimi rezultoi se, detyrimet ndaj hekurudhave të huaja, për orë qëndrimet e vagonëve që i përkasin periudhës 2009-2019, ka edhe detyrime ndaj hekurudhave të huaja të krijuara **në vitin 1990 - 1995, me vlerë sipas tabelës sa më poshtë vijon:**

<b>Lloji kredisë/ grantit</b>	<b>2019</b> vlera në		<b>2020</b> vlera në		<b>2021</b> vlera në		<b>2022</b> vlera në	
	mln lekë	valutë	mln lekë	valutë	mln lekë	Valutë	mln lekë	valutë
Kredia Italiane	58,99	516,456,9 Euro	106,48	860,761 Euro	83,16	688,609,19 Euro	58,99	516,456,9 Euro
Banka Botërore	107,05	1,000,000 Euro	100,84	1,000,000 Euro	106,54	1,000,000 Euro	107,05	1,000,000 Euro
Granti Japonez	187,85	491,690 euro 1,230,108 USD	184,87	491,690 Euro 1,230,108 USD	190,32	491,690 Euro 1,230,108 USD	187,85	491,690 Euro 1,230,108 USD
MFE kredinë Italiane	303,53	2.657.170,76 Euro	258,3	2,116,182 Euro	299,31	2,478,562,74 Euro	303,53	2.657.170,76 Euro

Burimi i të dhënave HSH sha

Detyrimi që ka HSH sha, për kredinë Italiane e marrë në vitin 1995, bazuar në VKM nr.178 dt.18.04.1995, në shumën 3.098.741.39 euro ose “6 miliard lireta”, vlerë kjo e cila është përdorur për financimin e projektit “Rikonstruksionit të linjës hekurudhore në segmentin Durrës-Tiranë”. Deri në vitin 2007, HSH sha, ka paguar vlerën e interesave, ndërsa nga viti 2008 dhe në vazhdim kërkohet që të kthehet edhe vlera e principalit të kredisë. HSH sha, deri në vitin 2008, ka likuiduar rregullisht detyrimet e principalit dhe të interesave. Për periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2022 si rezultat i situatës së vështirë që është përballur HSH sha, detyrimet janë likuiduar nga ana e MFE. Sa i takon detyrimin për shlyerjen e kredisë Italiane, theksojmë se për periudhën 2009 deri më 31.12.2022, principali prej 2,410,132,20 euro, ose 275,31 mln lekë dhe interesat prej 247,038,56 euro, ose 28,22 mln lekë janë shlyer nga MFE në total 303.53 mln/lekë. HSH sha për çdo vit (2009-2022) ka berë rakordimet me MFE.

Detyrimi që ka HSH sha për kredinë e Bankës Botërore e marë në vitin 1995 është 1,000,000 USD, dhe në vlerë leku 58,994,871 lekë 107,050,000 lekë, vlerë kjo e cila është përdorur për financimin e një pjese të projektit të rikonstruksionit të linjës hekurudhore Kashar-Tiranë, pra brënda segmentit të rikonstruksionit të linjes Durrës-Tiranë. Hekurudha Shqiptare nuk ka as një informacion se si do të veprohet për likuidimin e këtij detyrimi.

Detyrimi që HSH sha ka për grantin Japonez, të ardhur në vitin 2002-2003 është 1,230,107 USD, dhe në vlerë leku 131,683,053 lekë si dhe 491,690 Euro në vlerë leku 56,165,749 lekë. Në total vlera e grantit japonez e konvertuar në lekë është 187,848,802 lekë.

Gjithashtu edhe për këtë detyrim, Hekurudha Shqiptare nuk ka as një informacion se si do të veprohet për likuidimin e vlerës së këtij granti, sepse deri tani nuk është kërkuar për likuidimin e kësaj vlere me 1,230,107 USD dhe 491,690 Euro. HSH sqaron se siç kanë vepruar edhe me kredinë Italiane dhe atë të Bankës Botërore kanë bërë vetëm konvertimin për çdo fund viti të vlerës së dollarit dhe të euros.

Situata financiare dhe akumulimi i detyrimeve kreditore kanë si shkak vështirësinë mjaft të madhe për përballimin e likuiditeteve, si efekt: Amortizimi i mjeteve dhe linjave hekurudhore; Rënies së madhe të vëllimit të punës; Pamundësia e përthithjes së stafit të kualifikuar.

**Hekurudhat e huaja përveç detyrimeve të vjetra** dhe ato të periudhës 2009-2019, pra principlialit, **kërkohet edhe shlyerja e interesave**, konkretisht:

Periudha e detyrimit	Vendi i huaj	Detyrimi	Interesa
2009-2019	Hekurudha Serbe	412,7 mijë euro	139,7 mijë euro
	Hekurudha Hungareze	234 mijë euro	99,3 mijë euro
deri në vitin 1995	Hekurudha Serbe	3,434,7 mijë USD	10,275,1 mijë USD

Burimi i të dhënave HSH sha.

Për sa i përket detyrimeve të vjetra theksojmë se vetëm për hekurudhat e ish Jugosllavisë, sipas pasqyrave financiare që disponon HSH, borxhi është 6,886,478 USD, ku problem për këtë është ndarja e detyrimeve sipas hekurudhave që ekzistojnë sot, pra pas ndarjes së ish Jugosllavisë.

Lidhur me detyrimet ndaj hekurudhave të huaja, të vjetra dhe të reja mendojmë, që nëpërmjet MFE, sipas përkatësisë së çdo shteti që i përkasin këto borxhe, të mundësohet marrëveshje ndërshtetërore. Theksojmë se sipas ligjit nr.142/2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, sipas nenit 12, pika 1, thuhet: „Këshilli i Ministrave ngre mekanizmin dhe përshtat politikat për të ndihmuar uljen e borxhit të sipërmarrjeve hekurudhore dhe/ose administruesit të infrastrukturës me pronësi publike apo të kontrolluara, me synim përmirësimin e administrimit dhe gjendjes së tyre financiare. Në pikën 3 të këtij neni thuhet, Ministria përgjegjëse për transportet merr përsipër rregullimin dhe administrimin e të gjitha borxheve të akumuluar në sistemin hekurudhor shqiptar deri në hyrjen në fuqi të këtij kodi.

Lidhur me situatën financiare dhe sidomos të borxheve që HSH disponon kjo e fundit i është drejtuar disa herë Këshillit Mbikëqyrës të HSH sha, MIE dhe MFE, por nuk është marrë asnjë prononcim apo udhëzim nga ana e Ministrive të linjës.

**Përdorimi i subvencioneve shtetërore.** Subvencioni sipas viteve objekt auditimi është dhënë me shkresat sa vijon:

Shkresa MIE:	Objekti	Shkresa e MFE	Shuma lekë	Baza ligjore
Viti 2022: 147/4,	Rrjet hekurudhor i	Nr.22922/138, 24.01.22, ka miratuar detajimin e	390,000,000	Ligji nr.115/ 2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ndryshuar

<i>Shkresa MIE:</i>	<i>Objekti</i>	<i>Shkresa e MFE</i>	<i>Shuma lekë</i>	<i>Baza ligjore</i>
22.01.22	subvencionuar	planit për shpenzimet korrente <sup>3</sup>		UMFE nr.9, datë 20.03.18, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” Shkresa e MFE nr.22922/138, datë 24.01.22
5967/6, 06.09.2022		Nr.14405/109, 29.08.22, ka miratuar ndryshimet ne detajimin e planit për shpenzimet korrente	110,000,000	Akti Normativ nr.12, datë 29.07.2022, “Për disa ndryshime në ligjin 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ndryshuar; UMFE nr.9, datë 20.03.18, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; MFE nr.22922/138, datë 24.01.22
<b>Viti 2021:</b> 590/1, 18.01.21	Rrjet hekurudhor i subvencionuar	Nr.23724/67, 14.01.21, ka miratuar detajimin e planit për shpenzimet korrente	400,000,000	Ligji nr.137/ 16.11.20, “Për buxhetin e vitit 2021”, ndryshuar; UMFE nr.9, datë 20.03.18, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” Shkresa e MFE nr.23724/67, datë14.01.21
<b>Viti 2020:</b> 130/5, 31.01.20	S`ka objekt	Nr.24325/86, 24.01.20, ka miratuar detajimin e planit për shpenzimet korrente	400,000,000	Ligji nr.88/ 18.12.19, “Për buxhetin e vitit 2020”, ndryshuar; UMFE nr.9, datë 20.03.18, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” Shkresa e MFE nr.24325/86, datë 24.01.20
<b>Viti 2019:</b> 15503/4, 17.01.19	Rrjet hekurudhor i subvencionuar	Nr.22760/55, 11.01.19, ka miratuar detajimin e planit për shpenzimet korrente	400,000,000	Ligji nr.99/ 2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, UMFE nr.9, datë 20.03.18, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” Shkresa e MFE nr.22760/55, datë 11.01.19

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha

**Nga auditimi rezulton se nga ana e MFE me shkresat përkatëse është miratuar detajimi i planit për shpenzimet korente, ndërkohë që emërtimi i produktit është “rrjet hekurudhor i subvencionuar”.**

Në opinionin e grupit të auditimit emërtimi “Rrjet hekurudhor i subvencionuar” është në kundërshtim me pikën 26, 58 dhe 63, të nenit 5, të ligjit nr.142/2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohen përkufizimet sa vijon:

“26. “Infrastrukturë hekurudhore” është tërësia e vijave hekurudhore, degëzimeve hekurudhore, pajisjeve dhe instalimeve të ndërlidhjes, të sinjalizimit dhe pajimeve elektrike, stacioneve, të domosdoshme për qarkullimin e mjeteve hekurudhore dhe sigurinë e trafikut, drejtimi dhe administrimi i të cilave i është caktuar ligjërisht një administruesi të infrastrukturës.

58. “Rrjet” janë linjat, stacionet, терминаlet dhe të gjitha llojet e pajisjeve fikse, të nevojshme për të siguruar funksionimin e sigurt dhe të pandërprerë të sistemit hekurudhor.

63. “Sistem hekurudhor” është infrastruktura e përbërë nga linjat dhe instalimet fikse të rrjetit hekurudhor, si dhe mjetet hekurudhore të të gjitha kategorive dhe origjinave që udhëtojnë në atë infrastrukturë”. Pra rrjeti nuk është veprimtari por objekt.

Nga ana tjetër nga auditimi dokumentacionit për periudhën objekt auditimi, për përdorimin/realizimin e subvencionit sipas shkresave dërguar MIE-s dhe Degës së Thesarit Durrës, subvencioni ka numër artikulli 603000 “Subvencione për transportin hekurudhor” (sipas nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik) dhe jo artikullin përkatës për të cilin është kryer shpenzimi faktik.

<sup>3</sup> Shpenzimet korente përbëjnë shumën e të gjithë shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes, që kryen një njësi për një periudhë të caktuar kohore, dhe përfshin kostot e vazhdueshme të njësisë për përmbushjen e funksioneve të përditshme. Në këtë kategori përfshihen: shpenzime personeli për paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli, kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore; mallra dhe shërbime të tjera; subvencionet; transferimet korente të brendshme; transferimet korente jashtë; transferita për buxhetet familjare dhe individët; Fondi i veçantë; Rezervat.

Nga sa rezulton, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), Dega e Thesarit Durrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar), me veprimet apo mosveprimet e tyre, kanë krijuar një situatë të paqartë për alokimin dhe përdorimin e subvencionit nga HSH sha, duke i krijuar kësaj shoqërie mundësinë që ta përdor këtë subvencion për paga dhe sigurime shoqërore, duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi të akorduar po nga MFE.

Për ndryshimin e destinacionit të subvencionit, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr.1313/12 prot, datë 20.06.2018, ka çuar për indicie për ndjekje penale për përdorimin e subvencionit për vitin 2017, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, dhe pas hetimit dhe kalimit në shkallët e gjyqësorit Gjykata e Apelit Durrës, ka vendosur ndryshimin e vendimit penal nr (11-2019- 1312) 309 datë 06.03.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës dhe pranimin e kërkesës për pushimin e çështjes penale nr.1119, të vitit 2018, të Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Durrës. Vendimi është shpallur datë 15.05.2019.

**Nga auditimi rezulton se shpenzimet për paga, përmbaram dhe pagesa fiskale, mbulohen kryesisht nga subvencionit i dhënë me objekt “rrjet hekurudhor i subvencionuar”**

Nr.	SHPENZIMET	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019
A	Paga	319,757,000	340,245,324	310,793,397	319,791,315
B	Pagesa me përmbaram	67,278,000	2,186,062	3,452,452	1,960,426
C	Pagesa Fiskale	158,871,000	59,493,375	88,386,101	80,712,383
	<b>Totali A+B+C</b>	<b>545,906,000</b>	<b>401,924,761</b>	<b>402,631,950</b>	<b>402,464,124</b>
	BURIMET	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019
	Gjendje		13,442	14,722	51,846
	<b>Vlere nga subvencionit</b>	<b>500,780,000</b>	<b>400,000,000</b>	<b>400,000,000</b>	<b>400,000,000</b>
	Lapsus banke			2,455,000	2,377,000
	Ardhura NJBM	33,895,000			
	Ardhura NJBM (qira vagoni)	5,235,000			
	NJBU	255,000			
	NJBMIH	2,649,000			
	Të tjera	3,092,000			
	NJBMINF Lala shpk		100,000		
	Investim thesari punime vet hekurudha		1,812,606		
	Bashkia Durrës qira			155,945	
	Bashkia Rrogozhinë				50,000
	Derdhje nga arka			19,725	
	<b>Totali i burimeve</b>	<b>545,906,000</b>	<b>401,926,048</b>	<b>402,645,392</b>	<b>402,478,846</b>
	<b>% e mbuluar nga subvencionit</b>	<b>91.73</b>	<b>99.52</b>	<b>99.35</b>	<b>99.39</b>

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha

**Shënim: Lapsuse nga Banka.** Ne vitin 2020, banka me datë 07.05.2020 ka marrë dhe i ka rikthyer brenda ditës shumën

Në vitin 2019, Lapsus nga R.B., fondi i pagave te NJSHML gabimisht nga banka ka kaluar për llogari të kontributeve të sigurimeve dhe gjendja e bankes ka dalë me -.

Për të mos lënë punonjësit pa paga është lidhur kontratë nr rep 2907 dhe nr. Kol 1271, datë 11.10.2019, me objekt disbursim fondesh. Këto fonde kanë kaluar në paga.

Nga ku rezulton se shpenzimet për paga, pagesa për përmbaram dhe detyrime fiskale janë mbuluar nga subvencionit në masën nga viti 2019 për 99.4% deri në vitin 2022 në 91.73%, me tendencë në ulje për vitin 2022 në masën 7%. Këto shpenzime kanë kaluar me artikullin 603000 në Degën e Thesarit Durrës. Pas miratimit të programit ekonomik nga MFE, nga HSH sha, janë përgatitur kontrata për marrëveshjen financiare shtetërore e cila i është dërguar MIE-s, sipas viteve sa vijon:

Viti	Shkresa nr/datë	Administratori	Qëllimi i marrëveshjes Subvencionimi i HSH sha	Miratimi i programit ekonomik
2019	136/ 31.01.19	A. D.	për mbulimin e shpenzimeve operative	Nr. 1, datë 10.01.2019
2020	279/ 09.03.20	A. D.	për mbulimin e shpenzimeve operative	Nr.16, datë 19.12.2020
2021	138/ 29.01.21	A.D.	për mbulimin e shpenzimeve operative	Nr.7, datë 13.11.2020
2022	279/ 18.03.22	A. D.	për mbulimin e shpenzimeve operative	Nr.2, datë 02.03.2022

Këto marrëveshje janë firmosur në mënyrë të njëanshme vetëm nga HSH sha dhe në asnjë rast nuk janë firmosur nga MIE.

Ecuria e treguesve ekonomiko-financiare për vitet e fundit 2019, 2020, 2021 dhe 2022, pasqyron një krize likuiditeti HSH sha, si dhe ka detyrime të prapambetura ndaj të tretëve si kredi afatshkurtër e afatgjatë, për principial dhe interesa, fatura për blerje etj., në vlerën 3,870,023 mijë lekë (totali i detyrimeve afatshkurtra 1.096.943 mijë lekë + totali i detyrimeve afatgjata 2.773.080 mijë lekë). Në opinionin e grupit të auditimit Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sh.a Durrës, është në gjendje falimentimi. MIE dhe MFE, e kanë përdorur subveconin si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë HSH sha.

Duke e zbritur subvencionin si e ardhur e shoqërisë, humbjet thellohen edhe më tej. Në mënyrë të detajuar tabela si më poshtë vijon:

Viti (Në 000/lekë)	2019	2020	2021	2022
Të ardhura	670,466	632,374	586,656	796,768
Shpenzime	1,083,071	2,687,612	1,013,805	3,071,143
Rezultati	<b>-412.605</b>	<b>-2.055.238</b>	<b>-427.149</b>	<b>-2.274.376</b>

Pa llogaritur subvencionin si e ardhur gjendja është sa vijon:

Viti (Në 000/lekë)	2019	2020	2021	2022
Të ardhura	169,686	232,374	186,656	396,768
Shpenzime	1,083,071	2,687,612	1,013,805	3,071,143
Rezultati	<b>-913,385</b>	<b>-2,455,238</b>	<b>-827,149</b>	<b>-2,674,375</b>

Sa më sipër është vepruar jo në përputhje me: ligjet nr.115/ 2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ndryshuar; nr.137/ 16.11.20, “Për buxhetin e vitit 2021”, ndryshuar; nr.88/ 18.12.19, “Për buxhetin e vitit 2020”, ndryshuar; nr.99/ 2018, “Për buxhetin e vitit 2019” dhe UMFE nr.9, datë 20.03.18, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

## 2.4 Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit:

*a- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës, bankës në lekë dhe në valutë, blerjet e vogla për periudhën objekt auditimi (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.).*

- **“Zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullaritet mbi veprimet e kryera nëpërmjet arkës”.** Nga auditimi i dokumentacionit të arkës për vitet 2019, 2020, 2021, 2022, bazuar në mandat arktimet dhe mandat pagesat, librin e arkës, dhe dokumenteve të tjera justifikuese, për arkëtimet dhe pagesat e kryera, u konstatua që dokumentet ishin plotësuar sipas nenit 4, pika 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kreut III, pika 34 dhe 35, geramat a, b dhe c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Nga auditimi me zgjedhje bazuar në vlerësimin e riskut u auditua: *Për vitin 2019: muaji qershor, shtator, tetor, nëntor; Për vitin 2020: muaji janar, shkurt, nëntor, dhjetor; Për vitin 2021: muaji maj, shtator, nëntor; Për vitin 2022: muaji shkurt, qershor, shtator, tetor.*



Veprimet e kryera me arkë janë kryer në lekë dhe në monedha të huaja. Kontabilizimi i veprimeve të mandat arkëtimeve dhe mandat pagesave është bërë sipas pozicioneve të përcaktuara në planin kontabël të cilat janë rakorduar me librin ditor të arkës. Nga auditimi nuk u konstatuan pasaktësi. Nga krahasimi i gjendjes kontabël të arkës sipas të dhënave të pasqyruara në ditarin e kontabilizimeve dhe të librit të arkës ka përputhje.

Për veprimet me arkën, janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar me ligjin nr.25/2018, neni 6, neni 7 dhe neni 23, pika 5, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Kreu IV, pika 80, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Dokumentat e arkës që vërtetojnë lëvizjen e parave nga arka janë të firmosura dhe personat e caktuar me këtë funksion janë të ligjshëm, kjo sepse në mandat pagesat e arkës për derdhje në bankë, firmos Nëpunësi Zbatues dhe ekonomistja që bën derdhjen në bankë, pagesa të cilat arkëtohen të gjitha në llogarinë e thesarit.

Punonjësi i caktuar me administrimin dhe ruajtjen e vlerave monetare kishte kualifikimin e duhur për realizimin e kësaj detyre dhe nuk kishte pengesa ligjore, ishte me arsim të lartë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Përsa i përket ruajtjes së vlerave monetare të njësisë, nga pikpamja e sigurisë fizike, u konstatua se ambjenti dhe kushtet ku ruhen vlerat monetare ishin optimale, kjo në zbatim të pikës 72, të UMF nr. 30, datë 27/11/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike".

Nga verifikimi i ditarit të arkës, u konstatua se për të gjithë periudhën e audituar të ardhurat që vijnë kryesisht nga tarifat e aktivitet të transportit të udhëtarëve dhe nga qeratë e ambienteve që disponon Njësia e Biznesit Menaxhimit Infrastruktural Infrastruktural (NJBMI) të cilat shoqërohen me mandat arkëtimet përkatëse.

- **Zbatimit i ligjshmërisë dhe rregullaritetit në veprimet e kryera nëpërmjet bankës.**

Nga auditimi me zgjedhje bazuar në vlerësimin e riskut u auditua periudha: *Për vitin 2019: muaji qershor, shtator, tetor, nëntor; Për vitin 2020: muaji janar, shkurt, nëntor, dhjetor; Për vitin 2021: muaji maj, shtator, nëntor; Për vitin 2022: muaji shkurt, qershor, shtator, tetor.*

Në auditimin e ushtruar për rregullshmërinë e plotësimit dhe përpunimit të dokumentacionit të bankës, u konstatua se pagesat e kryera nëpërmjet degës së thesarit, përgjithësisht janë mbështetur në dokumentat justifikuese si fatura, situacione, përmbledhëse, listë pagesave etj.

Përpilimi i urdhër shpenzimeve dhe urdhër transfertave ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si: urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër shpenzim dhe urdhër transfertë, përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Nga verifikimi i shumave të urdhër shpenzimeve, për periudhën 12-mujore, për vitet periudhë auditimi, rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Të ardhurat dhe shpenzimet i përkasin periudhës raportuese, të rakorduar këto me Degën e Thesarit. Llogaria e disponibiliteteve në Thesar është e barabartë me rezultatin e ushtrimit e rakorduar me Degën e Thesarit. Dokumentacioni bazë që pasqyron veprimet e kryera me bankë e magazinë është pasqyruar në ditarët përkatës.

Në pagesat me bankë për periudhën e audituar rregjistrimi i veprimeve kontabile në ditar është kryer në mënyrë kronologjike dhe konformë planit kontabël. Dokumentacioni është i sistemuar dhe i rregjistruar në ditarin përkatës të bankës dhe shuma e veprimeve të kryera përputhet me ekstratin vjetor të lëshuar nga banka, të cilat, në të gjitha rastet kuadrojnë me ditarin e

shpenzimeve të konfirmuara nga Dega e Thesarit Durrës. Shumat e shpenzuara për periudhat objekt auditimi rezultoi se të ardhurat dhe shpenzimet i përkasin periudhës raportuese, të rakorduar këto me Degën e Thesarit.

*Pavarësisht sa u theksua më sipër, nga auditimi u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore që në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:*

- Nga auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se Shoqëria Hekurudha Shqiptare SHA, për vitet periudhën objekt auditimi, ka paguar gjoba në lidhje me kryerjen me vonesë të pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pagesa përmbaues privat detyrime të cilat kanë lindur si rrjedhojë e mos likuidimit në afatet e përcaktuara në kontratat e lidhura me sipërmarrësit, pagesa tatimi në burim etj. Për periudhën e auditimit, shuma e paguar nga ana e Shoqërisë është **30,787,598 lekë**. (të paraqitura në **Aneksin 2.4/a**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit).

<b>Titulli i gjetjes</b>	Hekurudha Shqiptare SH.A Durrës për periudhën objekt auditimi është penalizuar me gjoba nga sistemi i tatimeve për mos derdhjen në kohë të kontributeve si dhe ka paguar detyrime ndaj përmbauesve të ndryshëm privat në vlerën <b>30,787,598 lekë</b> .
<b>Situata:</b>	Hekurudha Shqiptare” SHA, për vitet periudhën objekt auditimi, ka paguar gjoba në lidhje me kryerjen me vonesë të pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pagesa përmbaues privat detyrime të cilat kanë lindur si rrjedhojë e mos likuidimit në afatet e përcaktuara në kontratat e lidhura me sipërmarrësit, pagesa tatimi në burim etj. Për periudhën e auditimit, shuma e paguar nga ana e Shoqërisë është 30,787,598 shumë e cila është efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë. Shoqëria nëpërmjet subvencioneve të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë (MFE), ka likuiduar detyrimet fiskale të ndryshme, likuidime të tjera të kërkuara nga zyrat përmbauese, si shkak mos likuidim në kohë të kontratave të ndryshme. Sa trajtuar është jo në përputhje me “Kodi i procedurës civile” , i ndryshuar; Ligji i Prokurimit Publik nr. 162, datë 23.12.2020, RRPP nr.285 datë 19.05.2021, i ndryshuar “Zbatimi i detyrimeve të Kontratave”; ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligji nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. “Kodi i procedurës civile” , i ndryshuar; Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 RRPP Nr.285 datë 19.05.2021, i ndryshuar “Zbatimi i detyrimeve të Kontratave”;
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e shqipërisë” i ndryshuar.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Situata e mësipërme ka shkaktuar efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë duke e rënduar akoma më shumë këtë të fundit e cila ndodhet në një situata tepër të vështirë financiare.
<b>Shkaku:</b>	Kjo situata e shkaktuar ka ardhur si rrjedhojë e gjendjes së rënduar financiare dhe pamjaftueshmërisë të likuiditeteve të nevojshme për shlyerjen e detyrimeve të ndryshme.



**Rëndësia:**

E lartë

**Rekomandim:**

Shoqëria të marrë masat e nevojshme që në ta ardhmen të eliminojë efektet financiare negative. Shoqëria duhet të marrë në konsideratë që mos shlyerja në kohë e detyrimeve të ndryshme ndaj punonjësve si (derdhja e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat personale etj) si dhe zgjidhja e kontratave me të tretët në gjykatë do të rëndonte akoma më shumë financat e shoqërisë.

Theksojmë se kjo situatë, mos likuidimi në kohë i kontributeve të sigurimeve shoqërore /shëndetësore dhe TAP, të cilat në mënyrë automatike shoqërohen me penalitete nga sistemi tatimor, kur përfundon afati i fundit i pagesës, ka ardhur si shkak i gjendjes së rënduar financiare të shoqërisë e shoqëruara me mungese likuiditetesh. Shoqëria nëpërmjet subvencioneve të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë (MFE), ka likuiduar detyrimet fiskale të ndryshme, likuidime të tjera të kërkuara nga zyrat përmbarimore, si shkak mos likuidim në kohë të kontratave të ndryshme.

- **Shpenzimet për udhëtime, dieta dhe shpenzimet e karburantit.**

Shpenzimet për udhëtime e dieta dhe shpenzimet e karburantit për periudhën e auditimi paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

000/Lekë

Vitet	Shpenzime Dieta		% e realizimit	Shpenzime karburant		% e realizimit
	Plan	Realizim		Plan	Realizim	
2019	15,400	8,189	53.18	123,700	87,198	70.49
2020	15,800	3,569	<b>22.59</b>	126,500	25,584	<b>20.22</b>
2021	13,800	4,870	<b>35.29</b>	99,990	34,628	<b>34.63</b>
2022	10,000	1,869	<b>18.69</b>	29,940	9,688	<b>32.36</b>
<b>Totali</b>	55,000	18,497	33.63	380,130	157,098	41.33

Burimi i të dhënave: HSH sha

Referuar tabelës së mësipërme, konstatohet se, shpenzimet e kaburantit dhe shpenzimet për udhëtime e dieta paraqiten me realizim shumë të ulët, për gjithë periudhën e audituar. Shpenzimet e karburantit janë kryesisht për mjetet lëvizëse për transportin e mallrave (lokomotivat) si dhe udhëtarëve të cilat kanë qenë në rënie nga viti në vit pasqyruar dhe në tabelën e mësipërme. Si shkak i realizimit shumë të ulët, ka ndikuar ulja e transportit të skrapit i kompanisë “K.”, e cila zë 84% të totalit të volumit të punës së parashikuar. Vetëm transporti i brendshëm për këtë zë përbën 49% të volumit të transportit të brendshëm të parashikuar. Mosrealizimi i sasive të parashikuara për kompaninë “K.”, zë peshën kryesore në mosrealizimin e programit, pa anashkaluar dhe mosrealizimin e transportit të brendshëm, sidomos të cakullit në linjën Fier-Ballsh, që përbën 40% të volumit të parashikuar të transportit të brendshëm. Dëmtimi i urës së Ishmit nga tërmeti ka ulur tarifën për transportin ndërkombëtar, pasi është shkurtuar distanca e transportit. Si dhe situata ndërkombëtare e krijuar nga pandemia, që ka bllokuar transportin ndërkombëtar.

- **Shpenzime karburanti:** Volumin më të madh të shpenzimeve të karburantit zënë kryesisht NJBU si dhe NJBM pasi lënda djegëse e tërhequr përdoret për vënie në lëvizje të lokomotivave, përqindje e cila është përlllogaritur mbi vlerën në lekë të shpenzuar, paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Njësia shpenzuese	Vitet:			
	2019	2020	2021	2022
Njësia e Biznesit të Udhëtarëve dhe Njësia e Biznesit të Mallrave	94.9%	90.1%	90%	74.7%
Shpenzime për njësitet e tjera	5.1%	9.9%	10%	15.3%

Burimi i të dhënave: HSH sha

Në lidhje me shpenzimet e karburantit për lokomotivat e NJBU si dhe NJBM, Shoqëria është mbështetur në “Udhëzimin Metodik mbi normimin e Karburanteve”, Ministria e Telekomunikacionit (Drejtoria e Furnizimit Materialo-Teknik), Tiranë, Mars/1985. Normativat e përdorimit të karburanteve për lokomotivat që punojnë në transportin e mallrave janë të mbështetura në Udhëzimin Metodik, Kapitulli III/1, Normativat e përdorimit të karburanteve, ku ka të përcaktuar metodat e përlogaritjes së harxhimit të karburantit referuar normave në litra/100 ton bruto, km të konvertuar, volumin e punës gjithsej të kryer në të gjithë linjën hekurudhore, normave në litra për 100/km, normave në litra për një ore/pune, normave në litra për një vagon etj. Duhet theksuar se normativat e harxhimit për lëvizjen e lokomotivave janë shumë më të larta se normativat e harxhimit të automjeteve që disponon Shoqëria dhe si e tillë argumentimi i nevojave është bërë në mënyra të ndryshme. Ndërkohë që për shpenzimet e karburantit për automjetet/makinat që disponon Shoqëria si dhe njësitë e tjera, janë mbajtur fletë udhëtimet për shpenzimet mujore, ku janë përshkruar data, vendi i nisjes dhe mbërritjes, distanca në km e përshkuara. Fletë udhëtimet janë firmosur nga titullari duke përcaktuar qëllimin e shërbimit, personat udhëtues, programin e shërbimit, etj. Për periudhën objekt auditimi shpenzimet e karburantit nuk kanë tejkaluar nivelin e programuar.

- **Shpenzime udhëtimi e dieta brenda dhe jashtë vendit:** Janë kryer bazuar në Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës, nr.19, datë 11.10.2018, "Për shpenzimet e dietave dhe udhëtimit për punonjësit që shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit", bazuar në VKM nr.329, datë 20.04.2018, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit", ku janë përcaktuar kriteret e përfitimit të dietave për qëllime shërbimi si edhe masa e përfitimit prej 5,500 lekë/ditë dhe 1,200 lekë/ditë, për shërbimet me largësi mbi 50 km, Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.15, datë 06.06.2018 dhe VKM nr.870, datë 14.12.2011, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit".

Nga auditimi i shpenzimeve për dietat rezultoi se ka pasur trajtim financiar për punonjësit të cilët janë dërguar jashtë vendit, e cila lidhet kryesisht me takime koordinuese dhe shpjeguese në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës hekurudhore si dhe diskutime të ndryshme në lidhje me investimet e mundshme në rrjetin hekurudhor, të cilat janë mbajtur në vendë të ndryshme të Europës. Dokumentacioni justifikues është i plotë, ka të përcaktuar axhendën dhe ditët e qëndrimit, aprovimin e titullarit të Institucionit, qëllimin e shërbimit, personat udhëtues, programin e shërbimit etj. Në lidhje me trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen jashtë rrethit rezultoi se, ka dokumentacioni justifikues dhe janë dërguar kryesisht në trajnime të ndryshme në Tiranë, kontrolle të ndryshme të kryera në Njësitë Rajonale, takime dhe dëgjesa publike në lidhje me projekte të ndryshme etj. Nga auditimi i shpenzimeve të udhëtimit, u konstatua se urdhër shërbimet janë plotësuar korrekt referuar dokumentacionit justifikues bashkëlidhur.

- **Analiza dhe vlerësimi zbatimit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël viti 2019,2020,2021,2022.**

Hekurudha Shqiptare Sha sipas viteve 2019, 2020, 2021, 2022 ka realizuar 162 procedura blerje me vlera të vogël, në shumën 18,566,239 lekë, për blerjen e artikujve dhe shërbimeve si dhe të grup artikujve dhe grup-shërbimeve. Nga auditimi i **zonës së llogarisë 602**, për blerjet me vlera të vogla, sipas viteve objekt auditimi, rezultoi se janë zhvilluar sa vijon:

Vitet	Blerje të vogla		Seleksionuar për tu audituar bazuar në riskun e auditimit		
	Numër	vlerë	numër	vlerë	në % ndaj totalit
<b>6 mujori 2019</b>	41	4,200,827	17	1,744,838	41.4%

Vitet	Blerje të vogla		Seleksionuar për tu audituar bazuar në riskun e auditimit		
	Numër	vlerë	numër	vlerë	në % ndaj totalit
<b>2020</b>	35	4,061,779	15	2,597,980	42.8%
<b>2021</b>	51	5,674,159	18	1,854,200	35.2%
<b>2022</b>	37	4,627,474	11	2,911,630	29.7%
<b>Totali</b>	<b>164</b>	<b>18,566,239</b>	<b>61</b>	<b>91,08,648</b>	<b>37.1%</b>

- Ngritja dhe zgjedhja e komisionit BVV është bërë në fillim të vitit, sa më poshtë vijon:

Viti	Urdhëri	Komisioni i BVV
2019	nr.45/1, datë 15.01.2019	L.D., kryetare, L.K., E. K.
2020	nr.3, datë 13.01.2020	L.D., kryetare, L.K., E. K.
2021	nr.18, datë 08.01.2021	L.D., kryetare, L.K., E. K.
2022	nr.82/1, datë 25.01.2022	L.D., kryetare, A.G., Sh.V.

Procedurat e prokurimit me blerje me vlera të vogla, të audituara me të dhënat specifike sipas UMF nr.57, datë 12.06.2014, “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, paraqiten sipas aneksit 2.4/b, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit. Nga auditimi i tyre rezultoi se:

- Në asnjë rast të përdorimit të formës së prokurimit “Blerje me vlerë të vogël”, fondi limit nuk ka qenë mbi 800,000 lekë pa TVSH, pra mbi kufirin monetar të përcaktuar me vendimin e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 56, “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël”.

- Në të gjitha rastet AK ka bërë përlllogaritjen e fondit limit, duke u bazuar në ofertat e marra në treg dhe të pasqyruara dokumentin e hartuar për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.

- Nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është zbatuar limiti i përcaktuar për prokurimet me vlera të vogla i cili nuk është tejkaluar në asnjë rast.

- Nuk ka copezim fondi.

- Miratimi i kërkesës për prokurim në të gjitha rastet janë miratuar nga Nëpunësi i Autorizuar i AK.

- Shpallja elektronike në sistem e procedurës, është realizuar në kohën e përcaktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël në të gjitha rastet, pasi kanë krijuar në sistem dosjen e tenderit, u janë drejtuar nëpërmjet ftesës për ofertë (sipas formularit nr. 3), 5 operatorëve ekonomikë për një periudhë 1-2 ditë nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit.

- Në të gjitha rastet është zbatuar kriteri i çmimit më të ulët për klasifikimin përfundimtar.

- Në të gjitha rastet nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, është mbajtur procesverbal për shpalljen e OE fitues, mbi bazën e ofertës më të ulët të shpallur nga sistemi. (Në të gjitha rastet ishin printuar ofertat e gjeneruara nga sistemi).

-Në të gjitha rastet OE fitues është njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik. Në rastet e tërheqjes së ofertave të vendeve të para është dokumentuar me shkresat zyrtare nga operatorët ose printimit nga sistemi i emali<sup>ve</sup> të kryera nga AK (njoftimi) dhe OE (përgjigja).

-Procesverbalet e mbajtura nga komisioni për kalimin tek operatori i radhës kanë qenë të firmosura nga komisioni.

- Në dosjen e prokurimeve me vlera të vogla ndodheshin Faturat Tatimore Shitje, të njëjta me vlerën e ofertuar si dhe me urdhër shpenzimet përkatëse.

- Për gjithë periudhën objekt auditimi për procedurat me blerje te vogla, është bërë inventarizimi i dosjeve dhe arkivimi, sipas Udhëzimit nr. 3, të APP, datë 08.01.2018,“Për zhvillimin e

Prokurimeve me vlerë të vogël në sistem të prokurimit elektronik për autoritetin kontraktor dhe operatorët ekonomik, ku thuhet shprehimisht që “Autoriteti kontraktor duhet të bëjë arkivimi e procedurës së prokurimit brenda 1ditë punë nga mbyllja e fazës së njoftimit fitues”, pasi faza arkivimit të kontratës është e papërfunduar.

-Për të gjitha rastet e blerjeve si për shërbimet dhe mallrat është kryer procesi i marrjes në dorëzim të mallit dhe shërbimit nga komisioni i ngritur për çdo rast nga Nëpunësi Autorizues.

*Pavarësisht sa u theksua më sipër, nga auditimi u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore që në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:*

Nga auditimi u konstatua se në të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të vogël **për vitet periudhë auditimi 2019, 2020, 2021 raste ku fatura tatimore e pranuar nuk është e nënshkruar nga anëtarët e komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, por nënshkruhet vetëm nga njëri prej anëtarëve apo magazinieri i njësisë**, ndërkohë që fatura tatimore duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 59, pika 2, Udhëzimin e APP-së nr.3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pikat 5, 7 dhe 19. Pas implementimit të sistemit të fiskalizuar e cila në mënyrë elektronike bën të mundur firmosjen dhe vulosjen e faturave të ndryshme, e bën të pamundur firmosjen nga anëtarët e komisionit të blerjeve të vogla.

**Konkluzion:** Nga auditimi i pagesave për blerje me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël rezultoi se procedurat në përgjithësi ishin të plotësuara dhe dokumentacioni bashkëlidhur përbën gjurmën e auditimit të këtyre procedurave në të gjitha fazat dhe hapat e kryera për realizimin e këtyre procedurave deri në momentin e kontabilizimit të tyre në përputhje me ligji nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, kreu II, Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, pika 2 dhe me UMF nr.57 datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

## **b- Nxjerrja e bilancit kontabël në afat, plotësimi i pasqyrave financiare sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe**

**4/d Mbajtja e evidencës kontabël në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e varësisë, analiza e debitorëve , kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore etj., ndaj buxhetit të shtetit.**

Shoqëria “Hekurudha Shqiptare sha Durrës” (HSH), është krijuar si shoqëri anonime me Urdhër të ish Ministrisë së Ekonomisë dhe Privatizimit nr. 15, datë 15.11.2000 (MFE) dhe regjistruar si person juridik në regjistrin tregtar me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 24830, datë 18.12.2000. Themelues i shoqërisë është aksionari i vetëm, Ministria e Financës dhe Ekonomisë. HSH është regjistruar në organin tatimor në Durrës me NIPT-in J..... D. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ndryshuar, si dhe nga statuti dhe legjislacioni shqiptar në fuqi. HSH sha, është shoqëri me kapital 100% shtetëror e përfaqësuar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë dhe është e organizuar me katër njësi dhe HSH qendër.

**Veprimtaria ekonomike** e shoqërisë rregullohet sipas dispozitave ligjore: Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligji nr. 10276, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Statuti i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sha; Legjislacioni tatimor e fiskal në fuqi; si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

**Objekti i veprimtarisë të shoqërisë “Hekurudha Shqiptare sha Durrës”** është “Transporti hekurudhor i udhëtarëve, i mallrave dhe ngarkim shkarkimi i tyre”.

**Për vitin 2021:** Me vendim nr. 99, datë 24.12.2021, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve, kapitali themeltar i Shoqërisë është zvogëluar 929,152 mijë lekë, vlerë kjo e cila përfaqëson fitimet e pa shpërndara dhe humbjet e periudhës 2018-2020. Gjatë vitit 2022 me zhbllokimin e QKB nga përmbauesit e ndryshëm është regjistruar dhe zvogëlimi i kapitalit.

**Për vitin 2022:** Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 10.05.2022, i cili ka hyrë në fuqi në 3-mujorin e IV, të vitit 2022, për ndryshimet në strukturat e njësive të biznesit është ulur numri i punonjësve me 110. Sipas këtij Vendimi, numri total i punonjësve do të ishte 659 persona. Kjo masë e shoqërisë, për të shkurtuar fuqinë punëtore është ndërmarrë në kuadrin e reduktimit të kostove të punës, reformimit dhe investimeve që po kryhen në HSH sha.

Nga auditimi i kryer u konstatua se, për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022, të dhënat kontabël dhe pasqyrat financiare janë mbyllur në afat. Edhe njësitë i kanë dorëzuar në Qendër në afatin e caktuar.

**Miratimet e pasqyrave financiare** janë bërë me vendimet e Këshillit Mbikëqyrës sa vijon:

Periudha	Dorëzuar në KM, nr./ datë	Vendimet e KM nr./ datë	Miratimi nga Ministria e linjës	Humbja për t'u bartur	Dorëzuar në organet tatimore
2019	836/1 19.08.20	3/ 03.09.20	16474/1 26.09. 20	412.605	28.06.20
2020	389/2 01/07/21	5/ 07.07.21	12427/1 29.07. 21	2.055.238	22.07.21
2021	763/ 19.07.22	8/ 27.07.22	14587/1 08.08. 22	427.149	10.03.22
2022	-	-	-	2.274.376	27.02.23

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha

**Për PF të vitit 2022, deri në përfundim të periudhës së auditimit, nuk janë paraqitur ekspertët kontabël.**

**Ekspertët kontabël të autorizuar sipas viteve janë:**

2019	2020	2021	2022
A. N. A.S. E. A. L.A. shpk	E. A. B.S. L.A. shpk G. A.	L.A. L.P. A&B A E. R. R A.	V.D. R.A. A.S. B.B.

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha

**Hekurudha Shqiptare SHA, Durrës operon me bankat:**

Banka	Numri i llogarive bankare	
R. B.	7	
A.B.	4	
B.B.	11	E bllokuar
C.B.	3	E bllokuar
O.+A.	4	E bllokuar
I. S. P.	2	E bllokuar
U.B.	2	E bllokuar
T.B.	1	E bllokuar

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha

*Shënim: vlera e bllokimit deri më datë 31.12.2022 është në shumën 756,921 lekë.*

**Objekt i auditimit** janë pasqyrat financiare të cilat përfshijnë bilancin kontabël, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, fluksit të parave dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare. Auditimi është fokusuar vetëm në aspektet që kanë të bëjnë me *auditimin financiar*. Duke kryer verifikimin e vërtetësisë dhe të koordinimit të të dhënave origjinale të Shoqërisë, nëpërmjet kontrollit të dokumenteve të mbajtura nga administratorët; krahasimin e besueshmërisë së të dhënave të kontabilitetit dhe analizimin kritik të tyre me aftësinë e tyre për të dhënë informacion, nëpërmjet rishikimit sistematik të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare; krahasimin e të dhënave të bilancit, shqyrtimin kritik të tij dhe krahasimin me parametra ligjor të përcaktuar. Regjistrimet kontabël janë të bazuara në dokumentacionin bazë, i cili është i autorizuar dhe i aprovuar nga personat e ngarkuar, me autoritetin që kanë në përputhje me rregullin e brendshëm. Çdo departament përgatit pasqyrat përkatëse të cilat konsolidohen nga departamenti qendror. Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Aktivitet monetare përfaqësojnë paratë në bankë dhe në arkë, të cilat janë vlerësuar dhe mbahen me vlerën e drejtë. Regjistrimet e transaksioneve në monedhë të huaj, janë regjistruar në kontabilitet me kursin e datës së kryerjes së transaksionit.

**Nga auditimi konstatohet:**

- Mungesa e politikave për provizionimin e borxheve të këqija.

**4. Titulli i Gjetjes:** Mungesa e politikave për provizionimin e borxheve të këqija.

<b>Situata:</b>	Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2022, huatë afatgjata dhe detyrimet e tjera afatgjata, paraqiten në vlerën 1,438,887 mijë lekë, kjo bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit nr. 37, në fuqi. Objektivi i SNK 37 është të sigurojë se janë zbatuar kriteret e duhura të njohjes dhe bazat e matjes për provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara. Në këtë vlerë, Shoqëria nuk ka përfshirë vlerat për interesa dhe kamatëvonesa të arritura sipas marrëveshjeve të huave. Shoqëria ka njohur në vitin 2000 provizionet afatgjata në vlerën 237,250 mijë lekë, që lidhen drejtpërdrejt me detyrimet e mundshme të huave dhe detyrimeve. Me shkresën nr. 48 prot., datë 19.01.2023, HSH sha, i është drejtuar MFESë, për të krijuar kushtet e nevojshme për likuidimin e borxheve të huaja. Duke marrë në konsideratë shumën e penaliteteve të pa llogaritura, pretendimet e hekurudhave të huaja dhe kostot potenciale për zgjidhjen e marrëveshjeve, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë mbi shumën e nevojshme të provizioneve shtesë që duhet të krijohen dhe efektet që kjo do të kishte në pasqyrat financiare. Shoqëria nuk ka pasur një politikë koherente të njohjes së provizioneve për borxhet e këqija dhe të dyshimta. Mungesa e një rregulloreje për provizione si dhe mungesa e një analize për vjetërsinë dhe vlerësimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta, mund të këtë ndikim në rritjen e rrezikut për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, dhe marrjen e vendimeve të gabuara lidhur me to.
<b>Kriteri: Ndikimi/Efekti:</b>	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit nr.37, në fuqi. Shoqëria është e riskuar për të gjeneruar efekte financiare.
<b>Shkaku:</b>	Mungesa e një rregulloreje për provizione si dhe mungesa e një analize për vjetërsinë dhe vlerësimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta, mund të këtë ndikim në rritjen e rrezikut për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, dhe marrjen e vendimeve të gabuara lidhur me to.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.

<b>Rekomandime:</b>	Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë duhet të ndërmerren veprimet e nevojshme për hartimin e një rregulloreje për trajtimin e provizioneve dhe borxheve të këqija të bazuar në politika të qarta dhe në harmoni me Standardet e kontabilitetit.
---------------------	---

- Nga auditimi i gjendjes debitore dhe kreditore konstatohet se:

**5. Titulli i Gjetjes:** Nuk janë marrë hapat e duhur për shqyrtimin dhe reduktimin e debitorëve dhe kreditorëve të Shoqërisë.

<b>Situata:</b>	Gjendja debitore dhe kreditore për “Hekurudha Shqiptare” SHA është shumë e rënduar, pavarësisht se nga organet drejtuese të saj është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre. Gjendja debitore për vitin 2022 është në vlerën 594,825,000 lekë. Peshën kryesore të llogarive të arkëtueshme, e mbajnë aktivet korrente në vlerën 369,000,000 lekë ose 67 %. Pjesë tjetër e cila është e rëndësishme, është TVSH me saldo debitore, në vlerën 36,129,000 lekë. Ndërsa në llogarinë 4671, e cila është në vlerën 68,464,784 lekë, janë detyrime të cilat nuk mblidhen prej vitesh dhe janë të ndjekura nga sektori juridik. Në llogarinë 411, të arkëtueshme, e cila ka vlerën 15,966,000 lekë, janë të viteve të fundit dhe mendohet se do jenë të arkëtueshme nga Njësia Biznes Mallit dhe Njësia e Menaxhimit të Infrastrukturës. Sa trajtuar janë në mospërputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, situatë e cila sjell ndikim në rezultatin financiar të Shoqërisë në fund të vitit ushtrimor.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Ndikim në rezultatin financiar të Shoqërisë në fund të vitit ushtrimor.
<b>Shkaku:</b>	Mos marrja e hapave të duhur për shqyrtimin dhe reduktimin e debitorëve dhe kreditorëve.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Organet Drejtuese të Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a, (Administratori, Këshilli Mbikëqyrës, Asambleja e Përgjithshme) të marrin masa për analizimin, shqyrtimin dhe reduktimin e humbjeve të shoqërisë.

- Në kontabilitet dhe pasqyrat financiare është pasqyruar penaliteti që ka shoqëria ndaj hekurudhave të huaja, për mos likuidimin e detyrimeve ndaj hekurudhave të huaja, lidhur me transportin e mallrave për orë qëndrimet e vagonëve në territorin e RSH<sup>së</sup>.

**6. Titulli i Gjetjes:** Pasqyrimi në kontabilitet dhe pasqyrat financiare bëhet vetëm për vlerën e detyrimit (borxhit).

<b>Situata:</b>	“Hekurudha Shqiptare” SHA, pasqyrimin në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, bëhet vetëm për vlerën e detyrimit (borxhit). Deri më 31.12.2022, detyrimi ndaj hekurudhave të huaja është në vlerën 1,976,747 euro ose
-----------------	---

<p><b>Kriteri:</b></p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b></p> <p><b>Shkaku:</b></p> <p><b>Rëndësia:</b></p> <p><b>Rekomandime:</b></p>	<p>225,803,918 lekë, nga të cilat 518,483 euro (59,221,332 lekë) penalitete, kryesisht detyrimet janë ndaj Hekurudhës Serbe dhe Hungareze. Mos likuidimet në kohë janë jo në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, si dhe ndikojnë në mos pasqyrim të saktë të rezultatit financiar të shoqërisë. Këto detyrime i përkasin periudhës 2009-2022, të cilat përfshijnë orë/qëndrimet e vagonëve të huaj në territorin shqiptar. Gjatë kësaj periudhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, e ka patur të pamundur likuidimin e tyre për shkak të gjendjes së rëndë financiare. Hekurudha Serbe (Serbia Carko) i ka kërkuar gjatë gjithë periudhës detyrimet e tyre madje kane kërkuar dhe interesa. Shoqëria ka vënë në dijeni dhe Ministrinë e Financave për detyrimin që ka “Hekurudha Shqiptare” SHA ndaj hekurudhave të huaja.</p> <p>Detyrime të tjera në këtë llogari paraqitet dhe detyrimi ndaj hekurudhave të huaja (të vjetra “deri në vitin 1990-1992”) në vlerën 781.465.000 lekë. Theksojmë se “Hekurudha Shqiptare” SHA nuk disponon dokumente ligjor, për ndarjen e detyrimeve të ish Hekurudhës Jugosllave, sipas shteteve që aktualisht janë, pra në pasqyrat financiare disponohet detyrimi i trashëguar që nga periudha 1990-1992 si Hekurudhë Jugosllave. Nga ana e “Hekurudha Shqiptare” SHA nuk janë llogaritur interesa ndër vite për këto detyrime afatgjata.</p> <p>Veprimet sa më sipër janë jo në përputhje me ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.</p> <p>Ligji nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.</p> <p>Mos pasqyrim i saktë i rezultatit financiar të shoqërisë</p> <p>Mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>E mesme.</p> <p>Nga Administratori i Përgjithshëm, Njësia Ekonomike dhe Sektori i Marketingut, të merren masa për të bërë evidentimin dhe regjistrimin e penaliteteve të shkaktuara nga mos likuidimi i kamatë vonesave për orë qëndrimet e vagonëve të hekurudhave të huaja, duke bërë në këtë mënyrë raportim të saktë dhe të besueshëm të detyrimeve financiare, si dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare.</p>
---	--

**7. Titulli i Gjetjes: Mungesa e një sistemi kontabël të informatizuar.**

<p><b>Situata:</b></p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b></p>	<p>“Hekurudha Shqiptare” SHA, në sistemin kontabël që përdor për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarive të njësive ekonomike nuk përdor bartësit informatikë, duke shfaqur rritje të riskut të gabimeve si dhe të vështirësive për monitorim të sistemit, mungesën e të dhënave financiare në kohë reale për t’u reflektuar në vendim-marrjen e organeve drejtuese të shoqërisë. Ky fakt ndikon në mos kontroll për sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave për të gjitha veprimet dhe ngjarjet ekonomike, mundësi për ndryshim të tyre nga përdoruesit dhe rezulton mos vlerësim sa dhe si duhet i programeve informatike bashkëkohore.</p> <p>Mos kontroll për sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave për të gjitha veprimet dhe</p>
--	---



<b>Shkaku:</b>	ngjarjet ekonomike, mundësi për ndryshim të tyre nga përdoruesit.
<b>Rëndësia:</b>	Mos vlerësim sa dhe si duhet i programeve informatike bashkëkohore. E mesme.
<b>Rekomandime:</b>	Nga ana e shoqërisë të merren masa që në sistemin e saj kontabël, evidence mbështetëse, dokumentet bazë, dokumentet plotësues dhe regjistrat kontabël, të implementojë bartësit informatikë që janë autorizuar nga organet përkatëse, të shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pa-manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.

•  
**8. Titulli i Gjetjes:** Mbajtja e llogarive të aktiveve jashtë kontabilitetit.

<b>Situata:</b>	Në “Hekurudha Shqiptare” SHA, mbajtja e llogarive të aktiveve jashtë kontabilitetit është në shumën 2,441,739,656 lekë, në të cilat paraqiten vlera e aktiveve afatgjata materiale që priten t'i transferohen bashkive Tiranë, Mirditë, Klos, Laç, Elbasan dhe Durrës, procedurë e cila ka mbetur përgjysmë. Si rrjedhojë, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë efektin që do të kishin patur në pasqyrën e performancës, si edhe në pozicionin financiar, nëse kjo procedurë e nisur nuk do të realizohet, bazuar në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në fuqi.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në fuqi.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Të dhënat e kontabilitetit nuk përputhen me Pasqyrat Financiare.
<b>Shkaku:</b>	Mbajtja e llogarive të aktiveve jashtë kontabilitetit
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandime:</b>	Shoqëria të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të vlerës <u>2,441,739,656</u> lekë, vlerë e cila ka të bëjë me aktivet afatgjata materiale të cilat janë në proces transferimi ndaj Bashkive Tiranë, Mirditë, Klos, Laç, Elbasan dhe Durrës, në zbatim të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.

•  
**9. Titulli i Gjetjes:** Të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, me përjashtim të 4 prej tyre, nuk janë regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

<b>Situata:</b>	Të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, me përjashtim të 4 prej tyre, nuk janë regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, veprim jo në përputhje me ligjin me ligjin nr.111/2018, “Për Kadastrën” dhe ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, fakt i cili ndikon në keq menaxhim të aktiveve të Shoqërisë.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Keq menaxhim të aktiveve të Shoqërisë.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatim plotësisht të procedurave ligjore për regjistrimin e pasurisë dhe mos monitorim me rigozitet të kontratave të dhëna me qira.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Nga Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sha, të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Durrës, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet.



**Bilanci për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2018, 2019,2020,2021 dhe 2022, në mënyrë të përmbledhur paraqitet sipas tabelës sa më poshtë vijon:**

**Pasqyrat financiare për periudhën 01.01- 31.12.2018, 2019,2020,2021 dhe 2022**

*Në 000/lekë*

	<b>AKTIVET</b>	<b>01/01/2018- 31/12/2018</b>	<b>01/01/2019- 31/12/2019</b>	<b>01/01/2020- 31/12/2020</b>	<b>01/01/2021- 31/12/2021</b>	<b>01/01/2022- 31/12/2022</b>
<b>I</b>	<b>AKTIVET AFATSHKURTRA</b>					
	Aktive Monetare	1.821	2.04	2.104	2.663	1.469
	Aktive të tjera financiare afatshurtra	9.368	11.166	11.492	10.061	11.209
	Kërkesa të arketueshme	47.823	3.595	5.604	16.3	15.966
	Kërkesa të tjera të arketueshme	81.654	105.327	106.081	100.417	169.772
	Inventari	242.132	251.064	252.082	243.859	396.409
	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra					
	<b>Totali i Aktiveve Afatshkurtra (I)</b>	<b>382.798</b>	<b>373.192</b>	<b>371.76</b>	<b>373.3</b>	<b>594.825</b>
<b>II</b>	<b>AKTIVET AFATGJATA</b>					
	Aktive afatgjata materiale	84.156.200	83.786.140	80.748.980	80.422.273	77.978.610
	Te tjera aktive financiare					
	<b>Totali i aktiveve afatgjata (II)</b>	<b>84.156.200</b>	<b>83.786.140</b>	<b>80.748.980</b>	<b>80.422.273</b>	<b>77.978.610</b>
	<b>TOTALI I AKTIVEVE ( I+II)</b>	<b>84.538.998</b>	<b>84.159.332</b>	<b>80.748.980</b>	<b>80.795.573</b>	<b>78.573.435</b>
	<b>Detyrimet dhe kapitali</b>					
<b>I</b>	<b>Detyrimet afatshkurtra</b>					
	Huatë dhe parapagimet					
	Të pagueshme ndaj furnitorve	326.001	371.94	393.773	440.037	527.559
	Të pagueshme të tjera	365.128	357.684	101.271	123.328	112.359
	Tatim fitimi	-	-	-	-	-
	Grante dhe të ardhura të shtyra	457.385	489.009	464.259	462.949	457.026
	<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)</b>	<b>1.148.514</b>	<b>1.218.633</b>	<b>959.306</b>	<b>1.026.314</b>	<b>1.096.943</b>
<b>II</b>	<b>DETYRIMET AFATGJATA</b>					
	Huate afatgjata	787.086	793.072	736.132	777.742	781.465
	Huamarrje të tjera afatgjata	471.111	427.93	676.474	679.44	657.422
	Provizionet afatgjata	237.25	237.25	237.25	237.25	237.25
	Grantet dhe të ardhura te shtyra					<b>1.676.137</b>
	<b>Totali i detyrimeve afatgjata (II)</b>	<b>1.495.447</b>	<b>1.458.252</b>	<b>1.649.856</b>	<b>1.694.432</b>	<b>2.773.080</b>
<b>III</b>	<b>KAPITALI</b>					
	Kapitali aksionit	48.379.982	48.379.982	48.379.982	47.450.830	47.450.830

Rezerva	33.696.569	33.392.496	31.060.748	30.676.414	28.407.680
Fitimet e mbartura			-290.001		-52.417
Fitimet e pashpërndara	345.725	122.604	1.416.087	374.732	2.268.637
Fitimi (humbja) e vitit financiar	-527.239	-412.605	(2.055.238)	-427.149	(2.274.376)
<b>Totali i kapitalit (III)</b>	<b>81.895.037</b>	<b>81.482.447</b>	<b>78.511.578</b>	<b>78.074.827</b>	<b>75.800.355</b>
<b>TOTALI DETYRIMEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)</b>	<b>84.538.998</b>	<b>84.159.332</b>	<b>81.120.740</b>	<b>80.795.573</b>	<b>78.573.435</b>

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha

### Pasqyra Fitim/Humbje për periudhat e mbyllura më 31 Dhjetor 2019, 2020,2021 dhe 2022 paraqiten:

Në 000/lekë

Pasqyra Fitim/Humbje	01/01-31/12/2019	01/01-31/12/2020	01/01-31/12/2021	01/01-31/12/2022
Shitjet (7041,7042,703,705)	152.159	77.479	535.013	571.798
Të ardhura të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit	518.307	554.895	51.643	224.97
<b>Totali i te ardhurave</b>	<b>670.466</b>	<b>632.374</b>	<b>586.656</b>	<b>796.768</b>
Kosto e punës (641,644,648)	416.79	406.614	450.541	417.766
Amortizime dhe zhvlerësimit (681,681/3,681/6)	418.666	1.850.494	342.886	313.348
Lendet e para dhe materialet harxhuese te perdorura	24.812	11.298	130.529	86.371
Fitime (humbjet) nga kursi i këmbimit (666)	222.803	419.205	59.488	35.011
Shpenzime të tjera			30.361	2.218.647
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>1.083.071</b>	<b>2.687.612</b>	<b>1.013.805</b>	<b>3.071.143</b>
<b>Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore</b>	<b>-412.605</b>	<b>-2.055.238</b>	<b>-427.149</b>	<b>-2.274.376</b>
Shpenzime financiare (628,661,658)	34.947	6.704	5.626	30.303
Shpenzime te tjera (657, penalitete e gjoba).	10.229	13.229	9.154	40.233
Të ardhura financiare				
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare</b>	<b>45.176</b>	<b>19.933</b>	<b>14.78</b>	<b>70.536</b>
<b>Fitim (humbje) per efekt fiscal (2.274.375 - 70,536)</b>	<b>-367.429</b>	<b>-2.035.305</b>	<b>-412.369</b>	<b>-2.203.840</b>
Shpenzimet e tatim fitimit	-	-	-	-
Fitimi (humbje) neto e vitit financiar	-412.605	-2.055.238	-427.149	-2.274.376

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha

### Aktivitet Afatgjata Materiale.

1/1	Toka (Trualli) 211				Ndërtesa dhe instalime 212				Makineri dhe paisje 213			
	2019	2020	2021	2022	2019	2020	2021	2022	2019	2020	2021	2022
AAM Vlera Bruto												
Gjendje 01.01.2019	43.595.358	43.595.358	45.812.555	45.812.555	53.692.777	53.742.638	34.557.691	34.592.254	847.602	825.712	305.043	283.065
Shtesa (blerje)					49.762	22.472	34.948	48.539	798			2,000

1/1	Toka (Trualli) 211				Ndërtesa dhe instalime 212				Makineri dhe paisje 213			
	2019	2020	2021	2022	2019	2020	2021	2022	2019	2020	2021	2022
Shtesa(te tjera+sistemi.)	7.021.671				8.804.314		2.047		7.568	1.14	2.749	
Pakësime (J-Përdorimi)						-209.014		-2,146,457	-23.956		-24.828	1.343
Pakësime (ne shitje)		3.650.015										
Riklasifikime nga CIP		-1.432.818				-18.998.759				540.541		
Tjetër mes njërive	-7.021.671				-8.804.214	354	-2.432		-6.299	18.732	101	
<b>Gjendje 31.12.2019</b>	<b>43.595.358</b>	<b>45.812.555</b>	<b>45.812.555</b>	<b>45.812.555</b>	<b>53.742.638</b>	<b>34.557.691</b>	<b>34.592.254</b>	<b>32.494.336</b>	<b>825.712</b>	<b>305.043</b>	<b>283.065</b>	<b>286.408</b>
<b>Zhvlersimi akumuluar</b>												
<b>Gjendje 01.01.2019</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>14.727.187</b>	<b>15.081.131</b>	<b>612.764</b>	<b>915.53</b>	<b>463.65</b>	<b>457.917</b>	<b>23.66</b>	<b>31.826</b>
Shtesa (amort.2019)					353.873	258.412	302.981	280.043	13.812	11.282	10.581	9.835
Shtesa(te tjera+sistemi.)					2.612.772	-15.194.591			5.702			
Pakësime						467.812	-215		-19.872	464.691		
Pakësime(sistemime)					-2.612.701			-59.944	-5.376		-2.415	-182
Riklasifikime nga CIP												
Tjetër										19.152		
<b>Gjendje 31.12.2019</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>15.081.131</b>	<b>612.764</b>	<b>915.53</b>	<b>1.135.629</b>	<b>457.916</b>	<b>23.66</b>	<b>31.826</b>	<b>41.843</b>
<b>Vlera mbetur neto</b>												
<b>Gjendje 01.01.2019</b>	<b>43.595.358</b>	<b>45.595.358</b>	<b>45.812.555</b>	<b>45.812.555</b>	<b>38.965.589</b>	<b>38.661.507</b>	<b>33.944.926</b>	<b>33.676.724</b>	<b>383.952</b>	<b>520.669</b>	<b>281.383</b>	<b>251.239</b>
<b>Gjendje 31.12.2019</b>	<b>43.595.358</b>	<b>45.812.555</b>	<b>45.812.555</b>	<b>45.812.555</b>	<b>38.661.507</b>	<b>33.944.926</b>	<b>33.676.724</b>	<b>31.358.708</b>	<b>367.796</b>	<b>281.383</b>	<b>251.239</b>	<b>244.564</b>

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha

### Aktivet Afatgjata Materiale, (vazhdim).

1/2	Mjete Transporti 215				Pajisje dhe informatike 218				TOTAL			
	2019	2020	2021	2022	2019	2020	2021	2022	2019	2020	2021	2022
<b>AAM Vlera Bruto</b>												
<b>Gjendje 01.01.2019</b>	<b>2.847.701</b>	<b>2.847.701</b>	<b>761.217</b>	<b>760.723</b>	<b>36.136</b>	<b>32.451</b>	<b>10.405</b>	<b>11.276</b>	<b>101.019.574</b>	<b>101.043.860</b>	<b>81.446.911</b>	<b>81.459.873</b>
Shtesa (blerje)					729	276	910	1,952	51.289	22.748	35.858	52,491
Shtesa (të tjera + sistemi.)					79				15.833.632		4.796	
Pakësime (J-përd.)		-88.158	-494	-111,705	-4.09	-102	-31	-107	-28.046	-297.274	-25.353	-2,256,926
Pakësime (ne shitje)										3.650.015		

1/2	Mjete Transporti 215				Pajisje dhe informatike 218				TOTAL			
	2019	2020	2021	2022	2019	2020	2021	2022	2019	2020	2021	2022
Riklasifik.nga CIP		-1.998.326				-24.742				-22.994.831		
Tjetër mes njësave					-404	2.522	-8		-15.832.587	22.393	-2.339	
<b>Gjendje 31.12.2019</b>	<b>2.847.701</b>	<b>761.217</b>	<b>760.723</b>	<b>649.018</b>	<b>32.451</b>	<b>10.405</b>	<b>11.276</b>	<b>13.121</b>	<b>101.043.860</b>	<b>81.446.911</b>	<b>81.459.873</b>	<b>79,255,438</b>
<b>Zhvlersimi akumuluar</b>												
<b>Gjendje 01.01.2019</b>	<b>1.649.618</b>	<b>1.698.326</b>	<b>60.11</b>	<b>88.166</b>	<b>22.919</b>	<b>20.346</b>	<b>1.397</b>	<b>2.078</b>	<b>16.863.374</b>	<b>17.257.720</b>	<b>697.931</b>	<b>1.037.600</b>
Shtesa (amort.2019)	48.708	28.809	28.137	22.619	789	631	658	670	417.182	299.134	342.357	313.167
Shtesa(te tjera+sistemi.)		-1.662.956							2.618.474	-17.322.646		
Pakësime					-3.362	-22.23	-18		-23.234	467.812	-233	
Pakësime(sistemime)		-4.069	-81	-14.195			-3	18	-2.6	-4.089	-2.499	-73.939
Riklasifikime nga CIP						-20			18.077			
Tjetër						2.67	44				44	
<b>Gjendje 31.12.2019</b>	<b>1.698.326</b>	<b>60.11</b>	<b>88.166</b>	<b>96.59</b>	<b>20.346</b>	<b>1.397</b>	<b>2.078</b>	<b>2.766</b>	<b>17.257.720</b>	<b>697.931</b>	<b>1.037.600</b>	<b>1.276.828</b>
<b>Vlera mbetur neto</b>												
<b>Gjendje 01.01.2019</b>	<b>1.198.082</b>	<b>2.086.484</b>	<b>701.107</b>	<b>672.557</b>	<b>13.218</b>	<b>22.046</b>	<b>9.008</b>	<b>9.198</b>	<b>84.156.200</b>	<b>86.886.064</b>	<b>80.748.979</b>	<b>80.442.273</b>
<b>Gjendje 31.12.2019</b>	<b>1.149.375</b>	<b>701.107</b>	<b>672.557</b>	<b>552.428</b>	<b>12.105</b>	<b>9.008</b>	<b>9.198</b>	<b>10.355</b>	<b>83.786.140</b>	<b>80.748.979</b>	<b>80.422.273</b>	<b>77.978.610</b>

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha

AAM janë njohur në kontabilitet me koston e blerjes së tyre dhe shoqëria ka zgjedhur si politike të saj kontabël, modelin e koston, ku çdo element i AAM paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar. Ajo nuk ka akumuluar as një humbje nga zhvlerësimi. Normat e amortizimit të zbatuara janë ato të përcaktuara në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 24, datë 18.12.2006 dhe jo me normat fiskale të përcaktuara në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Normat e amortizimit që janë aplikuar sipas Vendimi të Këshillit Mbikëqyrës të HSH, janë norma teknike që i janë përshtatur aseteve të HSH "sistemit hekurudhor".

**Viti 2019:** Shoqëria nga viti 2006 e në vazhdim ka kryer dy herë rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale (rivlerësimi i kryer me gjendjen e datës 31.12.2006 dhe të datës 31.12.2013).

Rivlerësimi i fundit është miratuar nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Transportit dhe Sipërmarrjes (aktualisht MFE) sipas shkresës nr. 8504/3, datë 17.02.2015, në zbatim të secilës janë kryer veprimet në kontabilitet të vitit 2014 me urdhër të Administratorit të Shoqërisë me nr. 220/1, datë 24.03.2015.

Gjatë këtij viti shoqëria nuk ka marrë asnjë rivlerësim të aktiveve ose përkeqësim.

**Viti 2020:** Gjatë këtij viti shoqëria ka marrë rivlerësim dhe zhvlerësim të aktiveve, me efekt nga viti 2018 (31.12.2018, kjo sipas raportit rivlerësimi, i miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 03 datë 19.02.2021, Vendim ky i cili i ka kaluar MFE bashkë me raportin e rivlerësimi.

Referuar tabelës se aseteve theksojmë se ka patur një rivlerësim të asetit "Toka" me një vlerë prej 3,650,015 mijë lekë, e cila i përket NJBMIH. Nga ana tjetër ka patur një zhvlerësim shumë të madh të aseteve për çdo njësi.

**Viti 2021:** Shoqëria nga viti 2006 deri në vitin 2018 ka kryer tre here rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale (rivlerësimet e aseteve janë kryer me gjendjet e datave 31.12.2006, të datës 31.12.2013 dhe të datës 31.12.2018). Rivlerësimi i fundit është miratuar nga ana e MFE, sipas Vendimit nr. 31, datë 25.05.2021, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionereve, në zbatim të secilës janë kryer veprimet në kontabilitet në PF të vitit 2020, me urdhër të Administratorit të Shoqërisë me nr. 221/5, datë 26.05.2021.

## Inventaret

Gjendja e inventarëve gjatë periudhës 01.01.2019 deri në 31.12.2022, paraqitet si më poshtë:

Në 000/lekë

Viti	Viti 2019			Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
	Gjendja e inventarëve ne fillim te periudhes	Lëvizjet dhe blerjet e periudhës	Gjendja e inventarëve në fund të periudhës	Gjendja e inventarëve ne fillim te periudhes	Lëvizjet dhe blerjet e periudhës	Gjendja e inventarëve në fund të periudhës	Gjendja e inventarëve ne fillim te periudhes	Lëvizjet dhe blerjet e periudhës	Gjendja e inventarëve në fund të periudhës	Gjendja e inventarëve ne fillim te periudhes	Lëvizjet dhe blerjet e periudhës	Gjendja e inventarëve në fund të periudhës
Produkte të gatshme 347	41,927	(6,212)	35,715	41,927	(6,212)	35,715	48,092	1,915	50,007	50,007		6,447
Prodhime në proces 342	5,367	(381)	4,986	5,367	(381)	4,986		5,169	5,169	192,412		346,953
Lëndë të para, 311-312 te konsumueshme, pjesëndërrimi.	186,719	16,495	203,214	186,719	16,495	203,214	197,025	-14,751	182,281	192,412		346,953
Mallra për rishitje+tjera 532	2,914	(41)	2,873	2,914	(41)	2,873	2,706	-34	2,672			
Inventarët 327	10,410	(1,857)	8,553	10,410	(1,857)	8,553	8,517	-1,058	7,459			
<b>Subtotal</b>	<b>247,337</b>	<b>8,004</b>	<b>255,341</b>	<b>247,337</b>	<b>8,004</b>	<b>255,341</b>	<b>256,340</b>	<b>-8,759</b>	<b>247,588</b>	<b>247,558</b>		<b>399,492</b>
Zhvlerësime për inventarët e vjetëruar. 3297	5,205	(928)	4,277	5,205	(928)	4,277	(4,258)	(528)	(3,730)	(3,730)		(3,083)
<b>Total</b>	<b>242,132</b>	<b>8,932</b>	<b>251,064</b>	<b>242,132</b>	<b>8,932</b>	<b>251,064</b>	<b>252,082</b>	<b>-8,231</b>	<b>243,858</b>	<b>243,858</b>		<b>396,409</b>

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sh.a

**Inventarët** fizik të pasurisë (aseteve), janë kryer sipas viteve në zbatim të urdhërit të Administratorit të Shqërisë përkatësisht: për vitin **2020**: me nr. 1078, datë 29.10.2020, për vitin **2021**: nr. 1068, datë 06.10.2021, për vitin **2022**: me nr. 1020, datë 26.10.2022.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

**Zhvlerësime në fundin e periudhës të artikujve të vjetërsuar të analizuara si vijon:**

Në 000/lekë

Emërtimi	Periudha			
	31/12/2019	31/12/2020	31/12/2021	31/12/2022
Produkte të gatshme	0	0	0	
Lëndë të para, të konsumueshme, pjesë ndërrimi.	0	0	0	
Mallra për rishitje.	0	0	0	
Nënprodukte dhe mbeturina	35,715	48,091	50,007	6,447
<b>Total</b>	<b>35,715</b>	<b>48,091</b>	<b>50,007</b>	<b>6,447</b>

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha

Shoqëria ka patur një rritje për periudhën e vitit 2022, në llogaritë (311, 327, 481, 312, 532) lëndë të para dhe pjesë ndërrimi ose të konsumueshme llogaritë (311, 327, 481, 312, 532) në krahasim me periudhën raportuese të vitit 2021. Kjo vjen si pasojë e çmontimit të linjës hekurudhore Durrës -Tiranë, e cila do t'i shërbejë projektit të ri të hekurudhës. Të gjitha këto linja janë magazinuar për përdorim në linja të tjera dhe një pjesë prej tyre janë propozuar për jashtë përdorimi.

**Tatim Fitimi**, paraqitet si më poshtë:

Në 000/lekë

	31.12.2019	31.12.2020	31.12.2021	31.12.2022
Tatim fitimi paguar gjatë vitit	0	0	0	0
Plus / Minus	0	0	0	0
<b>Tatimi mbi fitimin në Bilanc</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Fitimi ushtrimit (sipas bilancit)	(412,605)	(2,055,238)	(427,149)	(2,274,376)
<b>Plus : Shpenzime të panjohura</b>				
Shpenzime të tjera				
Te tjera (661,658)	34,947	6,704	5,626	30,303
Taksa & gjoba (657)	10,229	13,229	9,154	40,233
<b>Total</b>	<b>45,525</b>	<b>19,933</b>	<b>14,780</b>	<b>70,536</b>
<b>Fitimi para tatimit (fiskal)</b>	<b>(367,429)</b>	<b>(2,035,305)</b>	<b>(412,369)</b>	<b>2,203,840</b>
<b>Minus : Te ardhura jo të taksueshme</b>	0	0	0	0
Humbje taksash të viteve të mëparshëm	0	0	0	0
<b>Total</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Përfitime të taksueshëm</b>				
Norma e tatimit mbi fitimin	15%	15%	15%	15%
<b>tatim fitimi për vitin</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Fitimi neto për efekt fiskal</b>	<b>(367,429)</b>	<b>(2,035,305)</b>	<b>(412,369)</b>	<b>2,203,840</b>


Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha

**Të Ardhurat dhe Shpenzimet, sipas pasqyrave financiare paraqiten si më poshtë:**

Në 000/lekë

A Shitjet	01.01 - 31.12.19	01.01- 31.12.20	01.01- 31.12. 21	01.01. - 31.12.22
Shitje produktesh (703,705)	36,325	28,538	21,622	0
Shitje produkte të ndërmjetme	-	-	-	
Shitje e nënprodukteve	0	0	0	
Shitje e punimeve dhe shërbimeve 7041, 7042	115,834	52,380	57,712	3,497
Shitje mallrash				
Të ardhura nga shitje të tjera				
<b>Totali i: shitjeve</b>	<b>152,159</b>	<b>80,918</b>	<b>79,334</b>	<b>3,497</b>

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA**

*Në 000/lekë*

<b>Të ardhura të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit</b>	<b>01.01 - 31.12.19</b>	<b>01.01- 31.12.20</b>	<b>01.01- 31.12. 21</b>	<b>01.01. - 31.12.22</b>
Prodhimi i aktiveve afatgjata jo materiale	-	-	-	
Prodhimi i aktiveve afatgjata materiale	-	-	-	
Të ardhura nga grantet (731,751)	473,778	460,130	457,379	558,984
Të ardhura të tjera (7081,7088,777,713...)	44,529	16,640	19,990	<b>9,994</b>
Të ardhura nga rivlerësimi/shitja e aktiveve	-	-	-	
<b>Totali i të ardhurave të tjera</b>	<b>518,307</b>	<b>476,770</b>	<b>477,369</b>	<b>568,978</b>

*Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha*

*Në 000/lekë*

<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>01.01 - 31.12.19</b>	<b>01.01- 31.12.20</b>	<b>01.01- 31.12. 21</b>	<b>01.01. - 31.12.22</b>
Energji, avull, ujë (605)	5,607	6,969	7,042	6,758
Blerje të pastokueshme, materiale, furnitura (606)	0	0	5	0
Trajtime të përgjithshme (618)				
Qira repetitor (613)	123	146	154	129
Mirëmbajtje dhe riparime (615)	458	150	361	160
Sigurime (616,634,635)	1,732	3,609	565	1,006
Kërkime dhe studime				
Personel nga jashtë (621)	15,888	25,571	31,282	32,069
Publicitet, reklamë (624)	0	0	0	0
Transferime, udhëtime, dieta (625)	8,189	3,568	3,568	1,868
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni (626)	522	427	382	332
Shpenzime transporti (627)	17,461	12,461	7,876	737
Shpenzime për shërbimet bankare (628)	349	349	222	217
Taksa, tarifatat doganore				
Tatime të tjera (638)	1,210	425	165	0
Subvencione të dhëna*				
Shpenz. dalje j-përdorimi AAM (652)	4,829	293,271	19,061	2,179,788
Gjoha dhe dëmshpërblime (657)	10,229	13,229	9,154	40,233
Shpenzime të tjera 605,608,623,624, 654,658, 677,678,681/1, .....	27,190	1,610	18,205	363
<b>Total i: Shpenzime të tjera</b>	<b>93,787</b>	<b>1,970</b>	<b>98,042</b>	<b>2,263,660</b>

*Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha*

*Ne 000/lekë*

<b>d) Kosto e punës</b>	<b>01.01 - 31.12.19</b>	<b>01.01- 31.12.20</b>	<b>01.01- 31.12. 21</b>	<b>01.01. - 31.12.22</b>
Paga bruto dhe rrogë (Pagës) (641)	352,275	344,697	381,700	344,874
Kontribut sigurime shoqërore për punëtorët (644)	59,339	57,897	64,138	58,028
<b>Total</b>	<b>411,614</b>	<b>402,594</b>	<b>445,838</b>	
Kosto stafi të tjera (648)	5,176	3,748	4,703	14,864
(Pension charge) Pagesë pensioni	-	988	0	
<b>Total kosto e punës</b>	<b>416,790</b>	<b>407,330</b>	<b>450,541</b>	<b>417,766</b>

*Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha*

**Amortizimet dhe zhvlerësimet:** Normat e amortizimit të zbatuara janë ato të përcaktuara në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë, nr.24, datë 18.12.2006, dhe jo normat fiskale të përcaktuara në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar".



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Shoqëria në vitet 2006 dhe 2013 ka bërë rivlerësimin e AAM<sup>ve</sup> të shoqërisë, ku diferencat e rivlerësimit janë përfshirë në PF të vitit 2007 dhe 2014.

**Viti 2019:** Gjatë këtij viti shoqëria nuk ka marrë asnjë rivlerësim të aktiveve ose përkeqësim të tyre, por nënvizojmë se shoqëria ka kryer rivlerësimin e fundit të aktiveve afatgjata materiale “rivlerësimi i kryer me gjendjen e datës 31.12.2013”, që është miratuar nga ana e MZHETS, me shkresën nr.8504/3, datë 17.02.2015, në zbatim të së cilës janë kryer veprimet në kontabilitet (PF) të vitit 2014, kjo me urdhër të administratorit të shoqërisë (HSH) me nr.220/1, datë 24.03.2015.

**Viti 2020:** Është mbyllur procesi rivlerësimi të AAM<sup>ve</sup>, sipas gjendjes së datës 31.12.2018, i cili është miratuar nga ana e Këshillit Mbikëqyrës me Vendim nr.03, datë 19.02.2021, për të cilën janë kryer veprimet në kontabilitet me PF të vitit 2020.

**Viti 2021:** Shoqëria nga viti 2006 deri në vitin 2018 ka kryer tre herë rivlerësimin e AAM<sup>ve</sup> (rivlerësimet e aseteve janë kryer me gjendjet e datave 31.12.2006, 31.12.2013 dhe të datës 31.12.2018). Rivlerësimi i fundit është miratuar nga ana e MFE<sup>se</sup>, sipas Vendimit nr.31, datë 25.05.2021, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve, në zbatim të së cilës janë kryer veprimet në kontabilitet në PF të vitit 2020, me urdhër të Administratorit të Shoqërisë nr.221/5, datë 26.05.2021.


**Viti 2022:** Rivlerësimi i fundit është miratuar nga ana e MFE<sup>se</sup>, sipas Vendimit nr.31, datë 25.05.2021, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve, në zbatim të së cilës janë kryer veprimet në kontabilitet në PF të vitit 2021, me urdhër të Administratorit të Shoqërisë, nr.221/5 datë 26.05.2021.

Në 000/lekë

e) Amortizimet dhe zhvlerësimet	01.01 - 31.12.19	01.01- 31.12.20	01.01- 31.12.21	01.01- 31.12.22
Amortizimi i aktiveve afatgjata (681)	418.666	299.134	342.357	313.167
Provizione për zhvlerësimin e aktiveve financiare	-	-	-	-
Shpenzime të tjera (humbjet nga rivlerësimi aktiveve)	-	-	-	-
<b>Total e) Amortizimet dhe zhvlerësimet</b>	<b>418.666</b>	<b>299.134</b>	<b>342.357</b>	<b>313.167</b>
<b>f) Këmbim monedhë (fitime)/humbje</b>				
Këmbim fitime/humbje që rrjedhin gjatë vitit	-	-	-	-
Këmbim nga fitim/humbje që rrjedhin nga vlerësimi i fund-vitit (llogarinë 666 - llogarinë 766,757)	+22.514	-63.387	37.097	-36,048
<b>Total f) Këmbim monedhë fitime/humbje</b>	<b>+22.514</b>	<b>-63.387</b>	<b>37.097</b>	<b>-36,048</b>
<b>g) Kosto-te ardhura financiare neto</b>				
Interes në hua afatshkurtër (661)	30.752	4.273	4.846	29,897
Shpenzime të tjera financiare				
<b>Total g) i kostove financiare</b>	<b>30.752</b>	<b>4.273</b>	<b>4.846</b>	<b>29,897</b>
Të ardhura nga interesi (767)	0	0	0	0
Të ardhura nga investimet				
Të ardhura tjera (interes + ngjashme 758)	20.590	8.968	12.630	173,782
<b>Total i të ardhurave financiare</b>	<b>20.590</b>	<b>8.968</b>	<b>12.630</b>	<b>173,782</b>
<b>Total i të ardhurave (kostove) financiare neto</b>	<b>-10.162</b>	<b>(-4.698)</b>	<b>(-7.784)</b>	<b>(-143,885)</b>

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha

**Rezervat:** Më 31.Dhjetor 2019, 2020, 2021 dhe 31 dhjetor 2022, paraqiten si më poshtë:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Në 000/lekë

Emërtimi	31/12/2019	31/12/2020	31/12/2021	31/12/2022
Rezerva statutore			0	0
Rezerva ligjore (të tjera)			0	0
Rezerva nga rivlerësimi(106)	33,392,466	31,060,748	30,676,414	28,407,681
<b>Total</b>	<b>33,392,466</b>	<b>31,060,748</b>	<b>30,676,414</b>	<b>28,407,681</b>

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha

**Viti 2019:** Rezervat nga rivlerësimi (llogaria 106) janë pakësuar në vlerën 304,118 mijë lekë, vlerë kjo përfaqëson vlerën e amortizimit të AAM, ku në zbatim të standardeve të kontabilitetit ka kaluar në llogarinë 121 fitime të mbartura. Kjo vlerë përfaqëson diferencën midis amortizimit aseteve të llogaritur me vlerë të rivlerësuar dhe të amortizimit të llogaritur **me vlerë të pa rivlerësuar**, pra me vlerë historike. Ky veprim është kryer sipas Vendimit të Administratorit HSH<sup>së</sup>, nr.02, datë 20.02.2019.

**Viti 2020:** Rezervat nga rivlerësimi (llogaria 106) janë pakësuar në vlerën 2,331.718 mijë lekë, vlerë kjo e cila përbëhet nga:

- vlera 1.416.087 mijë lekë, që përfaqëson diferencën e vlerës së amortizimit të aseteve me vlerë të rivlerësuar dhe vlerës së amortizimit të aseteve me vlerë të pa rivlerësuar;
- vlera 915.631 mijë lekë, e cila përfaqëson rënien në vlerë.

Në zbatim të standardeve të kontabilitetit vlera 1,416,087, ka kaluar në llogarinë 421 “fitime të mbartura”. Ky veprim është kryer sipas Vendimit të Administratorit të Shoqërisë, nr.388, datë 26.03.2021.

**Viti 2021:** Rezervat nga rivlerësimi (llogaria 106) janë pakësuar për 384,334 mijë lekë, vlerë kjo e cila përfaqëson diferencën e vlerës së amortizimit të aseteve me vlerë të rivlerësuar dhe vlerës së amortizimit të aseteve me vlerë të pa rivlerësuar, ku:

- vlera 374,732 mijë lekë ka kaluar në të ardhura të mbartura;
- vlera 9,602 mijë lekë, përfaqëson sistemim veprimi tek NJSHML.

Në zbatim të standardeve të kontabilitetit vlera 374,732 mijë lekë ka kaluar në llogarinë 421 “fitime të mbartura”. Ky veprim është kryer sipas Vendimit të Administratorit të Shoqërisë nr.01 datë 25.02.2022.

**Viti 2022:** Rezervat nga rivlerësimi (llogaria 106) janë pakësuar në vlerën 2,268,733 mijë lekë, në krahasim me periudhën e kaluar raportuese. Kjo përfaqëson:

- diferencën midis amortizimit të rivlerësuar të aktiveve dhe vlerës së amortizimit të aktiveve me vlerë të pa rivlerësuar me vlerë 237,829 mijë lekë;
- dalje jashtë përdorimi të aseteve në vlerën 2,030,808 mijë lekë dhe 96 mijë lekë sistemim nga NJSHML.


**Palët e lidhura. Identifikimi i palëve të lidhura:** Palët e lidhura me shoqërinë janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë (si aksionari i vetëm dhe kontrollues) dhe personeli kryesor i menaxhimit këshilli mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë.

#### Balancat me palët e lidhura

Në 000 lekë

Të pagueshmet:	2019	2020	2021	2022
Kredi e paguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë	230,593	255,543.	299,311	303,529

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

**2. Titulli i Gjetjes:** Situata e vështirë ekonomike e shoqërisë është thelluar akoma më shumë në vitet e fundit duke e bërë të pamundur kthimin e detyrimit duke lënë këtë barrë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. **Vlera prej 2,657,170.76 euro është efekt financiar në dëm të buxhetit të Shtetit.**

<b>Situata:</b>	<p>Nga verifikimi i kryer në regjistrin e borxhit publik të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “Regjistri i Garancive Shtetërore”, rezultoi për llogari të “Hekurudha Shqiptare” SHA. është kredia italiane, (Artigiancassa, Itali), për projektin “Rehabilitimi i Hekurudhës së Durrësit, me datë nënshkrimi 08.05.1995, shuma e kredisë në vlerën 3,098,741.39 euro, me datë fillimi 17.01.2008, datë mbarimi 17.07.2025. Shoqëria kryen rakordimet e duhura me departamenti përkatës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për sqarimin e situatës debitore. Në lidhje me kredinë italiane shoqëria dispononte planin e amortizimit të kredisë si dhe ka marrë njoftime periodike nga BKT që funksionon si bankë ndërmjetëse në lidhje me detyrimet, por megjithëse nuk ka paguar këstet e principalit dhe interesat duhet të krijonte një llogari provizioni për këto këste dhe interesa të cilat janë paguar nga llogaria e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Këto vlera të likuiduara nga ana e MFE janë të kontabilizuara si detyrim në llog.4672/2.</p> <p>Vlera e cila llogaritet deri në fund të periudhës ushtrimore 2022 është në shumën 2.657.170,76 Euro ose në vlerën 303,529,000 lekë. Situata e vështirë ekonomike e shoqërisë është thelluar akoma më shumë në vitet e fundit duke e bërë të pamundur kthimin e detyrimit duke lënë këtë barrë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Vlera prej 2,657,170.76 euro është efekt financiar negativ për “Hekurudha Shqiptare” SHA.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Ligji nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<p>Kjo situatë sjell ndikim në rezultatin financiar të Shoqërisë në fund të vitit ushtrimor.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Gjendja e rënduar financiare e shoqërisë.</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p>E lartë</p>
<b>Rekomandime:</b>	<p>Nisur nga gjendja e rëndë financiare dhe situata përpara ndarjes së shoqërisë HSH sha, HSH sha në bashkëpunim me MFE në cilësinë e aksionarit të vetëm dhe që ka shlyer detyrimet e kësaj kredie që nga viti 2008, të marrin masat e duhura për sistemimin e detyrimit nga pasqyrat financiare të HSH sha në likuiduesin e kësaj kredie.</p>

Gjendja e kredive (huave) pa përfshirë MFE në monedhë të huaj dhe e konvertuar në lekë rezulton sa poshtë vijon:

**Emri Huadhënësit Vlera në Valute Kursi Vlera All (000/lekë)**

Kredia Italiane.....Euro 516,456.89 114.23 58.995



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Huatë janë vlerësuar me kursin e fundit të vitit 2022 dhe diferencat nga konvertimi janë kontabilizuar në llogarinë e diferencave të konvertimit.

Përsa i përket diferencës në vlerë që rezultojnë për këto detyrime, ka ardhur si rezultat i konvertimit të monedhës (euro dhe usd) në vitin 2022.

Në fund të vitit 2022, kursi i usd rezultojnë të jetë 107.05 lekë dhe i euros 114.23 lekë, ndërsa në vitin 2021 usd ishte 106.54 lekë dhe euro 120.76 lekë. Nën vizojmë se vlerat e përfituara nga konvertimi i monedhave të huaja që kanë kaluar në të ardhura dhe shpenzime nuk përbëjnë të ardhura që sjellin përmirësim në situatën e HSH.

Në 000 lekë

Transaksionet me palët e lidhura:	2019	2020	2021	2022
<b>Të ardhura:</b>				
<b>Subv.për Biznesin e Transportit Hek.të Udhëtarëve nga MFE</b>	<b>400,000</b>	<b>400,000</b>	<b>400,000</b>	<b>501,000</b>
Kuota për subvencione për investime nga MFE			57,379	73,917
<b>Total</b>	<b>400,000</b>	<b>400,000</b>	<b>457,379</b>	<b>574,917</b>
<b>Shpenzimet:</b>				
Pagat për Bordin (Këshilli Mbikëqyrës)	2,243	1,691	2,243	2,236
Drejtuesi Ekzekutiv (Administratori I shoqërisë)				
<b>Total</b>	<b>2,243</b>	<b>1,691</b>	<b>2,243</b>	<b>2,236</b>

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha

Në 000 lekë

Lëndët e para dhe materialet harxhuese të përdorura:	2019	2020	2021	2022
Kostot e karburantit	102,757	87,198	34,630	9,688
Kostot materiale	47,369	26,422	33,253	35,839
Kostot e punës të kontraktuara	15,888	25,571	31,282	32,069
Të tjera	23,539	16,794	31,364	8,775
<b>Total</b>	<b>189,553</b>	<b>155,985</b>	<b>130,529</b>	<b>86,371</b>

Burimi i të dhënave: Hekurudha Shqiptare sha

Nën vizojmë se duke krahasuar vlerën e humbjes që rezultojnë në vitin 2022, që është 2,274,376 mijë lekë”, me vitin 2021, që ishte 427,149 mijë lekë, rezultojnë se ka rritje të humbjes me vlerë 1,847,227 mijë lekë. Kjo vlerë vjen si pasojë e daljes jashtë përdorimi të linjës Durrës-Tiranë dhe asetëve të tjera që disponon Hekurudha Shqiptare sh.a.

Në lidhje me shpenzimet e tjera operative për veprimtarinë e kompanisë rezultojnë një tkurrje të tyre si pasojë e politikave të ndërmarrjes për reduktimin e fuqisë punëtore duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e shpenzimeve për paga dhe shpërblime, kontribute shoqërore dhe shëndetësore, uljes drastike të konsumit të karburantit, uljes së konsumit të energjisë elektrike, shpenzimeve për telekomunikacion etj.

**Nga auditimi rezultojnë se** nga verifikimi i kryer në regjistrin e borxhit publik të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe në Regjistrin e Garancive Shtetërore, të rishikuar në dhjetor të vitit 2022, rezultojnë se për rehabilitimin e hekurudhës së Durrësit (linja hekurudhore Durrës – Tiranë), janë marrë dy kredi (tabela në vijim).

Ndërkohë që nga kredia e vitit 1995, e marrë nga Qeveria Shqiptare për rehabilitimin e hekurudhës së Durrësit (linja hekurudhore Durrës – Tiranë) është shlyer vlera e cila llogaritet deri në fund të periudhës ushtrimore 2022 në shumën 2,657,170.76 Euro ose në vlerën 303,529,000 lekë dhe mbetet për tu likuiduar diferenca deri në 17.07.2025, ndërkohë që kjo linjë hekurudhore është prishur dhe është marrë kredi tjetër e nënshkruar më datë 29.12.16 përsëri për të njëjtën linjë hekurudhore Tiranë Durrës.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Kjo kredi e dytë ka si objekt rehabilitimin e linjës hekurudhore Durrës – Tiranë, objekt i cili është i njëjtë me kredinë e mëparshme që vazhdon të likuidohet. Praktikisht rezultojnë se po likuidohen dy kredi për të njëjtin objekt.

Loan ID	Kreditori	Shteti i Kreditorit	Projekti	Data e nënshkrimit	Shuma euro	Stoku	Data e		Njësia Zbatuese
							parë	fundit	
16/05/EBRD	EBRD	Institucion Financiar	Rehabilitimi i hek. Tiranë-Durrës dhe lidhja meTIA	29.12.2016	36,870,000	4,417,877.57	05.05.21	05.11.31	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (HSH sh.a)
61	Artigiancassa	Itali	Rehabilitimi i Hek. Durrësit	08.05.1995	3,098,742	688,609.19	17.01.08	17.07.25	Hekurudha Durrës

#### c- Mbi administrimin e pronës shtetërore dhe zbatimi i dispozitave për dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare.

*Nga auditimi i ushtruar rezultoi se për vitet objekt auditimi të dhënat janë sa vijon:*

Viti	Sipërfaqe e dhënë me qira			Detyrimi mujor lekë/tvsh
	gjithsej	objekt	funksionale	
2019	1,757.5	1,503	234.36	214,244
2020	1878.7	1524	335.16	224,345
2021	1869.3	1597	252.16	266,216
2022	2024.5	1679	325.16	279,038

*Burimi i të dhënave HSH sha*

*Në mënyrë analitike këto të dhëna janë në aneksin C, Tabelat nr.1, 2, 3 dhe 4 Projekt Raportit të Auditimit*

**Nga auditimi rezultoi se në vitin 2019, janë mbajtur detyrime për kamatë vonesa sa vijon:**

Nr.	Subjekti	Shlyerje detyrimi kamate vonese	Akt-Marreveshje me HSH.
1	M. B.	57,312	30.09.2019
2	M. T.	226,099	26.07.2019
3	A. D.	65,669	25.10.2019
4	V.Sh.	77,113	13.11.2019
5	J. D.	79,955	11.11.2019
	<b>Totali</b>	<b>506,148</b>	

*Burimi i të dhënave HSH sha*

- Për vitet objekt auditimi për sipërfaqet nën 200 m<sup>2</sup>, ka rezultuar se:**

-Në Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhës është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019 -2022 nga subjekti “Bashkia Durrës”, një ambient zyre me sipërfaqe totale 174.78 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për zyrat e Policisë Bashkiake Durrës, me vlerë detyrimi mujor 31,190 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me vlerë totale detyrimi mujor 31,625 lekë për vitet 2021, 2022.

-Në Stacionin e Udhëtarëve Durrës është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019 - 2022 nga subjekti “N. Z.” një ambient zyre me sipërfaqe totale 13.08 m<sup>2</sup>, i cili shfrytëzohet për aktivitetin Agjenci Udhëtimi, me vlerë totale detyrimi mujor 2,087 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me vlerë detyrimi mujor 2,119 lekë për vitet 2021, 2022.

-Në Stacionin e Udhëtarëve Durrës është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019 - 2022 nga subjekti “M.”, një ambient hapësirë në tarracën e godinës me sipërfaqe totale 20 m<sup>2</sup> i cili



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

shfrytëzohet për aktivitetin Reklamë Elektronike, me detyrim mujor 4,800 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me vlerë totale detyrimi mujor 4,860 lekë për vitet 2021, 2022.

-Në Stacionin e Udhëtarëve Durrës është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019 - 2022 nga subjekti “M. T.”, një ambient Bar-Kafe me sipërfaqe totale 88 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Bar-Kafe, me vlerë mujore 16,384 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me vlerë mujore 16,603 lekë për vitet 2021, 2022. Me datë 26.07.2019 ky subjekt ka lidhur Akt-Marrëveshje me Hekurudhën Shqiptare SHA për shlyerjen me këste të një detyrimi kamatë vonesë me vlerë 226,099 lekë.

-Në Stacionin e Udhëtarëve Durrës është marrë me qira me afat 24.09.2021 deri më 31.12.2021 dhe 01.01.2022 deri më 31.12.2022 nga subjekti “G. L.”, SHPK një ambient zyrë me sipërfaqe totale (objekt) 40 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Shërbime Mjekësore, me vlerë totale detyrimi mujor 8,100 lekë.

-Në Stacionin e Hekurudhor Lezhë është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019, 2020, 2021, nga subjekti “Shoqata e Invalidëve të Punës” një ambient zyrë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 20.2 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin zyrë, me vlerë mujore 2,460 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me vlerë mujore 2,710 lekë për vitin 2021. Për vitin 2022 nuk ka paraqitur kërkesë për rilidhje kontrate dhe ka liruar ambientin.

-Në Stacionin e Hekurudhor Lezhë, është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019-2020, nga subjekti “Y.”, shpk një ambient zyrë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 14 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin zyrë, me detyrim mujor 1,530 lekë, për vitin 2021 me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 14 m<sup>2</sup> me detyrim mujor 1,642 lekë dhe në vitin 2022 me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 15.5 m<sup>2</sup> me detyrim mujor 1,920 lekë.

-Në Stacionin e Mallrave Lezhë, është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019- 2022 nga subjekti “A.P.”, një ambient magazinë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 190 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin llamarinist, me detyrim mujor 15,960 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me detyrim mujor 26,448 lekë për vitet 2021, 2022.

-Në Ish Stacionin Hekurudhor Rrëshen është marrë me qira me afat 1 vjeçar, nga subjekti “M. B.” një ambient magazinë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 178 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Tregti Artikuj Ushqimor, me detyrim mujor 17,420 lekë për vitin 2019, 2020 me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 100 m<sup>2</sup> dhe me detyrim mujor 9,620 lekë dhe për vitet 2021, 2022 me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 100 m<sup>2</sup> me detyrim mujor 12,090 lekë. Me datë 30.09.2019 ky subjekt ka lidhur Akt-Marrëveshje me HSH sha për shlyerjen me këste të një detyrimi kamatë vonesë me vlerë 57,312 lekë.

-Në Ish Stacionin Hekurudhor Rrëshen është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019-2022 nga subjekti N.T. një ambient magazinë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 70 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Tregti Mobiliesh, me vlerë totale detyrimi mujor 6,240 lekë për vitet 2019,2020 dhe me vlerë totale detyrimi mujor 7,800 lekë për vitet 2021,2022.

-Në Stacionin e Udhëtarëve Dushk, Lushnje, është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019, 2020, nga subjekti “J. D.” një ambient zyrë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 81 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Agjenci Udhëtimi, me vlerë totale detyrimi mujor 7,720 lekë. Me datë 11.11.2019 ky subjekt ka lidhur Akt-Marrëveshje me Hekurudhën Shqiptare SHA për shlyerjen me këste të një detyrimi kamatë vonesë me vlerë 79,995 lekë. Për vitin 2021 nuk ka paraqitur kërkesë për rilidhje kontrate dhe ka liruar ambientin.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

-Në Stacionin Hekurudhor Dushk, Lushnje, është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 nga subjekti “A.D.” një ambient zyrë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 19.5 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Agjenci Udhëtimi, me detyrim mujor 1,570 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me detyrim mujor 1,966 lekë për vitet 2021, 2022.

-Në Stacionin Hekurudhor Dushk Lushnje është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 nga subjekti “S.B.” një ambient magazinë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 58 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Bar-Kafe, me detyrim mujor 5,420 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me vlerë totale detyrimi mujor 6,598 lekë për vitet 2021, 2022.

-Në Stacionin Hekurudhor Lushnje është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 nga subjekti “V.Sh.” një ambient zyrë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 86.9 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Bar-Kafe, me vlerë totale detyrimi mujor 10,755 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me vlerë totale detyrimi mujor 8,936 lekë për vitet 2021, 2022.

-Në Stacionin Hekurudhor Krastë është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 nga subjekti “G.K.”, një ambient dhomë peshore me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 19.5 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Bar-Kafe, me vlerë totale detyrimi mujor 2,241 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me vlerë totale detyrimi mujor 2,268 lekë për vitet 2021, 2022.

-Në Stacionin Hekurudhor Krastë është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2020, 2021 dhe 2022 nga subjekti “Sh. Q.”, një ambient zyrë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 198 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Riparim Makinash, me vlerë totale detyrimi mujor 17,901 lekë për vitin 2020 dhe me vlerë totale detyrimi mujor 19,228 lekë për vitet 2021, 2022.

-Në Stacionin Hekurudhor Bishqem është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 nga subjekti “E .Ç.” një ambient zyrë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 42.4 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Bar-Kafe, me vlerë totale detyrimi mujor 3,784 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me vlerë totale detyrimi mujor 5,723 lekë për vitet 2021, 2022.

-Në Stacionin Hekurudhor Librazhd është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 nga subjekti “L. K.” një ambient zyrë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 25.5 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Tregti Artikuj Ushqimor, me vlerë totale detyrimi mujor 2,094 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me vlerë totale detyrimi mujor 2,804 lekë për vitet 2021, 2022.

-Në Stacionin Hekurudhor Librazhd është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 nga subjekti “F. C.” një ambient zyrë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 83.6 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Tregti Artikuj Industrial, me vlerë totale detyrimi mujor 5,697 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me vlerë totale detyrimi mujor 10,073 lekë për vitet 2021, 2022.

-Në Stacionin Hekurudhor Librazhd është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 nga subjekti “A.D.” një ambient zyrë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 73 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Tregti Artikuj të Ndryshëm, me vlerë totale detyrimi mujor 3,272 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me vlerë totale detyrimi mujor 4,675 lekë për vitet 2021, 2022. Me datë 25.10.2019 ky subjekt ka lidhur Akt-Marrëveshje me Hekurudhën Shqiptare SHA për shlyerjen me këste të një detyrimi kamatë vonesë me vlerë 65,669 lekë.

-Në Stacionin Hekurudhor Elbasan është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 nga subjekti “A. S.”, një ambient zyrë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale)



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

51.1 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Bar-Kafe, me vlerë totale detyrimi mujor 7,038 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me vlerë totale detyrimi mujor 7,145 lekë për vitet 2021, 2022.

-Në Stacionin Hekurudhor Elbasan është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 nga subjekti “E. K.” një ambient magazinë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 200 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Mobilieri, me vlerë totale detyrimi mujor 29,430 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me vlerë totale detyrimi mujor 29,666 lekë për vitet 2021, 2022. Me datë 13.11.2019 ky subjekt ka lidhur Akt-Marrëveshje me Hekurudhën Shqiptare SHA për shlyerjen me këste të një detyrimi kamatë vonesë me vlerë 77,113 lekë.

Në Stacionin Hekurudhor Elbasan është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 nga subjekti “M .D.”, një ambient magazinë me sipërfaqe totale (objekt+ funksionale) 200 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Tregti Artikuj Industrial, me vlerë totale detyrimi mujor 29,772 lekë për vitet 2019, 2020 dhe me vlerë totale detyrimi mujor 29,974 lekë për vitet 2021, 2022.

-Në Stacionin e Mallrave Elbasan është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2019, 2020, nga subjekti “L.M.”, një ambient magazinë me sipërfaqe totale (objekt +funksionale) 53 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Punime Gipsi, me vlerë totale detyrimi mujor 7,380 lekë dhe në vitin 2021 me sipërfaqe totale (objekt +funksionale) 58 m<sup>2</sup> me vlerë totale detyrimi mujor 8,237 lekë. Ky objekt është liruar nga subjekti “L. M.” në vitin 2022 dhe është marrë me qira nga subjekti “R.H.”, me sipërfaqe totale (objekt +funksionale) 58 m<sup>2</sup> me vlerë totale detyrimi mujor 8,237 lekë.

-Në Stacionin Hekurudhor Elbasan është marrë me qira me afat 1 vjeçar në vitet 2021, 2022, nga subjekti “E.B.”, një ambient magazinë me sipërfaqe totale (objekt) 200 m<sup>2</sup> i cili shfrytëzohet për aktivitetin Punime Duralumini, me vlerë totale detyrimi mujor 30,180 lekë.

-Nga viti 2021 dhe në vijim tarifat e qirasë për subjektet që përdorin ambientet në pronësi të Hekurudhës Shqiptare SHA janë përcaktuar sipas V.K.M. Nr. 672, datë 02.09.2020, për disa ndryshime në Vendimin Nr.54, datë 05.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, të ndryshuar dhe janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin Nr.1, datë 27.01.2021.

- **Lidhur me dhënien me qira të ambienteve me sipërfaqe mbi 200 m<sup>2</sup>**

*Dhënia me qira e oficinës së HSH SHA, në Shkozë.*

Kjo oficinë, është aset nën administrimin e “Hekurudha Shqiptare” SHA. Është me certifikatë pronësie (titull pronësie) por MFE nuk ka lidhur asnjëherë kontratë qiraje me objekt këtë oficinë. Procedurat për miratimin e dhënies me qira, kanë nisur nga kërkesa e paraqitur nga shoqëria “A&Z D.M.” SHPK, që mban datën 05.07.2018. Ky subjekt ka në veprimtarinë e tij eksporte, importe përpunim guri si dhe importim të makinerive të ndryshme. Kërkesa e paraqitur nga ky subjekt, është me objekt “Marrjen me qira për 20 vite të repartit/oficinës”, pasi do të investonte në përmirësimin e kushteve aktuale të këtij reparti. Kjo oficinë gjendet në Zonën Kadastrale Nr. 8518. “HSH” sha, pasi është njohur me kërkesën e paraqitur dhe atë që është parashtruar në të, është informuar pas informacionit që ka kërkuar nga Njësia e Shërbimeve Mjeteve Lëvizëse me shkresën nr. 75 Prot., datë 01.03.2019, se ky repart nuk i shërben interesave të shoqërisë, në planin afatgjatë dhe afatmesëm.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Nisur nga sa më lartë, me shkresën nr. 261/3 Prot., datë 18.03.2019, HSH ka kërkuar miratimin për dhënien me qira të një pjese prone, pronësi shtet. Në këtë shkresë është sqaruar se kjo Oficinë në planet afatgjata dhe afatmesme nuk i shërben veprimtarisë së Shoqërisë. Në kuadër të riorganizimit, aktivitetit në këtë repart nuk funksionon, dhe veprimtaria që realizohej në të është integruar në Njësitë e reja të HSH. Në referim të Vendimit nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, i është kërkuar MIE miratimi si organ epror. Kërkesa për miratim, i është paraqitur edhe Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë, në përputhje me nenin 11 të Statutit të Shoqërisë, kërkesë kjo që mban nr. 261/4 Prot., datë 24.04.2019, e cila me Vendimin Nr. 12, datë 01.10.2019 është miratuar në parim dhe nga Këshilli Mbikëqyrës. Ky miratim në parim, i referohet një afati 10 vjeçar, për një sipërfaqe prej 1405 m<sup>2</sup>. MIE miratoi me kusht këtë kërkesë, dhe kushti konsistonte në vendosjen e klauzolës në kontratë “kontrata mund të prishet pa penalitet për entin pronar shtetëror, nëse do të ketë një investim të mundshëm”.

Pas kësaj korrespondence të mbajtur, Administratori i Shoqërisë i është drejtuar Ministrit Pronar, duke vënë në dukje dhe Tarifat që aplikohen në masën 200 lekë/m<sup>2</sup>. MFE ka kërkuar që të plotësohet dokumentacioni i nevojshëm që lidhet me përcaktimin e sipërfaqes funksionale dhe atë nën truall, si dhe të bëhen rregullime të caktuara në dokumentacionin e paraqitur. Miratimi në parim i është kërkuar serish MIE, sipas shkresës nr. 1205/ 2 Prot., datë 31.01.2020. Ky miratim kërkohej dhe nga shkresa nr. 10293/3 Prot., datë 11.03.2020 e MFE. Pas kësaj ka vijuar korrespondenca mbi plotësimin e dokumentacionit të munguar, me MFE. Pavarësisht sqarimeve dhe mbi tarifën dysHEME, dhe mbi dokumentacionin e munguar, kontrata me objektin në fjalë nuk u lidh asnjëherë mes MFE dhe Shoqërisë “A&Z D.M.” SHPK.

**Për Shoqërinë “SV M.,”:** Kontrata e qirasë me çmimin 1 euro/kontrata e lidhur me datë 21.02.2020 me Shoqërinë “SV M.”, konsiston në ndjekjen e një procedure të saktësuar nga kuadri ligjor në fuqi. Shoqëria “SV M.” është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, krijuar në vitin 2015 dhe regjistruar në QKB me numër identifikimi NUIS L.....P, e cila ka si objekt të veprimtarisë së saj prodhimin, përpunimin, rifinimin, bashkimin, shitjen e tregtimin e aksesorëve e komponentëve të auto veturave, arredimin me lëkurë, copë ose materiale të tjera dhe aksesorëve dhe komponentëve për mjetet e lundrimit të makinave për lëvizjen e tyre në rrugë. Në vendimin Nr.37, datë 22.01.2020 “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontratë”, ndërmjet MFE, si qiradhënës dhe “SV M.” shpk, si qira-marrës, për pasurinë shtetërore Nr.1/82, me sipërfaqe totale 554 m<sup>2</sup> dhe Nr.1/83, truall i lirë me sipërfaqe të përgjithshme 4246 m<sup>2</sup>, zona kadastrale 2646, pjesë e stacionit hekurudhor të Librazhdit, e përbërë nga dy pasuri, në administrim të “HSH” sha, Këshilli i Ministrave miratoi lidhjen e kontratës për një periudhë 20 (njëzet) vjeçare, sipas gen-planit dhe tekstit të projekt kontratës bashkëlidhur vendimit. Objekt i kësaj kontrate është dhënia me qira të pasurisë shtetërore “*Pjesë e Stacionit Hekurudhor të Librazhdit*” e përbërë nga dy pasuri: *Pasuria Nr. 1/82 me sipërfaqe totale 554 m<sup>2</sup> nga ku sipërfaqja ndërtimore 34 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe funksionale 520 m<sup>2</sup> dhe pasuria Nr.1/83, truall i lirë me sipërfaqe të përgjithshme 4246 m<sup>2</sup>, Zk. 2646, në total sipërfaqe të përgjithshme 4800 m<sup>2</sup>, në administrim të shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës, sipas gen-planit dhe dokumentit të ZVRPP Librazhd, nr.3557, datë 09.10.2018. Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm të këtyre pasurive për ndërtimin e një kapononi të ri me sipërfaqe rreth 1600 m<sup>2</sup>, në të cilin do montohen makineritë dhe pajisjet të cilat do të*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

shërbejnë në funksion të prodhimit, përpunimit, rifinimit, bashkimit, shitjen e tregtimin e aksesorëve e komponentëve dhe mjeteve lundruese. Në lidhje me objektin e kërkesës, është hartuar dhe Plani Biznesit nga ana e “SV M.” shpk për marrjen me qira të pasurisë shtetërore pjesë e stacionit Hekurudhor Librazhd, e përbërë nga dy pasuri me sipërfaqe totale 4800 m<sup>2</sup>. Qiramarrësi “SV M.” SHPK, sipas Plan Biznesit të paraqitur në konkurrim do të investojë për zgjerimin e aktivitetit të saj, nëpërmjet ngritjes në qytetin e Librazhdit të linjës së re për prodhimin, përpunimin, rifinimin dhe asamblimin e aksesorëve dhe komponentëve për auto vetura dhe mjete lundruese, produkte të cilat kanë si destinacion eksportin e tyre. Shoqëria nga data e marrjes në dorëzim të objekti dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse do të investojë 41 milion lekë pa TVSH e ndarë: Investimi që do të kryhet për punime e ndërtime në vlerën 40 milion lekë; Investime lidhur me transportin dhe montimin e makinerive të cilat kompania i ka gjendje të aktivitetit ekzistues të shoqërisë në vlerën 1 (një) milion lekë.

Është finalizuar ky dakortësim me kontratën e qirasë me çminim simbolik 1 Euro, Nr.180 rep., Nr.113 kol., datë 21.02.2020.

- **Mbi vagonët e mallit, të dhënë me qira:** Kontrata e qira-dhënies së vagonëve të mallit, e finalizuar me datë 22.09.2022, konsiston në ndjekjen e një procedure të saktësuar nga kuadri ligjor në fuqi. Në referim të Vendimit nr. 50, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, dhe statutit të Shoqërisë, i është paraqitur Këshillit Mbikëqyrës, relacioni sqarues nga Administratori i Shoqërisë. Ky relacion mban nr. 735/ 2 Prot., datë 26.07.2022 dhe bazohet në kërkesën me objekt “Dhënie me qira të 26 vagonëve të mallit Kompanisë 16 Februrar”. Këto vagonë administrohen nga Njësia e Biznesit të Mallit. Objekti i kësaj kërkesë për 26 vagonët që u dhanë me qira, pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë, përfshinin një përfitim prej 45000 euro në vit. Në referim të nenit 11 të Statutit të Shoqërisë dhe Udhëzimit nr. 50.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar kërkesën e parashtruar nga Administratori i Shoqërisë. Në lidhje me objektin e kërkesës është hartuar dhe Plan Biznesi për Përdorimin e vagonëve të mallit. Nga ana tjetër pala malazeze ka vënë në dispozicion dokumentacionin. Për sa më sipër, si dhe në referim të korrespondencës së mbajtur me palën qiramarrëse, është dakortësuar dhe finalizuar ky dakortësim, në kontratën e qiradhënies së vagonëve të mallit, me nr. 735/ 5 Prot., datë 22.09.2023.

#### **2.5 Mbi organizimin e strukturës organizative, dhënenin e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.**

Për auditimin e kësaj pike të Programit të Auditimit, Grupi i auditimit është bazuar në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligji nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjeve/rregullave specifike të institucionit që auditohet.

“Hekurudha Shqiptare” SHA, funksionon si një shoqëri Aksionare me kapital 100% shtetëror. Në periudha të ndryshme kohore, referuar dhe trafikut hekurudhor, subvencionimit në nivele të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

ndryshme në vite të ndryshme, apo fazave të tjera që synonin rehabilitimin e linjave të caktuara hekurudhore, kanë pasuar rrjedhimisht me uljen e numrit të fuqisë punëtore si dhe numrit të punonjësve të administratës hekurudhore.

Numri i punonjësve nuk ka tejkaluar strukturën organizative të miratuar, pasqyruar edhe me tabelën në vijim.

**Tabela Nr.1** Numri i fuqisë punëtore plan dhe fakt

Nr. punonjësve	Viti 2019		viti 2020		viti 2021		viti 2022	
	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
	992	962	992	947	992	936	908	826

Gjatë vitit 2020, “Hekurudha Shqiptare” SHA, ka patur në marrëdhënie punë dhe financiare 947 punonjës pavarësisht se plani dhe struktura organizativa parashikonte 992 nëpunës.

Në vitin 2021 kanë qenë të punësuar 936/ 992 punonjës, ndërsa për vitin 2022 ky numër është rishikuar edhe një herë në kuadrin e trafikut hekurudhor dhe bllokimit të segmentit hekurudhor Durrës-Tiranë për shkak të Rehabilitimit të linjës Hekurudhore Durrës-Tiranë dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në aeroportin Nënë Tereza. Viti 2022 përkon me procedurën për ndërprerjen e marrëdhënieve kolektive të punës, ku janë shkurtuar 333 poste pune. Ecuria e treguesve ekonomikë-financiarë të Shoqërisë, është shoqëruar me një performancë të dobët për mbulimin e shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe blerje karburanti dhe në të njëjtën kohë kjo ecuri pasqyron një vështirësi likuiditeti të Shoqërisë për shlyrjen nga ana e saj të detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve.

Subvencioni për vitin 2022 prej 390,000,000 lekë (10 milion lekë më pak nga viti paraardhës) rëndon në mënyrë direkte në pagesën e sigurimeve shoqërore pasi me rritjen e pagës minimale në 32,000 lekë në vitin 2022, nuk ka majftueshëm fonde për të mbuluar shpenzimet për sigurimet shoqërore. Aktualisht, 87% e punonjësve të HSH SHA, paguhen me pagë minimale dhe kjo rritje ka ndikuar në vlerën prej 4,500,000 lekë për 9 mujorin për vitin 2022 për sigurimet shoqërore në total.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 20 pika 3 të “Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Shoqërisë të Hekurudhave SHA dhe në zbatim të programit ekonomik-financiar të vitit 2022 (të rishikuar), rezulton se në HSH SHA, ka ndryshim në numrin total të fuqisë punëtore, që parashikonte organigramën e strukturimit organizativ. Nga data 01.10.2022 e në vazhdim, numri i punonjësve u ul në 659 punonjës, bazuar me Vendimin nr. 4, date 07.06.2022 e Këshillit Mbikëqyrës për ristrukturimin.

NR.	NJËSIA BIZNESIT	NR.AKTUAL PLAN	NR.SIPAS STRUKTURAVE TË REJA	NR.ULJES F.PUNËTORE
1	NJËSIA QËNDRORE	47	60	-13
2	NJËSIA BIZNESIT UDHËTARE	168	96	72
3	NJËSIA BIZNESIT MALLIT	117	91	26
4	NJ.B.M.INFRASTRUKTURËS	564	349	215
5	NJËSIA SHËRBIMIT TË MJETEVE	96	63	33
	<b>TOTALI</b>	<b>992</b>	<b>659</b>	<b>333</b>

**Tabela nr.2**-Treguesit e numrit të fuqisë punëtore e ndarë sipas Njësive të HSH SHA.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Ky ristrukturim ka pasur për qëllim:

-Uljen e shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore

-Funksionimin sa më të mirë të Strukturave të Njësive të Shërbimeve dhe Biznesit për zbatimin e detyrave të ngarkuara, për të përshtatur këtë Strukturë Organizative në funksion të punës dhe aktivitetit që kryejnë aktualisht HSH SHA si edhe në trafikun e trenave që kalojnë në linjën Hekurudhore Shqiptare.

-Mbi bazën e detyrave funksionale të cdo Njësie në zbatim të Rregullores së Shfrytëzimit teknik të Hekurudhave dhe Rregullores për Organizmin dhe Funksionimin e Shoqërisë.

Për shkaqe të ndryshme që lidhen edhe me fenomene natyrore, gjatë periudhës 2019 deri 2022, rrjeti Hekurudhor Shqiptar, është bërë i paaksesueshëm në disa nga segmentet e tij. Fillimisht pandemia COVID-19, ka qenë faktori kyç i cili paralizoi jo për pak kohë operimin e trenave, qofshin të transportit mallrave apo të pasagjerëve. Krahas të tjerave, funksionimi i linjave dhe rrjetit Hekurudhor Shqiptar, u dëmtua jo pak nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Dëmtimi i dy veprave të artit, “Urës së Ishmit” dhe “Urës së Rrogozhinës”, të cilat pësuan dëmtime duke i bërë këto dy ura jo funksionale ose më saktë duke kufizuar hartën e infrastrukturës Hekurudhore të aksesueshme. Trafiku hekurudhor, pësojë një ulje domethënëse, e cila vazhdon të jetë e tillë edhe sot.

Në zbatim të Rregullores dhe Statutit të Shoqërisë, në funksion të politikave, transportit si edhe projekt-programit ekonomik, në vijim janë vendimet e Këshillit Mbikëqyrës për Strukturat Organizative;

1. Vendimi nr. 5, datë 27.03.2019, lidhur me Strukturën e Re të Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë.

2. Vendimi Nr. 6, datë 03.09.2020, lidhur me emërtesën e re dhe oraganizimin e ri të Njesisë së Projekteve në dy grupime menaxheriale.

3. Vendimin nr. 4, datë 27.05.2022, lidhur me strukturën e re Organizative të Shoqërisë, shoqëruar me skemën organizative të saj.

Numri i punonjësve të sektorit hekurudhor Shqiptar miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës është 659 punonjës i përberë nga:

1. Njësia Qendrore 61 punonjës

2. Njësia e Biznesit të Mallit 91 punonjës

3. Njësia e Biznesit të Udhëtarit 96 punonjës

4. Njësia e Biznesit të Menaxhimit Infrastrukturës 349 punonjës

5. Njësia e Biznesit të Mjeteve Lëvizëse 62 punonjës

Aktualisht numri i punonjësve në HSH SHA në nivele të ndryshme është 641. Vakanca që konstatohet lidhet me profesione specifike që i shërbejnë Njesisë së Menaxhimit dhe Zbatimit të Projekteve. Sigurisht që për këtë ndikon paga, e cila vlerësohet ende si nën vlerat e tregut të punës. Në fakt, problematika e pagave është një çështje e vjetër në shoqërinë Hekurudha Shqiptare SHA. Niveli i ulët i pagave, vështirëson rekrutimin e burimeve njerëzore që nevojiten dhe sigurisht edhe nivelin e tyre të kualifikimeve.

Kjo çështje është prekur dhe nga auditimet e mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke e cilësuar si një çështje prioritare për t’u zgjidhur. Nëse i referohemi strukturës organizative të HSH SHA, vihet re se për personelin e lëvizshëm dhe të stacionuar, janë më shumë se 1 pozicion pune për pozicionet “Kryetar Treni”, “Mekanik Treni”, “Pastruese Salle”, “Shoqërues Vagoni”,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

“Vëzhgues Linje”, “Punëtor Linje”, etj. Nga auditimi lidhur me lëvizjen ose fluksin e trenave, u konstatua se HSH SHA, ka lidhur tre kontrata për transportin e mallrave dhe konkretisht me “D. 20 G.,” SHPK me kontratën nr.95 Prot., datë 31.01.2023, me “D.O.O ,” me kontratën nr. 152 Prot., datë 13.02.2023 dhe me “D.O.O P,” me kontratën nr.152/1 Prot., datë 13.02.2023. Të tre këto kontrata, janë lidhur për qarkullimin e trenave të mallrave në itinerarin Bajzë-Gjorm. Nuk ka asnjë të dhënë lidhur me nevojën për angazhimin në punë të stafit të cilësuar më lart për linjat e tjera hekurudhore. Gjithashtu edhe nëse i referohemi lëvizjes së trenave për pasagjerë, nuk konstatohet të ketë trafik të vazhdueshëm çdo ditë për transportin e pasagjerëve edhe për vetë faktin se linjat hekurudhore Shqiptare, në shumicën e rasteve janë të pakalueshme. Nisur nga sa më sipër, duke marrë në konsideratë dhe faktin se HSH SHA, ka kërkuar rritje të nivelit të pagave nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Ministria e Financave, mund të ishte një zgjidhje edhe ulja e numrit të stafit për të cilin nuk rezulton se janë të angazhuar në punë sistematikisht edhe për arsye të kufizimit të theksuar të lëvizjes së trenave. Njësia e Biznesit të Mallit, Njësia e Biznesit të Udhëtarit, Njësia e Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës, Njësia e Biznesit të Mjeteve Lëvizëse, në bashkëpunim me Njësinë Qendrore të HSH SHA, duhet të kryejnë një analizë të thelluar mbi performancën e strukturave të tyre, për të evidentuar nëse është ose jo i nevojshëm numri i punonjësve të çdo njësie dhe në vazhdim të kërkojnë nga Strukturat Vendimmarrëse, ndryshimin e strukturës organizative dhe marrjen e masave për uljen e numrit të stafit që nuk është e nevojshme të angazhohen në ato pozicione ku nuk justifikohet eficensa dhe efektiviteti i punonjësve, referuar ngarkesës së punës në lëvizjen e transportit hekurudhor shqiptar. Gjatë viteve 2019, 2020, 2021 dhe 2022, në Hekurudhën Shqiptare SHA Durrës, ka pasur lëvizje të punonjësve në pozicione të ndryshme pune brenda strukturës së saj si dhe largime nga puna ashtu dhe në marrjen në punë, sipas tabelës së mëposhtme:

Vitet	2019	2020	2021	2022
Punësime	95	108	115	62
Largime	146	62	187	325

*Tabela 3 Punësime dhe largime nga puna 2019-2022*

Këto lëvizje të, nuk janë reflektuar gjithmonë me procese gjyqësore, pasi një pjesë e largimeve kanë ardhur si rezultat i daljeve në pension, një pjesë nga mos paraqitja në punë, dalja në KEMP, dorëheqje, suprimim i vendit të punës si pasojë e ristrukturimit, etj.

-Gjatë vitit 2019, “Hekurudha Shqiptare” SHA, ka qenë palë në çështjen gjyqësore me paditës K. Sh., nga i cili, Gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë në favor të HSH SHA. Ky vendim nuk u ankimua nga pala paditëse.

-Përgjatë vitit 2020, janë marr vendime për tre kërkesë padi, vendime të cilat janë ekzekutuar. Lidhur me procedurat gjyqësore për vitin 2020, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, rezultoi se:

-Gjyqi me paditës z. P. Sh., është fituar nga paditësi në Gjykatën e Apelit Durrës, sipas vendimit të gjykatës me nr.10-2020-1033/284, datë 16.09.2020. Pas shpalljes së vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, Administratori i HSH SHA z. A D., nëpërmjet shkresës me nr. 41/18 Prot., datë 10.12.2020, urdhëron transferimin e fondeve për likuidime detyrimesh ndaj të tretëve dhe konkretisht për llogari të paditësit z. P.Sh., konform vendimit me nr. 10-2020-1033/284, datë 16.09.2020 të Gjykatës së Apelit Durrës. Vlera e transferuar për llogari të paditësit është **487,750**



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

**lekë** si vlerë që i përket dëmshpërblimit sipas vendimit të gjykatës për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës midis HSH SHA si punëdhënës dhe z. P. Sh. si punëmarrës.

-Gjyqi me paditës znj. Xh. F., është fituar nga paditësi në Gjykatën e Apelit Durrës, sipas vendimit të gjykatës me nr.10-2020-823/243, datë 30.06.2020. Pas shpalljes së vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës midis HSH SHA si punëdhënës dhe znj. Xh.F., si punëmarrës dhe vendimit nga Dhoma Kombëtare e Përmbaresve Gjyqësor Privat me nr.577 Prot., datë 12.11.2020, ardhur në HSH SHA në datën 17.11.2020, me objekt “*Pushimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv pasi është ekzekutuar plotësisht*” sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, HSH SHA ka likuiduar detyrimin palës paditëse në vlerën **657,216 lekë**, sipas Statement të Nxjerr nga A. B. të llogarisë rrjedhëse të HSH SHA nga dega nr.009 dhe datë veprimi datën 10.11.2020.

-Gjyqi me paditës z. L. B., është fituar nga HSH SHA në Gjykatën e Apelit Durrës, sipas vendimit të gjykatës me nr.10-2020-863/253, datë 23.07.2020.

-Përgjatë viti 2021, “Hekurudha Shqiptare” SHA, nuk ka patur çështje që kanë përfunduar, me objekt “Ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”. Për sa i përket çështjeve gjyqësore të cilat nisën shqyrtimin përgjatë vitit 2022, situata paraqitet si në vijim:

-Gjyqi me paditës z. F.N., është fituar nga paditësi në Gjykatën e Apelit Durrës, sipas vendimit të gjykatës me nr.10-2020-786/207, datë 26.04.2022. Gjyqi me paditës z. M. P., është fituar nga paditësi në Gjykatën e Apelit Durrës, sipas vendimit të gjykatës me nr.10-2020-786/207, datë 26.04.2022. Pas shpalljes së vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, Administratori i HSH SHA z. G.L., nëpërmjet shkresës me nr. 732/3 Prot., datë 18.07.2022, urdhëron transferimin e fondeve për likuidime detyrimesh ndaj të tretëve dhe konkretisht për llogari të paditësve z. F.N., dhe z. M.P., konform vendimit me nr. 10-2020-786/207, datë 16.09.2020 të Gjykatës së Apelit Durrës. Vlera e transferuar për llogari të të dy paditësve është **1,226,624 lekë** si vlerë që i përket dëmshpërblimit sipas vendimit të gjykatës për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës midis HSH SHA si punëdhënës dhe z. F. N., & z.M P., si punëmarrës.

-Sa më sipër, vlera në total e likuiduar për llogari të punëmarrësve z. P.Sh., znj. Xh. F., z. F. N., dhe z. M.P., pas vendimit të Gjykatave të Apelit (trajtuar më lart) me arsyen e zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratave të punës midis HSH SHA dhe punëmarrësve më sipër, **është 2,371,590 lekë dhe vlerësohet nga grupi i auditimit si vlerë me efekte financiare në dëm të buxhetit të shtetit.**

-Gjyqi me paditës z. N. D., është fituar nga HSH SHA në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, sipas vendimit të gjykatës me nr.1108, datë 04.03.2022. Ende nuk ka një njoftim nëse Vendimi është ankimuar nga pala paditëse apo jo.

-Gjyqi me paditës znj. A.Gj., është humbur në Gjykatën e Shkallës së Parë në Kurbin, sipas vendimit të gjykatës me nr.615-218, datë 13.05.2022. Vendimi është ankimuar nga pala e paditur (HSH SHA) sipas ankimit me shkresën nr. 624/3 Prot., datë 07.06.2022 MIE drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Gjykimi është në proces.

-Gjyqi me paditës z. B.D., është një gjyq i mbartur nga Njësia e Biznesit Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore. Aktualisht po shqyrtohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

-Gjyqi me paditës z. P.C., është një gjyq i mbartur nga Njësia e Biznesit Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore. Kjo çështje vijon në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Nuk ka seancë të radhës, për shkak se në seancën që ishte planifikuar të zhvillohej me datë 04.05.2023, mungonte gjyqtarja dhe sekretaria e çështjes.

Arsyeja	Pension/LPP/me dëshirë	Procedure Asistence/diipline	Total
2019	133	13	146
2020	55	7	62
2021	137	50	187
2022	83	242	325

*Tabela nr.4 Largimet 2019-2022*

-Hekurudha Shqiptare SHA për rekrutimet, jo në të gjitha rastet ka ndjekur procedurat që janë të miratuara me Vendim të këshillit Mbikëqyrës dhe që paraqiten në vijim.

-Shpallet njoftimi për vendin vakant të punës sipas Udhëzimit nr.1170, datë 15.11.2018 miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.14, datë 18.07.2018.

-Shqyrtohen dokumentacioni i dorëzuar pranë Burimeve Njerëzore nga personat e interesuar sipas nenit 6.3 të Udhëzimit nr.1170, datë 15.11.2018.

-Përzgjidhen nga Komisioni i përbërë nga tre anëtarë, dokumentacioni më i përshtatshëm për vendin vakant.

-Komisioni shqyrton dokumentacionin e ardhur dhe plotësohet formulari përkatës me pikët e mbledhura për të përzgjedhurin. Plotësohet Raporti përmbledhës për Administratorin e Shoqërisë ku vihet në dijeni mbi procedurën dhe fituesin e vendit vakant.

-Me urdhër të Administratorit të shoqërisë, bëhet emërimi në pozicionin e shpallur sipas nenit 6.9 të këtij Udhëzimi.

-Njoftohet njësia ku emërohet, lidhet kontrata midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, duke bashkëngjitur dhe detyrat që duhet të zbatojë sipas pozicionit të punës.

#### **Lidhur me rregullshmërinë e administrimit të dosjeve të personelit.**

-Nga auditimi me zgjedhje i disa dosjeve të personelit, u konstatuan parregullsi lidhur me dokumentacionin e ndodhur në dosje. Dosjet e audituara ishin pa inventarin përkatës, ose mungonte dokumentacioni vërtetues për shpalljen e pozicionit vakant ose dhe vendimi i komisionit të verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati për vendin vakant. Mungonte në disa raste certifikata familjare si dokument që nevojitet për të evidentuar ndonjë rast konflikti interesi në administratë. U konstatua në disa raste, mungesa e librezës së punës së punonjësit dhe kjo krijon pengesa për të evidentuar eksperiencat e mëparshme të punëmarrësit. U konstatua se mungonte në disa raste, urdhri i emërimit të punonjësit, urdhri i transferimit në një pozicion paralel ose edhe dokumenti për masat disiplinore të dhëna apo certifikatat e trajnimeve të ndryshme që mund të ketë ndjekur punëmarrësi. U evidentua gjithashtu edhe mungesa e urdhrimit për shkëputje të marrëdhënieve financiare me HSH SHA përse i përket punonjësve të larguar.

-Dosjet e personelit të administratës shtetërore, duhet të jenë të plotësuara me të gjithë dokumentacionin e cilësuar tek:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

-VKM nr.833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. Bashkëlidhur këtij akti lidhja (1) dhe lidhja (2) në total 5 faqe e VKM së mësipërme për sqarim për subjektin e audituar.

-VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. Bashkëlidhur këtij akti pjesë nga VKM e mësipërme në total 1 faqe, për sqarim për subjektin e audituar. (Kreu I, pika 8, specifikisht për dosjet e personelit të punonjësve të larguar).

*Për sa më sipër është mbajtur Akt konstatimi nr. 7, datë 12.05.2023.*

Titulli i Gjetjes:	Efekt negativ, largim i padrejtë nga puna (vendim gjyqësor).
<b>Situata:</b>	Për periudhën objekt auditimi, si rezultat i largimeve nga puna pa shkaqe të arsyeshme, “Hekurudha Shqiptare” SHA, është penalizuar me vlerën prej 2,371,590 lekë. Pavarësisht ndjekjes në të gjitha shkallët e gjykimit dhe kontestimeve nga HSH SHA të vendimeve të gjykatave, për dëmshpërblimet si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës konstatohet se vendimet në shumicën e rasteve janë në favor të punonjësve të larguar. Në vitin 2022, janë marrë 4 vendime të formës së prerë me vlerë totale dëmshpërblimi për punonjësit e larguar padrejtësisht në 2,371,590 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar në dëm të buxhetit të shtetit dhe në të ardhmen shkakton rëndim të situatës financiare duke cenuar zhvillimin normal të aktivitetit ekonomiko-financiar të “Hekurudha Shqiptare” SHA, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Ulje e të ardhurave të shoqërisë
<b>Shkaku:</b>	Largim i padrejte nga puna
<b>Rëndësia:</b>	E Mesme
<b>Rekomandim:</b>	Këshilli Mbikëqyrës i Hekurudhës Shqiptare SHA, të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive lidhur me largimet e padrejta nga puna të punonjësve nga Strukturat Drejtuese.
<b>Rekomandim:</b>	Strukturat Drejtuese të shoqërisë dhe Dega e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për rekrutimin e punonjësve bazuar në kërkesat e vendit të punës, me qëllim shmangien e efekteve negative financiare që shkaktohen nga dëmshpërblimi si pasojë e vendimeve gjyqësore.

#### 2.6 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

- **Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.**

Nga auditimi ka rezultuar se, është hartuar Regjistri i parashikimeve dhe i realizimit për vitet objekt auditimi.

Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi është mbështetur në Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës përkatëse ". Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pakësimeve është dërguar



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

regjistri përkatës. Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB –ve përkatëse.

NJP dhe NZ, kanë vepruar në përputhje me VKM, nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”, pika 1, ku cilësohet: “Në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime, AK është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së”.

Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 914, neni 4 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar.

- ***Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).***

Për auditimin e kësaj nën çështjeje u verifikuan: Dosjet e procedurave; Përcaktimi i kriterëve të vlerësimit; Hartimi i DT;

- **Mbi administrimin e dosjeve nga NJP:** Nga Grupi i auditimit u shqyrtua i gjithë dokumentacioni i ndodhur në Dosjen e prokurimit për të gjitha procedurat e audituara, nga ku rezultoi se: Në përgjithësi nga NJP, janë zbatuar të gjitha detyrat e përcaktuara, si: përgatitja e regjistrave të prokurimit; përzgjedhja e llojit të procedurës, hartimi Urdhrit të prokurimit; përgatitja e DT, plotësimi i gjithë dokumenteve standarde për t’u plotësuar nga AK, ka administruar të gjitha procesverbalet e mbajtura gjatë zhvillimit të procedurës; ka respektuar afatet e procedurës, ka administruar dokumentacionin e OE fitues, ka shqyrtuar dhe ka reflektuar të gjitha rekomandimet e APP-së, mbi kriteret kualifikuese, sipas vërejtjeve të saj gjatë monitorimit të procedurave, etj. Nga ana e Juristit të NJP janë administruar dhe inventarizuar të gjitha dosjet e prokurimit. Pjesë e dosjeve ishte i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas akteve ligjore, nënligjore dhe DST.

Sa më sipër, juristi i NJP ka vepruar në përputhje me VKM nenin 57, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 3.

- **Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik:**

Nga ana e AK Hekurudha Shqiptare sha gjatë periudhës objekt auditimi 01.06.18 – 31.12.2022, janë zhvilluar procedura prokurimi dhe janë audituar sa më poshtë vijon:



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Viti	Numër procedurash	Fondi limit	Operatorë Ekonomikë		Vlera e ofertës fituese	Diferenca nga fondi limit	Audituar nga KLSH	
			pjesëmarrës	të kualifikuar			Numër	Vlerë
<b>6 mujori II/ 2019</b>	13	134,455,935	57	17	119,254,536	15,201,399	9	117,006,163
<b>2020</b>	3	24,224,734	13	6	20,415,579	3,809,155	3	24,224,334
<b>2021</b>	10	109,948,548	70	13	89,972,610	19,975,938	4	64,785,901
<b>2022</b>	3	45,057,257	14	10	42,290,651	2,766,606	2	43,420,457
<b>Total</b>	<b>29</b>	<b>313,686,474</b>	<b>154</b>	<b>46</b>	<b>271,933,376</b>	<b>41,753,098</b>	<b>18</b>	<b>249,436,855</b>

*Burimi i dhënave: HSH sha.*


Në mënyrë nominale procedurat e audituara janë në Aneks nr.6, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit. Sipas riskut dhe materialitetit bazuar në llojin e procedurave për gjithë vitet objekt auditimi, është audituar **79,5%** të fondit limit.

Nga auditimi ka rezultuar se, në përgjithësi **ka fituar vlera më e ulët e vlefshme e paraqitur në procedurën e prokurimit si dhe ulja nga fondi limit është në masën 13.5%**.

Ndërkohë që për periudhën objekt auditimi nga procedurat e audituara ka rezultuar një pjesëmarrje e 154 OE prej së cilëve **janë s'kualifikuar 46 prej tyre ose 29.9 %**.

*Tabela analitike “Mbi procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga AK, HSH sha dhe të audituara nga grupi i auditimit të KLSH:*

Nr	Objekti I prokurimit	Procedura e prokurimit	Fondi limit	OE		Fituesi	Vlera fituese	Diferenca nga FL
				gjithsej	S'kualifikuar			
	<b>Viti 2019</b>							
1	Blerje pjesë këmbimi dhe agregatë për lokomotiva dhe vagonë në 2 lote	e hapur	8,371,580 2,458,029	1 1	0 0	Z. shpk	8,100,000 2,350,000	271,580 108,029
2	Rik. i godinës të NJSHML	kërkesë propozim	6,652,974	16	2	F.Shpk	4,588,126	2,064,848
3	Blerje traversa druri	e hapur	25,000,000	5	3	Z. shpk	24,300,000	700,000
4	Rikonstruksion i reparteve dhe linjave të NJSHML	kërkesë për propozim	7,498,199	10	3	E. shpk & A.Shpk	4,834,670	2,663,529
5	Rikonstruksion i linjës Kavajë - Rrogozhinë”,	kërkesë për propozim	10,000,000	4	2	“C” Shpk	8,336,810	1,663,190



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Nr	Objekti I prokurimit	Procedura e prokurimit	Fondi limit	OE		Fituesi	Vlera fituese	Diferenca nga FL
				gjithsej	S` kualifikuar			
6	Rinovim agregate për lokomotiva	e hapur	10,820,000	1	0	Z shpk	9,340,000	1,480,000
7	Punime për mbrojtjen e linjës	e hapur	21,250,000	4	2	E. B&B & V. E	17,781,681	3,468,319
8	Rikonstruksion i linjës Milot-Lezhë	e hapur	12,500,000	3	1	B. shpk	12,000,314	499,686
9	Rik. i linjës Shkozet-Kavaje	e hapur	12,455,381	4	3	C.shpk	12,402,727	52,654
<b>Viti 2020</b>								
10	Blerje traversa betoni 820 copë	e hapur	10,061,000	4	0	Z. shpk	7,954,000	2,107,000
11	Rikonstruksion i linjës hekurudhore Shkodër Hani i Hotit	kërkesë për propozim	8,333,334	7	2	Sh. shpk	7,091,579	1,241,755
12	Rinovim agregate për lokomotiva 2020	kërkesë për propozim	5,830,000	2	1	Z. shpk	5,370,000	460,000
<b>Viti 2021</b>								
13	Rikonstruksion i linjes Budull-Gjormë	kërkesë për propozim	10,000,000	6	0	E.2000 shpk	8,103,481	1,896,519
14	Rikonstruksion i linjës Milot Lezhë	kërkesë për propozim	9,785,902	6	2	E. B&B shpk & F. shpk	7,398,713	2,387,189
15	Riparim vepra arti	kërkesë për propozim	11,666,666	8	0	Rr. G. shpk	7,692,513	3,974,153
16	Blerje traversa druri	e hapur	33,333,333	3	0	E. B&B shpk	30,038,112	3,295,221
<b>Viti 2022</b>								
17	Riparim vepra arti – Mbrojtja e urës hekurudhore të Rogozhinës	E hapur	32,977,391	6	5	M. L V..&E. G.	31,499,772	1,477,619
18	“Rik. i reparteve dhe linjave hekurudhore të NJ.SH.M.L	E hapur e thjeshtuar	10,443,066	6	4	2 N shpk	9,218,870	1,224,196
<b>Totali</b>			<b>249,436,855</b>	<b>97</b>	<b>30</b>		<b>211,309,789</b>	<b>38,127,066</b>

*Burimi i dhënave: HSH sha.*

#### 1. Titulli i Gjetjes: Përbërja e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit

##### Situata:

Në procedurat e prokurimit publik të kryera nga AK, për periudhën objekt auditimi, pothuajse në të gjitha procedurat e audituara, nga ana e APP është dhënë asistencë teknike për kërkesat e veçanta për kualifikim. Pavarësisht se rekomandimet e dhëna nga APP janë zbatuar sipas shtojcave të modifikimit të




## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

<b>Kriteri:</b>	<p>DST-ve, kjo ka sjellë shtyrjen e afatit të procedurës së prokurimit.</p> <p>Në përbërjen e njësisë së prokurimit nuk ka specialistë të fushës, por ato janë me profesion jurist dhe vetëm në tre raste është inxhinier elektrik, por që nuk është i fushës konkrete, kërkesë kjo e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 57, “Njësia e prokurimit”, pika 1 dhe 2, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 74, pika 4, neni 78.</p> <p>Nisur nga fakti se projektet, preventivat dhe specifikimet teknike hartohen nga Njësia e Infrastrukturës, bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim mbikëqyrje dhe kolaudim”, neni 3, “Shërbimet dhe tipologjitë”, pika 5, ku janë përcaktuar tipologjitë e shërbimit, kriteret e veçanta teknike duhet të ishin hartuar nga njësia e cila paraqet projektet, preventivat dhe specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.</p> <p>Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar; VKM nr. 354, datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim mbikëqyrje dhe kolaudim”.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<p>Shtyrje e afatit të procedurës së prokurimit, për argumentim kriteresh kualifikuese.</p>
<b>Shkaku: Rëndësia:</b>	<p>Mosargumentim i kriterëve teknike të procedurës. E lartë</p>
<b>Rekomandime:</b>	<p>AK, Hekurudha Shqiptare sha, të marrë masa që hartimi i kriterëve teknike për kualifikim të kryhet nga specialisti i fushës së njësisë së prokurimit ose nga struktura të posaçme, Njësia e Infrastrukturës.</p>

#### **2. Titulli i Gjetjes:** Projektet nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse.

<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi rezulton se projektet nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat përgjegjës për realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Grupi i projektimit duhet jetë i përbërë minimumi nga: inxhinieri gjeodet për plan rlevimin dhe azhurnimin topografik, projektuesi arkitekt, projektuesi konstruktor, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi i instalimeve hidrosanitare, projektuesi i instalimeve ngrohje ftohje ventilim, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri, inxhinieri sizmolog, inxhinieri gjeolog, eksperti mjedisor, veprim jo në përputhje me VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe</p>
-----------------	--



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

<b>Kriteri:</b>	subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	ligji nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 5.
<b>Shkaku:</b>	Hartim i projektit me mangësi pa saktësi dhe të pa bazuar në situatën dhe kërkesat reale infrastrukturore.
<b>Rëndësia:</b>	Kjo situatë është shkaktuar si rrjedhojë e hartimit të projektit nga projektues të palicencuar.
<b>Rekomandime:</b>	E lartë Nga Administratori i shoqërisë të merren masa për të operuar vetëm me projekteve të zbatimit të hartuara nga projektues, të pajisur me licencat përkatëse.

**2. Titulli i Gjetjes:** Hartimi i kriterëve teknike nga struktura të specializuara apo antar të njësisë së prokurimit të fushës.

<b>Situata:</b>	Nga auditimi i dokumentacionit për përlllogaritjen e fondit limit nga komisionet përkatëse rezultoi se: Nuk ka të dhëna mbi çmimet bazë të kontratave të mëparshme të vetë AK. Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, nuk liston asnjë çmim të kontratave të mëparshme për të lënë gjurmë auditimi, por kërkojmë nga njësia e prokurimit dhe strukturat juridike pranë saj të bëjnë verifikimin ligjor të procedurës së ndjekur për hartimin e fondit limit dhe nëse del ndonjë problem të referohet për ndryshimet e nevojshme, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, neni 74/4, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, neni 76, “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, pika 3. Nga ana e këtij komisioni përcaktohet se: “Vlerat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve do të mbulohen nga ulja në procedurën e prokurimit”, veprim jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 1, “Përgjegjësia e autoritetit/entit kontraktor”.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar;
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Perlllogaritje dhe mos argumentim i saktë i fondit limit
<b>Shkaku:</b>	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të prokurimit publik.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	AK, Hekurudha Shqiptare sha, të marrë masa të argumentojë përlllogaritjen e fondit limit sipas detyrës së caktuar nga titullari.





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Komisioni i përlogaritjes së fondit limit të mostejkalojë kompetencat e caktuara, duke përcaktuar fondet për mbikqyrje e kolaudim nga përlogaritja e fondit limit të procedurës së urdhëruar.

**2. Titulli i Gjetjes:** Dokumentimi i specifikimeve teknike dhe arsyetimit të domosdoshmërisë së kryerjes së procedurës së prokurimit jo të saktë.

<b>Situata:</b>	Nga auditimi i procedurave të prokurimit kryesisht për blerje traversa druri apo rikonstruksione të linjave rezultoi se në specifikimet teknike, komision nuk ka përcaktuar llojin e standardit të KE në fuqi si dhe është kërkuar certifikatë cilësie e prodhuesit, pa përcaktuar numrin e saj, certifikatë garancie të prodhuesit pa përcaktuar afatin e garancisë së traversave, veprim jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, neni 27, Kontratat e mallrave, pika 1. Ndërsa në arsyetimin për nevojën e prokurimit për blerje traversa druri hekurudhore (kjo e vlefshme edhe për rikonstruksionin e linjave), jepet arsyetimi i gjendjes së rënduar hekurudhore, por në lidhje me rezultatet e kontrollit teknik periodik të kryer në linjën hekurudhore nuk jepet asnjë e dhënë mbi rezultatet se sa janë kërkuar dhe për kë linja janë kërkuar këto traversa. Sa më sipër është jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit”, pika 1.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar;
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Paqartësi në specifikime teknike dhe indirekt në kriteret teknike të procedurës së prokurimit.
<b>Shkaku:</b>	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të prokurimit publik
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	AK, Hekurudha Shqiptare sha, të marrë masa që hartimi i specifikimeve teknike të bëhet i plotë me të gjitha përcaktimet e duhura sipas objektit të prokurimit. AK, Hekurudha Shqiptare sha, të marrë masa të arsyetojë në mënyrë të drejtë domosdoshmërinë e kryerjes së procedurës së prokurimit.

**2. Titulli i Gjetjes:** Hartimi i preventivave me çmime të pashoqëruara me analiza teknike të çmimeve.

<b>Situata:</b>	Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit publik në të gjitha rastet rezultoi se preventivat nuk shoqërohen me analizë teknike të çmimeve për ato raste kur këto çmime nuk janë pjesë e manualeve teknike të çmimeve, veprim jo në përputhje me VKM nr.514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat: 9, 10, 11 dhe me Udhëzimi i
-----------------	---





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

<b>Kriteri:</b>	Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe nr. 1, datë 16.6.2011. Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar; VKM nr.514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”;
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe nr. 1, datë 16.6.2011. Përlllogaritje jo e saktë dhe e paargumentuar e fondit limit
<b>Shkaku:</b>	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të prokurimit publik dhe të fushës së ndërtimit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	AK, Hekurudha Shqiptare sha, të marrë masa që të hartojë preventiva, ku çmimet e reja që nuk përfshihen në manualin teknik të çmimeve të bëhen me analizë, duke u bërë pjesë e dosjes së procedurës së prokurimit.

#### Në mënyrë analitike sipas procedurave sa më poshtë vijon:

#### 1- Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje pjesë këmbimi dhe agregatë për lokomotiva dhe vagona” në dy lote:

- “Pjesë këmbimi dhe agregate për lokomotiva”, me fond limit 8,371,580 lekë;
  - “Pjesë këmbimi dhe agregate për vagonë”, me fond limit 2,458,029 lekë,
- me këto të dhëna:

<b>Urdhër Prokurimi</b> Nr. 552, datë 02.05.2019	<b>NJHDT:</b> – E. L. Sh.V. A.G.	<b>KVO</b> , urdhër nr. 552/1, datë 02.05.2019 K.I. K.H. L.K.	
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “e hapur”			
<b>Fondi Limit</b> <b>Loti I</b> , 8,371,580 lekë; <b>Loti II</b> , 2,458,029 lekë	<b>OE fitues:</b> <b>Z. shpk</b>	<b>Diferenca me fondin limit</b> Loti I- 271,580 lekë Loti II- 108,029 lekë	
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> <b>Loti I, 8,100,000</b> Loti II, 2,350,000	<b>Operatorët Ekonomike</b> <b>Loti I dhe Loti II veç e veç</b> - Pjesëmarrës në tender <b>1</b> - S’kualifikuar 0	
<b>Data e hapjes së tenderit</b> nga 14/06/2019	ndryshuar në 20/06/2019		
<b>Ankimime: S`ka</b>	<b>Ka asistence nga APP për DST</b>	<b>Përgjigje Ankesës: s`ka</b>	
<b>Lidhja e Kontratës</b> <b>Loti I:</b> nr.552/2, datë 22.08.19 <b>Loti II:</b> nr. 552/3, datë 22.08.19	<b>Vlera e kontratës</b> 9,720,000 lekë me tvsh 2,820,000 lekë me tvsh	Afati 60 ditë Loti I dhe loti II	<b>Likuiduar:</b> Komplet
<b>Titullari i AK A.D</b>			



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

**Fondi limit:** Me shkresën nr. 63/2, datë 19.04.2019, të firmosur nga N. K, drejtues i NJSHML, i është drejtuar HSH sha ku ka dërguar preventivin, fondin limit, specififikimet Teknik, grafikun e punimeve dhe argumentimin e zhvillimit të procedurës.

Dokumentacionin bashkëlidhur shkresës është i firmosur nga një komision i përbërë nga A.Sh, A. K., T.C. Ky komision ka hartuar listën e pjesëve të këmbimit dhe aggregate për lokomotiva (gjithsej 22 lloje), në shumën 8,371,580 lekë.

Në dokumentin e përllogaritjes së fondit limit ky komision ka përcaktuar se: “Nisur nga fakti se materialet (pjesët e këmbimit dhe aggregate për lokomotiva dhe vagonë) janë specifike për hekurudhën, si dhe nisur nga fakti se nuk ka çmime të INSTAT-it apo institucioneve të tjera jozyrtare të publikuara dhe as çmime tregu, për çmimet e pjesëve të këmbimit për lokomotiva, në zbatim të nenit 59, germa d, të i VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, është vepruar duke marrë për bazë çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga HSH sha”.

➤ Nuk ka të dhëna në këtë dokument mbi çmimet bazë të kontratave të mëparshme të vetë AK. Ky komision nuk liston asnjë çmim të kontratave të mëparshme për të lënë gjurmë auditimi, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 59 “Përllogaritja e vlerës limit të kontratës”, ku citohet se: “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës”.

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specififikimet teknike.

**Arsyetimi për nevojën e prokurimit për “Blerje pjesë këmbimi dhe agregatë për lokomotiva dhe vagona”:** rezulton se nuk ka asnjë arsyetim për këtë procedurë prokurimi.

Në urdhrin e prokurimit nuk janë përcaktuar emrat e anëtareve të NJHDT. Nga ana e titullarit të AK është nxjerrë një urdhër për NJHDT nr.45, datë 15.01.19, i cili do të funksionojë përgjatë gjithë vitit 2019, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit”.

**Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit për të dy lotet:**

Dokumentet e procedurës janë hartuar sipas procesverbalit datë 02.05.2019.

Me emailin datë 27.05.2019, APP me asistencën e saj ka rekomanduar modifikimin e DST në lidhje me:

- Hartimin e DST-ve për çdo lot më vete;
- Përcaktimin e pagesës me këste për shlyerjen e detyrimeve vendore;
- Për kërkimin e dokumenteve nga palë të treta në vend të vetdeklarimit.
- Gjithashtu APP rekomandon argumentimin e kriterëve.

Në këtë procesverbal NJHDT nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se çdo kriter i vecantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalet (dy) datë 20.06.2019 dhe është vlerësuar me procesverbalet (dy) datë 27.06.2019, sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
Loti I:	Z. shpk	J.....A	8,100,000	Kualifikuar
Loti II:	Z. shpk	J.....A	2.350.000	Kualifikuar



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

#### Nga auditimi i ofertës fituese, rezultoi se ky OE në zbatim të kërkesës:

”3. Shoqëria prodhuese duhet të ketë këto certifikata.

a. Certifikate ISO 9001:2015 e menaxhimit të cilësisë.

b. Certifikate 14001:2015 e menaxhimit të ambientit.

Rezulton se certifikatën ISO 14001:2015 të menaxhimit të ambientit nuk ka sjellë të shoqërisë prodhuese por ka paraqitur të vetën.

#### Lidhja e kontratës:

Loti I: nr.552/2, datë 22.08.19, me vlerë 9,720,000 lekë me tvsh, me afat 60 ditë.

Loti II, nr. 552/3, datë 22.08.2019, me vlerë 2,820,000 lekë me tvsh, me afat 60 ditë.

#### 2- Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i godinës të NJSHML”, me këto të dhëna:

<b>Urdhër Prokurimi</b> Nr. 439, datë 05.04.2019	<b>NJHDT:</b> E.L. L. D. A.G.	<b>KVO:</b> Urdhër Nr. 439/1, datë 05.05.2019 K. I. E.J. Sh. V.
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “kërkesë për propozim”		
<b>Fondi Limit</b> 6,652,974 lekë.	<b>OE fitues:</b> F. Shpk	<b>Diferenca me fondin limit</b> <b>2,064,848</b> lekë
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 4,588,126 lekë	<b>Operatorët Ekonomike</b> - Pjesëmarrës në tender <b>16</b> - S’kualifikuar 2
<b>Data e hapjes së tenderit</b> 03.05.2019		
<b>Ankimime: 1 për DST</b>	<b>S’ka monitorim nga APP për DST</b>	<b>Përgjigje Ankesës: 1</b>
<b>Lidhja e Kontratës</b> 583/2, datë 29.05.2019	<b>Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 5,505,721.2 lekë	Afati 120 ditë <b>Likuiduar:</b> Komplet
<b>Titullari i AK A. D.</b>		

**Fondi limit:** Komisioni për përlogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik është ngritur me urdhrin e brendshëm të firmosur nga N. K., drejtues i NJSHML, nr. 63/1, datë 22.02.2019, dhe është i përbërë nga A.Sh., A. K., dhe T.Ç.

Ky komision ka përcaktuar fondin limit (preventivin) në shumën 6,652,974 lekë, por nuk ka procesverbal si dhe datë kur e ka hartuar. Në fund të preventivit citohet se ka zbatuar çmimet në bazë të VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”.

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specifikimet teknike dhe projektet. Nga auditimi rezulton se projektet nuk shqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat përgjegjës për realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Grupi i projektimit duhet jetë i përberë minimumi nga: inxhinieri gjeodet për plan rievimin dhe azhurnimin topografik, projektuesi arkitekt, projektuesi konstruktor, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi i instalimeve hidro sanitare, projektuesi i instalimeve ngrohje ftohje ventilim, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri, inxhinieri sizmolog, inxhinieri gjeolog, eksperti mjedisor, veprim jo në përputhje me VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, e cila ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, neni 16.

**Arsyetimi për nevojën e prokurimit për “Rikonstruksion i reparteve dhe linjave të NJSHML”:** Nga ana e komisionit sipas një dokumenti **pa numër dhe datë**, jepet arsyetimi i gjendjes së amortizuar si dhe mungesa e investimeve që në vitin 1990.

**Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:** Dokumentet e procedurës janë hartuar sipas procesverbalit datë 05.04.2019. Në këtë procesverbal NJHDT nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se **çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjrisht**, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.

**Sipas kërkesës për sqarim** nga “Kevin Konstruksion” sha NJHDT ka bërë një sqarim ne lidhje me stafin Teknik ku sqarohet se ky staf do të jetë në listë pagesa për një vit.


#### **Ankimim për DT:**

Në AK ka paraqitur ankimim e protokolluar në AK me nr.519, datë 19.04.2019, “K. K.,” shpk i cili ankimohet për sa vijon:

- Mos përcaktimin e saktë se për sa kohë duhet të paraqitet stafi Teknik në listë pagesa; Në dosje ndodhet vetëm një shkresë me nr.519/1, datë 23.04.2019 drejtuar ankimesit “K. C.,” shpk, ku jepet sqarimi se: “duhet të paraqiten listë pagesat sipas formularëve standard për sigurimet për një vit”, fakt i cili ka ndjekur procedurën ligjore sipas LPP.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 03.05.2019, vlerësimi me procesverbalet datë 03.05.2019 dhe 22.05.2022, sa vijon:

Nr.	OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	M. shpk	J.....V	4.976.942	Kualifikuar
2	2. shpk	L.....L	5.373.322	Kualifikuar
3	A. shpk	J.....O	4.644.883	Kualifikuar
4	B. shpk	J.....V	5.217.478	Kualifikuar
5	D. shpk	K.....B	6.509.309	Kualifikuar
6	E. shpk	K.....W	0	S`kualifikuar: Subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument
7	E.2000 shpk	K.....O	4.929.213	Kualifikuar
8	F. shpk	J.....M	4.588.126	<b>Kualifikuar dhe shpallur fituese sipas OV datë</b>
9	K.M.K shpk	L.....E	5.920.626	Kualifikuar
10	K. C.shpk	K.....Ë	4.257.907	<b>S`kualifikuar</b> si ofertë anomalisht e ulet, pasi: Argumentimi nuk është shoqëruar me analize çmimi dhe për pasojë nuk merret parasysh. Për piken 2 sqarohet se ne manual kostoja e transportit është llogaritur me Ton/Km dhe makineritë me ore/pune për çdo proces. Pika 3 te argumentimit te elementeve te ofertës tuaj nga ana juaj, ky argument nuk merret parasysh pasi nuk është shoqëruar me analizën shpjeguese teknike ekonomike ne baze te VKM 629.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA**

				Pika 4 ne manualin nr.2 për Ndërtimet shpenzimet plotësuese përfaqësojnë 8 % te çmimit te procesit te punës dhe jo 10%. Argumentimi i elementeve te ofertës tuaj nuk merret parasysh pasi elementet e kosos nuk mund te merren te ndara nga njëra-tjetra dhe shpjegimi juaj nuk është i shoqëruar me analizën tekniko – ekonomike për çdo proces pune”.
11	K. G.	L.....G	4.750.841	Kualifikuar
12	M. shpk	J.....W	4.635.989	Kualifikuar
13	N.shpk	J.....U	4.332.310	Ne lidhje me ofertën tuaj mbështetur ne VKM 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”, mbi analizën e kosos se punimeve, sipas analizës teknike qe ju keni paraqitur te zëri 2.196 janë ulur orët e punës (punëtorja), ky modifikim është bere pothuajse ne te gjithë zërat. Shpjegimet tuaja se kosto e punëtorisë është ulur bie ndesh me VKM-ne pasi normat e kohës se punës janë fikse dhe çmimi për çdo proces pune për ore pune është e përcaktuar sipas VKM-se 629 datë 15.07.2015. Ne zërin shtrese betoni c 16/20 është hequr vlere e makinerive, nuk është argument qe ju kemi makineritë e shoqërisë dhe nuk akne kosto, pasi ato kane kosto si për lëvizje dhe për mirëmbajtje. Argumentimi i analizës tekniko-ekonomike nuk merret parasysh për çdo proces pune ne kundërshtim me VKM 629 dt.15/07/2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.
14	P. G.	L.....L	5.956.992	Kualifikuar
15	Sh. kt.shpk	L.....F	5.595.740	Kualifikuar
16	Sh.	K.....N	5.251.467	Kualifikuar

**Vlerësimi i ofertave:** Nga auditimi rezultoi se vlerësimi i KVO si për ofertat anomalisht të ulta dhe për vlerësim është sipas akteve ligjore e nënligjore të LPP. Në këtë procedurë ka fituar vlere më e ulët e vlefshme.

**Lidhja e kontratës: Mungon në dosje kontrata e punimeve me subjektin “F” shpk.**

Është kontrata shtesë me numër 583/7, datë 23.09.2019 e cila shtyn afatin deri më datë 26.10.2019.

Kontratat e mbikëqyrjes me nr.583/3, datë 05.06.2019 dhe e kolaudimit të punimeve me nr. 563/4, datë 05.06.2019, për ndjekje është dërguar nga HSH sha në NJSHML me shkresën nr. 583/2, datë 29.05.2019.

### 3- Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje traversa druri” me këto të dhëna:

<b>Urdhër Prokurimi</b> Nr. 390, datë 28.03.2019	<b>NJHDT:</b> 45 datë 15.01.2019	<b>KVO:</b> 390/1, datë 28. 03.2019
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “e hapur”	E.L. L.D. A.G.	K I Sh. V. L. K.
<b>Fondi Limit</b> 25,000,000 lekë.	<b>OE fitues:</b> Z. shpk	<b>Diferenca me fondin limit</b> 700,000 lekë
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 24,300,000 lekë	<b>Operatorët Ekonomike</b>
<b>Data e hapjes së tenderit</b> nga 30/04/2019 behet 07/05/2019		- Pjesëmarrës në tender 5 - S’kualifikuar 3



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Ankimime: S`ka	Monitorim nga APP për DST	Përgjigje Ankesës: s`ka	
Lidhja e Kontratës 330/2, datë 24.06.2019	Vlera e kontratës (me TVSH) 29,160,000 lekë	Afati 09.12.2019	Likuiduar: Komplet
Titullari i AK Ani Dymishi			

**Fondi limit:** Komisioni për përlllogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik është ngritur me urdhrin e brendshëm nr. 282/2, datë 01.03.2019, dhe është i përbërë nga M.K., M.B., dhe Xh.B., Ky komision sipas procesverbalit **pa datë** ka përcaktuar çmimin për:

- 1 m<sup>3</sup> traversa druri normale 60,500 lekë / m<sup>3</sup>;
- 1 m<sup>3</sup> traversa druri speciale 71,000 lekë/m<sup>3</sup>.

Fondi limit 25,000,00 lekë, duke u mbështetur në eksperiencat e mëparshme të AK, **por pa vënë këto eksperiencat në këtë procesverbal.**

➤ Nuk ka të dhëna në këtë dokument mbi çmimet bazë të kontratave të mëparshme të vetë AK. Ky komision nuk liston asnjë çmim të kontratave të mëparshme për të lënë gjurmë auditimi, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, ku citohet se: “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës”.

Ky komision nëpërmjet këtij procesverbali i kërkon njësisë së prokurimit dhe strukturat juridike pranë saj të bëjnë verifikimin ligjor të procedurës së ndjekur për hartimin e fondit limit dhe nëse **del ndonjë problem të referohet për ndryshimet e nevojshme**, veprim jo në përputhje me nenin 57 “Njësia e prokurimit” të VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, pika 2. ku thuhet se: “2. Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:

- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;
- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);
- përlllogaritjen e fondit limit, **nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukturë të posaçme**; - hartimin e urdhrin të prokurimit;
- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, **nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukturë të posaçme**”;

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specifikimet teknike, në të cilat rezulton se:

➤ Nuk ka përcaktuar llojin e standardit të KE në fuqi, e konkretisht në rastet sa më poshtë ka përcaktuar:

- “Procesi i mbrojtjes së traversave të drurit nga kalbja dhe dëmtimi i tyre (imprenjimi), duhet të realizohet me vaj ekologjik creosot në përputhje me Standardin e Komunitetit Evropian në fuqi ose në përputhje me Standardin e vendit ku prodhohen traversat, i cili duhet t’i përgjigjet Standardit të Komunitetit Evropian”.
- “Dimensionet e traversave të drurit normale dhe speciale të imprenjuara duhet të jenë në përputhje me Standardet Evropiane”.
- Në specifikimet teknike është kërkuar certifikatë cilësie e prodhuesit, pa përcaktuar numrin e saj, certifikatë garancie të prodhuesit pa përcaktuar afatin e garancisë së traversave, e konkretisht është kërkuar sa vijon: “Malli do të shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm teknik.

Dokumentacioni shoqërues i traversave do të jetë si më poshtë:





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

- 1.Çertifikate cilësie nga prodhuesi e shoqëruar me analizën kimike te procesit te imprenjimit.
- 2.Çertifikate garancie nga prodhuesi.
- 3.Dokumentacioni i zhdoganimit.
- 4.Faturat shoqëruese te mallit (CMR) për çdo mjet qe kryen transportin”.

➤ Mos përcaktimi i standardit dhe llojit të certifikatës së cilësisë që kërkohet, është jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, neni 27, Kontratat e mallrave, pika 1, ku është përcaktuar se: “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”.

#### **Arsyetimi për nevojën e prokurimit për blerje traversa druri hekurudhore**


Nga ana e komisionit është bërë arsyetimi sipas një dokumenti **pa numër dhe datë**, ku jepet arsyetimi i gjendjes se rënduar hekurudhore, por në lidhje me rezultatet e kontrollit teknik periodik të kryer në linjën hekurudhore **nuk jepet asnjë e dhënë mbi rezultatet se sa janë kërkuar dhe për kë linja janë kërkuar këto traversa. Sa më sipër është jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit”, pika 1, ku është përcaktuar se: “Me miratimin e ligjit për buxhetin dhe pas përlogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, kur ka nevojë për punë/mallra/ shërbime, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit”.**

**Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:** Dokumentet e procedurës janë hartuar sipas procesverbalit datë 28.03.2019. Në këtë procesverbal NJHDT nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se **çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht**, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.

Nga ana asistencës së APP me email datë 09.04.2019, është kërkuar janë konstatuar disa mangësi dhe NJHDT ka hartuar dhe publikuar shtojcën e DT në SPE, duke reflektuar asistencën e APP.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 07.05.2019 dhe më datë 21.05.2019 është kryer vlerësimi i ofertave, sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	Sh. shpk	K.....W	23.212.000	<b>S'kualifikohet</b> pasi: Për vlefshmërinë e akt marrëveshjes duke i kërkuar firmës prodhuese ne rrugën elektronike, konfirmimin e kësaj akt marrëveshje dhe te na vinte ne dispozicion një kopje te saj. Nga ana e subjektit prodhues MVK PROMED nuk na u kthye asnjë përgjigje brenda afateve ligjore. Certifikatat ISO te paraqitura nga prodhuesi nuk janë origjinale ose te njehsuara me origjinalin. fusha e veprimtarisë se MVK PROMED nuk është e specializuar për këtë veprimtari (prodhim traversash normale/speciale), por certifikata dhe licencat janë kryesisht për “Ekzekutimi dhe projektimi i punimeve elektrike dhe te Ndërtimit”.
2	A L.	J.....N	24.752.000	<b>Kualifikuar</b>
3	E .S. shrfs	K.....K	0	<b>S'kualifikohet</b> për mos paraqitjen e asnjë dokumentacioni ne lidhje me ofertën
4	V. I.	L.....L	0	<b>S'kualifikohet</b> për mos paraqitjen e asnjë dokumentacioni ne lidhje me

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA**

Nr.	OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
				ofertën
5	Z. shpk	J.....A	24.300.000	Kualifikuar dhe shpallur fitues

**Lidhja e kontratës:** Kontrata me numër 330/2, datë 24.06.2019, me objekt “Blerje traversa druri normale dhe speciale të reja”, me “Z.” shpk, me vlerë 29,160,000 lekë me afat 120 ditë, bashkëlidhur formulari i sigurimit të kontratës.

Për këtë kontratë nga ana e Titullarit të AK (Administratori i Shoqërisë) me shkresën e objekt “Dërgim amendamenti kontratë për ndjekje” nr.390/7, datë 21.10.2019, i është dërguar sektorit të investimeve amandamet kontrata për shtyrje afati deri më **09.12.2019**.

**Likuidimi:** Për marrjen në dorëzim është ngritur komisioni I marrjes në dorëzim dhe pranimin e traversave ka dalë urdhri I Drejtuesit të Njësisë së biznesit të menaxhimit të infrastrukturës hekurudhore D.M., nr. 752/1, datë 01.07.2019, me përbërje: L.S., Gj. B., C. M., dhe B.M (magaziniere).

**4- Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i reparteve dhe linjave të NJSHML”, me këto të dhëna:**

<b>Urdhër Prokurimi</b> Nr. 583, datë 14.05.2019	<b>NJHDT:</b> E.L. Sh.V. A.G.	<b>KVO:</b> 583/1, datë 14.05.2019 K.I. E.J. B.D.
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “kërkesë për propozim”		
<b>Fondi Limit</b> 7,498,199 lekë.	<b>OE fitues:</b> E.B&B & A.Shpk	<b>Diferenca me fondin limit</b> 2,663,529 lekë
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 4,834,670 lekë	<b>OE:</b> - Pjesëmarrës në tender <b>9</b> - S’kualifikuar 3
<b>Data e hapjes së tenderit</b> 09/06/2019		
<b>Ankimime: S`ka</b>	<b>Ka monitorim nga APP</b>	<b>Përgjigje Ankesës: s`ka ankesa</b>
<b>Lidhja e Kontratës</b> 583/7, datë 08.07.2019	<b>Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 5,801,604 lekë	Afati 60 ditë <b>Likuiduar:</b> Komplet
<b>Titullari i AK A.D.</b>		

**Fondi limit:** Komisioni për përlogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik është ngritur me urdhrin e brendshëm të firmosur nga N.K., drejtues i NJSHML, nr. 63/1, datë 22.02.2019, dhe është i përbërë nga A.Sh., A.K., dhe T. Ç., komision i cili është shtuar me urdhrin e brendshëm nr.28, datë 02.04.2019 me B.K., dhe N.K.

Ky komision ka përcaktuar fondin limit (preventivin) në shumën 7,498,199 lekë pa tvsh. Në fund të preventivit citohet se ka zbatuar çmimet në bazë të VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”.

Nga auditimi i preventivit rezultoi se nga ana e komisionit është zbatuar ky manual.

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specifikimet teknike dhe projektet. Nga auditimi rezulton se projektet nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat përgjegjës për realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Grupi i projektimit duhet jetë i përberë minimumi nga: inxhinieri gjeodet për plan rlevimin dhe





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

azhurnimin topografik, projektuesi arkitekt, projektuesi konstruktor, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi i instalimeve hidro sanitare, projektuesi i instalimeve ngrohje ftohje ventilim, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri, inxhinieri sizmolog, inxhinieri gjeolog, eksperti mjedisor, **veprim jo në përputhje** me VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, e cila ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, neni 16/1 “Licenca – kategoritë e punimeve”.

**Arsyetimi për nevojën e prokurimit për “Rikonstruksion i reparteve dhe linjave të NJSHML”:** Nga ana e komisionit sipas një dokumenti **pa numër dhe datë**, jepet arsyetimi i gjendjes së amortizuar të repartit elektrik dhe të riparimit të lokomotivave si dhe mungesa e investimeve që në vitin 1990.

**Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:** Dokumentet e procedurës janë hartuar sipas procesverbalit datë 14.05.2019. Në këtë procesverbal NJHDT nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se **çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjrisht**, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.

Nga ana e APP me emalin datë 21.05.2019, e cila ka konstatuar problematika në DST, në lidhje me: 1 inxhinier hidroteknik, 1 inxhinier mjedisi, 1 manovrator me IQT, 1 murator me IQT, 1 hidraulik me IQT dhe 1 elektrikist me IQT.

Sa më sipër është bërë shtojcë në DT dhe janë reflektuar.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 09.06.2019 dhe më datë 14.06.2019 është kryer vlerësimi i ofertave, sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	2.Shpk	5,049,322	<b>Kualifikuar</b>
2	2.shpk K.Shpk	6,233,305	<b>S`kualifikuar pasi:</b> Ne lidhje me (1 fadrome) Subjekti nuk ka paraqitur fature blerje apo kontrate qiraje si dhe dokumentacionin shoqëruar. Ne lidhje me (2 pompe betoni) subjekti nuk ka paraqitur asnjë fature blerje apo kontrate qiraje për të vërtetuar disponibilitetin e këtij mjeti. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm (dëshmi IQT për murator, hidraulik, elektrikist)
3	C.Shpk	5,544,387	<b>S`kualifikuar pasi:</b> Për mos paraqitjen e asnjë fature blerje apo kontrate qiraje për të vërtetuar disponibilitetin e mjetit (pompe betoni).
4	E.B&B & A. Shpk	4,834,670	<b>Kualifikuar dhe shpallur fitues</b>
5	F.Shpk	5,112,363	<b>Kualifikuar</b>
	K.C. Shpk	4,815,879	<b>S`kualifikuar pasi:</b> Ne lidhje me (1 ekskavator me goma) Subjekti ka paraqitur një kontrate qiraje e cila përcakton: Shoqëria “V I.” sh.p.k deklaron se ka ne pronësinë e saj mjetet “ekskavator me goma”, pronësinë mbi të cilat e vërteton ne baze të Certifikatës se



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

			Pronësisë, lejes se qarkullimit, dokumentacionit shoqëruar të mjeteve, faturave tatimore të shitjes dhe deklaratave doganore. Në këtë kontratë nuk identifikohet për cilin mjet bëhet fjale sepse nuk ka asnjë të dhënë identifikuese. Është paraqitur vetëm një deklaratë doganore ku vërtetohet se janë ç doganuar 2 mjete për llogari të V. I. sh.p.k Në lidhje me 2 pompe betoni në Pronësi ose me qira), nga verifikimi i gjithë dokumentacionit të skanuar, rezultoi se subjekti nuk ka paraqitur asnjë faturë blerje apo kontratë qiraje për të vërtetuar disponibilitetin e kësaj mjeti.
6	Ll.Shpk	6,370,000	<b>Kualifikuar</b>
7	M. Shpk	5,598,752	<b>Kualifikuar</b>
8	Sh.	6,860,326	<b>Kualifikuar</b>
9	Sh.	5,575,787	<b>Kualifikuar</b>

**Vlerësimi i ofertave:** Nga auditimi rezultoi se KVO ka vepruar sipas kërkesave të DST. Në këtë procedurë ka fituar oferta më e ulët e vlefshme.

**Lidhja e kontratës:** Kontrata me numër 583/7, datë 08.07.2019, me objekt “Rikonstruksion i repartëve dhe linjave hekurudhore të NJSHML”, me “E.B&B” shpk & “A.” Shpk, me vlerë 5,801,604 lekë me afat 60 ditë, bashkëlidhur formulari i sigurimit të kontratës.

**5- Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i linjës Kavajë - Rrogozhinë”, (km 32+400 - 34+000) me këto të dhëna:**

<b>Urdhër Prokurimi</b> 581, datë 14.05.2019	<b>NJHDT:</b>	<b>KVO</b> 581/1, datë 14.05.2019
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “kërkesë për propozim”	E.L. Sh.V. A.G.	K.Sh. E.J. B.D.
<b>Fondi Limit</b> 10,000,000 lekë.	<b>OE fitues:</b> “C” Shpk	<b>Diferenca fl</b> 1,663,190 lekë
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 8.336.810 lekë	<b>Operatorët Ekonomike</b> - Pjesëmarrës në tender 4 - S’kualifikuar 2
<b>Data e hapjes së tenderit</b> 27.06.2019		
<b>Ankimime: S`ka</b>	<b>Ka monitorim nga APP për DST</b>	<b>Përgjigje Ankesës: s`ka</b>
<b>Lidhja e Kontratës</b> 581/2, datë 29.07.2019	<b>Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 10,004,172 lekë	Afati 3 muaj <b>Likuiduar:</b> Komplet
<b>Titullari i AK A.D.</b>		

Dokumentacioni është dërguar në HSH sha nga Njësia e Biznesit Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore me shkresën nr. 568, datë 09.05.2019, firmosur nga Drejtuesi i njësisë D.M. Preventivi, llogaritja e fondit limit, specifikimet teknike, arsyetimi për nevojën e prokurimit, grafiku dhe projektet janë hartuar nga M.K., M.B., dhe Xh.B., Ky komision ka përcaktuar fondin limit (preventivin) në shumën **10,288,528** lekë pa tvsh. Komisioni në përlllogaritjen e fondit limit citon se ka zbatuar çmimet në bazë të VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, manualit shtetëror nr.3, për punimet e Ndërtimit të rrugëve **i vitit 1992 për pjesën e punimeve të hekurudhës** si dhe librit të normave hekurudhore.

Po në përlllogaritjen e fondit limit ky komision përcakton se “Vlera e mbikëqyrjes dhe kolaudimit do të mbulohen nga ulja në procedurën e prokurimit”.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

➤ Sa përcaktuar në lidhje me vlerën e mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të punimeve të cilat sipas grupit të punës së hartimit të fondit limit “do të mbulohen nga ulja në procedurën e prokurimit”, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, ndryshuar, neni 1, “Përgjegjësia e autoritetit/entit kontraktor:, ku është përcaktuar se: “Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimet me fonde publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, (më poshtë “LPP”), të këtyre rregullave dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik (më poshtë “APP”), të dala në bazë dhe për zbatim të LPP”.

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specifikimet teknike dhe projektet. Në specifikimet teknike është përcaktuar se: “Përcaktimi i traversave të kalbura të cilat nuk mund të montohen me në linjë pas rikonstruksionit në km 32+400 – 34+000 do të bëhet në prezencë të teknikut të linjës hekurudhore, mbikëqyrësit të punimeve dhe sipërmarrësit dhe pas këtij përcaktimi do të realizohet zëvendësimi me traversa druri të reja”, ndërkohë që në preventivin e punimeve është përcaktuar sasia sa vijon:

6	An	Furnizim me traversa druri për linjen hekurudhore	m3	97,434
---	----	---	----	--------

Në lidhje me traversat në specifikimet teknike janë përcaktuar se:

Traversat e drurit do të plotësojnë specifikimet teknike si më poshtë:

**Për traversat e drurit normale dimensionet janë si më poshtë:**

Gjatësia 2600 mm, me tolerance plus minus 30 mm; Gjerësia 260 mm, me tolerance plus minus 20 mm ; Lartësia 160 mm, me toleranca plus minus 10 mm.

Forma e seksionit tërthor të traversave si normale dhe speciale duhet të jetë katërkëndësh kënddrejtë. Në të dy faqet e seksioneve tërthore të traversave duhet të jenë të vendosura pllaka metalike standarde për mbrojtjen e traversave nga çarja. Forma e seksionit tërthor të traversave si normale dhe speciale duhet të jetë katërkëndësh kënddrejtë. Në të dy faqet e seksioneve tërthore të traversave duhet të jenë të vendosura pllaka metalike standarde për mbrojtjen e traversave nga çarja. Nuk lejohen çarje të traversës në zonën e mbështetjes të pllakës metalike ku montohet shina hekurudhore. Nuk lejohen plasaritje të traversës. Nuk lejohen nyje të shëndosha dhe jo të shëndosha në vendin e shtruarjes së shinës. Për gjatësitë, thellësitë e çarjeve të respektohen normat e standardit shqiptar dhe Evropian. Përcaktimi i traversave të kalbura që do të zëvendësohen do të përcaktohet në prezencë të supervisorit dhe teknikut të linjës hekurudhore.

➤ Nga ku rezulton se për to nuk është zbatuar i njëjti standard si në procedurën « Blerje traversa », etj. procedura, duke punuar me standarde të ndryshme për të njëjtin objekt në procedura të ndryshme.

**Arsyetimi për nevojën e prokurimit për “Rikonstruksion i linjës Kavajë - Rrogozhinë”:**

Nga ana e komisionit është bërë arsyetimi sipas një dokumenti **pa numër dhe datë**, ku jepet arsyetimi i se linja hekurudhore nuk është në parametrat teknik të kërkuar për shpejtësi lëvizje deri në 40 km sipas gjithë perigonit.

➤ Në urdhrin e prokurimit nr. 581, datë 14.05.2019, **fondi limit është 10,000,000 lekë nga 10,288,528 lekë të përcaktuar nga preventivuesit** dhe nuk ka asnjë argumentim se ku është ulur kjo vlerë, çka tregon mos argumentim të fondit limit në urdhrin e prokurimit.

**Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:** Dokumentet e procedurës janë hartuar sipas procesverbalit datë 14.05.2019. Në këtë procesverbal NJHDT nuk ka zbatuar përcaktimet e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

nenit 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se *çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht*, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.

Nga ana e APP me emalin datë 21.05.2019, e cila ka konstatuar problematika në DST, në lidhje me pikën 2.2/c “Kapaciteti teknik” të cilat NJHDT i ka reflektuar në shtojcën e hartuar për këtë qëllim.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 27.06.2019 dhe më datë 05.07.2019 është kryer vlerësimi i ofertave, sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	Sh. shpk	8.511.592	<b>S`kualifikuar pasi:</b> Akt-marrëveshja midis ofertuesit dhe prodhuesit për lëvrimin e mallit objekt i kësaj kontrate nëpërmjet së cilës garantohej prodhimi dhe furnizim në sasi dhe në kohë, nuk është e vlefshme pasi subjekti prodhues nuk ka ne veprimtarinë e vet prodhimin e traversave. Gjithashtu ISO e paraqitura për prodhuesin MVK-PROMED nuk janë te vlefshme sepse nuk është e specializuar për këtë veprimtari (prodhim traversash normale/speciale), por certifikata dhe licencat janë kryesisht për “Ekzekutimi dhe projektimi i punimeve elektrike dhe të ndërtimit. Dhënie me qira e makinerive dhe mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit.”
2	B. shpk	9.805.660	Kualifikuar
3	C.shpk	8.336.810	Kualifikuar dhe shpallur fitues
4	N.shpk	9.114.094	<b>S`kualifikuar pasi:</b> Nuk është paraqitur asnjë dokument për Akt marrëveshja duhet te shoqërohet me vërtetimin e regjistrimit te shoqërisë e cila furnizon operatorin ofertues me mallrat objekt kontrate, ne Regjistrin Tregtar te vendit ku kryen veprimtarinë e saj për plotësimin e këtij kriteri. Lidhur me pikën 2 Kapaciteti teknik dhe profesionale ku kërkohet Mungon Licenca e shoqërisë e vlefshme për kategorinë NS 11-A Punime mbi shina e traversa.

**Vlerësimi i ofertave:** Në këtë procedurë është shpallur fituese vlera më e ulët e vlefshme e ofruar.

**Lidhja e kontratës:** Kontrata me numër 581/2, datë 29.07.2019, me objekt “**Rikonstruksion i linjës Kavajë - Rrogozhinë**”, me “C.” Shpk, me vlerë 10,004,172 lekë me afat 3 muaj, bashkëlidhur formulari i sigurimit të kontratës.

**6- Procedura e prokurimit me objekt: “Rinovim agregate per lokomotiva me këto të dhëna:**

<b>Urdhër Prokurimi</b> Nr. 501, datë 16.04.2019	<b>NJHDT:</b> E.L. Sh.V. A.G.	<b>KVO</b> , nr. 501/1, datë 16.04.2019 K.I. K.H. L.K.
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “kërkesë e hapur”		
<b>Fondi Limit</b> 10.820.000 lekë.	<b>OE fitues:</b> Z.shpk	<b>Diferenca me fondin limit</b> 1,480,000 lekë
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 9.340.000 lekë (pa tvsh)	<b>Operatorët Ekonomike</b> - Pjesëmarrës në tender <b>1</b>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

<b>Data e hapjes së tenderit 27/05/2019</b>		- S'kualifikuar 0	
<b>Ankimime: S`ka</b>	<b>Ka sqarim për DST</b>	<b>Përgjigje Ankesës: s`ka</b>	
<b>Lidhja e Kontratës</b> 501/2, datë 24.06.2019	<b>Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 11,208,000 lekë	Afati 60 ditë	<b>Likuiduar:</b> Komplet
<b>Titullari i AK A.D.</b>			

**Fondi limit:** Komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik është ngritur me urdhrin e brendshëm të firmosur nga N.K., drejtues i NJSHML, nr. 63/1, datë 22.02.2019, dhe është i përbërë nga A.Sh., A.K., dhe T.Ç.

Ky komision ka përcaktuar fondin limit (preventivin) në shumën 10,820,000 lekë pa tvsh. Nuk ka të dhëna në këtë dokument mbi çmimet bazë të kontratave të mëparshme të vetë AK. Ky komision nuk liston asnjë çmim të kontratave të mëparshme për të lënë gjurmë auditimi, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 59 “Përllogaritja e vlerës limit të kontratës”, ku citohet se: “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës”. Ky komision ka hartuar specifikimet teknike.

**Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:** Dokumentet e procedurës janë hartuar sipas procesverbalit datë 16.04.2019.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 27.05.2019 dhe më datë 03.06.2019 është kryer vlerësimi i ofertave, sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1.	Z. shpk	9.340.000	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Në këtë procedurë është shpallur fituese vlera më e ulët e vlefshme e ofruar.

**Lidhja e kontratës:** Kontrata me numër 501/2, datë 24.06.2019, me objekt “Rinovim agregatë për lokomotiva 2019”, me “Z.” Shpk, me vlerë 11,208,000 lekë me afat 60 ditë, bashkëlidhur formulari i sigurimit të kontratës.

**7- Procedura e prokurimit me objekt: “Punime për mbrojtjen e linjës”, me këto të dhëna:**

<b>Urdhër Prokurimi</b> Nr. 984, datë 10.09.2019	<b>NJHDT:</b> – NUK KA urdhër E.L. Sh.V. A.G.	<b>KVO:</b> Nr. 984/1, datë 10.09.2019 K.I. E.J. N.K.	
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur”			
<b>Fondi Limit</b> 21.250.000 lekë.	<b>OE fitues:</b> E. B&B & V.E shpk	<b>Diferenca me fondin limit</b> 3,468,319 lekë	
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 17,781,681 lekë	<b>Operatorët Ekonomike</b> - Pjesëmarrës në tender 2 - S'kualifikuar 2	
<b>Data e hapjes së tenderit</b> nga 14/10/2019 ora 10.00, behet 21/10/2019			
<b>Ankimime: S`ka</b>	<b>Ka monitorim nga APP për DST</b>	<b>Përgjigje Ankesës: s`ka</b>	
<b>Lidhja e Kontratës</b> 984/2, datë 18.11.2019	<b>Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 21,338,017 lekë	Afati 3 muaj	<b>Likuiduar:</b> Komplet
<b>Titullari i AK A.D.</b>			



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

**Fondi limit:** Me shkresën nr. 651, datë 03.06.2019, të firmosur nga D.M., drejtues i NJBMIH, i është drejtuar HSH sha ku ka dërguar preventivin, fondin limit, specifikimet Teknik, arsyetimin, grafikun e punimeve dhe skicat.

Grupi i punës i përbërë nga M.K., M.B., Xh.B., ka përcaktuar fondin limit (preventivin) në shumën 21,627,657 lekë pa tvsh, bazuar në çmimet e VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” dhe manualin shtetëror nr.3, për punimet e ndërtimit të rrugëve i vitit 1992, për pjesën e punimeve të hekurudhës si dhe librit të normave hekurudhore.

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specifikimet teknike dhe projektet. Në asnjë rast nuk ka të dhëna mbi traversat që do të përdoren si dhe vizatime për to. Konkretisht për objektet:

#### 1- Punime për mbrojtjen e linjës Zhame km 40+050 perigoni Rrogozhine-Lushnje;

Gjate zmontimit të linjës hekurudhore do të dalin traversa të kalbura që nuk mund të montohen më në linjë dhe do të bëhet furnizimi me traversa druri të reja normale.

12	NH	Furnizim traversa druri normale	m3	16,224
----	----	---------------------------------	----	--------

#### 2- Ndërtim mure pritës në km 67+050 perigoni Lushnje-Fier (Gogolas);

Do të zëvendësohen traversat e kalbura në këtë pjesë të linjës ku do të realizohen punimet.

9	NH	Furnizim traversa druri normale	m3	21,632
---	----	---------------------------------	----	--------

➤ Në asnjë rast në specifikimet teknike dhe në vizatime nuk janë dhënë përmasat dhe kriteret që duhet të zbatohen për traversat.

**Arsyetimi për nevojën e prokurimit për “Punime për mbrojtjen e linjës:** Nga ana e komisionit sipas një dokumenti pa numër dhe datë, jepet arsyetimi i rrëshqitjeve të trasesë, dëmtimi i veprave të artit nga rrëshqitjet si dhe dëmtimi i mureve mbajtës dhe pritës ekzistues nga rrëshqitja e dherave, bllokimi i kanaleve kulluese, etj., si dhe përmbytjet, por nuk i jep të specifikuar sipas linjave.

**Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:** Dokumentet e procedurës janë hartuar sipas procesverbalit datë 10.09.2019. Në këtë procesverbal NJHDT nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se *çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht*, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.

Kjo edhe pas emalit të ardhur nga APP datë 28.09.2019, nisur edhe nga fakti që është rishpallje procedure prokurimi e për rrjedhojë AK duhet të plotësojë saktë seksionin përkatës të DST. Kjo asistencë e APP ka të bëjë me:

- Kërkesën për punësim me kohë të plotë të një punësimi mesatar të paktën 40 punonjës për periudhën janar -korrik 2019;
- Në lidhje me periudhën për të cilën kërkohen këta punëtorë të jenë me kohë të plotë;
- Në lidhje me kategoritë e licencave NS10A dhe NP5A;
- Në lidhje me akt ekspertizën e ekspertit kontabël të miratuar e cila duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimit të nenit 41, germa c, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar;





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

- Në lidhje me kriterin për certifikatën OHSAS 18001: 2007, për të cilën duhet të pranohet edhe ekuivalenti i njohur nga Standardet Shqiptare ISO 45001: 2018.
- Në lidhje me certifikatën ISO 9001:2015 të prodhuesit, pasi është dokument i palëve të treta, të shikohet mundësia e vet deklarimit;
- Në lidhje me kriterin për 3 manovratorë një auto makinist dhe 2 ekskavatorist, të cilët duhet të jenë në listë pagesa për 6 muajt e fundit, kjo nisur nga fakti se nëse mjetet merren me qira drejtuesit e tyre mund të jnë pjesë e qiramarrjes;
- Drejtuesi Teknik të jetë gjatë gjithë kohës në kantier, por vlera e punimeve është nën 30 milion lekë.

Nisur nga sa më sipër NJHDT ka hartuar shtojcën e DT duke reflektuar për asistencën e dhënë.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 21.10.2019 dhe më datë 01.11.2019 është kryer vlerësimi i ofertave, sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	B.shpk	18,998,744	<b>Kualifikuar</b>
2	K.shpk	16,564,932	<b>S`kualifikuar pasi:</b> Operatori K-V_nuk është i pajisur me licence NS- 11-A. NP-12-A Pune të inxhinierisë së mjedisit .Sipas listë pagesave të paraqitura operatori për këtë periudhë ka të regjistruar mesatarisht 26 punonjës nga 40 personave. Persa i përket traversave druri normale, Operatori nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kriterit Akt-marrëveshje mes ofertuesit dhe furnizuesit. <ul style="list-style-type: none"><li>- Certifikatë ISO 9001:2015 të prodhuesit e menaxhimit të cilësisë.</li><li>- Certifikatë ISO 14001:2015 të prodhuesit e menaxhimit të cilësisë.</li><li>- Akt marrëveshja duhet të shoqërohet me vërtetimin e regjistrimit të shoqërisë e cila furnizon operatorin ofertues me mallrat objekt kontrate, në Regjistrin Tregtar të vendit ku kryen veprimtarinë e saj.</li></ul> Operatori nuk ka paraqitur dokument licence të vlefshme - Kodi III.2.B të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, për grumbullim dhe transportim të mbetjeve të ndryshme urbane (mbetjet që dalin nga punimet). Autovinç dokumentacioni i paraqitur nga operatori ka skaduar siguracioni 28.06.2018 dhe kontrolli teknik me date 07.07.2018.
3	E.B& V. E.	17,781,681	<b>Kualifikuar dhe shpallur fituese</b>
4	V.shpk	20,606,324	<b>S`kualifikuar pasi:</b> Auto betoniere vetëngarkuese mbi (3) tre m3 (Është paraqitur kontrate qiraje fotokopje (e pa noterizuar), nuk disponon Certifikatën e transportit për trete dhe me qira, por vetëm Certifikatë transporti për vete (për subjektin qiradhënës), siguracioni i mjetit i pavlefshëm (ka përfunduar afati me date 17.06.2019). Mjetet me targa; AA 267 TB, AA 873 PH, AA 872 PH,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

			<p>AA 243 VZ, AA 172 CJ, AA 112 CJ, AA 816 HO, (kontrate qiraje) nuk disponon Certifikatën e transportit për trete dhe me qira, por vetëm Certifikatë transporti për vete (për subjektin qiradhënës). Mjeti me targe AA 981 EZ ka siguracion te skaduar.</p> <p>Auto betonierë me targe AA794 Cp ka skaduar siguracioni me date 17.06.2019.</p> <p>Fadroma me goma dhe ekskavator me goma nuk është paraqitur leja e qarkullimit.</p> <p>Mjetet me targa; AA 675 PI, (kontrate qiraje) nuk disponon Certifikatën e transportit për trete dhe me qira, por vetëm Certifikatë transporti për vete (për subjektin qiradhënës).</p> <p>Persa i përket traversave druri normale, Certifikatë ISO 9001:2015 te prodhuesit e menaxhimit të cilësisë.</p> <p>Certifikatë ISO 14001:2015 te prodhuesit e menaxhimit të cilësisë.</p> <p>Certifikatat ISO nuk janë paraqitur te prodhuesit por te furnizuesit dhe kane si objekt (Ndërtimi i objekteve civile, industrialë dhe infrastrukturore (rruge ujësjellës, kanalizime etj.) Prodhimi dhe tregtimi i inerteve, betonit, asfaltit, konstruksione metalike. Nuk kane si objekt prodhimin dhe tregtimin e traversave hekurudhore.</p>
--	--	--	---

#### Vlerësimi i ofertave

##### Oferta fituese E.B.shpk & V.shpk:

Për plotësimin e kërkesës: “Persa i përket traversa druri hekurudhore normale

Certifikate ISO 9001: 2015 te prodhuesit e menaxhimit te cilësisë.

Certifikate ISO 14001: 2015 te prodhuesit e menaxhimit te ambientit.

Akt marrëveshje mes ofertuesit dhe furnizuesit e cila garanton lëvrimin e mallit objekt i kësaj kontrate ne sasi dhe kohe , sipas kushteve ne shtojcën 12, te DST.

Akt marrëveshja duhet te shoqërohet me vërtetimin e regjistrimit te shoqërisë e cila furnizon operatorin ofertues me mallrat objekt kontrate, ne Regjistrin Tregtar te vendit ku kryen veprimtarinë e saj”.

Rezulton se: OE V. ka paraqitur certifikata ISO të prodhuesit të palexueshme .

**Lidhja e kontratës:** Kontrata me numër 984/2, datë 18.11.2019, me objekt “Punime për mbrojtjen e linjës”, me E.B.shpk & V.E. shpk, me vlerë 21,338,017 lekë me afat 3 muaj, bashkëlidhur formulari i sigurimit të kontratës.

#### 8- Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i linjës Milot-Lezhë”, me këto të dhëna:

<b>Urdhër Prokurimi</b> 580, datë 14.05.2019	<b>NJHDT:</b>	<b>KVO:</b> 580/1, datë 14.05.2019
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “hapur”	E.L. Sh.V. A.G.	K.Sh. E.J. B.D.
<b>Fondi Limit</b> 12.500.000 lekë.	<b>OE fitues:</b> B.shpk	<b>Diferenca me fondin limit</b> 499,686 lekë





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 12.000.314 lekë	<b>Operatorët Ekonomike</b> - Pjesëmarrës në tender <b>3</b> - S'kualifikuar 1	
<b>Data e hapjes së tenderit</b> nga 02/07/2019, behet 08/07/2019			
<b>Ankimime: S`ka</b>	<b>Ka monitorim nga APP për DST</b>	<b>Përgjigje Ankesës: s`ka</b>	
<b>Lidhja e Kontratës</b> 580/2, datë 03.09.2019	<b>Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 14,400,314 lekë	Afati 3 muaj	<b>Likuiduar:</b> Komplet
<b>Titullari i AK A.D.</b>			

**Fondi limit:** Me shkresën nr. 548, datë 06.05.2019, të firmosur nga D.M., drejtues i NJBMIH, i është drejtuar HSH sha, ku ka dërguar preventivin, fondin limit, specifikimet Teknik, arsyetimin, grafikun e punimeve dhe skicat. Grupi i punës i përbërë nga M.K., M.B., Xh.B. ka përcaktuar fondin limit (preventivin) në shumën 12,502,118 lekë pa tvsh, bazuar në çmimet e VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, dhe manualin shtetëror nr.3, për punimet e ndërtimit të rrugëve i vitit 1992, për pjesën e punimeve të hekurudhës si dhe librit të normave hekurudhore.

Bashkëlidhur preventivit nuk janë çmimet me analizë, 4 raste nga 14 çmime gjithsej, veprim jo në përputhje me VKM nr.514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat 9, 10 dhe 11 dhe me Udhëzimet e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe nr. 1, datë 16.6.2011.

Po në përlllogaritjen e fondit limit ky komision përcakton se “Vlera e mbikëqyrjes dhe kolaudimit do të mbulohen nga ulja në procedurën e prokurimit”.

➤ Sa përcaktuar në lidhje me vlerën e mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të punimeve të cilat sipas grupit të punës së hartimit të fondit limit “do të mbulohen nga ulja në procedurën e prokurimit”, është jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, ndryshuar, neni 1, “Përgjegjësia e autoritetit/entit kontraktor”.

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specifikimet teknike dhe projektet.

Në specifikimet teknike ky komision ka përcaktuar se: “Mbas heqjes së traversave të kalbura do të bëhet vendosja dhe montimi i traversave të reja të drurit dhe aksesoreve që mungojnë në pozicionet që do të shënohen nga tekniku i linjës hekurudhore në bashkëpunim me shoqërinë zbatuese dhe supervizorin e objektit.

Mbas montimit të traversave të drurit normale të reja do të bëhet plotësimi i linjës me material ballast cakulli në trashësinë 25 cm duke kryer dy ngritjet e linjës hekurudhore me pajisje të nevojshme si binda, etj.


5	An	Furnizim me traversa druri normale për linjën hekurudhore	m3	102,752
---	----	---	----	---------

Gjithashtu ky komision për traversat ka përcaktuar se: “Traversat e drurit që do të vendosen në linjën hekurudhore do të plotësojnë parametrat teknike si më poshtë:

Traversat e drurit hekurudhore të imprenjuara të reja duhet të jenë të prodhuara nga druri i lisit, druri i ahut, druri i vidhit të kuq ose prej druri azobe.

Traversat e drurit hekurudhore duhet të jenë të prodhuara nga lende drusore e sharruar nga trungu i drurit.

Procesi i mbrojtjes së traversave të drurit nga kalbja dhe demtimi i tyre (imprenjimi), duhet të realizohet me vaj ekologjik creosot në përputhje me Standardin e Komunitetit Evropian në



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

**fuqi ose në përputhje me Standardin e vendit ku prodhohen traversat**, i cili duhet ti përgjigjet Standardit të Komunitetit Evropian.

Thellessia e impenjimit të traversave të drurit hekurudhore të reja duhet të jetë në thellësinë 30 mm në largësi deri 600 mm nga koka e traversës dhe jo më e vogël se 10 mm në pjesën tjetër të traversës.

Mostrat për përcaktimin e thellësisë së impenjimit të merren 5 – 10 % të numrit të traversave për çdo parti në një ose dy vende për secilën traverse me tryele tubolare.

Në analizën e mostrave duhet të plotësohet kërkesa për thellësinë e impenjimit, në të kundërt prova përsëritet. Në rast se kjo kërkesë nuk plotësohet përsëri, malli nuk pranohet.

Traversat e drurit duhet të jetë të drejta dhe në forme të rregullt.

Dimensionet e traversave të drurit normale të reja të impenjuara duhet **të jenë në përputhje me Standardet Evropiane.**

**Për traversat e drurit normale dimensionet janë si më poshtë:**

Gjatësia 2600 mm, me tolerance plus minus 30 mm.

Gjerësia 260 mm, me tolerance plus minus 20 mm.

Lartësia 160 mm, me toleranca plus minus 10 mm.

Forma e seksionit tërthor të traversave si normale duhet të jetë katërkëndësh kënddrejtë.

Në të dy faqet e seksioneve tërthore të traversave duhet të jenë të vendosura pllaka metalike standarde për mbrojtjen e traversave nga çarja. Nuk lejohen plasaritje të traversës.

Çarje lejohen për secilën koke deri në 3 copë me thellësi sa Gjerësia e traversës dhe gjatësi deri në 300 mm. Nuk lejohen nyje të shëndosha dhe jo të shëndosha në vendin e shtruarjes së shinës.

Malli do të shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm teknik. Traversat të jenë të shoqëruara **me dokumentacionin që të vërtetojë cilësinë, garancinë, origjinën dhe gjithë parametrat teknike për përdorim në linjat hekurudhore**”.

➤ Si konkluzion ky komision në rikonstrukcionin e kësaj linje i ka shënuar parametrat por: Mos përcaktimi i standardit dhe llojit të certifikatës së cilësisë që kërkohet, është jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, nenin 27, Kontratat e mallrave, pika 1, ku është përcaktuar se: “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”.

**Arsyetimi** për nevojën e prokurimit për “Rikonstrukcion i linjës Milot-Lezhë”: Nga ana e komisionit sipas një dokumenti **pa numër dhe datë**, jepet arsyetimi gjendja e keqe e mbi strukturës së linjës, ka segmente me shumë ulje ngritje, duke krijuar rampa të theksuara, kjo nga cilësia shumë e dobët e materialit mbushës së trupit të trasesë dhe kalbëzimi i traversave nga përdorimi i gjatë ndër vite.

**Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:** Dokumentet e procedurës janë hartuar sipas procesverbalit datë 14.05.2019.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 08/07/2019. Vlerësimi i ofertave, nga ana e KVO paraqitet sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
	Sh.shpk	K.....W	11.372.434	Akt-marrëveshja midis ofertuesit dhe prodhuesit për lëvrimin e mallit objekt i kësaj kontrate nëpërmjet së cilës



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

				garantohet prodhimi dhe furnizim në sasi dhe në kohë, nuk është e vlefshme pasi subjekti prodhues nuk ka ne veprimtarinë e vet prodhimin e traversave. Ne veprimtarinë e subjektit sipas Certifikatës se regjistrimit është e cilësuar se objekti i veprimtarisë është veprimtari e pa specializuar tregtimi me shumice.
	B.shpk	J.....V	12.000.314	Kualifikuar dhe shpallur fitues
	C.shpk	K.....f	12.103.273	kualifikuar

**Vleresimi i ofertave:** Nga auditimi rezultoi se vlera më e ulët e ofruar është s`kualifikuar sipas kriterëve të DST. Nga ana e KVO-së është shpallur fituese vlera më e ulët e ofruar e vlefshme.

**Lidhja e kontratës:** Kontrata me numër 580/2, datë 03.098.2019, me objekt “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Milot -Lezhë”, me “B.” Shpk, me vlerë 14,400,314 lekë me afat 3 muaj, bashkëlidhur formulari i sigurimit të kontratës.

**9- Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Shkozet-Kavaje” (km 6+500-7+500, km 11+000 - 12+000) me këto të dhëna:**

<b>Urdhër Prokurimi</b> nr. 582, datë 14.05.2019	<b>NJHDT:</b> E.L. Sh.V. A.G.	<b>KVO:</b> nr. 582/1, datë 14.05.2019 K.Sh. E.J. B.D.
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “e hapur”		
<b>Fondi Limit</b> 12.455.381 lekë.	<b>OE fitues:</b> C.shpk	<b>Diferenca me fondin limit</b> 52,654 lekë
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 12.402.727 lekë	<b>Operatorët Ekonomike</b> - Pjesëmarrës në tender 4 - S`kualifikuar 3
<b>Data e hapjes së tenderit nga 01/07/2019 , behet 08/07/2019</b>		
<b>Ankimime: S`ka</b>	<b>Ka sqarim për DST</b>	<b>Përgjigje Ankesës: s`ka</b>
<b>Lidhja e Kontratës</b> 582/3, datë 08.08.2019	<b>Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 12,402,727 lekë	Afati 3 muaj <b>Likuiduar:</b> Komplet
<b>Titullari i AK Ani Dyrmishi</b>		

**Fondi limit:** Me shkresën nr. 555, datë 07.05.2019, të firmosur nga D.M., drejtues i NJBMIH, i është drejtuar HSH sha ku ka dërguar preventivin, fondin limit, specifikimet Teknik, arsyetimin, grafikun e punimeve dhe skicat.

Grupi i punës i përbërë nga M.K., M.B., Xh.B. ka përcaktuar fondin limit (preventivin) në shumën 12,455,381 lekë pa tvsh, bazuar në çmimet e VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ” dhe manualin shtetëror nr.3, për punimet e ndërtimit të rrugëve i vitit 1992, për pjesën e punimeve të hekurudhës si dhe librit të normave hekurudhore.

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specifikimet teknike dhe projektet.

Në specifikimet teknike thuhet se : “**Përcaktimi i traversave të kalbura** të cilat nuk mund të montohen me në linjë pas rikonstruksionit ne km 6+500-7+500 do të bëhet në prezencë të teknikut të linjës hekurudhore, mbikëqyrësit te punimeve dhe sipërmarrësit **dhe pas këtij përcaktimi do të realizohet zëvendësimi me traversa druri të reja.**

Po kështu do te veprohet dhe për zëvendësimin e traversave të kalbura me traversa druri të reja ne km 11+000- 12+000.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Ndërkohë në preventiv është përcaktuar sasia prej:

10	An	Furnizim me traversa druri për linjën hekurudhore	m3	116,8128
11	N-35	Ndërrim traversa druri me gozhde në linjën hekurudhore	copë	1080

**Në lidhje me traversat ky komision ka përcaktuar se:** “Traversat e drurit do të plotësojnë specifikimet teknike si më poshtë: **Për traversat e drurit normale dimensionet janë si më poshtë:**

Gjatësia 2600 mm, me tolerance plus minus 30 mm.

Gjerësia 260 mm, me tolerance plus minus 20 mm.

Lartësia 160 mm, me toleranca plus minus 10 mm.

Forma e seksionit tërthor të traversave si normale dhe speciale duhet të jetë katërkëndësh kënddrejtë. Në të dy faqet e seksioneve tërthore të traversave duhet të jenë të vendosura pllaka metalike standarde për mbrojtjen e traversave nga çarja. Nuk lejohen çarje të traversës në zonën e mbështetjes të pllakës metalike ku montohet shina hekurudhore. Nuk lejohen plasaritje të traversës. Nuk lejohen nyje të shëndosha dhe jo të shëndosha në vendin e shtruarjes së shinës.

Për gjatësitë, thellësitë e çarjeve të respektohen normat e standardit shqiptar dhe Evropian. Përcaktimi i traversave të kalbura që do të zëvendësohen do të përcaktohet në prezencë të supercivorit dhe teknikut të linjës hekurudhore.

➤ Nga ku rezulton se komisioni i specifikimeve teknike nuk ka përcaktuar asnjë standard dhe certifikatës së cilësisë që kërkohet për traversat, veprim i cili është jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, nenin 27 Kontratave të mallrave, pika 1, ku është përcaktuar se: “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”,

➤ **Arsyetimi për nevojën e prokurimit për “Rikonstrukcionin e linjës hekurudhore Shkozë-Kavajë”:** Nga ana e komisionit sipas një dokumenti pa numër dhe datë, jepet arsyetimi amortizimi i materialit mbushës të trupit të trasesë, hedhja e dherave përgjatë trasesë nga ndërtimi i autostradës, ndërtimi i rrugës dytësore që ka sjellë bllokimin e kanaleve, etj.

**Hartimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit:** Dokumentet e procedurës janë hartuar sipas procesverbalit datë 14.05.2019.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 08.07.2019 dhe më datë 22.07.2019 është kryer vlerësimi i ofertave, sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	Sh.shpk	10.639.554	<b>Skualifikuar pasi:</b> Akt-marrëveshja midis ofertuesit dhe prodhuesit për lëvizimin e mallit objekt i kësaj kontrate nëpërmjet së cilës garantohet prodhimi dhe furnizim në sasi dhe në kohë, nuk është e vlefshme pasi subjekti prodhues nuk ka në veprimtarinë e vet prodhimin e traversave. Në veprimtarinë e subjektit sipas Certifikatës së regjistrimit është e cilësuar se objekti I veprimtarisë është veprimtari e pa specializuar tregtimi me shumicë. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e ballasti.
2	B. shpk	12.378.690	<b>Skualifikuar pasi:</b> Operatori ka paraqitur tërheqjen nga procedura me shkresën me nr. Prot 582/2 të dt, 11.07.2019



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
3	C. shpk	12.402.727	Kualifikuar dhe shpallur fitues
4	Sh.shpk	10.525.971	<p><b>S'kualifikuar pasi:</b> Lidhur me piken 2 kapaciteti teknik dhe profesionale ku kërkohet. Përsa i përket traversa druri hekurudhore normale</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Certifikatë ISO 9001: 2015 te prodhuesit e menaxhimit të cilësisë.</li> <li>• Certifikatë ISO 14001: 2015 te prodhuesit e menaxhimit te ambientit.</li> </ul> <p>Akt marrëveshje mes ofertuesit dhe furnizuesit e cila garanton lëvrimin e mallit objekt i kësaj kontrate ne sasi dhe kohe, sipas kushteve ne shtojcën 12, te DST. Akt marrëveshja duhet te shoqërohet me vërtetimin e regjistrimit te shoqërisë e cila furnizon operatorin ofertues me mallrat objekt kontrate, ne Regjistrin Tregtar te vendit ku kryen veprimtarinë e saj.</p>

**Vlerësimi i ofertave:** Nga auditimi rezultoi se në këtë procedurë ka fituar vlera më e ulët e vlefshme.

**Lidhja e kontratës:** Kontrata me numër 582/3, datë 08.08.2019, me objekt “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Shkozet Kavajë”, me “C.” Shpk, me vlerë 12,402,727 lekë me afat 3 muaj, bashkëlidhur formulari i sigurimit të kontratës.

#### Viti 2020

**10- Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje traversa betoni 820 copë” me këto të dhëna:**

<b>Urdhër Prokurimi</b> 93, datë 13.07.20	<b>NJHDT:</b> E.L. Sh.V. A.G.	<b>KVO:</b> 93/1, datë 13.07.20 D.M. P.P. L.A.
<b>Lloji i Procedurës</b> “hapur”		
<b>Fondi Limit</b> 10.061.000 lekë.	<b>OE fitues:</b> Z. Shpk	<b>Diferenca me fondin limit</b> 2,107,000 lekë
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 7.954.000 lekë	<b>Operatorët Ekonomike</b> - Pjesëmarrës në tender 4 - S'kualifikuar 0
<b>Data e hapjes së tenderit nga 21/08/2020 behet 28/08/2020</b>		
<b>Ankimime: për vlerësim</b>	<b>Ka monitorim nga APP për DST</b>	<b>Përgjigje Ankesës: Po</b>
<b>Lidhja e Kontratës</b> 14.10.20, nr. 93/2	<b>Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 9,554,800 lekë	Afati 90 dite   <b>Likuiduar:</b> Komplet
<b>Titullari i AK A.D.</b>		

**Fondi limit:** Grupi i punës i përbërë nga M.K., M.B., Xh.B. ka përcaktuar fondin limit në shumën 10,061,400 lekë pa tvsh, bazuar në eksperiencën e vitit 2011.

➤ Nuk ka të dhëna në këtë dokument mbi çmimet bazë të kontratave të mëparshme të vetë AK. Ky komision nuk liston asnjë çmim të kontratave të mëparshme për të lënë gjurmë auditimi, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 59 “Përlllogaritja e vlerësimit të kontratës”, ku citohet se: “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerësimit të kontratës”.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

➤ Ky komision në këtë përlllogaritje ka kërkuar nga njësia e prokurimit dhe strukturat juridike të saj të bëjnë verifikimin ligjor të procedurës së ndjekur për hartimin e fondit limit dhe nëse del ndonjë problem të referohet për ndryshimet e nevojshme”.

➤ Sa më sipër është jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, neni 57 “Njësia e prokurimit”, pika 2, ku është përcaktuar se: “Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:  
- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;  
- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);  
- përlllogaritjen e fondit limit, **nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme**”.

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specifikimet teknike. Në këto specifikime ky komision ka përcaktuar: “Traversat duhet të jenë të reja të kompletuara me aksesore mbërthimi të rinj, të prodhuar me paranderje **konform standardeve teknike Evropiane** për hekurudha (në fabrika të licencuara e të specializuara për këtë qëllim).

Këndi i inklinimit të traversave të jetë 1:20 **sipas Standardit Evropian**”.

Ky komision në asnjë rast nuk përcakton standardin evropian për këto traversa betoni, si dhe nuk ka dhënë vizatimet për traversat.

➤ Mos përcaktimi i standardit dhe llojit të certifikatës së cilësisë që kërkohet, është jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, neni 27, Kontratat e mallrave, pika 1, ku është përcaktuar se: “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”.

**Arsyetimi** për nevojën e prokurimit për “Blerje traversa betoni”: Nga ana e komisionit sipas një dokumenti **pa numër dhe datë**, jepet arsyetimi gjendja e rëndë e cilësisë së traversave të drurit në linjën hekurudhore. Këto traversa do të përdoren në linjat me shina tip S-49 duke qenë se sasia është shumë e vogël në krahasim me nevojat, ato do të përdoren për përforcim dhe jo radhazi.

➤ Sa më sipër në asnjë rast nuk janë përcaktuar linjat konkrete dhe sasi të traversave të betonit, që duhen sipas linjave.

**Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:** Dokumentet e procedurës janë hartuar sipas procesverbalit datë 13.07.2020. Në këtë procesverbal NJHDT nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se **çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjorisht**, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.

Nisur nga email i ardhur nga APP, njësia e prokurimit ka bërë ndryshime në DST.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 28.08.20 dhe më datë 02.09.2020 është kryer vlerësimi i ofertave, sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	A-A.Shpk	9.430.000	kualifikuar
2	E. B. Shpk	8.126.200	Kualifikuar
3	E. Shpk	9.471.000	Kualifikuar
4	Z. Shpk	<b>7.954.000</b>	<b>Kualifikuar dhe shpallur fitues</b>





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

**Ankimim për vlerësimin: “E.B.,” shpk,** i cili ankimohet për faktin se: “Furnizimi me traversa betoni dhe aksesoret e kërkuar për shinat hekurudhore shqiptare mund të realizohet vetëm nëpërmjet disa kompanive kineze dhe 2 kompanive që operojnë në Serbi. Shoqëria jonë vlerësoi që të kërkoj oferta dhe në Serbi, kompania R. Sh. D. garantonte prodhimin e traversave të betonit dhe aksesorëve të mbërthimit. Fabrika tjetër në Serbi, D. B.P. D.S. nga verifikimet e kryera rezultoi se nuk prodhon aksesorë mbërthimi sipas specifikave të kërkuara duke mos garantuar lëvrimin e mallrave në kohë dhe cilësi.

Sa më sipër rezultoi se KVO ka vepruar pa kryer asnjë verifikim në lidhje me aktmarrëveshjet e paraqitura nga OE pjesëmarrës.

Për këtë arsye ankimesi kërkon nga KSHA të verifikojë të gjitha aktmarrëveshjet e OE pjesëmarrës nëse janë në përputhje me kriteret. Gjithashtu të verifikojë nëse subjektet prodhuese të kenë në fushën e veprimtarisë prodhimin e traversave së bashku me aksesorët.

Nga ana e Titullarit të AK, ka dalë Vendim pezullimi nr. 152/4, datë 15.09.2020.

Me Urdhër nr.152/3, datë 15.09.2020 të Titullarit të AK, është ngritur KSHA i përbërë nga Sh.Xh., I.H., M.M., me afat deri 18.09.20.

Kthim përgjigje OE ankimesi është bërë me shkresën nr.152/5, datë 17.09.2020.

**Vlerësimi i ofertave:** KVO ka klasifikuar të 4 OE pjesëmarrës dhe ka shpallur fitues OE Z.Shpk, me vlerë më të ulët të ofruar.

**Lidhja e kontratës:** është bërë më datë 14.10.20, nr. 93/2, me vlerë 9,554,800 lekë me tvsh, me afat 90 ditë.

**Likuidimi:** në dosjen e procedurës ndodhet shkresa nr.93/4, datë 04.11.2020, drejtuar Degës Thesarit, Durrës për grafikun e likuidimeve në shumën 9,554,800 lekë.

**11- Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Shkodër Hani i Hotit”, me këto të dhëna:**

<b>Urdhër Prokurimi</b> Nr. 815, datë 11.08.20	<b>NJHDT:</b> E.L. Sh.V. A.G.	<b>KVO:</b> 815/1, datë 11.08.20 D.M. P.P. L.A.
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “kërkesë për propozim”		
<b>Fondi Limit</b> 8,333,334 lekë.	<b>OE fitues:</b> Sh. shpk	<b>Diferenca me fondin limit</b> 1,241,755 lekë
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 7.091.579 lekë	<b>Operatorët Ekonomike</b> - Pjesëmarrës në tender 7 - S’kualifikuar 2
<b>Data e hapjes së tenderit nga 28/08/2020 behet 03/09/2020</b>		
<b>Ankimime: për vlerësim</b>	<b>Ka monitorim nga APP për DST</b>	<b>Përgjigje Ankesës: Po</b>
<b>Lidhja e Kontratës</b> 14.10.20, nr. 29/2	<b>Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 8,509,895 lekë	<b>Likuiduar:</b> Afati 90 dite Komplet
<b>Titullari i AK A.D./ me urdhër dhe me prorsori zv/administratori S.P.</b>		

**Fondi limit:** Me shkresën nr. 159/2, datë 05.03.2020, të firmosur nga D.M., drejtues i NJSHML, i është drejtuar HSH sha, ku ka dërguar preventivin, fondin limit, specifikimet Teknik, arsyetimin, grafikun e punimeve dhe skicat.

Grupi i punës i përbërë nga M.K., M.B., Xh.B., ka përcaktuar fondin limit në shumën 8,333,334 lekë pa tvsh, bazuar në manualin e çmimeve viti 2015, manuali nr.3/viti 92, për punimet e



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

ndërtimit të rrugëve dhe hekurudhave si dhe librit të normave hekurudhore. Ky komision ka hartuar preventivin e punimeve.

Bashkëlidhur preventivit nuk janë çmimet me analizë, 8 raste nga 16 çmime gjithsej, veprim jo në përputhje me VKM nr.514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat 9, 10, 11 dhe me Udhëzimet e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe nr. 1, datë 16.6.2011.

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specifikimet teknike. Në këto specifikime ky komision ka përcaktuar: “Traversat duhet të jenë të shoqëruara me dokumentacionin që të vërtetojë cilësinë, garancinë, origjinën dhe gjithë parametrat teknikë për përdorim në linjat hekurudhore”, ndërsa për të tjerat në specifikimet teknike cilëson standardet evropiane pa përcaktuar se kush janë këto standarde.

➤ Ky komision në asnjë rast nuk përcakton dokumentacion konkret për këto traversa, veprim jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, neni 27, Kontratat e mallrave, pika 1, ku është përcaktuar se: “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”.

4	An	Furnizim traversa druri normale për linjën hekurudhore	m3	40,66816
7	An	Furnizim me traversa druri normale për linjën hekurudhore	m3	32,448

**Arsyetimi** për nevojën e prokurimit për “**Rikonstruksion i linjës hekurudhore Shkodër Hani i Hotit**”: Nga ana e komisionit sipas një dokumenti **pa numër dhe datë**, jepet arsyetimi gjendja e rëndë e në linjën hekurudhore.

**Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:** Dokumentet e procedurës janë hartuar sipas procesverbalit datë 11.08.2020. Më emalin e APP datë 21.08.20, nga asistenca e APP janë rekomanduar modifikim i DST në lidhje me: Kategorinë e licencës NP12A; Inxhinier mekanik; Certifikatën OHSAS 18001.

Në këtë email theksohet se përpos këtyre rekomandimeve NJHDT duhet të që çdo kriter të veçantë për kualifikim ta argumentojë sipas nenit 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar. NJHDT ka hartuar shtojcën e DST-ve, duke reflektuar për asistencën e dhënë.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 03.09.20 dhe më datë 08.09.2020 është kryer vlerësimi i ofertave, sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	Sh.shpk	7.091.579	<b>Kualifikuar dhe shpallur fitues</b>
2	B.shpk	8.000.648	Kualifikuar
3	B. shpk	7.983.937	<b>S`kualifikohet</b> pasi ka nuk paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterëve teknike
4	C. shpk	8.001.133	Kualifikuar
5	E. shpk	7.953.472	<b>S`kualifikohet</b> pasi nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterëve plotësuar teknike të vendosura nga Hekurudha Shqiptare si autoritet kontraktor. Nuk është pjesë e licencës së shoqërisë kategoria NS -11-A.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

6	E.B. shpk	7.582.244	Kualifikuar
7	Rr.G. shpk	7.313.255,60	Kualifikuar

**Ankimim për vlerësimin:** nga OE **E.B.**, shpk, datë 11.09.2020, i cili ankimohet për “na rezulton se KVO ka vepruar pa kryer asnjë verifikim në lidhje me aktmarrëveshjet e paraqitura nga OE pjesëmarrës pasi asnjë prej tyre nuk ka paraqitur aktmarrëveshje të vlefshme për furnizimin me traversa druri sipas specifikimeve teknike”.

Në lidhje me këtë ankimim ka dalë pezullimi i procedurës së prokurimit me Vendimin e Titullarit të AK me nr.152/4, datë 15.09.2020 dhe me urdhërin nr.31/4, datë 16.09.2020 është ngritur KSHA, i përbërë nga Sh.Xh., M.M., dhe I.H.

Ky komision në procesverbalin datë 17.09.2020, drejtuar Administratorit të shoqërisë përcakton se:

“Ankimimi i subjektit nuk qëndron. Subjekti i cili është renditur i pari me ofertën më të ulët të ofruar si dhe subjekti i renditur i dyti, **Sh.**, shpk dhe **Rr.G.**, shpk nga kontrolli në sistem rezultojnë se disponojnë aktmarrëveshje me një subjekt prodhues të këtyre traversave në Rumani nëpërmjet nënkontraktorit “Z.” shpk dhe një shoqërie në Mal të Zi “15 f.” subjekte të cilat garantojnë sasinë dhe cilësinë sipas specifikimeve të DST. Gjithashtu edhe subjektet që kanë paraqitur ofertë më të lartë se ankuesi kanë paraqitur secila aktmarrëveshjet përkatëse, sipas kërkesave të veçanta për kualifikim”.

Kthim përgjigje është bërë më shkresën nr. 153/5, datë 17.09.2020.

#### Vlerësimi i ofertave:

**Rr.G.**,shpk, nga auditimi rezulton se vetëm akt marrëveshjen me “11 F.” mal i Zi e ka në gjuhen shqipe. I gjithë dokumentacioni tjetër nuk është i përkthyer në gjuhen shqipe, ne kundërshtim me kërkesën **Seksioni 4 “Procedura”, pika 4.6, “gjuha”**.

**B.**,shpk, ka paraqitur akt marrëveshje me subjektin M. srl R., ku në pikën 2, thuhet se i ofrohen nëpërmjet internetit dhe në pikën 2 thuhet se kompania duhet të firmosë akt marrëveshjen. Ndërkohë ky dokumet është paraqitur i pa firmosur dhe pa datë

C.,shpk dhe “Sh.” shpk rezultojn sipas DST.

**Sa më sipër KSHA Sh.Xh., M.M., dhe I.H., dhe KVO D.M., P.P., dhe L.A., nuk ka zbatuar vlerësimin sipas DST.**

**Lidhja e kontratës:** nr.29/2, datë 14.10.2020, në vlerën 8,509,895 lekë me tvsh me afat 90 ditë kalendarike.

**12- Procedura e prokurimit me objekt: “Rinovim agregate për lokomotiva 2020” me këto të dhëna:**

<b>Urdhër Prokurimi</b> Nr. 911, datë 07.07.2020	<b>NJHDT:</b> – E.L. Sh.V. A.G.	<b>KVO</b> , nr. 91/1, datë 07.07.20 K.I. N.K. M.M.
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “kërkesë për propozim”		
<b>Fondi Limit</b> 5,830,000 lekë.	<b>OE fitues:</b> <b>Z. shpk</b>	<b>Diferenca me fondin limit</b> 460,000 lekë
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 5,370,000 lekë	<b>Operatorët Ekonomike</b> - Pjesëmarrës në tender 2 - S’kualifikuar 1
<b>Data e hapjes së tenderit</b> 31.07.2020 behet 03.08.2020		
<b>Ankimime: per vlerësim</b>	<b>Ka modifikim për DST</b>	<b>Përgjigje Ankesës: po</b>
<b>Lidhja e Kontratës</b>	<b>Vlera e kontratës (me TVSH)</b>	Afati 60 ditë   <b>Likuiduar:</b>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

31/4, datë 22.09.20	6,444,000 lekë		Komplet
<b>Titullari i AK A.D.</b>			

**Fondi limit:** Përlllogaritja e fondit limit dhe përgatitja e dokumentacionit teknik është kryer nga A.Sh., A.K., dhe T.Ç., për të cilën nuk ka në dosje urdhër.

Dokumentacioni Teknik ka ardhur në HSH sha me shkresën nr. 38/5, datë 12.05.20, I firmosur nga Drejtuesi Teknik I NJSHML N.K..

Fondi limit është përcaktuar në vlerën 5,830,000 lekë. Komisioni për argumentimin e çmimit citon se: “Nisur nga fakti se agregatet e kërkuara janë specifike për hekurudhën, si dhe nisur nga fakti se nuk ka çmime INSTAT-i apo institucioneve të tjerë zyrtare të publikuara dhe as çmime të tregut, për çmimet e rinovimit të agregatëve për lokomotiva në zbatim të nenit 59/d të VKM nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar është vepruar duke marrë për bazë çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga HSH sha, duke marrë parasysh nevojat e sektorit teknik si dhe faktin e mos tejkalimit të fondit limit”.

#### Sa më sipër:

➤ Nuk ka të dhëna në këtë dokument mbi çmimet bazë të kontratave të mëparshme të vetë AK. Ky komision nuk liston asnjë çmim të kontratave të mëparshme për të lënë gjurmë auditimi, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, ku citohet se: “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës”.

➤ Nga ana e këtij komisioni vihet në dukje fakti se “...duke marrë parasysh nevojat e sektorit teknik si dhe faktin e mos tejkalimit të fondit limit”, një argumentim kontradiktor pasi ky komision është ngritur për përlllogaritjen e fondit limit dhe jo për të përcaktuar nevojat sipas një fondi limit të caktuar, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit”, ku është përcaktuar se: “1. Me miratimin e ligjit për buxhetin dhe pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit..”.

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specifikimet teknike. Argumentimi Teknik është bërë nga Krye inxhinieri i NJSHML K.H., (datë 12.05.2020), për riparim kapital të dy lokomotivave M6 dhe një lokomotive M5 në lidhje me Indoto MT 8 copë dhe Indoto gjeneratori 1 copë.

**Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:** me procesverbalin datë 07.07.2020 dhe me datë 22.07.2020 është kryer modifikim i DST-ve.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 03.08.2020, vlerësuar më datë 10.08.2020, ku kanë marrë pjesë dhe janë vlerësuar sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	Z.shpk	J.....A	5,370,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	A. M.	K.....N	4,663,600	S`kualifikuar pasi:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

				- Faturat janë të palexueshme por edhe në rastet kur janë të lexueshme nuk janë punime të ngjashme
--	--	--	--	--

**Ankimimi për vlerësim:** Me shkresën nr.31/1, datë 17.08.2020, nga Titullari I AK ka dalë Vendimi për pezullim procedurë dhe është ngarkuar Sektori Juridik pranë Njësisë së Shërbimeve mbështetëse i përbërë nga Sh.Xh., A.Sh., dhe I.H.për shqyrtimin e ankesës.

Ky komision me procesverbalin datë 19.08.2020, ka vendosur se faturat nuk janë të rregullta.

Përgjigje ankesës është dhënë me shkresën nr.155/2, datë 18.08.2020.

#### Vlerësimi i ofertave

**A.M.PF**, nga auditimi rezultoi se ky OE faturat i ka pa marrë në dorëzim dhe në shumë raste të palexueshme.

**“Z.” shpk**, nga auditimi rezulton se i përmbush kriteret për kualifikim.

**Lidhja e kontratës:** Kontrata me numër 31/4, datë 22.09.20, me objekt “Rinovim agregatë për lokomotiva 2020”, me “Z.” Shpk, me vlerë 6,444,000 lekë. Në kontratë nuk është përcaktuar afati ndërsa sipas DST është 60 ditë.

## 2021

**13-** Procedura e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion i linjës Budull-Gjormë”** me këto të dhëna:

<b>Urdhër Prokurimi</b> 52/2, datë 06.05.2021	<b>NJHDT:</b> E.L. Sh.V. P.V.	<b>KVO:</b> 52/3, datë 06.05.21 K.Sh. B.D. D.S.
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Kërkesë për propozim”		
<b>Fondi Limit</b> 10,000,000 lekë.	<b>OE fitues:</b> E.N. shpk	<b>Diferenca me fondin limit</b> 1,896,519 lekë
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 8.103.481 lekë	<b>OE- Pjesëmarrës në tender</b> 6
<b>Data e hapjes së tenderit</b> nga 03.06.2021 behet 08.06.2021		<b>OE- S’kualifikuar</b> 0
<b>Ankimime: s`ka</b>	<b>Monitorim nga APP - DST</b>	<b>Përgjigje Ankesës: ska ankesë</b>
<b>Lidhja e Kontratës</b> numër s`ka, datë 12.07.2021 shtesë kontrate nr.52/21, 04.10.2021	<b>Vlera e kontratës</b> 9,724,178.16 lekë	<b>Afati 3 muaj</b> Shtuar deri më datë 15.11.2021.
<b>Titullari i AK A. D.</b>		

**Fondi limit:** Me shkresën nr. 439, datë 07.04.21, të firmosur nga D.M., drejtues i NJBMIH, i është drejtuar HSH sha, ku ka dërguar preventivin, fondin limit, specifikimet teknike, arsyetimin, grafikun e punimeve dhe skicat.

Grupi i punës i përbërë nga M.K., M.B., Xh.B. ka përcaktuar fondin limit në shumën **10,024,540 lekë pa tvsh**, bazuar në manualin e çmimeve viti 2015, manuali nr.3/viti 92, për punimet e ndërtimit të rrugëve dhe hekurudhave si dhe librit të normave hekurudhore.

Në përlllogaritjen e fondit limit, ky komision përcakton se vlerat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit do të mbulohen nga ulja në procedurën e prokurimit.

➤ Sa përcaktuar në lidhje me vlerën e mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të punimeve të cilat sipas grupit të punës së hartimit të fondit limit “do të mbulohen nga ulja në procedurën e prokurimit”, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, ndryshuar, neni 1, “Përgjegjësia e autoritetit/entit kontraktor:, ku



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

është përcaktuar se: “Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimet me fonde publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, (më poshtë “LPP”), të këtyre rregullave dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik (më poshtë “APP”), të dala në bazë dhe për zbatim të LPP”.

➤ Gjithashtu po në këtë dokument ky komision kërkon sa vijon: “Kërkojmë nga njësia e prokurimit dhe strukturat juridike pranë saj të bëjnë verifikimin ligjor të procedurës së ndjekur për hartimin e fondit limit dhe nëse del ndonjë problem të referohet për ndryshimet e nevojshme”, veprim jo në përputhje me nenin 57 “Njësia e prokurimit” të VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, pika 2 ku thuhet se:

“2. Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:

- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;
- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti); - përlllogaritjen e fondit limit, **nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme**; - hartimin e urdhrat të prokurimit;
- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, **nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme**”;

Ky komision ka hartuar preventivin e punimeve. Bashkëlidhur preventivit nuk janë çmimet me analizë në 3 raste nga 14 çmime gjithsej, veprim jo në përputhje me VKM nr.514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat: 9,10 dhe 11 dhe me Udhëzimet e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe nr. 1, datë 16.6.2011.

Nr.	Nr.An	Pershkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia
7	An	Furnizim me traversa betoni për linjën hekurudhore	m3	661
9	An	Furnizim trifona linje	copë	400.0
10		Montim i aksesoreve qe mungojnë në linjë	op	400.0

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specifikimet teknike. Në këto specifikime ky komision ka përcaktuar: “Traversat e betonit duhet të jenë të reja të kompletuara me aksesore mbërthimi të rinj, për shina S-49 të prodhuara me paranderje **konform standardeve teknike Evropiane për hekurudha** (në fabrika të licencuara e të specializuara për këtë qëllim). Marka e betonit sipas standardit të prodhimit të traversave të jetë jo me pak se MB 550 kg/cm<sup>2</sup>. Traversat e betonit do të vendosen ne pjesën e linjës hekurudhore pjese e këtij segmenti ne rikonstruksion. Traversat e drurit qe dalin nga linja do te depozitohen anash linjës dhe ne përfundim te punimeve do te hiqen nga kontraktori. Këndi i inklinimit të traversave të jetë 1:20 **sipas Standardit Evropian**. Gjatësia e traversës se betonit duhet të jetë jo më pak se 2.4 m. Për të gjitha llojet e traversave duhet të garantohet **me dokumentacionin tekniko ligjor** shpejtësia e sigurt jo më pak se 120 km/h. Ngarkesa e llogaritur e linjës jo më pak se 20 ton/aks. Aksesoret e mbërthimit do të jenë të rinj të aftë të mbërthejnë profilin e shinës S49 të inkorporuara në trupin e traversës, prodhime të Uzinave të licencuara **sipas standardeve Evropiane për Hekurudha**. Përpara



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

montimit në linjë traversat e betonit do të merren në dorëzim me proces- verbal. Traversat se bashku me aksesoret do të jenë të shoqëruara me gjithë **dokumentacionin e nevojshëm teknik** në varësi të origjinës prodhimit. Dokumentacioni original duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar.

➤ Ky komision në asnjë rast nuk përcakton dokumentacion konkret për këto traversa, veprim jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, neni 27, Kontratat e mallrave, pika 1, ku është përcaktuar se: “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”, **veprim që e ngarkon këtë të fundit me përgjegjësi.**

**Arsyetimi për nevojën e prokurimit për “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Shkodër Hani i Hotit”:** Nga ana e komisionit sipas një dokumenti **pa numër dhe datë**, jepet arsyetimi gjendja e së keqe të mbi strukturës së linjës (si ballast, traversa, aksesore).

#### **Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:**

Dokumentet e procedurës janë hartuar sipas procesverbalit datë 11.08.2020 dhe janë modifikuar sipas shtojcës përkatëse pas asistencës së APP.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 08.06.21 dhe më datë 15.06.21 është kryer vlerësimi i ofertave, sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	Sh. shpk	9.746.090	Kualifikuar
2	B. shpk	9.809.809	Kualifikuar
3	E. B. shpk & F. shpk	9.857.504	Kualifikuar
4	E.N. shpk	8.103.481	Kualifikuar dhe shpallur fituese
5	F. shpk	9.876.599	Kualifikuar
6	Sh. shpk	9.659.708	Kualifikuar

#### **Në këtë procedurë ka fituar oferta më e ulët e vlefshme.**

**Lidhja e kontratës:** Kontrata me numër s`ka, datë 12.07.2021, me objekt “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Budull Gjormë”, me “E.N.,” shpk, me vlerë 9,724,178.16 lekë, me afat 3 muaj. Për këtë kontratë është bërë amendament kontratë nr.52/21, datë 04.10.2021, është shtuar afati i kontratës deri më datë 15.11.2021.

**14-** Procedura e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion i linjes Milot Lezhë”** me këto të dhëna:

<b>Urdhër Prokurimi</b> 56/2, datë 06.05.2021	<b>NJHDT:</b> E. L. Sh.V. P.V.	<b>KVO:</b> 56/3, datë 06.05.21 B.K. I.H. B.D.
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “kërkesë për propozim”		
<b>Fondi Limit</b> 9,785,902 lekë.	<b>OE fitues:</b> E.B. & F.shpk	<b>Diferenca me fondin limit</b> 2,387,189 lekë
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 7.398.713 lekë	<b>Operatorët Ekonomike</b> - Pjesëmarrës në tender <b>6</b> - S`kualifikuar 2
<b>Data e hapjes së tenderit</b> nga 16/06/2021 behet 21/06/2021		
<b>Ankimime:</b> s`ka	<b>Ka monitorim nga APP për DST</b>	<b>Përgjigje Ankesës:</b> ska ankesë



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

<b>Lidhja e Kontratës</b> 56/5, datë 22.07.2021	<b>Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 8,878,456 lekë	Afati 3 muaj	<b>Likuiduar:</b> Komplet
<b>Titullari i AK A.D.</b>			

**Fondi limit:** Grupi i punës i përbërë nga M.K., M.B., E.Q. ka përcaktuar fondin limit në shumën **9,785,902** lekë, bazuar në manualin e çmimeve viti 2015, manuali nr.3/viti 92, për punimet e ndërtimit të rrugëve dhe hekurudhave si dhe librit të normave hekurudhore. Në përlllogaritjen e fondit limit, ky komision përcakton se vlerat e mbikëqyrjes dhe kolauditimit do të mbuloohen nga ulja në procedurën e prokurimit.

➤ Sa përcaktuar në lidhje me vlerën e mbikëqyrjes dhe të kolauditimit të punimeve të cilat sipas grupit të punës së hartimit të fondit limit “do të mbuloohen nga ulja në procedurën e prokurimit”, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, ndryshuar, neni 1, “Përgjegjësia e autoritetit/entit kontraktor:, ku është përcaktuar se:

1. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimet me fonde publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, (më poshtë “LPP”), të këtyre rregullave dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik (më poshtë “APP”), të dala në bazë dhe për zbatim të LPP.

➤ Gjithashtu po në këtë dokument ky komision kërkon sa vijon: “Kërkojmë nga njësia e prokurimit dhe strukturat juridike pranë saj të bëjnë verifikimin ligjor të procedurës së ndjekur për hartimin e fondit limit dhe nëse del ndonjë problem të referohet për ndryshimet e nevojshme”, veprim jo në përputhje me nenin 57 “Njësia e prokurimit” të VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, pika 2 ku thuhet se:

“2. Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:

- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;

- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti); - përlllogaritjen e fondit limit, **nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme**; - hartimin e urdhrat të prokurimit;

- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, **nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme**”;

Ky komision ka hartuar preventivin e punimeve. Bashkëlidhur preventivit nuk janë çmimet me analizë, 6 raste nga 21 çmime gjithsej, si dhe në çmimet me numër rendor 8, 14 dhe 20, nuk ka asnjë lloj numri analize apo shënim tjetër për origjinën e çmimit, veprim jo në përputhje me VKM nr.514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat: 9, 10 dhe 11;

- Dhe me Udhëzimet e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe nr. 1, datë 16.6.2011.

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specifikimet teknike. Në këto specifikime ky komision ka përcaktuar: “**Traversat e drurit** që do të vendosen në linjën hekurudhore do të plotësojnë parametrat teknike si më poshtë:

Traversat e drurit hekurudhore të imprenjuara të reja duhet të jenë të prodhuara nga druri i lisit, druri i ahut, druri i vidhit të kuq ose prej druri azobe.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Traversat e drurit hekurudhore duhet të jenë të prodhuara nga lende drusore e sharruar nga trunghi i drurit.

Procesi i mbrojtjes së traversave të drurit nga kalbja dhe demtimi i tyre (imprenjimi), duhet të realizohet me vaj ekologjik creosot në përputhje me **Standardin e Komunitetit Evropian** në fuqi ose në përputhje me **Standardin e vendit ku prodhohen traversat, i cili duhet të përgjigjet Standardit të Komunitetit Evropian**.

Thellessia e impenjimit të traversave të drurit hekurudhore të reja duhet të jetë në thellësinë 30 mm në largësi deri 600 mm nga koka e traverses dhe jo më e vogël se 10 mm në pjesën tjetër të traversës. Mostrat për përcaktimin e thellësisë së impenjimit të merren 5 – 10 % të numrit të traversave për çdo parti në një ose dy vende për secilën traverse me tryele tubolare. Në analizën e mostrave duhet të plotësohet kërkesa për thellësinë e impenjimit, në të kundërt prova përsëritet. Në rast se kjo kërkesë nuk plotësohet përsëri, malli nuk pranohet. Traversat e drurit duhet të jenë të drejta dhe në forme të rregullt. Dimensionet e traversave të drurit normale të reja të imprenjuara **duhet të jenë në përputhje me Standardet Evropiane. Për traversat e drurit normale dimensionet janë si më poshtë:**

Gjatësia 2600 mm, me tolerance plus minus 30 mm.

Gjerësia 260 mm, me tolerance plus minus 20 mm.

Lartësia 160 mm, me toleranca plus minus 10 mm.

Forma e seksionit tërthor të traversave si normale duhet të jetë katërkëndësh kënddrejte. Në të dy faqet e seksioneve tërthore të traversave duhet të jenë të vendosura pllaka metalike standarde për mbrojtjen e traversave nga çarja. Nuk lejohen plasaritje të traversës. Çarje lejohen për secilën koke deri në 3 copë me thellësi sa Gjerësia e traversës dhe gjatësi deri në 300 mm. Nuk lejohen nyje të shëndosha dhe jo të shëndosha në vendin e shtruarjes së shinës. Malli do të **shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm teknik**. Traversat të jenë të **shoqëruara me dokumentacionin që të vërtetojë cilësinë, garancinë, origjinën dhe gjithë parametrat teknike** për përdorim në linjat hekurudhore. **Traversat e betonit** duhet të jenë të reja të kompletuara me aksesore mbërthimi të rinj, për shina S-49 të prodhuara me parandërje konform *standardeve teknike Evropiane* për hekurudha (në fabrika të licencuara e të specializuara për këtë qëllim). Marka e betonit sipas standardit të prodhimit të traversave të jetë jo më pak se MB 550 kg/cm<sup>2</sup>. Traversat e betonit do të vendosen në pjesën e linjës hekurudhore që kalon neper urën hekurudhore mbi lumin Mat pjese e këtij segmenti në rikonstruksion ndërsa në pjesën tjetër jashtë urës do të vendosen vetëm traversa druri në kthese dhe në pjesën e kësaj linje në drejtim mund të vendosen dhe traversa betoni. Traversat e betonit që dalin nga linja do të depozitohen në stacionin hekurudhor të Milotit. Këndi i inklinimit të traversave të jetë 1:20 sipas **Standardit Evropian**. Gjatësia e traversës betonit duhet të jetë jo më pak se 2.4 m. Për të gjitha llojet e traversave duhet të garantohet me dokumentacionin tekniko ligjor shpejtësia e sigurt jo më pak se 120 km/h. Ngarkesa e llogaritur e linjës jo më pak se 20 ton/aks.

➤ Ky komision në asnjë rast nuk përcakton dokumentacion konkret për këto traversa, veprim jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, neni 27, Kontratat e mallrave, pika 1, ku është përcaktuar se: “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

**Arsyetimi** për nevojën e prokurimit për “**Rikonstruksion i linjës hekurudhore Shkodër Hani i Hotit**”: Nga ana e komisionit sipas një dokumenti **pa numër dhe datë**, jepet arsyetimi gjendja e së keqe të mbi strukturës së linjës pasi linja është në kthesë me rreze të vogël 300 m.

#### **Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:**

Dokumentet e procedurës janë hartuar sipas procesverbalit datë 06.05.2021 dhe janë modifikuar sipas shtojcës pas asistencës së APP.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 21.06.21 dhe më datë 28.06.21 është kryer vlerësimi i ofertave, sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	Sh. Shpk	K.....Ŵ	8,500,000	Kualifikuar
2	B. shpk	J.....V	9,001,270	Kualifikuar
3	E.B.& F.shpk	L.....M J.....M	7,398,713	<b>Kualifikuar dhe shpallur fitues</b>
4	Sh.shpk	K.....N	7,496,090	Kualifikuar
5	G.shpk	K.....A	8,592,009	S`kualifikuar pasi nuk është i pajisur me licence NS- 11-A
6	Rr.G.shpk	K.....H	7,220,446	S`kualifikuar pasi: ka paraqitur kontratën individuale për Inxhinier mekanik e lidhur me date 25.01.2018 ne prani te noterit, Rr.G. ne cilësinë e punëdhënësit dhe z. K.V. punëmarrësi me pozicion Inxhinier mekanik kjo kontrate e vlefshme për një periudhe 3 vjeçare, e cila ka përfunduar me date 25.01.2021. Kamioni me targe AB 870 AD- Leja e qarkullimit ne piken 24 është e korrigjuar me dore, kjo e bën te pamundur llogaritjen e tonazhit te mjetit nga KVO. Polisa e sigurimit për periudhën e vlefshmërisë se siguracionit është e korrigjuar.

**Nga auditimi i dokumentacionit të BOE të shpallur fitues rezulton se, ky BOE ka paraqitur aktmarrëveshjen e bashkimit dhe nuk ka paraqitur prokurë.**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi nuk është sipas kërkesave të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pikat 1 dhe 2, ku është përcaktuar:

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. **Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.**

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit /furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me **prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës**. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi”.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Ky BOE nuk ka ndarë as punët konkrete që do të kryejë çdo anëtar i këtij bashkimi (bashkëlidhur oferta ekonomike.

**Sa trajtuar KVO, nuk duhej ta kualifikonte BOE.**

**Lidhja e kontratës:** Kontrata me numër 56/5, datë 22.07.2021, me objekt “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Milot Lezhë”, me E.B., shpk & F., shpk, me vlerë 8,878,456 lekë, me afat 3 muaj.

Kontrata është firmosur vetëm nga përfaqësuesi i BOE I.Sh., jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 2, ku ndër të tjera është përcaktuar se: “Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.”, **veprim për të cilin ngarkohet me përgjegjësi NJHDT dhe Titullari i AK.**

**15-** Procedura e prokurimit me objekt: “**Riparim vepra arti (mbrojtja e urës së Kirit + plotësim urash me guardrail)**” me këto të dhëna:

<b>Urdhër Prokurimi</b> Nr. 74/2, datë 20.05.2021	<b>NJHDT:</b> E.L. Sh.V. P.V.	<b>KVO:</b> Urdhër Nr. 74/3, 20.05.21 B.K. I.H. B.D.	
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “kërkesë për propozim”			
<b>Fondi Limit</b> 11,666,666 lekë.	<b>OE fitues:</b> Rr.G.shpk	<b>Diferenca me fondin limit</b> 3,974,153 lekë	
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 7,692,513 lekë	<b>Operatorët Ekonomike</b> - Pjesëmarrës në tender 8 - S’kualifikuar 0	
<b>Data e hapjes së tenderit</b> nga 11.09.2021	behet 18.09.2021		
<b>Ankimime: s`ka</b>	<b>Ka monitorim nga APP për DST</b>	<b>Përgjigje Ankesës: ska anese</b>	
<b>Lidhja e Kontratës</b> 74/5, datë 11.11.2021	<b>Vlera e kontratës</b> 9,231,016 lekë	Afati 70 ditë	<b>Likuiduar:</b> Komplet
<b>Titullari i AK A.D.</b>			

**Fondi limit:** Me shkresën nr. 313/3, datë 13.04.21, të firmosur nga D.M., drejtues i NJBMIH, i është drejtuar HSH sha, ku ka dërguar preventivin, fondin limit, specifikimet Teknik, arsyetimin, grafikun e punimeve dhe skicat.

Grupi i punës i përbërë nga M.K.,M.B., E.Q., ka përcaktuar fondin limit në shumën **11,666,666** lekë, bazuar në manualin e çmimeve viti 2015.

Në përlllogaritjen e fondit limit, ky komision përcakton se vlerat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit do të mbulohen nga ulja në procedurën e prokurimit.

➤ Sa përcaktuar në lidhje me vlerën e mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të punimeve të cilat sipas grupit të punës së hartimit të fondit limit “do të mbulohen nga ulja në procedurën e prokurimit”, jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, ndryshuar, neni 1, “Përgjegjësia e autoritetit/entit kontraktor”, ku është përcaktuar se:

1. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimet me fonde publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, (më poshtë “LPP”), të këtyre rregullave dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik (më poshtë “APP”), të dala në bazë dhe për zbatim të LPP.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

➤ Gjithashtu po në këtë dokument ky komision kërkon sa vijon: “Kërkojmë nga njësia e prokurimit dhe strukturat juridike pranë saj të bëjnë verifikimin ligjor të procedurës së ndjekur për hartimin e fondit limit dhe nëse del ndonjë problem të referohet për ndryshimet e nevojshme”, veprim jo në përputhje me nenin 57, “Njësia e prokurimit” të VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, pika 2 ku thuhet se:

“2. Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:

- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;

- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti); - përlllogaritjen e fondit limit, **nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme**; - hartimin e urdhrat të prokurimit;

- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specififikimet teknike, **nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme**”;

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specififikimet teknike dhe projektet. Nga auditimi rezulton se projektet nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat përgjegjës për realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Grupi i projektimit duhet jetë i përberë minimumi nga: inxhinieri gjeodet për plan rilevimin dhe azhurnimin topografik, projektuesi arkitekt, projektuesi konstruktor, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi i instalimeve hidro sanitare, projektuesi i instalimeve ngrohje ftohje ventilim, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri, inxhinieri sizmolog, inxhinieri gjeolog, eksperti mjedisor.

Për veprimet e mësipërme, jo në përputhje me VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, e cila ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, neni 16 “Licenca – kategoritë e punimeve”, pika 1.

**Arsyetimi** për nevojën e prokurimit për “**Riparim vepra arti**”: Nga ana e komisionit sipas një dokumenti **pa numër dhe datë**, jepet arsyetimi në km 103 + 000 në perigonin Mjedë -Shkodër është i domosdoshëm për shkak se nga prurjet e lumit Kir është dëmtuar mbrojtja e shpatullës së urës, krahu i Mjedës.

**Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:** Dokumentet e procedurës janë hartuar dhe argumentuar sipas procesverbalit datë 27.09.2021 dhe janë modifikuar sipas shtojcës.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është vlerësuar me procesverbalin datë 22.10.21 sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	2.shpk	8 415 669	Kualifikuar
2	A.-2 .C. shpk	9 784 485	Kualifikuar
3	A. shpk	10 450 504	Kualifikuar
4	B. shpk	8 180 775	Kualifikuar



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

5	D.05 shpk	7 857 458	Kualifikuar
6	E.-A shpk	9 955 547	Kualifikuar
7	N. shpk	8 048 626	Kualifikuar
8	Rr. G. shpk	7 692 513	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Në këtë procedurë ka fituar oferta më e ulët e vlefshme.

**Lidhja e kontratës:** Kontrata me numër 74/5, datë 11.11.2021, me objekt “Riparim vepra arti”, me R.G. shpk, me vlerë 9,231,016 lekë, me afat 45 ditë.

**16-** Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje traversa druri/ 2021” me këto të dhëna:

<b>Urdhër Prokurimi</b> 53/2, datë 12.04.21	<b>NJHDT:</b> 53/2, 12.04.21 E,L. Sh,V. P.V.	<b>KVO:</b> Nr. 53/2, datë 12.04.21 D.M. P.P. L.A.
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “e hapur”		
<b>Fondi Limit</b> 33,333,333 lekë.	<b>OE fitues:</b> E.B. shpk	<b>Diferenca me fondin limit</b> 3,295,221 lekë
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 30,038,112 lekë	<b>Operatorët Ekonomike</b> - Pjesëmarrës në tender <b>3</b> - S’kualifikuar 0
<b>Data e hapjes së tenderit</b> nga 21/05/2021 , behet 26/05/2021		
<b>Ankimime: S`ka</b>	<b>Monitorim nga APP për DST</b>	<b>Përgjigje Ankesës: s`ka</b>
<b>Lidhja e Kontratës</b> 53/5, datë 23.06.21	<b>Vlera e kontratës</b> 36,045,734 lekë	<b>Afati 120 ditë</b> <b>Likuiduar:</b> JO
<b>Titullari i AK A. D</b>		

#### Përlllogaritja e fondit limit dhe dokumentacioni teknik i procedurës.

**Fondi limit:** Dokumentacioni bashkëlidhur shkresës është firmosur nga grupi i përbërë nga M.K., M.B. dhe E.Q.

Ky komision sipas procesverbalit pa datë ka përcaktuar çmimin për:

- 1 m<sup>3</sup> traversa druri normale 60,500 lekë / m<sup>3</sup>;
- 1 m<sup>3</sup> traversa druri speciale 63,000 m<sup>3</sup> (tek tenderi i vitit 2019 është 71,000 lekë/m<sup>3</sup>).

Nr.	Përshkrimi i Punimeve	Njësia	Sasia
1	Blerje traversa druri hekurudhore normale të reja me dimensione (2.6x0.26x0.16 ) m	m3	465.088
2	Blerje traversa druri hekurudhore normale të reja me dimensione ( 3.5x0.26x0.16 ) m	m3	20.384
3	Blerje traversa druri hekurudhore normale të reja me dimensione ( 3.8x0.26x0.16 ) m	m3	44.2624
4	Blerje traversa druri hekurudhore normale të reja me dimensione (4x0.26x0.16 ) m	m3	24.128

Ky komision ka përcaktuar fondin limit 33,333,333.3 lekë, duke u mbështetur në eksperiencat e mëparshme të AK, por pa vënë këto eksperiencat në këtë procesverbal. Ndërkohë që eksperiencat e mëparshme është edhe procedura e prokurimit e vitit 2019 ku ky çmim është më i lartë dhe nuk ka asnjë argumentim se pse është ulur çmimi.

➤ Nuk ka të dhëna në këtë dokument mbi çmimet bazë të kontratave të mëparshme të vetë AK. Ky komision nuk liston asnjë çmim të kontratave të mëparshme për të lënë gjurmë auditimi, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, ku citohet se:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës”.

Ky komision nëpërmjet këtij procesverbali i kërkon njësisë së prokurimit dhe strukturat juridike pranë saj të bëjnë verifikimin ligjor të procedurës së ndjekur për hartimin e fondit limit dhe nëse **del ndonjë problem të referohet për ndryshimet e nevojshme**, veprim jo në përputhje me nenin 57 “Njësia e prokurimit” të VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, pika 2 ku thuhet se:

“2. Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:

- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;

- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti); - përlllogaritjen e fondit limit, **nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme**; - hartimin e urdhrin të prokurimit;

- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, **nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme**”;

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specifikimet teknike, në të cilat rezulton se:

➤ Nuk ka përcaktuar llojin e standardit të KE në fuqi, e konkretisht në rastet sa më poshtë ka përcaktuar:

“Procesi i mbrojtjes së traversave të drurit nga kalbja dhe dëmtimi i tyre (imprenjimi), duhet të realizohet me vaj ekollogjik creosot **në përputhje me Standardin e Komunitetit Evropian** në fuqi ose në përputhje me Standardin e vendit ku prodhohen traversat, i cili duhet t’i përgjigjet **Standardit të Komunitetit Evropian**.

Dimensionet e traversave të drurit normale dhe speciale të imprenjuara duhet të jenë në përputhje **me Standardet Evropiane**.

➤ Nuk është përcaktuar dokumenti konkret (numri i certifikatës së cilësisë) që duhet të paraqesë kontraktori, e konkretisht është kërkuar:

➤ **Nuk është përcaktuar afati i garancisë**

Në specifikimet teknike është përcaktuar se: „Te gjitha specifikimet teknike të traversave duhet të përmbahen standardeve evropiane për hekurudha ose standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardit evropian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë“.

➤ Mos përcaktimi i standardit dhe llojit të certifikatës së cilësisë që kërkohet, është jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, Neni 27 Kontratat e mallrave, pika 1, ku është përcaktuar se: “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”.

**Arsyetimi për nevojën e prokurimit për blerje traversa druri hekurudhore**

Nga ana e komisionit është bërë arsyetimi sipas një dokumenti pa numër dhe datë, ku jepet arsyetimi i gjendjes së rënduar të cilësisë të traversave të drurit në linjën hekurudhore kryesore sidomos të kthesave të saj dhe të ndërruesve në stacionet hekurudhore por nuk jepet asnjë e dhënë mbi rezultatet se sa janë kërkuar dhe për konkretisht me emërtime zonash për të cilën janë kërkuar këto traversa. Sa më sipër është jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, Neni 60 “Urdhri i prokurimit”, pika 1, ku është përcaktuar se: “Me miratimin e ligjit



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

për buxhetin dhe pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, kur ka nevojë për punë/mallra/ shërbime, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit”.

#### **Ndërkohë në specifikimet teknike jepen të dhënat sa më poshtë vijon:**

” Depozitimi i traversave do të bëhet në magazinat e pritësit në Shkozë Durrës, Stacioni Milot dhe Stacioni Elbasan. Në stacionin Elbasan 70 m<sup>3</sup> traversa normale, në stacionin Milot 130 m<sup>3</sup> traversa normale dhe pjesa tjetër e traversave normale prej 265.088 m<sup>3</sup> do të depozitohet në stacionin Mallra Shkozë Durrës.

Ndërsa traversat speciale 20 m<sup>3</sup> në stacionin Milot, 15 m<sup>3</sup> në stacionin Elbasan dhe pjesa tjetër prej 53.7744 m<sup>3</sup> në Mallra Shkozë Durrës”, për të cilat duhet të kishte akte të mbajtura konkretisht.

**Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:** Dokumentet e procedurës janë hartuar sipas procesverbalit datë 12.04. 2021. Këto dokumente janë modifikuar pas rekomandimeve të APP.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 26.05.2021 dhe më datë 03.06.21 është kryer vlerësimi i ofertave, sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	D.&K .shpk	32 449 794	Kualifikuar
2	E. &B. shpk	<b>30 038 112</b>	<b>Kualifikuar dhe shpallur fitues</b>
3	Z. shpk	31 371 392	Kualifikuar

**Vlerësimi i ofertave:** Nga ana e KVO të tre OE janë konsideruar të kualifikuar dhe është renditur në vend të parë OE me vlerë të ulët të ofruar në procedurë.

**Lidhja e kontratës:** Kontrata me numër 53/5, datë 23.06.21, me objekt “Blerje traversa druri”, me “E. & B.,” shpk, me vlerë 36,045,734 lekë me afat 120 ditë, bashkëlidhur formulari i sigurimit të kontratës.

Nga ana e kontraktorit “E.&B.” shpk, me datë 19.10.2021, e protokolluar në HSH sha me numër 53/8, datë 10.10.21, është bërë kërkesë për zgjatje afati të përfundimit të kontratës sipas arsytimit:

- vështirësitë e shkaktuara nga situata Covid;

- Është i varur nga aktmarrëveshja e lidhur me operatorë të huaj për të cilët ka ndikuar mungesa e burimeve njerëzore për shkak të pandemisë; muaji gusht ka qenë periudhë pushimesh, periudha 20 shtator – 5 tetor 21 ka pasur vështirësi në transport për shkak të konfliktit në kufirin Serbi – Kosovë. Sa më sipër trajtuar kontraktori bazuar në nenin 12, pika 12.1 të kontratës kërkon shtyrjen e afatit për 60 ditë. Nga ana e AK HSH sha, me shkresën nr. 53/10, datë 03.11.2021 përgjigjet se: “Asnjë nga arsyet dhëna nga kontraktori nuk janë të përcaktuara në nenin 15 “Forcat madhore”, të kontratës. Deri në realizimin e kontratës do i referohen nenit 5 pika 5/1 për çdo ditë vonesë. Theksohet se fondet e disponueshme për këtë objekt janë të vitit 2021.

- Me shkresën nr.1762, datë 24.12.2021, Drejtuar Kontraktorit nga Njësia e Biznesit (firmosur Dashamir Mehmeti), **kërkohet informacion mbi ecurinë e zbatimit të kontratës.**

-me shkresën nr.53/14, datë 31.12.2021 HSH sha/ Administratori drejtuar shoqërisë së **sigurimeve Atlantik sha**, kërkohet shuma e siguruar të transferohet në llogarinë e HSH sha:

Realizimi i kontratës është në masën 14%.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Nga ana e HSH sha, në cilësinë e paditësit është bërë kërkesë padi nr.727, datë 07.07.2022 me të paditur shoqërinë e sigurimeve “atlantik” sha, me objekt pagim i detyrimit që rrjedh nga sigurimi i kontratës me objekt “Blerje traversa druri” kontratë e lidhur me E. &B., shpk, për të cilën nuk është sjellë fletëthirrja nga gjykata për të caktuar datën e gjyqit.

#### 2022

**17- Procedura e prokurimit me objekt: “Riparim vepra arti – Mbrojtja e urës hekurudhore të Rrogozhinës km. 37 + 500 deri në pikën 37 + 746”, 2022, me këto të dhëna:**

Urdhër Prokurimi Nr. 110/2, datë 24.08.22	NJHDT: E.L. Sh.V. P.V.	KVO: 110/3, 28.08.28 K.I. N.K. M.A.
Lloji i Procedurës së Prokurimit e hapur		
Fondi Limit 32,977,391.26 lekë.	OE fitues: M. & V.K & E.K sh.p.k & N.- G..p.k	Diferenca me fondin limit 1,477,619.26 lekë
Burimi Financimit Buxheti i shtetit	Oferta fituese 31'499'772 lekë	Operatorët Ekonomike - Pjesëmarrës në tender 6 - S'kualifikuar 5
Data e hapjes së tenderit nga 26.09.2022 behet 03.10.2022		
Ankimime: s'ka	Ka monitorim nga APP për DST	ska ankese
Lidhja e Kontratës 160/4, datë 03.11.2022	Vlera e kontratës 37,799,726.4 lekë	Afati 40 ditë Likuiduar: Komplet
Titullari i AK G, L.		

**Fondi limit:** grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit, projekt idesë, termave të referencës, preventivi orientues, afatit të realizimit dhe argumentimi është ngritur me Urdhër të Brendshëm nr. 306/29 prot., datë 27.07.2022 të Administratorit të shoqërisë dhe është i përbërë nga: inxhinierët **P.P., L.J., M.K., M.,B., dhe R.H.**

**Ky grup ka përcaktuar fondin limit në shumën 32,977,391.26 lekë.**

Sipas këtij komisioni fondi limit është përllogaritur bazuar në VKM nr.354, datë 11.05.2016, “Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit”. Fondi limit sipas këtij komisioni është përllogaritur në shumën 31,157,451 lekë.

Ky komision ka hartuar preventivin orientues të projektit, në të cilin ka vënë shënimin: Është orientues; Jep orientimin e masave inxhinierike që duhet të merren; Kontraktori në bazë të të dhënave që do të sigurojë dhe matjeve faktike do të hartojë projektin dhe preventivin final sipas kërkesave të TOR; Grupi i punës nuk mban dhe nuk pranon përgjegjësi për supozimin mbi të cilin është bazuar në hartimin e Project idesë dhe preventivit përkatës.

Në materialin e përgatitur nga ky grup është përcaktuar se:

“Hartimi i **projektit të zbatimit nga kontraktori duhet të përfshijë:**

- 1- Hartimin e projektit dhe preventivit përfundimtar të objektit;
- 2- Punime për ndërtimin e rrugës provizore;
- 3- Preventivin e punimeve, pastrime, punime prishje që do të kryhen me makineri;
- 4- Projekt preventivin, për punimet ;
  - me makineri për devijimin e lumit për të mundësuar kryerjen e punimeve në nën strukturat e urës;
  - gjurmime dhe me makineri në shtratin e lumit;
  - gjurmim dhe me krah në shtratin e lumit pranë nën strukturave;





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

- për ndërtimin e pritës së betonit të shuarësit të energjisë së lumit Shkumbin;
- e mbrojtjes me gabiona, blloqe betoni ose tetraeda, për mbrojtjen e lumit , në drejtim gjatësor të tij;

- e mbrojtjes (këmishimit b/a së ballinave të urës.

➤ Në këtë dokument është përcaktuar se: “Kërkojmë nga njësia e prokurimit dhe strukturat juridike pranë saj të bëjnë verifikimin ligjor të procedurës së ndjekur për hartimin e fondit limit dhe nëse del ndonjë problem të referohet për ndryshimet e nevojshme”, veprim jo në përputhje me kërkesat e VKM nr. 285, datë 19.5.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, nenet:

- **neni 74, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 4, ku është përcaktuar se:**

“4. Në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme, detyrat e mëposhtme kryhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit:

- Hartimi i specifikimeve teknike;
- Përlllogaritja e fondit limit;
- Hartimi i kërkesave për kualifikim, lidhur me kapacitetin teknik;
- Hartimi i kritereve për shpalljen e ofertës fituese, nëse është rasti;
- Përcaktimi i çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si p.sh., grafiku i lëvrimin).

Në rast se detyrat e sipërpërmendura **në këtë pikë nuk janë hartuar nga struktura të posaçme, si më sipër, ato do të kryhen nga njësia e prokurimit për objektin që prokurohet**”.

- **Neni 76, “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, pika 3, ku është përcaktuar se:**

“3. Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

➤ Po në këtë dokument është përcaktuar se: “Vlerat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve do të mbulohen nga ulja në procedurën e prokurimit”.

Sa përcaktuar në lidhje me vlerën e mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të punimeve të cilat sipas grupit të punës së hartimit të fondit limit “do të mbulohen nga ulja në procedurën e prokurimit”, është totalisht e gabuar, pasi:

- fondi limit presupozohet të jetë bërë i saktë, bazuar në manuale dhe analiza teknike çmimesh të mirë mbështetura me fakte, dhe
- ekziston mundësia që OE fitues të jetë afër ose sa fondi limit dhe procedura e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të jetë pa fonde në dispozicion.

Sa më sipër është jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 1, “Përgjegjësia e autoritetit/entit kontraktor., ku është përcaktuar se:

1. Autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike të përcaktuara për përdorim në prokurimet publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik” (në vijim, LPP), të këtyre rregullave, dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik (në vijim, APP), të dala në bazë dhe për zbatim të LPP-së.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

2. Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të planifikojë në cilësi dhe në kohë nevojat e tij e fondet publike respektive dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specifikimet teknike në të cilat ka përcaktuar se: “**Dokumentacioni Teknik.**

OE gjithë materiali i projektit duhet të dorëzohet (ne CD) ne PDF versionet finale dhe ne formatin origjinal të punuar, kompatibel me programet AutoCAD, Word, Exel **brënda 10 ditësh nga data e lidhjes së kontratës dhe i dorëzohet për miratim autoritetit kontraktor.**

Bazuar në llogaritjet edhe vizatimet e projektit, OE **do të hartojë një listë me të gjitha zërat e punimeve që janë pjesë përbërëse e Listës Përfundimtare të Volumeve (Preventivit).** Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe mënyrën e llogaritjes së tyre. Çmimet do të jenë sipas analizave teknike në fuqi. **Zërat e punimeve që nuk janë parashikuar në këtë listë çmimesh njësi të miratuar, konsulenti do t’i shoqërojë me analizën e llogaritjes së çmimit.**

Zbatimi i projektit **nuk mund të tejkaloj periudhën prej 40 ditësh** nga data e njoftimit të fillimit të punimeve. Projekti me të gjitha raportet e kërkuara do të dorëzohet në formë të printuar në 5 (pesë) kopje në shqip të firmosura në origjinal dhe në formatet e kërkuar.

Garancia e punimeve, në vlerën prej 5% të preventivit, do të rikthehet OE fitues 2 vite pas kolaudit të punimeve”. Gjithashtu në specifikimet teknike është kërkuar: “Kontraktori **duhet të deklarojë garancinë e jetëgjatësisë së projektit që do të hartojë dhe të realizojë**” .

**Arsyetimi** për nevojën e prokurimit për “**Riparim vepra arti**”:

- Bën pjesë në korridorin tetë hekurudhor trans evropian;
- Mundëson lidhjen hekurudhore të mallrave dhe të udhëtarëve të jugut të Shqipërisë me pjesën juglindore në drejtim të Elbasanit dhe më tej me pjesët qendrore dhe veriore të Shqipërisë;
- Do të bëjë të mundur rifillimin e trafikut hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve në drejtim të Vlorës;
- Do të rrisë gjatësinë e linjës hekurudhore.

**Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:** Dokumentet e procedurës janë hartuar dhe argumentuar sipas procesverbalit datë 26.08.2022 dhe janë modifikuar sipas shtojcës datë 16.09.22, pas asistencës së APP.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 03.10.22 dhe është vlerësuar me procesverbalin datë 14.10.2022, sa më poshtë vijon:

OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
E.- Al.shpk	32'917'003	<b>S`kualifikuar pasi:</b> -nuk disponon licencë projektimi -mjetet nuk janë deklaruar ne shtojcën 8





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
F.shpk & D. sh.p.k	26'825'828	<b>S`kualifikuar pasi:</b> OE ka paraqitur kontrate për pune publike me nr.4928/2 prot. - 04.02.2021 me objekt “Ndërtim vepra arti ne rrugët rurale dhe komunale” Vlera e kontratës për këtë objekt është 12.176.823 me tvsh -, duhet te ishte minimumi 16.488.695 pa tvsh. OE ka paraqitur kontrate me objekt (Rehabilitimi I Hekurudhës segmenti Fier-Vlore -nuk ka paraqitur aktin e kolaudimit. - nuk është plotësuar deklarata e kërkuar Drejtuesin Teknik të punimeve -Mungojnë Damper kantieri 2 copë; Rul 1 copë; Pompe uji, min Q= 700 m3/h, min H=25m, Filtri i grimcave solide > 70 mm 1 copë; Ekskavator/Vinç krah gjate mbi 30m, aftësi mbajtëse mbi 40 ton, me grejder 1 copë; Ekskavator krah gjate me pinçe prerëse/shkulëse 1 copë (operatori ka deklaruar 1 ekskavator normal me pinca dhe jo krahë gjate siç kërkohet ne DST) Makineri për shkulje palankolash 1 copë
G. shpk	32'739'136	<b>S`kualifikuar pasi:</b> - vlera e xhiros për te paktën ne një nga vitet e periudhës se kërkuar nuk e kalon vlerën e fondit limit . - nuk plotësohet pasi vlera kontratës se ngjashme duhet te ishte minimumi 16.488.695 pa tvsh. -nuk disponon licencat N.P-9 A; N.S.-9 A; N.S.-18 A -nuk disponon licencat e projektimit dhe nuk ka paraqitur B.O.E me nje shoqëri projektuese te licencuar - nuk ka deklaruar asnjë mjet - ka deklaruar 15 punonjës ne formularin e vet deklarimit. - nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës - nuk ka paraqitur asnjë certifikatë iso
M. L.& V. K. E. K. N. – G. sh.p.k	31'499'772	<b>Kualifikuar dhe shpallur fitues</b>
R.C.sh.p.k	32'877'541	<b>S`kualifikuar pasi:</b> OE - nuk disponon licencat e projektimit dhe nuk ka paraqitur B.O.E - me një shoqëri projektuese te licencuar - nuk ka deklaruar numrin e punonjësve -nuk janë deklaruar mjetet e pajisjet teknike - nuk ka paraqitur asnjë certifikatë iso - nuk ka paraqitur pune te ngjashme.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA**

OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
R. G.-K.-sh.p.k	32'933'942	<b>S`kualifikohet pasi:</b> - nuk disponon licencën N.S.-9 A; N.S.-18 A - nuk disponon licencat e projektimit dhe nuk ka paraqitur B.O.E - ka deklaruar 25 punonjës ne formularin e vet deklarimit. - nuk ka deklaruar Inxhinierin Topograf. - nuk ka deklaruar mjetet e kërkuara sipas DST

**Nga auditimi rezultoi se KVO ka vlerësuar sipas kërkesave të DST-ve.**

**Lidhja e kontratës:** Kontrata me numër 160/4, datë 03.11.2022, me objekt “Riparim vepra arti”, me M. & V.K., sh.p.k & E. K., sh.p.k & N. – G., sh.p.k, me vlerë 37,799,726.4 lekë, me afat 45 ditë, me garanci defektesh 2 vjet në masën 5% të kontratës së lidhur.

**18-** Procedura e prokurimit me objekt: “**Rikonstruksion i reparteve dhe linjave hekurudhore të NJ.SH.M.L (Repartet e oficinës Stacioni Hekurudhor Bajzë)**”, me këto të dhëna:

<b>Urdhër Prokurimi</b> Nr. 116, datë 17.08.2022	<b>NJHDT:</b> E.L. L. D. P.V.	<b>KVO:</b> Nr. 116/1, datë 17.08.22 K.I. L.K. B.D.
<b>Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur e thjeshtuar”		
<b>Fondi Limit</b> 10.443.066 lekë.	<b>OE fitues:</b> 2 .shpk	<b>Diferenca me fondin limit 1,224,196</b> lekë
<b>Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit	<b>Oferta fituese</b> 9.218.870 lekë	<b>Operatoret Ekonomike</b> - Pjesëmarrës në tender 6 - S`kualifikuar 4
<b>Data e hapjes së tenderit</b> 23/09/2022		
<b>Ankimime: s`ka</b>	<b>S`ka monitorim nga APP për DST</b>	<b>Përgjigje Ankesës:</b> s`ka ankesë
<b>Lidhja e Kontratës</b> nr.116/5, datë 28.10.2022	<b>Vlera e kontratës</b> 11,062,645 lekë	Afati 45 dite <b>Likuiduar:</b> Komplet
<b>Titullari i AK G. L.</b>		

**Fondi limit:** Komisioni për përlllogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik është ngritur me urdhrin e brendshëm të Administratorit të Shoqërisë, nr. 93/1, datë 15.06.22, dhe është i përbërë nga P.P., M.K. dhe N.K..

Ky komision ka përcaktuar fondin limit (preventivin) në shumën 10,443,006 lekë. Në fund të preventivit citohet se ka zbatuar çmimet në bazë të VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” dhe për FV vinçi në repartin e Bajzës ka testuar tregun me 4 kompani.

➤ Në preventiv rezulton se në 68 çmime në 23 prej tyre që janë me analizë, nuk ka paraqitur analizat e çmimeve të hartuara nga ky grup, veprim jo në përputhje me VKM nr.514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat 8 -14., dhe ngarkon me përgjegjësi ky grup.

➤ Në këtë dokument është përcaktuar se:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

“Kërkojmë nga njësia e prokurimit dhe strukturat juridike pranë saj të bëjnë verifikimin ligjor të procedurës së ndjekur për hartimin e fondit limit dhe nëse del ndonjë problem të referohet për ndryshimet e nevojshme”, veprim jo në përputhje me kërkesat e VKM nr. 285, datë 19.5.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, nenet:

- neni 74, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 4, ku është përcaktuar se:

“4. Në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme, detyrat e mëposhtme kryhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit:

- Hartimi i specifikimeve teknike;
- Përlllogaritja e fondit limit;
- Hartimi i kërkesave për kualifikim, lidhur me kapacitetin teknik;
- Hartimi i kritereve për shpalljen e ofertës fituese, nëse është rasti;
- Përcaktimi i çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si p.sh., grafiku i lëvrimit).

Në rast se detyrat e sipërpërmendura **në këtë pikë nuk janë hartuar nga struktura të posaçme, si më sipër, ato do të kryhen nga njësia e prokurimit për objektin që prokurohet**”.

- Neni 76, “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, pika 3, ku është përcaktuar se: “3. Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. **Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.**”

➤ Po në këtë dokument është përcaktuar se: “Vlerat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve do të mbulohen nga ulja në procedurën e prokurimit”.

Sa përcaktuar në lidhje me vlerën e mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të punimeve të cilat sipas grupit të punës së hartimit të fondit limit “do të mbulohen nga ulja në procedurën e prokurimit”, është totalisht e gabuar, pasi:

- fondi limit presupozohet të jetë bërë i saktë, bazuar në manuale dhe analiza teknike çmimesh të mirë mbështetura me fakte, dhe
- ekziston mundësia që OE fitues të jetë afër ose sa fondi limit dhe procedura e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të jetë pa fonde në dispozicion.

Sa më sipër është jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, ndryshuar, neni 1, “Përgjegjësia e autoritetit/entit kontraktor.

**Specifikimet teknike:** Ky komision ka hartuar specifikimet teknike dhe projektet. Nga auditimi rezulton se projektet nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat përgjegjës për realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Grupi i projektimit duhet jetë i përberë minimumi nga: inxhinieri gjeodet për plan rilevimin dhe azhurnimin topografik, projektuesi arkitekt, projektuesi konstruktor, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi i instalimeve hidro sanitare, projektuesi i instalimeve ngrohje ftohje ventilim, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri, inxhinieri sizmolog, inxhinieri gjeolog, eksperti mjedisor.

Për veprimet e mësipërme, që bien jo në përputhje me VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrorjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

zbatimit në ndërtim”, e cila ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, neni 16 “Licenca – kategoritë e punimeve”, pika 1.

**Arsyetimi për nevojën e prokurimit për “Rikonstruksion i reparteve dhe linjave të NJSHML”:** Nga ana e komisionit nuk ka dokument **ku të jepet** arsyetimi i nevojës së prokurimit, veprim jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 2, “Dokumentimi i procesit”, pika 2.

**Hartimi dokumenteve të procedurës së prokurimit:** Dokumentet e procedurës janë hartuar sipas procesverbalit datë 09.08.2022.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 23.09.2022, vlerësimi me procesverbalet datë 30.09.2022, sa më poshtë vijon:

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	N. shpk	8.155.221	<b>S`kualifikuar pasi:</b> Për punonjësit e kërkuar duhet të paraqitet dokumenti që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional; certifikatë; apo diplomë) të lëshuara nga institucione të njohura apo të akredituara nga shteti për formimin profesional sipas ligjit nr 15/2017. Për 2 punonjës suvatues (Z.Nd. dhe G. B.) 2 punonjës bojaxhi (H. M. dhe G. Q) janë paraqitur certifikata pjesëmarrje nga kompania R. Sh.p.k . Kjo kompani është e njohur nga shërbimi kombëtar i punësimit por nuk është akredituar sipas rregullave të përcaktuara në ligjin 15-2017 ashtu siç kërkohet në pikën e sipërcituar.
2	F.shpk & A. shpk	9.105.781,95	<b>S`kualifikuar pasi:</b> Sipas marrëveshje së lidhur ndërmjet F. shpk dhe A. shpk me date 22.09.2022 pjesëmarrja do të jetë 22 % te punimeve F. dhe 78 % te punimeve A.. Te gjitha punimet e sistemit elektrik do te kryhen nga A. Shpk referuar akt marrëveshjes se sipërcituar. Sa me sipër operatori nuk përmbush kërkesën e sipërcituar pasi kjo kompani nuk disponon licencën NS14 –A impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni Tv.
3	2.shpk	9.218.870	Kualifikuar dhe shpallur fitues
4	Z.	9.428.324	Kualifikuar
5	S.shpk	9.473.070	<b>S`kualifikuar pasi:</b> Operatori ekonomik në vetë deklarinimin e sjellë nuk ka deklaruar asnjë punonjës për punime në lartësi. Subjekti nuk ka deklaruar asnjë makineri Kamionçinë kapaciteti mbajtës minimum 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton.
6	Rr.G.	0	<b>S`kualifikuar pasi:</b> S`ka paraqitur ofertë

**Vlerësimi i ofertave:** Nga auditimi i dokumentacionit KVO ka vlerësuar sipas kriterëve të DST. **Kontrata** me nr.116/5, datë 28.10.2022, e lidhur me OE “2N” shpk, është më vlerë 11,062,645 lekë dhe me afat 45 ditë kalendarike nga data e dhënies së lejes së sheshit të ndërtimit.

- **Mbi zbatimin e ligjshmërisë në ankandet publike**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

**“Për procedurën e Ankandit të anuluar në vitin 2020”, me objekt shitje “Vagonë malli dhe udhëtari, automjete, shina etj.”, me masën 2,141,494 kg, me vlerë fillestare 37,476,145 lekë.** “Hekurudha Shqiptare” sha, ka ndërmarr në vitin 2020 hapat e nevojshëm procedurale për zhvillimin e Ankandit, që rezultoi në një procedurë e përsëritur. Pasi janë ezauruar të gjitha hapat e nevojshme për finalizimin e kësaj procedure, dhe është marrë miratimi i ministrit pronar për raportin e përgatitur nga ekspertët për vlerësimin e aseteve të listuar bashkëlidhur shkresës nr. 227/1, datë 27.02.2020.

Për nxjerrjen e aseteve jashtë përdorimit është bazuar në *Udhëzim nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* si dhe miratimi në Parim të nxjerrjes jashtë përdorimit të këtyre aseteve nga ana e Administratorit të Shoqërisë, sipas Vendimit nr. 6, datë 25.10.2019. Një vendim për miratim në parim është marrë dhe nga Këshilli Mbikëqyrës, me nr. 15, datë 13.11.2019. Pasi është ezauruar niveli hierarkik Vendimmarrës, Ministri pronar ka miratuar procedurën për nxjerrjen jashtë përdorimit të aseteve, sipas listës së përgatitur dhe miratuar më parë nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë. Vlera e mbetur e aseteve prej 354,107,837 lekë ka kaluar në rezultat.

Të dhënat mbi këtë ankand janë:

Njoftimi i ankandit	Nr. 227/3 prot, datë 28.04.2020
Data e zhvillimit të ankandit	01.06.2020
Objekt ankandit	shitje “Vagonë malli dhe udhëtari, automjete, shina etj”
Sasia për tu shitur	2,141,494 kg
Vlera fillestare	37,476,145 lekë
Shpallja e ankandit	Buletinin e APP, me nr. 26, datë 11.05 2020
Urdhër Ankandi	Nr. 227/4 prot., datë 28.04.2020
Njësia e Ankandit	L.D., kryetare, anëtarë Sh. Xh ., A. G.
Proçes- verbali i hapjes së ankandit	Datë 01.06.2020
Operatorët pjesëmarrës	Sh. shpk, C. M. shpk, R. sha,
Faza e dytë	Datë 10.06.2020

Operatorët ekonomik, kanë paraqitur kërkesën për t’u pajisur me dokumentacionin standart, dhe në raste të caktuara kjo kërkesë ka bashkëlidhur autorizimin, kur për tërheqjen e dokumentacioneve standarde është një person i autorizuar.

Në fazën e dytë të ankandit datë 10.06.2020, Njësia e Ankandit ka kualifikuar të gjithë operatorët pjesëmarrës.

Me datë 10.06.2020, ora 10:00, është mbajtur procesverbali për vijimin e fazës së dytë të procedurës ankand i hapur me objekt: “Shitje skrapit hekurudhor”. Njësia e Ankandit i ka komunikuar operatorëve kualifikimin e tyre në këtë fazë. Ky vendim është kundërshtuar nga dy operator. Procedura është pezulluar me Vendim nr.227/7 prot., datë 12.06.2020, për shkak të ankimit të operatorëve.

Në referim të ankesave që u paraqiten nga operatorët “C.” shpk dhe “R.” sh.a, është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të ankesave me Urdhër nr.85, datë 12.06.2020 dhe është pezulluar procedura e ankandit sipas Vendimit e Administratorit të Shoqërisë nr. 227/7 prot., datë 12.06.2020, “Për pezullimin e procedurës së ankandit”.

Komisioni pas shqyrtimit të ankesave ka dale me Vendim duke mos pranuar ankesat. Kthim përgjigje ankimesve është bërë me shkresën nr. 227/9 prot., datë 17.06.2020.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Nga ana e AK është marrë vendim “Për heqjen e masës së pezullimit të procedurës së ankandit”. Operatori “C.” shpk, ka vijuar ankimim në KPP, datë 24.06.2020.

KPP pas shqyrtimit të ankesës ka dalë me Vendim nr.222/2020 për mospranimi të ankesës.

Kjo procedurë është rihapur dhe operatori “R.” sha që kishte paraqitur ofertën më të lartë është shpallur fitues, me ofertë 63,696,601 lekë.

Në zbatim të procedurës është plotësuar Formulari i Njoftimit të Fituesit, me nr. 227/13 prot., datë 06.07.2020.

Kontrata nuk është lidhur për shkak të kërkesë së paraqitur nga fituesi, me objekt: “Tërheqje nga nënshkrimi i kontratës me objekt shitje skrapu hekurudhor”, kërkesë kjo që mban nr.272 prot, dt.29.07.2020, me arsyetimin se: “për shkak të vështirësive të konsiderueshme ekonomike dhe financiare, që kanë rënduar ndjeshëm, aftësinë paguese, duke e pamundësuar vijimin e procedurave të mëtejshme të ankandit dhe finalizimin e kontratës së shitjes”.

Marr shkas nga sa kishte parashtruar operatori fitues i kësaj procedure Ankandi është anuluar, sipas Vendimit me nr. 227/11 prot., datë 10.08.2020.

Ky ankand është ripërsëritur.

#### **“Për procedurën e Ankandit të zhvilluar në vitin 2020”**

Është ndjekur procedura për vlerësimin e aseteve për nxjerrjen jashtë përdorimi, në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe miratimi në parim të nxjerrjes jashtë përdorimi të këtyre aseteve nga ana e Administratorit të Shoqërisë me Vendimin nr. 6, datë 25.10.2019. Gjithashtu vendim për miratimin në parim është marrë dhe nga Këshilli Mbikëqyrës, me nr. 15, datë 13.11.2019.

Ministri pronar MFE, ka miratuar procedurën për nxjerrjen jashtë përdorimi të aseteve, sipas listës së përgatitur dhe miratuar më parë nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë. Pas miratimit të procedurës së ndjekur, nga ana e Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, është kryer vlerësimi i aseteve dhe përcaktimi i çmimit të skrapit për materialet e dala nga përdorimi. Ky raport është dërguar për miratim në MFE dhe është miratuar. Vlera e mbetur e aseteve prej 354,107,837 lekë të kalojë në rezultat.

Me datën 24.04.2020, me shkresën nr. 4445/1 Prot, është miratuar raporti i vlerësimit për nxjerrjen nga përdorimi, në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008, “Për ankandin publik” dhe VKM nr. 1719 datë 14.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, për listën e aseteve të pasqyruara në shkresën nr. 227/1, datë 27.02.2020.

Sasia e miratuar pas raportit të vlerësimit të këtyre aseteve ishte 2,141,494 kg, me 17.5 çmimi/kg, me një vlerë totale të përlogaritur 37,476,145 lekë.

Të dhënat mbi këtë ankand janë:

Njoftimi i ankandit	Nr. 227/15 prot, datë 17.08.2020
Data e zhvillimit të ankandit	01.09.2020
Objekt ankandit	shitje “Vagonë malli dhe udhëtari, automjete, shina etj”
Sasia për tu shitur	2,141,494 kg
Vlera fillestare	37.476.145 lekë
Shpallja e ankandit	Buletinin e APP, me nr. 59, datë 24.08 2020
Urdhër Ankandi	Nr. 227/4 prot., datë 28.04.2020
Njësia e Ankandit	L. D., kryetare, anëtarë Sh. Xh., A.G.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Proces- verbali i hapjes së ankandit	datë 24.08.2023
Operatorët pjesëmarrës	Sh.shpk, C. M. shpk, R.” sha,
Faza e dytë	18.09.2020
Shpallur fitues	“Sh.” sh.p.k
Vlera fituese	55.042.000 lekë
Komisioni i evadimit të skrapit	E.J., K.H., R. D.,

Në fazën e dytë të ankandit datë 18.09.2020, që lidhet në fakt dhe me rritjen me një hap të operatorëve ofertues, hap i cili ishte në masën e 2% të vlerës. Në këtë fazë, operatorët “R., ” sha dhe “Ç.M.,” shpk, janë tërhequr nga dhënia e ofertës. Oferta e “Sh.” sh.p.k, me vlerën e 55.042.000 lekë, është shpallur oferta fituese.

Në vijim të procedurës Njësia e Ankandit me datën 24.09.2020, në mbështetje të Urdhrit të Ankandit Nr. 227/ 4 datë 28.04.2020, ka raportuar mbi procedurën e ndjekur.

Njoftimi i fituesit është shpallur në faqen e Buletinit e APP, duke i dhënë fituesit afatin 10 ditor për lidhjen e kontratës. Pas lidhjes së kontratës, janë arkëtuar në favor të HSH sha, vlera e dalë fituese dhe pas kësaj, ka nisur evadimi i skrapit në zbatim të kontratës.

Me Urdhrin e Brendshëm, nr. 144 prot, datë 19.10.2020, është ngritur Komisioni për tërheqjen e skrapit. Komisioni ka ndjekur të gjithë procedurën e evadimit të skrapit, pas nënshkrimit të kontratës, duke përfshirë fletë - peshimet, proces - verbalet për demolimin e një aktivi të caktuar deri në aktivin e fundit, dhe në fund në zbatim të kontratës është bërë dhe rakordimi i diferencave. Evadimi është bërë sipas një grafiku të dakortësuar e të nënshkruar nga të dyja palët. Tërheqja e skrapit ka nisur me datën 15.01.2021, sipas Njoftimit të Komisionit me nr. 144, datë 14.11.2021. Për shkak të kushteve të vështira atmosferike, afati i evadimit të skrapit është kërkuar të shtyhet, por që është përmbjllur brenda afateve të dakortësuar mes palëve.


#### ***“Për procedurën e Ankandit të zhvilluar në vitin 2022”***

“Hekurudha Shqiptare” sha, në vitin 2022, me datë 31.10.2022, në zbatim të ligjit nr.9874, datë 14.02.2008, “Për ankandet” dhe VKM nr.1719, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” ka ndërmarrë hapat për zhvillimin e procedurës për Ankandin e hapur të “Shitjes së Skrapit Hekurudhor”.

Është ndjekur procedura për vlerësimin e aseteve dhe për nxjerrjen jashtë përdorimi të tyre, në përputhje me UMF nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”.

Asetet e vlerësuar të cilat janë nxjerr jashtë përdorimi nga komisionet e ngritura përkatësisht sipas objektit të ngritjes së tyre, janë miratuar në parim për nxjerrjen jashtë përdorimi, me Vendimin nr.4 datë 09.12.2021 dhe Vendimin nr.5, datë 28.12.2021, të Administratorit të Shoqërisë. Në referim të kompetencave të Këshillit Mbikëqyrës, dhe nivelit hierarkik vendimmarrës, Vendimet e Administratorit të Shoqërisë, të shoqëruara me relacionin përkatës, janë dërguar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë.

Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin nr.5, datë 27.05.2022, ka miratuar në parim nxjerrjen jashtë përdorimi të 70 vagonë malli, 3 lokomotiva, makineri e pajisje, mjete transporti, linja të dyta dhe të treta të Njesisë Biznesit Mallit, Njesisë Shërbimeve Mjeteve Lëvizëse, Njesisë Biznesit Menaxhimit Infrastruktural Hekurudhore.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Pas miratimit të procedurës së ndjekur, Ministria Financave dhe Ekonomisë, ka miratuar dhe raportin e vlerësimit të aseteve të HSH sha, në mbështetje të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2020, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit”, ligjit nr.25, datë 10.05.2018, “Për kontabilitet dhe pasqyra financiare”, UMF nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1719, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”. Sasia e miratuar e këtyre aseteve është 1,499,090 kg, me 19.5 çmimi për kg, me një vlerë totale të përlogaritur 29,232,255 lekë.

Në datë 29.09.2022, më shkresën nr.959 prot., në zbatim të ligjit nr.9874, datë 14.02.2008, “Për ankandet” dhe VKM nr.1719, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, është nxjerrë Urdhër Ankandi me nr. 959 prot, datë 29.09.2022, me objekt; “Vagonë malli, lokomotiva, automjete, shina, vinça, etj.”, me peshë 1,706,476 kg dhe me vlerë fillestare 33,276,282. Kjo vlerë është përlogaritur duke marrë në konsideratë edhe aktive të tjera të cilat nuk kanë nevojë të miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe nga Ministria e Financave e Ekonomisë (mallra konsumi), e si rrjedhim nuk është përfshirë në raportin e vlerësimit të miratuar nga ministri pronar.

Të dhënat mbi këtë ankand janë:

Njoftimi i ankandit	Nr. 959 prot., datë 27.09.2022
Data e zhvillimit të ankandit	31.10.2022, ndryshuar pas ankimit në datë 07.11.2022
Objekt ankandit	shitje “Vagonë malli, lokomotiva, automjete, shina, vinça, etj.”
Sasia për tu shitur	1,706,476 kg
Vlera fillestare	33,276,282 lekë
Shpallja e ankandit	Buletin e APP, me nr. 139, datë 10.10.2020
Urdhër Ankandi	Nr. 959 Prot, datë 29.09.2022
Njësia e Ankandit	L.D., kryetare, anëtarë Sh.Xh., e A.G.
Proces- verbali i hapjes së ankandit	datë 07.11.2022
Operatorët pjesëmarrës	“Sh.” shpk, Fushë Krujë, , me ofertë 33,276,282 lekë. “C. M.” shpk, me ofertë 33,650,000 lekë. BOE “S.” shpk & “R.” sha, NIPT , me ofertë 33,276,282 lekë.
Faza e dytë	23.11.2022
Shpallur fitues	“Sh.” sh.p.k.
Vlera fituese	33,650,000 lekë
Komisioni i evadimit të skrapit	S.P., K.H., R.D.

Në referim të njoftimit të bërë, me datë 03.10.2022, ankandi ishte parashikuar të zhvillohej me datë 31.10.2022. Për shkak të ankimit të bërë në lidhje me kriteret e kualifikimit nga “Sh.” sh.p.k, në propocion me ligjin, është pezulluar procedura e ankandit me Vendimin nr. 959/6, prot., datë 18.10.2022. Në datë 18.10.2022, me shkresën nr.959/9 prot., është njoftuar pezullimi i ankandit për shkak të ankimit mbi kriteret e kualifikimi.

Për sa më lartë, bazuar në ligjin nr.9874, datë 14.02.2008, “Për ankandin publik”, i ndryshuar, në VKM nr.1719, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar si dhe në dokumentet standarde të ankandit publik, operatorët janë njoftuar se ky ankand do të zhvillohet me datë 07.11.2022.

Me Urdhrin nr.135, datë 18.10.2022, është ngritur komisioni për kthimin e përgjigjes. Komisioni sipas proces-verbalit të datës 18.10.2022 ka bërë pranimin e pjesshëm të ankimit, pasi konstatoi se ankimi i subjektit qëndron. Ankesa lidhet me kërkesën që të vendosej vetëm licenca III.2.B, e





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit dhe të hiqet kriteri i kërkuar në pikën 2.3.1/ a dhe 2.3.1/b. Gjithashtu Komisioni vendosi të hiqet kërkesa për mjete të tonazhit me kapacitet 35 ton dhe të lihen mjete transporti me sponde metalike. Përsa i përket ankesës për vënien në staf të një inxhinieri mekanik, ka mbetur e pandryshuar, për vetë procesin e administrimit të skrapit.

Me datën 27.10.2022 “Rafaelo 2002” sha ka paraqitur kërkesën me nr.83 prot., datë 27.10.2022, e cilës lidhet me rishikimin dhe sqarimin e kriterëve të veçanta kualifikuese të ankandit. Kjo kërkesë është shqyrtuar dhe i është kthyer përgjigje me nr. 959/19 prot., datë 01.11.2022, u sqarua Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për Licensën III.2.B, të konsideruar si të mjaftueshme për t’u kualifikuar dhe në rast se shpallej fitues, si të mjaftueshme për realizimin e objektit të Ankandit.

Faza e parë e ankandit u mbajt në datë 07.11.2022. Anëtarët e Njesisë së Ankandit dhe pjesëmarrësit në ankand kanë nënshkruar deklaratën përkatëse për mospasje konflikt interesi, deklaratë kjo e nënshkruar edhe nga ofertuesit.

Në orën dhe datën e caktuar për zhvillimin e Ankandit u paraqitën tre ofertues, këto ishin:

“Sh.” shpk, Fushë Krujë, me ofertë 33,276,282 lekë.

“C.” shpk, me ofertë 33,650,000 lekë.

Bashkimi i Shoqërive “S.” shpk dhe Shoqëria “R.” sha me ofertë 33,276,282 lekë.

Në këtë fazën e dytë janë paraqitur:

- “Sh.” shpk, Fushë Krujë, me ofertë 33,276,282 lekë.
- “C.” shpk, me ofertë 33,650,000 lekë.
- BOE “S.” shpk & “R.” sha, me ofertë 33,276,282 lekë.

Komisioni ka konstatuar se dokumentacioni i paraqitur nga BOE “S.” shpk & “R. 2002” sha, me ofertë 33,276,282 lekë, nuk plotëson kriteret për shkaqet e mëposhtme:

1. Mosparaqitja e lejes mjedisore të tipit III.2.B, nga operatori ekonomik “R. 2002”, por vetëm nga operatori tjetër, në kundërshtim me kriteret e kualifikimit,
2. Mosparaqitja e kontratës të ngjashme me objektin e ankandit sipas konstatimeve nga komisioni.

Kryetari i Njesisë së Ankandit ka njoftuar pezullimin e ankandit për t’i dhënë afatin ligjor ofertuesit të s’kualifikuar për të bërë ankimin e tij.

Pas mbarimit të afateve ligjore për ankimin dhe kthimin e përgjigjes së ankimit, është hapur faza e dytë e ankandit, me datë 23.11.2022, ku kanë marrë pjesë vetëm dy ofertues shoqëria “C. M.” sh.p.k dhe “Sh.” sh.p.k.

Ankandi është hapur duke u nisur nga vlera më e lartë e ofruar nga Shoqëria “C.” sh.p.k, prej 33,650.000 lekë dhe duke përdorur hapin 2% të kësaj vlere e barabartë në shumën 673,000, ndërsa Shoqëria “Sh.” sh.p.k., në momentin e dhënies së ofertës së saj është tërhequr nga gara. Në këtë mënyrë Njësia e Ankandit ka identifikuar ofertën më të lartë të paraqitur nga ofertuesi “Ç.” shpk, në vlerë 33,650,000, ofertë e cila është shpallur fituese.

Njoftimi i fituesit është shpallur në Buletinin e APP, nr. 167, datë 05.12.2022.

Komisionit i Evadimit të Skrapit, është ngritur sipas Urdhrit të Brendshëm Nr. 959/30 Prot, me datë 15.12.2022. Në të njëjtën datë është nënshkruar dhe kontrata e Shit- Blerjes, e cila është protokolluar me nr. 959/12 mes Autoritetit shitës dhe operatorit ofertues fitues i Ankandit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

#### **Mbi zbatimin e kontratave të lidhura nga AK HSH SHA.**

Për auditimin e kësaj pike të Programit të Auditimit, Grupi i auditimit është bazuar në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjin për “Prokurimin Publik”, VKM mbi “Miratimin e rregullave për prokurimin publik”, ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe ligjeve/rregullave specifike të institucionit që auditohet.

Nga auditimi rezultoi:

#### **1. Mbi realizimin e kontratës me objekt “Punime për mbrojtjen e linjës”.**

-Kontrata midis BOE “E.,&B.,” SHPK & “V.-E.,” SHPK dhe HSH SHA, është me nr. 984/2 Prot., datë 18.11.2019 dhe objekt “Punime për mbrojtjen e linjës”. Është me afat 90 ditë kalendarike nga dita e dhënies së lejes së sheshit të ndërtimit nga AK, sipas nenit 4 “Kryerja e punimeve dhe punimet e padukshme” të kontratës së mësipërme me nr. 984/2 Prot., datë 18.11.2019. Vlera e plotë e kontratës është 21,338,017 lekë me TVSH. Përfaqësuesi i AK për ndjekjen e zbatimit të kontratës, është Njësia e Biznesit dhe Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, Durrës, sipas nenit 2 të kontratës së punimeve “Komunikimi dhe përfaqësimi”.

-Kontrata midis Mbikëqyrësit të punimeve “THC” shpk & “HMKC” shpk, me nr. License MK.2720/5 dhe HSH SHA, është me nr. 984/3 Prot., datë 18.11.2019.

-Njoftimi për fillimin e punimeve është me nr. 984/6 Prot., datë 20.11.2019 (Datë fillimi punimesh, data 19.11.2019) dhe i nënshkruar nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi i punimeve. (Nr.10 në inventarin e dosjes teknike)

-Akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, është mbajtur në datën 19.11.2019 dhe nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe Njësia e Biznesit dhe Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, Durrës, përfaqësuar nga D.M. Nga të njëjtët përfaqësues është nënshkruar edhe procesverbali mbi fillimin e punimeve, i cili ka datën 19.11.2019.

-Akti i piketimit të objektit, është mbajtur me procesverbalin e datës 19.11.2019 dhe është nënshkruar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi.

-Sa më sipër, punimet kanë filluar në datën 19.11.2019 dhe përfundojnë pas 90 ditësh kalendarike sipas nenit 4 “Kryerja e punimeve”, i kontratës së lidhur midis HSH SHA dhe sipërmarrësit dhe data e përfundimit të tyre (pas 90 ditësh) është data 16.02.2020.

-Me shkresën nr. 984/14 Prot., datë 20.02.2020, është nënshkruar amendamenti i kontratës bazë i cili zgjat afatin e ekzekutimit të punimeve deri në datën 23.03.2020.

-Me shkresën nr. 583/27 Prot., datë 03.03.2020, “E.B” SHPK, njofton HSH SHA mbi problematikat me pronësinë e banorëve në segmentin Vorë- Budull.

-Me shkresën me datë 07.04.2020, BOE “E.B” SHPK & “V-E” SHPK, njofton HSH SHA, për shtyrje të afatit të punimeve për shkak të pandemisë COVID-19. Nga dokumentacioni në dosjen teknike, rezulton se BOE “E.B” SHPK & “V-E” SHPK, ka aplikuar për leje për lëvizje në portalin e-Albania, në datën 31 Mars 2020 pas daljes së urdhrit me nr.1434 Prot., datë 12.03.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë për kufizimin e lëvizjeve të mjeteve të transportit. Konfirmimi për lëvizje nga Policia e Shtetit, është miratuar në datën 06.04.2020.

-Njoftimi për përfundimin e punimeve, mban datën 17.04.2020 dhe njëkohësisht dita e fundit e punimeve sipas ditarit të punimeve është data 17.04.2020.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

-Sa më sipër, BOE “E. B” SHPK & “V-E” SHPK, kanë aplikuar për leje pas mbarimit të afatit të kontratës shtesë. Pas datës 23.03.2020, datë në të cilën përfundon kontrata shtesë, punimet kanë vazhduar pa një kontratë e si të tilla, zërat e punimeve të kryera jashtë afateve ligjore janë zëra punimesh të kryera me vonesë nga BOE “E. B” SHPK & “V-E” SHPK. Sipas ditarit të objektit të ndodhur në dosjen teknike, zërat e punimeve të kryera jashtë afateve ligjore, pasqyrohen në ditar nga data 07.04.2020 deri në datën 17.04.2020 dhe përfshijnë punimet e kryera në segmentin Lushnje – Fier km 75 + 0.50, si në tabelën më poshtë:

Nr.	An	Përshkrimi	Njësia	sasia	Çmimi	Vlera
5	NH	Furnizim traversa druri normale	m3	16.224	62.500	1,014,000
6	474/477	Montim linje hekurudhore	MI	50	742	37.100
7	491	Ngritje e linjës me traversa druri, ballast cakulli	MI	50	400	20.000
8	493	Drejtim përfundimtar i linjës	MI	50	250	12.500
Totali						1,083,600
TVSH						216,720
<b>Totali me TVSH</b>						<b>1,300,320</b>

-Si rezultat, vlera e punimeve të kryera pas afatit të përfundimit të kontratës në periudhën 06.04.2020 deri 17.04.2020 (12 ditë vonesë), është 1,300,320 lekë. Në këto kushte, Njësia e Biznesit e Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore Durrës, e ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës sipas nenit 2, “Komunikimi dhe përfaqësimi”, pika 2.5 e saj, duhej të njoftonte HSH SHA për vonesa në kryerje të punimeve duke u aplikuar në vazhdim, neni 7, “Dëmshpërblimet për vonesat”, i kontratës më nr. 984/2 Prot., datë 18.11.2020, pika 7.1 ku cilësohet se: “Kontraktori do ti paguajë për çdo ditë vonesë, Autoritetit Kontraktor dëmshpërblimet prej 4/1000 pjesë së vlerës së kontratës së pa zbatuar.....”.

-Sa më sipër, vlera e penalitetit që i duhej mbajtur BOE “E. B SHPK & “V-E” SHPK, për 12 ditë vonesë kryerje punimesh në vlerën e 1,300,320 lekë, është:  $4/1000 * 12 * 1,300,320 = 62415.36$  lekë.

-Nga auditimi në terren, i punimeve të kryera edhe pse në fakt mungonin gurët kilometrikë dhe punimet janë kryer në shumicën e tyre në segmente të shkurtra pra nga 30ml deri 60ml të shkëputura dhe jo në vazhdimësi nga njëri tjetri, grupi i auditimit në prezencë të përfaqësuesit të HSH SHA, konstatoi diferenca paraprake në zëra punimesh si në tabelën në vijim:

Theksohet fakti se nuk u paraqit Mbikëqyrësi i punimeve për saktësimin e kilometrave të linjës hekurudhore në terren edhe pse grupi i auditimit i kërkoi disa herë HSH SHA, që të njoftonte mbikëqyrësin e punimeve.

Nr.	An	Emërtimi i Objektit	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera
Ndërtim muri (Usek) km 74 +850 – km 75+000, L=46 ml perigoni Lushnje-Fier						
5	An-9	Mbushje me zhavorr mbrapa murit	m3	79.33	1300	103,129
Ndërtim muri (Usek) km 75 +700, L=65 ml perigoni Lushnje-Fier						
5	An-9	Mbushje me zhavorr mbrapa murit	m3	104	1300	135,200
Totali						238.329
TVSH						47665.8
<b>Totali me TVSH</b>						<b>285,994.8</b>

-Punime për mbrojtjen e linjës Zhame km 40+050 perigoni Rrogozhinë-Lushnje.

-Ndërtim muri (Usek) km 74 +850 – km 75+000, L=46 ml perigoni Lushnje-Fier. Nga auditimi në terren i këtij segmenti linje, u konstatua se nuk kishte zhavorr të hedhur pas murit.

-Ndërtim muri (Usek) km 75 +700, L=65 ml perigoni Lushnje-Fier. Nga auditimi në terren i këtij segmenti, nuk u konstatua të jetë hedhur zhavorr pas murit të betonit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Sa më sipër, vlera në total e punimeve të pakryera është 285,994.8 lekë. Kjo vlerë është efekt financiar në dëm të buxhetit të shtetit.

-Nga auditimi i punimeve të kryera, jo vetëm për rastin e mësipërm por edhe për rikonstruksionin e linjave të ndryshme hekurudhore, në shumicën e rasteve, u konstatuan mangësi jo vetëm lidhur me mungesën e theksuar të gurëve kilometrikë por edhe me mungesën e theksuar të sinjalistikës hekurudhore si ajo që nevojitet për makinistët e trenave por edhe sinjalistika e domosdoshme për këmbësorët ose automjetet që kalojnë kryqëzimet hekurudhore.

Njësia e Biznesit e Menaxhimit Të Infrastrukturës Hekurudhore, N/Njësia e Mirëmbajtjes së Linjave Hekurudhore, N/Njësia rajonale e mirëmbajtjes së linjave dhe Kontrollori i Linjës në N/Njësinë Rajonale të Mirëmbajtjes, nuk kanë marrë asnjë masë për saktësimin e gjatësive kilometrike të linjave hekurudhore Shqiptare duke vështirësuar kryerjen e verifikimeve lidhur me investimet e deklaruara për çdo km nëpër dokumentacionin përkatës por që nuk mund të evidentohen këto km në terren për shkak të mungesës së sinjalistikës hekurudhore si ajo e saktësimin të gjatësive kilometrikë hekurudhor por edhe ajo e sigurisë hekurudhore që pothuajse nuk ekziston dhe që duhet riparuar nga Njësia Teknike dhe e Sigurisë, Sektori i Sinjalizimit & Telekomunikacionit Hekurudhor.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	<b>Zëra punimesh të kryera me vonesë jashtë afatit të kontratës.</b>
<b>Situata:</b>	-Nga auditimi i kontratës së lidhur me objekt “Punime për mbrojtjen e linjës”, midis BOE “E. B.” SHPK & “V-E” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 984/2 prot., datë 18.11.2019, me afat 90 ditë kalendarike nga dita e dhënies së lejes së sheshit të ndërtimit, me vlerë 21,338,017 lekë me TVSH, rezultoi se kontraktori “E.B” SHPK & “V-E” SHPK, ka aplikuar për leje për lëvizje në portalin e-Albania, në datën 31 mars 2020, pas daljes së Urdhrit nr.1434 prot., datë 12.03.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për kufizimin e lëvizjeve të mjeteve të transportit, aplikim pas mbarimit të afatit të kontratës shtesë, 23.03.2020. Punimet kanë vazhduar pa një kontratë e si të tilla, zërat e punimeve të kryera jashtë afateve ligjore, janë zëra punimesh të kryera me vonesë nga kontraktori. Sipas ditarit të objektit zërat e punimeve të kryera jashtë afateve ligjore, janë nga data 07.04.2020 - 17.04.2020 dhe përfshijnë punimet e kryera në segmentin Lushnje – Fier km 75 + 0.50. Vlera e zërave të punimeve, të kryera jashtë afatit të përfundimit të kontratës (12 ditë vonesë), është 1,300,320 lekë. Në këto kushte, Njësia e Biznesit e Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore Durrës, e ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës sipas nenit 2, “Komunikimi dhe përfaqësimi”, pika 2.5 e saj, duhej të njoftonte HSH SHA, për vonesa në kryerje të punimeve, duke u aplikuar në vazhdim, neni 7, “Dëmshpërblimet për vonesat”, i kontratës me nr. 984/2 Prot., datë 18.11.2020, pika 7.1, për 12 ditë vonesë kryerje punimesh me vlerë 1,300,320 lekë, është: $4/1000 * 12 * 1,300,320 = 62,415$ lekë.
<b>Kriteri:</b>	Kontrata me nr.984/2 Prot., datë 18.11.2019, neni 7 “Dëmshpërblimet për



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

	vonesat”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Ekzekutimi i punimeve jashtë afateve të përcaktuara.
<b>Shkaku:</b>	Mos respektimi i nenit 7 “Dëmshtëpërblimet për vonesat” i kontratës nr.984/2 Prot., datë 18.11.2019.
<b>Rëndësia:</b>	E Mesme
<b>Rekomandim:</b>	Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 62,415 lekë, nga kontraktori “E.B” SHPK & “V-E” SHPK, si vlerë që i përket penaltetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 984/2 prot., datë 18.11.2019.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	<b>Zëra punimesh të pa kryera.</b>
<b>Situata:</b>	-Nga auditimi në terren lidhur me punimet e kryera, u konstatua se jo në përputhje me kontratën e lidhur, nuk është ekzekutuar zëri nr.5, An-9, “Mbushje me zhavorr mbrapa murit”, me vlerë 285,994.8 lekë me TVSH, për segmentin hekurudhor Rrogozhinë-Lushnje, km 74+850 deri km 75+000 dhe km 75+700 deri 75+765, me vlerë të punimeve të pa kryera në shumën <b>285,995 lekë.</b>
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mangësi në kryerjen me cilësi të punimeve me pasojë dëm ekonomik.
<b>Shkaku:</b>	Mos pasqyrimi me korrektësi i volumeve të kryera.
<b>Rëndësia:</b>	E Mesme
<b>Rekomandim:</b>	Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 285,995 lekë, nga kontraktori “E.B” SHPK & “V-E” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar dhe likuiduar por të pa kryer nga kontraktori sipas kontratës nr. 984/2 Prot., datë 18.11.2019.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	<b>Pamundësi verifikimi në terren i disa zërave punimesh për arsye të mungesës së sinjalistikës hekurudhore.</b>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi në terren lidhur me punimet e kryera, sipas kontratës së lidhur midis kontraktorit “E.B&B” SHPK & “V.-E” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 984/2 prot., datë 18.11.2019, objekt “Punime për mbrojtjen e linjës”, grupi i auditimit, nuk mundi të verifikonte disa zëra punimesh, konkretisht, në km 75 +050, L=35 ml, perigoni Lushnje-Fier, pasi hasi në vështirësi për të evidentuar me saktësi segmentet e deklaruara (km) nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, si segmente që duheshin riparuar. Mungonin gurët kilometrikë e si rezultat nuk ishte e mundur të evidentohesh saktësisht nëse punimet ishin kryer në segmentet/kilometrat e deklaruara nga





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

	<p>“Hekurudha Shqiptare” SHA. U konstatuan mangësi të theksuara të sinjalistikës hekurudhore si ajo që nevojitet për makinistët e trenave por edhe sinjalistika e domosdoshme për këmbësorët ose automjetet që kalojnë kryqëzimet hekurudhore. Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA nuk është marrë asnjë masë për saktësimin e gjatësive kilometrike të linjave hekurudhore shqiptare, duke vështirësuar kryerjen e verifikimeve në terren, lidhur me investimet e deklaruara për kilometrat respektiv. Veprimet sa më sipër janë jo në përputhje me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7 dhe Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të “Hekurudha Shqiptare” SHA, nenet 112, 114, 149 dhe neni 152.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>-Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.</p> <p>-Rregullore e Organizimit dhe Funksionimit të HSH SHA, neni 112 “Detyrat e Shefit të N/Njesisë Rajonale të Menaxhimit të Kapaciteteve”, neni 114 “Detyrat e Shefit të Stacionit”, neni 149 “Detyrat e Kontrollorit të Linjës në N/Njesisë Rajonale të Mirëmbajtjes” dhe neni 152 “Detyrat e Teknikut të Linjës Hekurudhore të N/Njesisë Rajonale të Mirëmbajtjes së Linjave”.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<p>-Vështirësi në kryerjen e verifikimeve në terren të punimeve të kryera.</p> <p>-Rritja e rrezikut për aksidente hekurudhore në të ardhmen.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Mos respektimi i Kodit Hekurudhor dhe Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të HSH SHA.</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p>E Lartë</p>
<b>Rekomandim:</b>	<p>Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të merren masa për vendosjen e sinjalistikës hekurudhore me qëllim garantimin e sigurisë në trafikun hekurudhor dhe vendosjen e gurëve kilometrikë të paktën për çdo 100 km gjatësi të linjës hekurudhore, me qëllim lehtësimin e kryerjes së verifikimeve në të ardhmen të zërave të punimeve për rikonstruksionet e segmenteve të ndryshëm të linjës hekurudhore.</p>

*Për sa është trajtuar në projekt raport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 109/519 Prot., datë 04.07.2023 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, nga Njësia e Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës (nr. 496 Prot., datë 15.06.2023 HSH SHA) përfaqësuar nga G.H., V.Gj.dhe P. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

#### **Pretendimi i subjektit:**

*1-“.....bazuar në urdhrin e brendshëm nr. 444 Prot., datë 13.06.2023 të Drejtuesit të NJBMI, grupi i punës bëri verifikimin në vend në zbatim të detyrës së ngarkuar nga Administratori i Shoqërisë sipas shkresës nr. 109/40 Prot., datë 09.06.2023 me lëndë “Në vijim të rekomandimeve të KLSH-së” me qëllim verifikimin e situatës së punimeve të kryera në Km 75+50, L=35 ml të segmentit Lushnje-Fier, Konstatoi se: Investimi në këtë segment është kryer sipas zërave të preventivit të hartuar nga Autoriteti Kontraktor. Konkretisht ju sqarojmë se: Investimi nuk është kryer në Km 75+50 por në Km 74+726.....”.*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

2-“Përsa i përket aplikimit të sipërmarrësit për leje..... Përsa i përket zërit të punimeve mbushje me zhavorr mbrapa murit.....”

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Referuar pretendimeve të mësipërme, sqarojmë se ato merren në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Auditimi pasi ju keni kryer verifikimet lidhur me saktësimin e gurëve kilometrikë dhe në këtë mënyrë të saktësimit të Km ku janë kryer investimet.

Lidhur me pretendimet e pikës 2, ju sqarojmë se keni bërë të njëjtat argumentime si në observacionet e akt konstatimeve të cilat nuk qëndronin e si rrjedhojë edhe këto observacione nuk mund të merren në konsideratë pasi janë të pabazuara në prova dhe fakte të dokumentuara.

#### **2 Mbi realizimin e kontratës me objekt “Rikonstruksioni i Linjës Budull - Gjorëm”.**

-Kontrata midis OE “E.” SHPK dhe HSH SHA, është me nr. 52/5 Prot., datë 02.07.2021 dhe objekt “Rikonstruksioni i Linjës Budull - Gjorëm”. Është me afat 3 muaj kalendarikë duke filluar nga data e lidhjes së kontratës sipas nenit 4 “Kryerja e punimeve” të kontratës së mësipërme me nr. 52/5 Prot., datë 02.07.2021. Vlera e plotë e kontratës është 8,103,481.8 lekë pa TVSH ose 9,724,178 lekë me TVSH. Përfaqësuesi i AK për ndjekjen e zbatimit të kontratës, është Njësia e Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, Durrës, sipas nenit 2 të kontratës së punimeve “Komunikimi dhe përfaqësimi”.

-Me shkresën nr. 6 Prot., datë 19.07.2021 protokolluar pranë “E.” SHPK dhe nr. 1001/2 Prot., datë 19.07.2021 protokolluar pranë HSH SHA, midis HSH SHA dhe OE “E.” SHPK, lidhet një Akt-Marrëveshje, për kryerjen e punimeve ndërtimore pa ndërprerje të trafikut hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve me objekt “Rikonstruksioni i Linjës Budull - Gjorëm”. Kjo Akt-Marrëveshje, lidhet me qëllimin e ruajtjes së sigurisë së qarkullimit të trenave gjatë kryerjes së punimeve në linjën hekurudhore. Tek kjo Akt-Marrëveshje, tek Kapitulli I, i saj, pika 7, midis të tjerash, cilësohet se: 7. Punimet do të realizohen çdo ditë të javës me përjashtim të ditës së diel dhe;

a. Pa ndërprerje të trafikut hekurudhor;

b. Punimet nga sipërmarrësi do të kryhen nga ora 8 deri në orën 16, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të akt-marrëveshjes deri në datën 30.11.2021.

-Njësoj cilësohet edhe tek Kapitulli IV. Të ndryshme, i marrëveshjes lidhur me datën e përfundimit të punimeve duke theksuar datën 30.11.2021.

Si rrjedhojë: Kontrata bazë është nënshkruar në datën 02.07.2021 me afat të përcaktuar të punimeve, 3 muaj nga data e nënshkrimit të saj ose me datë përfundimi punimesh, datën 29.09.2021. Sipas DST, afati i ekzekutimit të punimeve, është përcaktuar 3 muaj. (Faqja nr.8 e DST). Njësoj edhe tek Shtojca 12 e DST, afati i punimeve është përcaktuar 3 muaj. Tek e njëjta Shtojcë (Faqja nr.37 e DST), midis të tjerash, cilësohet se: “.....Përpara fillimit të punimeve nga ana e shoqërisë zbatuese do të bëhet akt – marrëveshja me HSH-në për kryerjen e punimeve deri në realizimin e plotë të tyre ku do të përcaktohet koha e nevojshme për çdo ditë pune me qëllim mos ndërprerjen e trafikut hekurudhor. Asnjë punim në linjën hekurudhore nuk do të bëhet jashtë kohës të përcaktuar në marrëveshjen midis palëve...”.

-Pra sa më sipër, është mëse e qartë se Akt-Marrëveshja ka pasur si objektiv të vetëm, përcaktimin e kohës ditore të punës me qëllim mos ndërprerjen e trafikut hekurudhor. Duke ndryshuar me këtë Akt-Marrëveshje, kushtet e tjera të kontratës bazë të cilat kanë qenë thelbësore për procedurën e prokurimit dhe përzgjedhjen e fituesit, i bën përcaktimet e cilësuar



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

në Kapitullin I, pikën 7 të kësaj marrëveshjeje, të pavlefshme. Nuk mundet që me një marrëveshje të ndryshohet afati i ekzekutimit nga 90 ditë kalendarike i përcaktuar në kontratën bazë, në 135 ditë kalendarike.

-Këto kufizime dhe detyrime të institucioneve për mos ndryshimin e kriterëve bazë të përzgjedhjes së fituesit, janë të përcaktuara në: Ligjin 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar:

a) Neni 59 “Kushtet për zbatimin e kontratës” ku cilësohet se: 1. Autoriteti kontraktor mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe të përfshira në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

2. Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jodiskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës.

b) Neni 60 “Rregullat që zbatohen për kontratën” ku cilësohet se:

1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese.

2. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, duhet të përmbushen në mirëbesim nga palët.

3. Pa cenuar dispozitat e këtij ligji dhe ndonjë dispozitë tjetër të zbatueshme nga autoriteti kontraktor, kontratat e prokurimit rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil.

-DST-në e procedurës së prokurimit:

a) Neni 35, “Negociatat dhe Amendamentet”, pika 35.1, ku cilësohet se: “Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit”.

-Si rezultat, data e përfundimit të punimeve, është data e përcaktuar në nenin 4 të kontratës bazë dhe që korrespondon me datën 29.09.2021.

-Nga auditimi i dosjes së zbatimit të punimeve, është konstatuar se me shkresën nr. 73/16 Prot., datë 28.09.2021, ka ardhur kërkesa pranë HSH SHA nga mbikëqyrësi i punimeve tek e cila midis të tjerash cilësohet se: “...Duke ju referuar kërkesës nr.10, datë 27.09.2021, të kontraktorit....., me të cilën kontraktori bën me dije se ka shumë vonesa nga furnitorët e huaj me të cilët kanë kontaktuar për furnizimin me materiale sipas projektit.....”.

-Në vazhdim, është nënshkruar një amendament kontrate. Konkretisht, me shkresën nr. 52/21 Prot., datë 04.10.2021, midis HSH SHA me përfaqësues Titullarin A.D. dhe OE “E.” SHPK me përfaqësues Q.S., është nënshkruar kontrata shtesë e cila zgjat afatin e kontratës bazë (sipas nenit 4, pika 1 të saj) deri në datën 15.11.2021. Nëse i referohemi nenit 4 të kontratës bazë, rezulton se kontrata bazë fillon në datën e nënshkrimit të saj pra në datën 02.07.2021 dhe përfundon pas 90 ditësh kalendarike ose në datën 29.09.2021.

Si rezultat:

1. Kontrata shtesë është nënshkruar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në kontratën bazë e cila e ka humbur fuqinë e saj ligjore në datën 29.09.2021 (datë në të cilën përfundon afati i realizimit të punimeve) së bashku me nenet e saj. Kontrata shtesë i referohet një neni të shfuqizuar e si e tillë, është e pavlefshme juridikisht.

2. Argumentimi i cilësuar në kërkesën e mbikëqyrësit të punimeve, drejtuar HSH SHA lidhur me mos disponueshmërinë e stafit të një operatori tjetër ekonomik me të cilin bashkëpunon OE “E.” SHPK, fitues i procedurës së prokurimit dhe nënshkruar i kontratës me HSH SHA, nuk qëndron pasi në procedurën e prokurimit, tek DST, nuk kërkohet që OE fitues të dorëzojë një marrëveshje bashkëpunime me ndonjë OE për furnizimin e materialeve objekt të kontratës por mbi të gjitha,





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

OE “E.” SHPK, nuk ka dorëzuar gjatë fazës së konkurrimit, asnjë marrëveshje bashkëpunimi me ndonjë OE që operon në këtë fushë e si e tillë, kjo kërkesë dhe ky argumentim i kontratës shtesë, nuk mund të konsiderohen të bazuara në ligj.

-Për veprimet e mësipërme, për konceptimin e akt-marrëveshjes me kritere të ndryshme nga ato të përcaktuara në kontratën bazë (cilësuar më lart) dhe për konceptimin e një kontrate shtesë bazuar tek një nen i shfuqizuar i një kontrate bazë të shfuqizuar, duke favorizuar në këtë mënyrë OE “E.” SHPK, pasi i është zgjatur afati i ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në procedurën e konkurrimit, mban përgjegjësi Shefi i Sektorit Juridik, Sh. Xh. si konceptues konform detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e HSH SHA, neni 25, pika 25.7, ku cilësohet se Shefi i Sektorit Juridik: “Drejton dhe kontrollon punën për përgatitjen e ratifikimit të amendamenteve, kontratave apo çdo dokument tjetër që lidhet me marrëdhëniet ligjore në veprimtarinë e HSH-së, përfshirë dhe marrëdhëniet me hekurudhat e huaja”.

-Kontrata midis Mbikëqyrësit të punimeve H.Xh.me nr. Licencë MK.1245/4 dhe HSH SHA, është me nr. 52/10 Prot., datë 15.07.2021.

-Kontrata midis Kolaudatorit të punimeve M.Sh. me nr. Licencë MK.3835 dhe HSH SHA, është me nr. 52/18 Prot., datë 30.09.2021.

-Akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, është mbajtur në datën 16.07.2021 dhe nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe Titullari i HSH SHA. Nga të njëjtët përfaqësues është nënshkruar edhe procesverbali mbi fillimin e punimeve, i cili ka datën 16.07.2021.

-Njoftimi për fillimin e punimeve është me datë 16.07.2021 dhe i nënshkruar nga sipërmarrësi i punimeve.

-Akti i piketimit të objektit, është mbajtur me procesverbalin e datës 16.07.2021 dhe është nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe investitori.

-Njoftimi për përfundimin e punimeve, është me datë 08.11.2021 dhe është nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve H.Xh.

-Situacioni përfundimtar i punimeve të kryera, është i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi i punimeve dhe investitori HSH SHA.

-Çertifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve, është e nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi i punimeve dhe investitori përfaqësuar nga komisioni i marrjes në dorëzim i punimeve me përbërje K.P. S.D. dhe F.Sh.

-Akti i kolaudimit të objektit është me datë 01.12.2021 dhe është i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe kolaudatori. Tek ky akt, cilësohet se kontrata është nënshkruar në datën 12.07.2021 kur në fakt ajo është nënshkruar në datën 02.07.2021. Cilësohet gjithashtu se punimet kanë filluar në datën 16.07.2021 kur në fakt data e fillimit të punimeve duhej të ishte data e nënshkrimit/lidhjes së kontratës sipas nenit 4 të saj. Data e përfundimit të punimeve deklarohet data 08.11.2021.

-Sa më sipër, punimet kanë përfunduar me vonesë. Duhej të përfundonin pas 90 ditësh nga data e lidhjes së kontratës me nr. 52/5 Prot., datë 02.07.2021 dhe objekt “Rikonstruksioni i Linjës Budull - Gjorëm” midis OE “E.” SHPK dhe HSH SHA ose në datën 29.09.2021. Në këto kushte kur punimet kanë përfunduar në datën 08.11.2021, operatori ekonomik “E.” SHPK, ka tejkaluar afatet e përcaktuara në kontratë me 40 ditë vonesë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

-Referuar ditarit të objektit në dosjen teknike, me numrin rendor 38 sipas inventarit të dosjes i cili ka 117 fletë, konstatohet se nga data 30.09.2021 deri në datën 08.11.2021, janë ekzekutuar zërat e punimeve si në tabelën në vijim referuar situacionit përfundimtar.

Nr.	Nr. An	Përshkrimi i Punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
11	491	Ngritje e linjës me traversa druri, ballast cakulli ngritje e parë.	MI	1000	190	190,000
12	491	Ngritje e linjës me traversa druri, ballast cakulli ngritje e dytë.	MI	1000	180	180,000
13	493	Drejtim përfundimtar i linjës	MI	1000	70	70,000
14	N-16	Planifikim linje	MI	1000	160	160,000
Shuma pa TVSH						600,000
<b>Shuma me TVSH</b>						<b>720,000</b>


-Si rezultat, vlera e punimeve të kryera pas afatit të përfundimit të kontratës në periudhën 30.09.2021 deri 08.11.2021, është 720,000 lekë. Në këto kushte, Njësia e Biznesit e Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore Durrës, e ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës sipas nenit 2, “Komunikimi dhe përfaqësimi”, pika 2.5 e saj, duhej të njoftonte HSH SHA për vonesa në kryerje të punimeve duke u aplikuar në vazhdim, neni 7, “Dëshmipërblimet për vonesat”, i kontratës më nr. 52/5 Prot., datë 02.07.2021, pika 7.1 ku cilësohet se: “Kontraktori do ti paguajë për çdo ditë vonesë, Autoritetit Kontraktor dëshmipërblimet prej 4/1000 pjesë së vlerës së kontratës së pa zbatuar.....”.

-Sa më sipër, vlera e penaltetit për 40 ditë vonesë nga OE “I” SHPK për kryerje punimesh me vlerë 720,000 lekë, është:  $4/1000 * 40 * 720,000 = 115,200$  lekë.

-Verifikimi në terren i zbatimit të punimeve.

-Në datën 23.03.2023, në orën 11:40, grupi i auditimit ka komunikuar me mbikëqyrësin e punimeve H.Xh. i cili është

njoftuar që të paraqitej një moment në terren për inspektime të punimeve të kryera. Në këto kushte, të mungesë së mbikëqyrësit, grupi i auditimit ka kryer verifikimet në terren pa praninë e tij në datën 29.03.2023, nga ku rezultoi se: -Punimet kanë filluar në Km 38+050 deri tek ura mbi kanalën vaditës si në foto. Pastaj për një gjatësi prej 70 m, ose mbi të gjithë gjatësinë e urës, nuk është kryer asnjë punim. Pjesa e shinave mbi urë është tejet e amortizuar dhe e pa kalueshme pasi ka dëmtime të shumta dhe çarje të urës.



-Nga kilometri 38 deri tek kilometri 39, u konstatua se:

-Janë vendosur 672 copë traversa betoni. Traversat e betonit janë me dimensione (26\*16\*240)cm dhe e shprehur në vëllim, vëllimi i një traverse është afro  $0.11 \text{ m}^3$ . Për 672 traversa, vëllimi total i traversave të montuara është:  $672 \text{ copë} * 0.11 \text{ m}^3 = 73 \text{ m}^3$  dhe jo  $672 \text{ m}^3$  sa është deklaruar në



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

situacionin përfundimtar dhe në librezën e masave. Pra janë deklaruar më tepër  $672\text{m}^3 - 73\text{m}^3 = 599\text{m}^3$  traversa betoni ose e shprehur në vlerë, janë faturuar 4,792,000 lekë më tepër.

-Në situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 3575 orë pune për vendosjen e  $672\text{m}^3$  traversa betoni. Në fakt janë vendosur  $73\text{m}^3$  traversa betoni dhe respektivisht për këtë vëllim, nevojiten  $(73 \cdot 3575) / 672 = 388$  orë pune. Pra janë pasqyruar më tepër në situacionin përfundimtar 3187 orë pune ose janë faturuar më tepër 509,920 lekë.

-Si rezultat, zërat e deklaruar më tepër në situacionin përfundimtar, janë:

Nr.	Nr.An	Përshkrimi i Punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
7	An	Furnizim me traversa betoni për linjën hekurudhore.	$\text{m}^3$	599	8.000	4,792,000
8	477	Montim traversa betoni të reja në linjën hekurudhore	op	3187	160	509,920
Totali						5,301,920
<b>Totali me TVSH</b>						<b>6,362,304</b>

-Sa më sipër, vlera e punimeve të pakryera dhe e deklaruar më tepër në situacionin përfundimtar, është 6,362,304 lekë.

-Për mos deklarim të saktë të zërave të punimeve të ekzekutuara, mban përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve H.Xh. pasi ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, ku midis të tjerash cilësohet se: “..Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi i punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.

-Për kolaudimin e punimeve të pa kryera, mban përgjegjësi kolaudatori i punimeve M.Sh.pasi ka vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, kapitulli II “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

-Për marrjen e përkohshme në dorëzim të punimeve, është nënshkruar certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve nga komisioni i marrjes në dorëzim.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	<b>Zëra punimesh të kryera me vonesë jashtë afatit të kontratës.</b>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i kontratës së lidhur me objekt “Rikonstruksioni i Linjës Budull - Gjorëm”, midis kontraktorit “E.” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 52/5 prot., datë 02.07.2021, me afat 3 muaj kalendarikë duke filluar nga data e lidhjes së kontratës (deri në datën 29.09.2021), me vlerë 9,724,178 lekë me TVSH, rezultoi se: me shkresën nr. 1001/2 Prot., datë 19.07.2021 protokolluar pranë “Hekurudha Shqiptare” SHA, është lidhur Akt-Marrëveshje për kryerjen e punimeve ndërtimore pa ndërprerje të trafikut hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve, me qëllimin e ruajtjes së sigurisë së qarkullimit të trenave gjatë kryerjes së punimeve në linjën hekurudhore. Kontrata bazë, (lidhur datë 02.07.2021) ka afatin 3 muaj nga data e nënshkrimit të saj, ndërkohë që Akt-Marrëveshja është lidhur vetëm, për përcaktimin e kohës ditore të punës me qëllim mos ndërprerjen e trafikut hekurudhor. Nga auditimi



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

	<p>rezultoi se është ndryshuar afati i ekzekutimit nga 90 ditë kalendarike i përcaktuar në kontratën bazë, në 135 ditë kalendarike. Në vazhdim, është nënshkruar me shkresën nr. 52/21 Prot., datë 04.10.2021, një amendament kontrate, e cila zgjat afatin e kontratës bazë (sipas nenit 4, pika 1 të saj) deri në datën 15.11.2021. Nëse i referohemi nenit 4 të kontratës bazë, rezulton se kontrata bazë fillon në datën e nënshkrimit të saj pra në datën 02.07.2021 dhe përfundon pas 90 ditësh kalendarike ose në datën 29.09.2021. Si rezultat:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Kontrata shtesë është nënshkruar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në kontratën bazë e cila e ka humbur fuqinë e saj ligjore në datën 29.09.2021. Kontrata shtesë i referohet një neni të shfuqizuar e si e tillë, është e pavlefshme juridikisht.</li><li>2. Argumentimi i cilësuar në kërkesën e mbikëqyrësit të punimeve, drejtuar “Hekurudha Shqiptare” SHA lidhur me mos disponueshmërinë e stafit të një operatori tjetër ekonomik me të cilin bashkëpunon “E.” SHPK, fitues i procedurës së prokurimit dhe nënshkrues i kontratës, nuk qëndron pasi në procedurën e prokurimit, OE “E.” SHPK, nuk ka dorëzuar gjatë fazës së konkurrimit, nuk ka deklaruar nënkontraktim. Njoftimi për përfundimin e punimeve, është me datë 08.11.2021 dhe punimet kanë përfunduar me vonesë, nga data 29.09.2021, ka tejkaluar afatet e përcaktuara në kontratë me 40 ditë vonesë. Referuar ditarit të objektit në dosjen teknike, me numrin rendor 38 sipas inventarit të dosjes i cili ka 117 fletë, konstatohet se nga data 30.09.2021 deri në datën 08.11.2021, janë ekzekutuar zërat e punimeve në vlerën 720,000 lekë. Në këto kushte, duhej të aplikohesh neni 7, “Dëmshpërblimet për vonesat”, i kontratës, pika 7.1. Vlera e penaltetit për 40 ditë vonesë që duhet mbajtur nga kontraktori “E.” SHPK për kryerje punimesh me vlerë 720,000 lekë, është: <math>4/1000 * 40 * 720,000 = 115,200</math> lekë.</li></ol>
<b>Kriteri:</b>	Kontrata me nr.52/5 Prot., datë 02.07.2021, neni 7 “Dëmshpërblimet për vonesat”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Ekzekutimi i punimeve jashtë afateve të përcaktuara.
<b>Shkaku:</b>	Mos respektimi i nenit 7 “Dëmshpërblimet për vonesat” i kontratës nr.52/5 Prot., datë 02.07.2021.
<b>Rëndësia:</b>	E Mesme
<b>Rekomandim:</b>	Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 115,200 lekë, nga kontraktori “E.” SHPK, si vlerë që i përket penaltetit që duhet mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 52/5 prot., datë 02.07.2021.
<b>Titulli i Gjetjes:</b>	<b>Zëra punimesh të pa kryera.</b>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi në terren për punimet e kryera, sipas kontratës midis “E.”



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

	<p>SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, nr. 52/5 Prot., datë 02.07.2021 dhe objekt “Rikonstruksioni i Linjës Budull-Gjorëm”, u konstatuan diferenca në zëra punimesh të pa ekzekutuara, por të situacionuara dhe faturuara. Punimet kanë filluar në Km 38+050 deri tek ura mbi kanalin vaditës. Për një gjatësi prej 70 m, ose mbi të gjithë gjatësinë e urës, nuk është kryer asnjë punim. Pjesa e shinave mbi urë është tejet e amortizuar dhe e pa kalueshme pasi ka dëmtime të shumta dhe çarje të urës. Janë vendosur 672 copë traversa betoni. Traversat e betonit janë me dimensione (26*16*240) cm dhe e shprehur në vëllim, një traverse është afro 0.11 m<sup>3</sup>. Për 672 traversa, vëllimi total i traversave të montuara është: 672 copë * 0.11 m<sup>3</sup> = 73 m<sup>3</sup> dhe jo 672 m<sup>3</sup> sa është deklaruar në situacionin përfundimtar dhe librezën e masave. Në situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 3575 orë pune për vendosjen e 672 m<sup>3</sup> traversa betoni. Në fakt janë vendosur 73 m<sup>3</sup> traversa betoni dhe respektivisht për këtë vëllim, nevojiten (73*3575)/672=388 orë pune. Vlera totale e punimeve të pa kryera është 6,362,304 lekë.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mangësi në kryerjen me cilësi të punimeve me pasojë dëm ekonomik.
<b>Shkaku:</b>	Mos pasqyrimi me korrektësi i volumeve të kryera.
<b>Rëndësia:</b>	E Mesme
<b>Rekomandim:</b>	Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 6,362,304 lekë, nga kontraktori “E.” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer nga kontraktori, sipas kontratës nr. 52/5 prot., datë 02.07.2021.

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 109/519 Prot., datë 04.07.2023 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit” nga sipërmarrësi i punimeve (nr. 109/49 Prot., datë 27.06.2023), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

#### **Pretendimi i subjektit:**

*1-“.....Sipërmarrësi i punimeve nuk mund të fillojë punimet në datën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes nëse nuk ka një shesh ndërtimi.....”.*

*2-“.....se në segmentin 70 ml të urës nuk është kryer asnjë punim dhe se pjesa e shinave....., shprehem se Riparimi i urës nuk është pjesë e kontratës sonë.....”.*

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Referuar pretendimeve të mësipërme, sqarojmë:

Pretendimi juaj, nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Auditimi. Grupi i auditimit i referohet kontratës ligjore të nënshkruar midis palëve dhe konkretisht neni 4, pika 4.1 ku cilësohet se punimet fillojnë në datën e nënshkrimit të kontratës. Për atë kohë sa tek ky nen është e përcaktuar data e fillimit të punimeve, grupi i auditimit nuk mund të konsiderojë se ky nen nuk duhet zbatuar pasi punimet nuk fillojnë me nënshkrimin e kontratës pra grupi i auditimit nuk mund të shprehet në kundërshtim me kontratën e nënshkruar.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Lidhur me pretendimet e tjera për urën apo diferencat e konstatuara të volumeve. Sqarojmë se nuk merren në konsideratë. Janë trajtuar njëherë në obseravcionet e sjella përpara Projekt Raportit dhe po juarinisim edhe njëherë. Nuk bëhet fjalë për konkluzione të grupit të auditimit apo për opinione. Bëhet fjalë për fakte të cilat janë të vërtetuara me matje në terren, me foto dhe video nga grupi i auditimit meqenëse ju (mbikqyrësi) nuk erdhët kurrë në terren për verifikime. Këtu ju ritheksoj atë që cilësohet në akt. Nuk jeni vënë përpara përgjegjësisë për mos riparim të urës se kjo është vërtetë absurde. Nuk e dimë se ku e gjetët këtë të shënuar në akt. Fakti dhe jo konkluzioni apo opinionin se ura është e dëmtuar, është mëse i dukshëm se mbi urë nuk është vendosur asnjë transversë betoni dhe kjo është përsëri e faktuar nga grupi i auditimit në terren në të cilin ju nuk u paraqitët edhe pse ju është kërkuar. Lidhur me atë që pretendoni se ka qenë lapsus, ju sqaroj se ky lapsus është përsëritur plot 6 herë. Në fillim duhet të ketë qenë lapsus në DST. Pastaj në ofertën e depozituar nga ju në APP. Pastaj në kualifikimin e OE. Pastaj në lidhjen e kontratës. Pastaj në librezën e masave që vet ju keni dorëzuar në dosjen teknike (këtu vlen të përmendet fakti që ju e mohoni se në librezën e masave shpreheni me copë kur në fakt gjatë auditimit kjo nuk u evidentua por gjithsesi, grupi i auditimit i referohet dokumentacionit të protokolluar në dosje). Pastaj në situacionin përfundimtar që ka nënshkrimin tuaj gjithashtu. Pra ju pretendoni se të gjitha këto veprime janë thjesht një neglizhencë apo lapsus! Grupi i auditimit, sido që të pretendoni, ka bërë verifikimet në terren dhe diferencat në zëra punimesh krahasur me situacionin përfundimtar dhe librezën e masave, janë absolutisht të pa kundërshtueshme. Gjithsesi, është marrë në konsideratë vlera koresponduese lidhur me ngritjen e linjës dhe planifikimin për gjatësinë 70 ml për të cilën edhe pse është marrë në konsideratë në hartimin e Projekt Raportit përsëri ju pretendoni se nuk është marrë në konsideratë.

### **3 Mbi realizimin e kontratës me objekt “Rikonstruksioni i godinës së Njesisë së Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse Durrës”.**

-Kontrata midis OE “F.” SHPK dhe HSH SHA, është me nr. 583/2 Prot., datë 29.05.2019 dhe objekt “Rikonstruksioni i godinës së NJSHML Durrës”. Është me afat 120 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës midis AK dhe Mbikëqyrësit të punimeve por dhe dhënies njëkohësisht të lejes për kantierin e ndërtimit, sipas nenit 4 “Kryerja e punimeve” të kontratës së mësipërme me nr. 583/2 Prot., datë 29.05.2019. Vlera e plotë e kontratës është 5,505,751.2 lekë me TVSH. Përfaqësuesi i AK për ndjekjen e zbatimit të kontratës, është Njësia e Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse, Plazh, Durrës, sipas nenit 2 të kontratës së punimeve “Komunikimi dhe përfaqësimi”.

-Kontrata midis Mbikëqyrësit të punimeve H.Xh. me nr. licence MK.1245/4 dhe HSH SHA, është me nr. 583/3 Prot., datë 05.06.2019.

-Njoftimi për fillimin e punimeve është me datë 29.05.2019 dhe i nënshkruar nga sipërmarrësi i punimeve. (Nr.12 në inventarin e dosjes teknike).

-Akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, është mbajtur në datën 29.05.2019 dhe nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe Titullari i HSH SHA. Nga të njëjtët përfaqësues është nënshkruar edhe procesverbali mbi fillimin e punimeve, i cili ka datën 29.05.2019.

-Akti i piketimit të objektit, është mbajtur me procesverbalin e datës 29.05.2019 dhe është nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe investitori.

-Sa më sipër, punimet kanë filluar në datën 29.05.2019 por kontrata me mbikëqyrësin është lidhur në datën 05.06.2019. Meqenëse neni 4 “Kryerja e punimeve”, i kontratës së lidhur midis



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

HSH SHA dhe sipërmarrësit “F.” SHPK me nr. 583/2 Prot., datë 29.05.2019, përcakton se afati prej 120 ditësh fillon pas plotësimit të dy kushteve pra pas lidhjes së kontratës midis AK dhe mbikëqyrësit të punimeve por edhe pas dorëzimit të sheshit të ndërtimit, atëherë data e fillimit të punimeve është data 05.06.2019 dhe data e përfundimit të tyre (pas 120 ditësh) është data 02.10.2019.

-Sipas ditarit të objektit të ndodhur në dosjen teknike, rezulton se dita e fundit e punës, është data 26.10.2019.

-Njoftimi për përfundimin e punimeve, është me datë 26.10.2019 dhe është nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve H.Xh..

-Situacioni përfundimtar i punimeve të kryera, është me datë 26.10.2019 dhe i nënshkruar nga sipërmarrësi “F.” SHPK me përfaqësues A.O, mbikëqyrësi i punimeve H.Xh. dhe investitori HSH SHA përfaqësuar nga Titullari A.D.

-Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve, është e nënshkruar nga sipërmarrësi dhe HSH SHA përfaqësuar nga N.K., L.A. dhe Teuta Hoxha të emëruar me urdhrin nr.266, datë 21.10.2019, mbikëqyrësi i punimeve, kolaudatori dhe investitori. Tek kjo certifikatë, cilësohet se punimet kanë filluar në datën 29.05.2019 dhe kanë përfunduar në datën 26.10.2019.

#### **4 Mbi realizimin e kontratës me objekt “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Shkozet-Kavajë”.**

-Kontrata midis “E.” SHPK dhe HSH SHA, është me nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021 dhe objekt “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Shkozet-Kavajë”. Është me afat 3 muaj kalendarik nga dita e nënshkrimit të kontratës midis palëve, sipas nenit 4 “Kryerja e punimeve” të kontratës së mësipërme me nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021. Vlera e plotë e kontratës është 8,879,149.92 lekë me TVSH. Përfaqësuesi i AK për ndjekjen e zbatimit të kontratës, është Njësia e Biznesit dhe Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, Durrës, sipas nenit 2 të kontratës së punimeve “Komunikimi dhe përfaqësimi”.

-Kontrata midis Mbikëqyrësit të punimeve “D” SHPK, përfaqësuar nga Z. V.T., me nr. licence MK.1676/9 dhe HSH SHA, është me nr. 73/8 Prot., datë 09.07.2021.

-Kontrata midis Kolaudatorit të punimeve “Dh.S.” SHPK, përfaqësuar nga J.Dh., me nr. licence MK.3749 dhe HSH SHA, është me nr. 73/19 Prot., datë 30.09.2021.

-Njoftimi për fillimin e punimeve është me nr. 73/12 Prot., datë 14.07.2021 dhe i nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve.

-Akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, është mbajtur në datën 14.07.2021 dhe nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe Titullari i HSH SHA përfaqësuar nga A.D.

-Akti i piketimit të objektit, është mbajtur me procesverbalin e datës 19.11.2019 dhe është nënshkruar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi.

-Sa më sipër, data e fillimit të punimeve duhej të ishte data e nënshkrimit të kontratës sipas nenit 4 të saj “Kryerja e punimeve” dhe të përfundonin pas 90 ditësh kalendarike sipas nenit 4 “Kryerja e punimeve”, i kontratës së lidhur midis HSH SHA. Pra punimet duhej të fillonin në datën 30.06.2021 dhe të përfundonin pas 3 muaj kalendarik ose në datën 30.10.2021. Në vazhdim, paraqitet situata sipas dokumentacionit të ndodhur në dosjen e zbatimit të punimeve.

-Me shkresën nr. 73/11 Prot., datë 13.07.2021, është nënshkruar midis HSH SHA dhe sipërmarrësit të punimeve, një akt marrëveshje për kryerjen e punimeve, e përcaktuar edhe në





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

DST por vetëm për përcaktimin e kohës së punës pa penguar lëvizjen e trenave. Pra akt marrëveshja duhej të kishte për qëllim vetëm përcaktimin e orareve ditore ku do të lejohej të kryhej puna pa ndërprerë në këtë mënyrë lëvizjen e trenave në linjën hekurudhore. Në fakt, akt marrëveshja e mësipërme, në kapitullin I të saj, pika 7, germa (b), cilëson se: “Punimet nga sipërmarrësi do të kryhen nga ora 8:00 deri në orën 16:00, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të akt marrëveshjes deri në datën 30.10.2021”. Si rezultat, me këtë akt marrëveshje, HSH SHA ka ndërhyrë tek neni 4 i kontratës bazë me nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021, ku përcaktohet se afati i punimeve është 3 muaj kalendarikë dhe fillon që nga data e nënshkrimit të kontratës bazë. Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, Kreu VI, “Zbatimi i kontratës”:

-Neni 59 “Kushtet për zbatimin e kontratës” pika 1 dhe pika 2 ku cilësohet se:

1. “Autoriteti kontraktor mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe të përfshira në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit”.

2. “Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jo diskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës”.

-Neni 60, “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1 ku cilësohet se:

1. “Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”.

-Me shkresën nr. 73/22 Prot., datë 04.10.2021, midis HSH SHA dhe OE “E.” SHPK, është nënshkruar një amendament i kontratës bazë i cili zgjat afatin e ekzekutimit të punimeve nga data 30.10.2021 deri në datën 09.11.2021. Në këtë amendament, midis të tjerash cilësohet se: “Kjo shtesë e kontratës së sipërpërmendur, bëhet në bazë të kërkesës së ardhur nga kontraktuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve në lidhje me problematikat në furnizimin nga kontraktorë jashtë vendit për shkak të pandemisë dhe punës së tyre më staf të reduktuar dhe që nuk mund të bëjnë të mundur përfundimin e punimeve brenda afatit të kontratës.”

-Me shkresën me nr. 73/28 Prot., datë 04.11.2021, mbikëqyrësi i punimeve, i kërkon HSH SHA zgjatjen e afatit të ekzekutimit të kontratës për arsye se në segmentin tek Kalesa e Plepave, duhet pritur përgjigja nga ARRSH për kryerjen e rikonstruksionit të linjës hekurudhore pasi në këtë pikë, linja hekurudhore kryqëzohet me rrugën automobilistike. Shkresa drejtuar ARRSH për dhënien e lejes për kryerjen e punimeve, është dërguar nga HSH SHA në datën 13.10.2021 sipas përgjigjes së ARRSH asaj me nr. 9672/2 Prot., datë 06.12.2021 për lejimin e kryerjes së punimeve në segmentin e rrugës.

-Me shkresën nr. 73/29 Prot., datë 04.11.2021, midis HSH SHA dhe OE “E.” SHPK, është nënshkruar amendamenti i dytë i kontratës bazë i cili zgjat afatin e ekzekutimit të punimeve nga data 09.11.2021 (Përcaktuar në amendamentin e parë) deri në datën 25.12.2021. Në këtë amendament, midis të tjerash cilësohet se: “Kjo shtesë e kontratës së sipërpërmendur, bëhet në bazë të kërkesës së ardhur nga kontraktuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve në lidhje me problematikat në marrjen e lejeve nga ARRSH për shkak të punimeve në nivel në kalesën në Plepa”.

-Në vazhdim, me shkresën me nr. 73/34 Prot., datë 15.12.2021, sipërmarrësi punimeve OE “E” SHPK, njofton HSH SHA për vazhdimin e punimeve pas ndërprerjes në pritje për miratimin e lejes nga ARRSH.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

-Sa më sipër, në dosjen e vënë në dispozicion të grupit të auditimit, nuk u konstatua asnjë dokument apo argument lidhur me vonesën për rifillimin e punimeve nga data që ARRSH ka dhënë lejen për të kryer punimet pra nga data 06.12.2021 sipas shkresës me nr. 9672/2 Prot., datë 06.12.2021 deri në datën që OE ka njoftuar HSH SHA për rifillimin e punimeve pra në datën 15.12.2021. Kjo vonesë prej 9 ditësh, nuk është e justifikuar as nga OE dhe as nga HSH SHA.

-Me shkresën nr. 73/36 Prot., datë 20.12.2021, mbikëqyrësi i punimeve njofton HSH SHA për përfundimin e punimeve.

-Sa më sipër, sipas amendamentit të dytë ai me nr. 73/29 Prot., datë 04.11.2021, punimet duhet të përfundonin në datën 25.12.2021. Pra kanë përfunduar 5 ditë përpara afatit por nga vonesa e pa justifikuar prej 9 ditësh e rifillimit të punimeve pas përgjigjes nga ARRSH, mbeten 4 ditë vonesa të pa justifikuar.

-Akti i kolaudimit, është mbajtur në datën 21.12.2021.

-Certifikata e marrjes në dorëzim të punimeve është mbajtur në datën 24.12.2021 dhe është e nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe HSH SHA përfaqësuar nga M.B., Ll.I. dhe F.T., në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve sipas urdhrit me nr. 1654, datë 03.12.2021 nga Drejtuesi i NJBMIH D..M.

-Sa më sipër, referuar edhe ditarit të punimeve, punimet janë pezulluar në datën 28.10.2021 dhe kanë rifilluar në datën 15.12.2021. Kjo vonesë prej 9 ditësh është rikuperuar nga OE pasi ka përfunduar punimet 5 ditë përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në amendamentin e dytë. Pra janë 4 ditë vonesë të pa justifikuar. Si rezultat, referuar nenit 7 të kontratës bazë me nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021, “Dëmshtëpërblimet për vonesat”, HSH SHA duhej të kalkulonte penaltetin për 4 ditë vonesë ekzekutimi zërash punimesh. Konkretisht, zërat e punimeve të ekzekutuara me 4 ditë vonesë, janë:

Nr.	II	Ndërtimi i kalesës në nivel (Kalesa e Plepave)	Njësia	sasia	Cmimi	Vlera
1	N-61	Çmontim linje Hekurudhore në kalesë.	ml	96	218	20928
2	An	Prishje shtresa asfalti dhe betoni ekzistues	m2	36	600	21600
3	3.89/a	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet.	m3	31.5	361	11371.5
4	3.244	Beton C 25/30 për në kalesë.	m3	17	11399	193,783
5	474/477	Montim linje hekurudhore në kalesë	ml	96	834	80064
6	491	Ngritje linjë hekurudhore	ml	96	240	23040
7	493	Drejtimit përfundimtar i linjës	ml	96	87	8352
8	474/477	Montim kondrashina në kalesa	ml	88	605	53240
Totali						412,378.5
<b>Totali me TVSH</b>						<b>494,854.2</b>

-Si rezultat, vlera e punimeve të kryera për 4 ditë vonesë, është 494,854.2 lekë. Në këto kushte, Njësia e Biznesit e Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore Durrës, e ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës sipas nenit 2, “Komunikimi dhe përfaqësimi”, pika 2.5 e saj, duhej të njoftonte HSH SHA për vonesa në kryerje të punimeve duke u aplikuar në vazhdim, neni 7, “Dëmshtëpërblimet për vonesat”, i kontratës më nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021, pika 7.1 ku cilësohet se: “Kontraktori do të paguajë për cdo ditë vonesë, Autoritetit Kontraktor dëmshtëpërblimet prej 4/1000 pjesë së vlerës së kontratës së pa zbatuar, por jo më pak se 25% të vlerës së saj”.

-Sa më sipër, efekti negativ që ka ardhur si rezultat i vonesave gjatë zbatimit të kontratës me 4 ditë, nga OE “E.” SHPK, për vlerën 494,854.2 lekë, që korrespondon me vlerën e punimeve të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

kryera jashtë afateve të përcaktuara në kontratë, është:  $4/1000 * 4 * 494,854.2 = 7917.7$  lekë. Meqenëse kjo vlerë është më pak se 25% e vlerës së kontratës të mbetur pa u zbatuar, atëherë aplikohet formula:  $25% * 494,854.2$  lekë = 123,713.55 lekë efekt financiar në dëm të HSH SHA.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	<b>Zëra punimesh të kryera me vonesë jashtë afatit të kontratës.</b>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i zbatimit të kontratës të lidhur me objekt “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Shkozet-Kavajë”, midis “E.” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021, me afat 3 muaj kalendarik nga dita e nënshkrimit të kontratës midis palëve, me vlerë 8,879,149.92 lekë me TVSH, rezultoi se: nuk u konstatua asnjë dokument apo argument lidhur me vonesën për rifillimin e punimeve nga data që ARRSH ka dhënë lejen për të kryer punimet pra nga data 06.12.2021 sipas shkresës me nr. 9672/2 Prot., datë 06.12.2021 deri në datën që kontraktori ka njoftuar “Hekurudha Shqiptare” SHA për rifillimin e punimeve pra në datën 15.12.2021. Kjo vonesë prej 9 ditësh, nuk është e justifikuar as nga kontraktori dhe as nga “Hekurudha Shqiptare” SHA. Referuar edhe ditarit të punimeve, punimet janë pezulluar në datën 28.10.2021 dhe kanë rifilluar në datën 15.12.2021. Kjo vonesë prej 9 ditësh është rikuperuar nga OE pasi ka përfunduar punimet 5 ditë përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në amendamentin e dytë. Referuar nenit 7 të kontratës bazë me nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021, “Dëmshpërblimet për vonesat”, HSH SHA duhej të kalkulonte penalitetin për 4 ditë vonesë të vlerës së punimeve të kryera për 494,854.2 lekë, që korrespondon me vlerën e punimeve të kryera jashtë afateve të përcaktuara në kontratë, penalitet i cili është: $4/1000 * 4 * 494,854.2 = 7917.7$ lekë. Meqenëse kjo vlerë është më pak se 25% e vlerës së kontratës të mbetur pa u zbatuar, atëherë aplikohet formula: $25% * 494,854.2$ lekë = 123,713.55 lekë në dëm të “Hekurudha Shqiptare” SHA.
<b>Kriteri:</b>	Kontrata me nr 73/7 Prot., datë 30.06.2021, neni 7 “Dëmshpërblimet për vonesat”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Ekzekutimi i punimeve jashtë afateve të përcaktuara.
<b>Shkaku:</b>	Mos respektimi i nenit 7 “Dëmshpërblimet për vonesat” i kontratës nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021.
<b>Rëndësia:</b>	E Mesme
<b>Rekomandim:</b>	Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 123,714 lekë, nga kontraktori “E.” SHPK, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021.

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 109/519 Prot., datë 04.07.2023 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”*



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

nga sipërmarrësi i punimeve (nr. 109/49 Prot., datë 27.06.2023), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

#### **Pretendimi i subjektit:**

1-“.....Sipërmarrësi i punimeve nuk mund të fillojë punimet në datën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes nëse nuk ka një shesh ndërtimi.....”.

2-“....Gjetjet e grupit të auditimit duhet të kundërshtohen edhe nga HSH SHA.....”.

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Referuar pretendimeve të mësipërme, sqarojmë:

Pretendimi juaj, nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Auditimi. Grupi i auditimit i referohet kontratës ligjore të nënshkruar midis palëve dhe konkretisht nenit 4, pika 4.1 ku cilësohet se punimet fillojnë në datën e nënshkrimit të kontratës. Për atë kohë sa tek ky nen është e përcaktuar data e fillimit të punimeve, grupi i auditimit nuk mund të konsiderojë se ky nen nuk duhet zbatuar pasi punimet nuk fillojnë me nënshkrimin e kontratës pra grupi i auditimit nuk mund të shprehet në kundërshtim me kontratën e nënshkruar. Gjithashtu, përse pretendoni në pikën 2, ju sqarojmë se HSH SHA, është treguar bashkëpunuese duke na vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm atë të cilin ju e keni sjellë me observacionet tuaja.

#### **5 Mbi realizimin e kontratës me objekt “Riparime vepra arti”.**

-Kontrata midis “RR.G.” SHPK dhe HSH SHA, është me nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021 dhe objekt “Riparime vepra arti”. Është me afat 45 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës midis palëve, sipas nenit 4 “Kryerja e punimeve” të kontratës së mësipërme me nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021 ose me datë përfundimi datën 25.12.2021. Vlera e plotë e kontratës është 9,231,016 lekë me TVSH. Përfaqësuesi i AK për ndjekjen e zbatimit të kontratës, është Njësia e Biznesit dhe Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, Durrës, sipas nenit 2 të kontratës së punimeve “Komunikimi dhe përfaqësimi”.

-Kontrata midis Mbikëqyrësit të punimeve “V.E.” SHPK, përfaqësuar nga Z. M.Sh. me nr. licence MK.3835 dhe HSH SHA, është me nr. 74/7 Prot., datë 12.11.2021.

-Kontrata midis Kolaudatorit të punimeve “A.P.” SHPK, përfaqësuar nga D. A. me nr. licence MK.3573 dhe HSH SHA, është me nr. 7/12 Prot., datë 20.12.2021.

-Njoftimi për fillimin e punimeve është me datë 12.11.2021 dhe i nënshkruar nga sipërmarrësi i punimeve dhe mbikëqyrësi.

-Akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, është mbajtur në datën 12.11.2021 dhe nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe Titullari i HSH SHA përfaqësuar nga A.D.

-Akti i piketimit të objektit, është mbajtur me procesverbalin e datës 12.11.2021 dhe është nënshkruar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi.

-Me shkresën nr. 74/13 Prot., datë 20.12.2021, OE “RR.G.” SHPK, kërkon pezullimin e punimeve për objektin “Riparime vepra arti”, me argumentimin se “....Reshjet e shumta gjatë këtyre ditëve kanë bërë që niveli i ujit në lumin Kir të rritet shumë duke e bërë të pamundur vazhdimin e punimeve në objekt.....”.

-Me shkresën nr. 74/26 Prot., datë 24.12.2021, është nënshkruar midis HSH SHA dhe sipërmarrësit të punimeve OE “RR.G.” SHPK, një amendament për shtyrjen e afatit të kontratës deri në datën 31.01.2022. Pra një ditë përpara përfundimit të afatit të kontratës bazë, HSH SHA zgjat afatin ligjor edhe me 37 ditë pune nga 45 ditë që ishte parashikuar. OE “RR.G.” SHPK, referuar kërkesës së ardhur për shtyrje afati të punimeve por edhe ditarit të objektit, rezulton se



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

ka punuar plot 38 ditë pune dhe i kanë mbetur edhe 7 ditë pune për të kryer punimet brenda afateve ligjore sipas kontratës bazë.

-Me shkresën nr. 74/27 Prot., datë 10.01.2021, është nënshkruar midis HSH SHA përfaqësuar nga Administratori A.D. dhe sipërmarrësit të punimeve OE “RR. G.” SHPK, një amendament i dytë për shtyrjen e afatit të kontratës deri në datën 29.07.2022. Me këtë amendament, shtyhet afati i ekzekutimit të punimeve edhe me 179 ditë pune të tjera. Në total, afati i ekzekutimit të punimeve është bërë nga 45 ditë në 261 ditë. Për këtë amendament, në dosjen teknike (referuar dhe inventarit të dosjes) nuk ka kërkesë të ardhur nga OE “RR. G.” SHPK, për shtyrje të afatit të punimeve.

-Si rezultat, me të dy amendamentet, duke shtyrë afatin e kontratës bazë nga 45 ditë punimesh në 261 ditë, HSH SHA ka ndërhyrë tek neni 4 i kontratës bazë me nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021, ku përcaktohet se afati i punimeve është 45 ditë kalendarike dhe fillon që nga data e nënshkrimit të kontratës bazë. Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, Kreu VI, “Zbatimi i kontratës”:

-Neni 59 “Kushtet për zbatimin e kontratës” pika 1 dhe pika 2 ku cilësohet se:

1. “Autoriteti kontraktor mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe të përfshira në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit”.
2. “Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jo diskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës”.

-Neni 60, “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1 ku cilësohet se:

1. “Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”.

-Me shkresën me nr. 74/32 Prot., datë 25.05.2022, Administratori i HSH SHA G.L., ka njoftuar sipërmarrësin “RR.G.” SHPK, për afatin e përfundimit të punimeve. Tek kjo shkresë midis të tjerash cilësohet se: “Afati përfundimtar për zbatimin e kontratës ka qenë data 31.01.2022. Duke qenë se kërkesa juaj datë 20.12.2021 me nr. 74/13 Prot., për pezullimin e punimeve me një afat të pacaktuar, është miratuar nga Administratori i Shoqërisë, nuk janë kryer të gjitha punimet për shkak të kushteve atmosferike, deri në datën 22.05.2022 punimet kanë qenë të pezulluara. Nisur nga njoftimi juaj për rifillimin e punimeve me datë 23.05.2022, në zbatim të kontratës kanë mbetur edhe 41 ditë nga data e përfundimit të punimeve, ju njoftojmë se afati përfundimtar për zbatimin e kontratës është data 04.07.2022”.

-Me shkresat pa numër protokollit dhe datë 04.07.2021, OE “RR.G.” SHPK me përfaqësues znj. V.G. Mbikëqyrësi punimeve M.Sh. veç e veç dhe së bashku, (shkresat me nr. rendor 7, 8 dhe 9 sipas inventarit të dosjes të firmosur nga M.K.) kanë mbajtur dokumentacionit teknik të përfundimit të punimeve.

-Akti i kolaudimit, është mbajtur në datën 12.09.2021.

-Certifikata e marrjes në dorëzim të punimeve është mbajtur në datën 01.11.2021 dhe është e nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe HSH SHA përfaqësuar nga R.O, K.P. dhe C.M.

-Sa më sipër, OE “RR.G.” SHPK, pas lidhjes së kontratës në datën 11.11.2021, ka filluar punimet në datën 12.11.2021 dhe ka punuar deri në datën 20.12.2021 datë në të cilën ka njoftuar për pezullim punimesh si pasojë e përmbytjeve në lumin Kir. Deri në datën 20.12.2022, edhe sipas ditarit të objektit, janë ezauruar plot 38 ditë pune. Pas pezullimit të punimeve, punimet kanë rifilluar (sipas ditarit të punimeve dhe shkresës së Administratorit të HSH SHA G. L., me





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

nr. 74/32 Prot., datë 25.05.2022) në datën 23.05.2022. Pas kësaj date, punimet kanë vazhduar deri në datën 04.07.2022. Pra është punuar edhe 42 ditë akoma. Në fakt, OE “RR.G.” SHPK, i janë dashur edhe 7 ditë pune për të përfunduar punimet brenda afateve të përcaktuara në kontratën bazë. Pra punimet (duke marrë në konsideratë vonesat për shkak të përmbytjeve të lumit Kir) duhej të përfundonin në datën 29.05.2022 dhe jo në 04.07.2022. Referuar edhe ditarit të punimeve, punimet janë pezulluar në datën 20.12.2021 dhe kanë rifilluar në datën 23.05.2022. Punimet kanë përfunduar me 35 ditë vonesë. Si rezultat, referuar nenit 7 të kontratës bazë me nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021, “Dëmshpërblimet për vonesat”, HSH SHA duhej të kalkulonte penalitetin për 35 ditë vonesë. Në këto kushte, Njësia e Biznesit e Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore Durrës, e ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës sipas nenit 2, “Komunikimi dhe përfaqësimi”, pika 2.5 e saj, duhej të njoftonte HSH SHA për vonesa në kryerje të punimeve duke u aplikuar në vazhdim, neni 7, “Dëmshpërblimet për vonesat”, i kontratës me nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021, pika 7.1 ku cilësohet se: “Kontraktori do ti paguajë për cdo ditë vonesë, Autoritetit Kontraktor dëmshpërblimet prej 4/1000 pjesë së vlerës së kontratës së pa zbatuar, por jo më pak se 25% të vlerës së saj”.

-Sa më sipër, vlera e penalitetit që i duhej mbajtur OE “RR.G.” SHPK, për 35 ditë vonesë kryerje punimesh, është:  $4/1000 * 35 * 9,231,016 = 1,292,342$  lekë. Meqenëse kjo vlerë është më pak se 25% e vlerës totale, atëherë aplikohet formula  $25% * 9,231,016 = 2,307,754$  lekë.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	<b>Zëra punimesh të kryera me vonesë jashtë afatit të kontratës.</b>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i zbatimit të kontratës të lidhur me objekt “Riparime vepra arti”, midis “Rr.G.” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021, me afat 45 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës midis palëve dhe me vlerë 9,231,016 lekë me TVSH, rezultoi se: punimet (duke marrë në konsideratë vonesat për shkak të përmbytjeve të lumit Kir) duhej të përfundonin në datën 29.05.2022 dhe jo në 04.07.2022. Referuar edhe ditarit të punimeve, punimet janë pezulluar në datën 20.12.2021 dhe kanë rifilluar në datën 23.05.2022. Punimet kanë përfunduar me 35 ditë vonesë. Referuar nenit 7, të kontratës bazë, me nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021, “Dëmshpërblimet për vonesat”, “Hekurudha Shqiptare” SHA duhej të kalkulonte penalitetin për 35 ditë vonesë, kryerje punimesh, e cila është: $4/1000 * 35 * 9,231,016 = 1,292,342$ lekë. Meqenëse kjo vlerë është më pak se 25% e vlerës totale, atëherë aplikohet formula $25% * 9,231,016 = 2,307,754$ lekë.
<b>Kriteri:</b>	Kontrata me nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021, neni 7 “Dëmshpërblimet për vonesat”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Ekzekutimi i punimeve jashtë afateve të përcaktuara.
<b>Shkaku:</b>	Mos respektimi i nenit 7 “Dëmshpërblimet për vonesat” i kontratës nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021.
<b>Rëndësia:</b>	E Mesme
<b>Rekomandim:</b>	Nga Hekurudha Shqiptare SHA, Durrës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 2,307,754 lekë, nga kontraktori



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

“Rr.G.” SHPK, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021.

#### **6 Mbi realizimin e kontratës me objekt “Rinovim Agregatësh për Lokomotiva”.**

-Kontrata midis OE “Z.” SHPK dhe HSH SHA (dokumenti nr. 5 sipas inventarit të dosjes), është me nr.501/2 Prot., datë 24.06.2019 dhe objekt “Rinovim Agregatesh për Lokomotiva”. Është me afat 60 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës ose me datë përfundimi datën 22.08.2019, sipas nenit 6, pika 6.1 “Mënyra dhe afati i lëvrimit të agregateve të rinovuara për lokomotiva”. Vlera e plotë e kontratës është 11,208,000 lekë me TVSH. Përfaqësuesi i AK për ndjekjen e zbatimit të kontratës, është Njësia e Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse, Plazh, Durrës, sipas nenit 7 të kontratës “Inspektimet dhe Testimet”.

-Me shkresën nr.907/1 Prot., datë 20.08.2019, OE “Z.” SHPK dhe HSH SHA, nënshkruajnë një amendament kontrate (dokumenti nr. 7 sipas inventarit) që shtyn afatin e përfundimit të përcaktuar në kontratën bazë, nga data 22.08.2019 që ishte, bëhet 15.10.2019, pra shtyhet kontrata bazë edhe 55 ditë të tjera ose afro 100 % e periudhës së ekzekutimit të përcaktuar në kontratën bazë dhe në kriteret e kualifikimit në DST të procedurës.

-Me shkresën nr.552/5 Prot., datë 11.10.2019, OE “Z.” SHPK dhe HSH SHA, nënshkruajnë një amendament tjetër kontrate (dokumenti nr. 7 sipas inventarit) që shtyn afatin e përfundimit të përcaktuar në amendamentin e parë, nga data 15.10.2019 që ishte, bëhet 10.12.2019, pra shtyhet afati me këtë amendament edhe 32 ditë të tjera nga amendamenti i parë ose në total, me të dy amendamentet së bashku, kontrata bazë që ishte për 60 ditë, është shtyrë edhe 87 ditë të tjera më shumë se afati i përcaktuar në kontratën bazë dhe në kriteret e kualifikimit tek DST e procedurës së prokurimit.

-Tek të dy amendamentet e mësipërm, cilësohet e njëjta arsye për shtyrjen e afatit të zbatimit të kontratës dhe konkretisht: “Kjo shtesë e kontratës së sipërpërmendur, bëhet në bazë të kërkesës së ardhur nga kontraktuesi, në lidhje me problematikat në riparimin e Agregateve (amendamenti i parë) dhe Takografëve (amendamenti i dytë) të dërguara nga autoriteti kontraktor, pasi shumë prej tyre kanë shfaqur defekte të rënda që do të donin më shumë kohë për riparimin e tyre nga ajo e përcaktuar në kontratë, duke u nisur edhe nga fakti se afati kohor, nuk mundëson riparimin e tyre deri në përfundim të afatit të kontratës, duke u nisur nga interesi publik dhe emergjenca që ka Njësia e Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse për vënien në punë të lokomotivave, në zbatim të nenit 33, pika 5 dhe nenit 35, pika 1, të Kushteve të Përgjithshme të kontratës të furnizimit me mallra”.

-Sa më sipër, mungon kërkesa e ardhur nga kontraktuesi siç cilësohet në argumentimin për shtyrjen e afatit. Argumentimi për shtyrje të afatit vetëm me shprehjet se ka pasur problematika lidhur me riparimin e defekteve pasi ato kanë qenë të rënda, nuk është i faktuar me asnjë dokumentacion shtesë si ndonjë relacion nga kompania e huaj “E. D. S.” me vendndodhje në Serbi, ose foto ku të jepeshin detaje se agregatet kanë pasur defekte të rënda që duan më shumë kohë se sa koha e përcaktuar në DST dhe kriteret e kualifikimit ose koha e përcaktuar nga vetë OE “Z.” SHPK me anë të ofertës së tij duke plotësuar shtojcën nr.11, “Grafiku i Lëvrimit”, ku cilësohet se: “Mallrat do të lëvrohen brenda 60 ditësh nga data e nënshkrimit të kontratës”.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

- Me urdhrin e brendshëm nr. 102, datë 26.09.2019, drejtuesi i Njësisë së Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse, N. K., ngre komisionin për pranimin e agregateve me përbërje M. J., A. M. dhe E.M.
- Në datën 27.09.2019, komisioni i mësipërm, mban procesverbalin për marrjen në dorëzim të agregateve. Ky procesverbal, është i nënshkruar edhe nga personi me përgjegjësi materiale L.A..
- Në datën 10.10.2019, komisioni i mësipërm, mban procesverbalin për matjen e izolimit të agregateve të ardhura nga OE.
- Në datën 11.10.2019, komisioni, mban procesverbalin e pranimit të agregateve dhe midis të tjerash cilëson se: *“Komisioni pasi verifikoi përputhshmërinë e agregateve për NJSHML, me dokumentacionin përkatës dhe specifikimet teknike, pas verifikimeve vizuale dhe matjeve të izolimit, vendosi ti pranojë. Prova në Lokomotivë do të bëhet në momentin e montimit”*.
- Procesverbali i gjetjeve dhe riparimit është me numër 12 në inventarin me 10 fletë të dosjes. Ky procesverbal është mbajtur nga operatori që ka kryer riparimin “E. D. S.” me vendndodhje në Serbi. Procesverbali është krijuar në datën 20.09.2019 nga Momcilovic Igor, Kovac Striko Istvan dhe Sic Dragan. Procesverbali, përshkruan të gjitha proceset e ndjekura për riparimin e agregateve që në fazën e çmontimit të tyre deri në atë përfundimtare të asamblimit dhe paketimit.
- Certifikata e garancisë së shërbimeve të kryera tek agregatet, është lëshuar në datën 25.09.2019.
- Deklarata doganore e doganës Fier për dërgimin e agregateve nga OE “Z.” SHPK tek “E. D.S.” në Serbi, është me numër referimi 637/2019 dhe datë 06.07.2019 pra pas 12 ditësh nga nënshkrimi i kontratës bazë.
- Deklarata doganore e doganës Fier për hyrjen e agregateve nga “E. D. S.” në Serbi tek OE “Z.” SHPK, është me numër referimi 975/2019 dhe datë 27.09.2019. Nga të dy deklaratat doganore, mungon vetëm zëri nr. 6 sipas specifikimeve teknike ai për “Rinovimin e Takografëve të Lokomotivës Tip ÇKD T669, tip 662 A 120 “METRA-Pragë”.
- Në dosjen e zbatimit të kontratës nuk u gjet fletë-dalje dhe as ndonjë akt-dorëzim të agregateve nga NJSHML tek OE “Z.” SHPK. Në dosje gjendet një fletë-hyrje me nr.02 dhe datë 11.10.2019. Tek kjo fletë-hyrje, nuk janë Takografët por vetëm agregatet ashtu siç përshkruhen në deklaratat doganore.
- Fatura është me nr.2340, datë 11.10.2019 dhe vlerë 11,016,000 lekë me TVSH.
- Lidhur me Takografët, në dosje u konstatua se:
- Takografët janë dërguar për riparim tek “S. C.” S.R.O në “Strojnícka 97, 821 05 Bratislava të Republikës së Slovenisë”, në datën 05.07.2019 me shërbimin postar EMS.
- Takografët janë bërë hyrje në Shqipëri sipas deklaratës doganore në Qafë Thanë, në datën 05.11.2019.
- Certifikata e garancisë për riparimin e Takografëve, është me datë 30.10.2019.
- Procesverbali i marrjes në dorëzim të Takografëve, është mbajtur në datën 11.11.2019 nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 102, datë 26.09.2019. Tek ky procesverbal, komisioni cilëson edhe faktin se: *“Takografët e dorëzuar komisionit kanë respektivisht numrat serial nr.91278 dhe nr.28260. Verifikuar dhe të njëjtë me fletë-daljen nr. 2, datë 05.07.2019 Magazina Rikupero”*.
- Procesverbali i pranimit të Takografëve, është mbajtur nga komisioni, në datën 12.11.2019. tek ky procesverbal, midis të tjerash, cilësohet se: *“Komisioni pasi verifikoi përputhshmërinë e agregateve për NJSHML-në (Takografët me nr.91278 dhe nr.28260) me dokumentacionin përkatës dhe specifikimet teknike, vendosi ti pranojë”*.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

-Takografët janë bërë hyrje në magazinën e NJSHML-së sipas fletë-hyrjes me nr. 4, datë 12.11.2019.

-Fatura është me nr. 2349, datë 12.11.2019 dhe vlerë 192,000 lekë me TVSH.

Sa më sipër:

-Referuar kontratës së lidhur midis OE “Z.” SHPK dhe HSH SHA asaj me nr.501/2 Prot., datë 24.06.2019, me objekt “Rinovim agregatesh për lokomotiva”, neni 3 “Dorëzimi Agregateve të Rinovuar”, pika 3.1 ku cilësohet se “Dorëzimi i agregateve të rinovuar për lokomotiva, do të bëhet në magazinat e Njësisë së Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse, Plazh, Durrës”, nënkupton edhe faktin se në fillim, përpara se agregatet e rinovuar, ti dorëzoheshin HSH SHA, NJSHML në fillim duhej të kryente veprimin e dorëzimit të agregateve tek OE.

-Në dosje mungojnë dokumentet dhe argumentet teknik nga sektorët përkatës të HSH SHA ku të pasqyrohej qartësisht nevoja për rinovimin e agregateve. Konkretisht:

-Për agregatet që janë kërkuar të rinovohen duhej që Përgjegjësi i sigurimit teknik sipas nenit 173 të Rregullores për Funkcionimin dhe Organizimin e HSH SHA, të dokumentonte veprimet përpara çdo nevoje për riparim të Lokomotivave konform pikës 173.10 ku midis të tjerash, cilësohet se “Mban përgjegjësi për plotësimin e saktë dhe ruajtjen e dokumentacionit të nevojshëm teknik”, Merr pjesë si specialist elektrik në komisione për:

-Evidentimin e nevojave për pjesë këmbimi dhe agregate, si dhe kontrollin e këtyre pjesëve/agregateve gjatë procesit të pranimit të tyre në NJSHML.

-Përpilimin e normativave të llojeve të ndryshme të pjesëve të këmbimit dhe materialeve që nevojiten për procesin e riparimit dhe shërbimit të lokomotivave.

-Për agregatet që janë kërkuar të rinovohen duhej që Kontrollori i Cilësisë së Lokomotivave, sipas nenit 174 të Rregullores për Funkcionimin dhe Organizimin e HSH SHA, të dokumentonte veprimet përpara çdo nevoje për riparim të Lokomotivave konform pikës 174.6 duke “Propozuar procedurat apo inovacionet për përmirësimin e punës dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve”, konform pikës 174.7 duke faktuar me dokumentacion justifikues se ka “Bashkëpunuar ngushtë me përfaqësuesit e NJBU, NJBM si dhe makinistët përkatës për çdo problematikë të mjetit”.

-Pa argumentimin dhe dokumentimin e nevojës për kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt “Rinovim agregatesh për lokomotiva” HSH SHA nuk duhej të inicioje këtë procedurë edhe për vetë faktin se në strukturën e saj, referuar edhe detyrave të përcaktuara në Rregulloren e Funkcionimit dhe Organizimit të HSH SHA, ka mjaftueshëm staf të kualifikuar me detyra specifike dhe ofiçinë të kompletuar e të përshtatshme për kryerjen e riparimit të çdo defekti të mundshëm në çdo lokomotivë apo vagon. Në dosjen teknike të dorëzuar pranë grupit të auditimit, nuk u gjet asnjë relacion teknik të mbajtur nga nëpunësit përkatës të HSHA SHA, dhe konkretisht nga:

1-“Shefi i Sektorit Teknik”, sipas detyrave të përcaktuara në nenin 171 të Rregullores së Funkcionimit dhe Organizimit të HSH SHA;

2-“Teknologu Mekanik”, sipas detyrave të përcaktuara në nenin 172 të Rregullores së Funkcionimit dhe Organizimit të HSH SHA;3-“Përgjegjësi i sigurimit teknik, Teknologu elektrik”, sipas detyrave të përcaktuara në nenin.

173 të Rregullores së Funkcionimit dhe Organizimit të HSH SHA;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

4-“Kontrollori i cilësisë për Lokomotiva dhe vagonë, Kontrollori i cilësisë së Lokomotivave”, sipas detyrave të përcaktuara në nenin 174 të Rregullores së Funkcionimit dhe Organizimit të HSH SHA;

5-“Sektori i Riparimit dhe Shërbimit të Lokomotivave, Shefi i Sektorit”, sipas detyrave të përcaktuara në nenin 175 të Rregullores së Funkcionimit dhe Organizimit të HSH SHA;

6-“Kontrollori i cilësisë për vagonët dhe Akset e Mjeteve Hekurudhore”, sipas detyrave të përcaktuara në nenin 176 të Rregullores së Funkcionimit dhe Organizimit të HSH SHA;

7-“Sektori Mekanik dhe i Vagonëve, Shefi i Sektorit”, sipas detyrave të përcaktuara në nenin 177 të Rregullores së Funkcionimit dhe Organizimit të HSH SHA;

8-“Sektori i Eliminimit të Avarive, Shefi i Sektorit”, sipas detyrave të përcaktuara në nenin 178 të Rregullores së Funkcionimit dhe Organizimit të HSH SHA.

-NJSHML nuk ka ndjekur procedurat ligjore për menaxhimin me korrektësi të aktiveve duke mos dokumentuar me saktësi lëvizjen e tyre pasi nuk ka mbajtur asnjë procesverbal lidhur me arsyet e klasifikimit të agregateve si agregate me probleme ose agregate me defekte. Nuk ka asnjë relacion nga stafi i NJSHML-së lidhur me provat e kryera për agregatet dhe të dhënat pas këtyre provave ku të evidentoheshin problemet reale dhe pasojat që mund të kenë qenë evidente në funksionimin e lokomotivave. Nuk ka asnjë të dhënë (procesverbal) lidhur me çmontimin e këtyre agregateve nga lokomotivat respektive dhe arsyet e çmontimit të tyre. Nuk ka asnjë të dhënë lidhur me problematikat e mundshme në ndonjë lokomotivë gjatë lëvizjes së tyre të cilat (problemet) duhej të pasqyroheshin në dokumentet e udhëtimit ose në librezën e çdo mjeti. Nuk u konstatua asnjë dokument tek i cili të pasqyroheshin testet e mundshme të kryera (për agregatet) gjatë punës në lokomotiva apo edhe testet e kryera për agregatet në ofiçinat e HSH SHA ku të përcaktohej në mënyrë profesionale se agregatet janë me defekt. Në vazhdim, nuk është dokumentuar mënyra e dorëzimit të tyre (agregateve) pas çmontimit nga lokomotivat, në magazinën e NJSHML-së. Nuk ka asnjë dokument lidhur me dorëzimin e aktiveve (agregateve) tek kontraktuesi. Nuk u konstatua asnjë fletë-dalje nga magazina e NJSHML-së për çdo aktiv (agregat) ku të nënshkruhej edhe nga kontraktuesi dhe të vërtetohej se aktivet janë bërë dalje nga HSH SHA dhe janë transportuar me mjetin përkatës nga OE i shpallur fitues i procedurës.

-Në vazhdim, në rastin e dorëzimit nga OE “Z.,” SHPK tek NJSHML të agregateve të riparuar, përsëri nuk është dokumentuar fakti që agregatet janë testuar në lokomotivën/lokomotivat përkatëse, konform nenit 7 të kontratës së lidhur por komisioni i marrjes në dorëzim të agregateve, është mjaftuar me evidentimin vizual të agregateve pra gjendjes së tyre fizike ose me matje të rezistencës së izolimit por edhe kjo e pa faktuar me ndonjë grafik të mundshëm me vlerat e rezistencës së izolimit. Komisioni i marrjes në dorëzim të agregateve, duhej të kryente testimin e tyre (konform nenit 7 të kontratës bazë) duke i montuar ato (agregatet) në lokomotivat që i kishin çmontuar dhe duke kryer një itinerar të caktuar për të verifikuar nëse lokomotivat respektive nuk kanë më probleme dhe se agregatet janë riparuar dhe nuk kanë asnjë lidhje me gjendjen e tyre teknike përpara riparimit.

-Procedura e prokurimit, është e pa argumentuar, e pa bazuar në prova dhe fakte lidhur me nevojën e riparimit të agregateve por dhe e pa dokumentuar lidhur me çmontimin ose montimin e agregateve nga lokomotivat përkatëse në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli III, “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” dhe “Transportimi i aktiveve”.

-Sa më sipër, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, intervistave të kryera gjatë auditimit pranë HSH SHA por edhe procesverbalit të marrjes në dorëzim të Takografëve, të mbajtur në datën 11.11.2019 nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 102, datë 26.09.2019, ku cilësohet se “Takografët e dorëzuar komisionit kanë respektivisht numrat serial nr.91278 dhe nr.28260. Verifikuar dhe të njëjtë me fletë-daljen nr. 2, datë 05.07.2019 Magazina Rikupero”, grupi i auditimit, konkludon se agregatet mund të kenë qenë gjendje në magazinën rikupero të NJSHML-së (edhe kjo e pa faktuar nga HSH SHA pasi nuk ka asnjë procesverbal të çmontimit dhe dorëzimit të tyre në magazinë me fletë-hyrjen respektive përpara periudhës së kryerjes së procedurës së prokurimit).

-NJSHML dhe Komisioni i marrjes në dorëzim, nuk ka kryer procedurat e duhura ligjore për marrjen në dorëzim të shërbimeve duke vepruar në kundërshtim me nenin 7 “Inspektimet dhe Testimet”, ku midis të tjerash tek pika 7.2 e këtij neni, cilësohet se: “Autoriteti Kontraktor (NJSHML në rastin konkret si përfaqësues i AK konform pikës 7.1 të po këtij neni) do të kryejë për agregatet e rinovuar, **provat në lokomotiva**”.

Në gjykim të grupit të auditimit, vlera e investuar prej 11,208,000 lekë, përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.

-OE “Z.” SHPK, ka riparuar një pjesë të mallrave tek një operator me të cilin nuk ka akt marrëveshje e si rezultat, NJMSHL dhe HSH SHA nuk duhej të merrnin në dorëzim lëvrimin/shërbimin e kryer për Takografët por duhej të kërkonin nga OE “Z.” SHPK, riparimin e tyre sipas kushteve të kontratës.

-Për veprimet ose mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi:

a) Strukturat drejtuese të HSH SHA, pasi kanë iniciuar një procedurë prokurimi pa pas në fillim argumentimet e domosdoshme për nevojat reale të HSH SHA lidhur me riparimin e agregateve, duke mos pasur paraprakisht kërkesat dhe argumentet reale nga stafi përgjegjës sipas “Rregullores për Funksonimin dhe Organizimin e HSH SHA”, nenet 170 deri 178, lidhur me defektet e ndodhura në lokomotiva e për pasojë, kryerjen e një investimi me pasoja financiare negative për institucionin.

b) Drejtuesi i Njesisë së Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse, si përfaqësues i HSH SHA për ndjekjen e zbatimit të kontratës, përcaktuar në nenin 7 të kontratës bazë “Inspektimet dhe Testimet” dhe komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimeve të agregateve të emëruar me urdhrin e brendshëm nr. 102, datë 26.09.2019, pasi kanë vepruar në kundërshtim me nenin 7 të kontratës bazë “Inspektimet dhe Testimet”, pika 7.2 dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli III, “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” dhe “Transportimi i aktiveve”.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	<b>Efekt negativ, procedurë prokurimi pa argumentuar nevojat për kryerjen e saj.</b>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i kontratës së lidhur midis OE “Z.” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr.501/2 Prot., datë 24.06.2019, me objekt “Rinovim agregatesh për lokomotiva”, me vlerë 11,208,000 lekë me TVSH, me afat 60 ditë kalendarike, me datë përfundimi



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

	<p>22.08.2019, rezultoi se: në dosjen e zbatimit të kontratës nuk u gjet fletë-dalje dhe as akt-dorëzimi të agregateve nga NJSHML tek kontraktori “Z.” SHPK. Në dosje gjendet një fletë-hyrje me nr.02 dhe datë 11.10.2019. Tek kjo fletë-hyrje, nuk janë Takografët por vetëm agregatet ashtu siç përshkruhen në deklaratat doganore. Referuar kontratës së lidhur, neni 3, pika 3.1, në fillim, përpara se agregatet e rinovuar, ti dorëzoheshin “Hekurudha Shqiptare” SHA, NJSHML duhej të dokumentonte veprimin e dorëzimit të agregateve tek OE. Në dosjen teknike të dorëzuar pranë grupit të auditimit, nuk u gjet relacioni teknik i mbajtur nga nëpunësit përkatës të “Hekurudha Shqiptare” SHA sipas detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara në Rregullore. NJSHML nuk ka ndjekur procedurat ligjore për menaxhimin me korrektësi të aktiveve duke mos dokumentuar me saktësi lëvizjen e tyre, pasi nuk ka mbajtur procesverbal lidhur me arsyet e klasifikimit të agregateve si agregate me probleme ose agregate me defekte. Nuk u konstatua asnjë fletë-dalje nga magazina e NJSHML-së (edhe pse në fakt agregatët janë dërguar për riparim) për çdo aktiv (agregat) ku të nënshkruhej edhe nga kontraktuesi dhe të vërtetohej se aktivet janë bërë dalje nga “Hekurudha Shqiptare” SHA dhe janë transportuar me mjetin përkatës nga kontraktori. Procedura e prokurimit ka mangësi lidhur me nevojat për riparimin e lokomotivave që kanë pasur defekt. NJSHML, nuk ka kryer procedurat e duhura ligjore për marrjen në dorëzim të shërbimeve duke vepruar në kundërshtim me kontratën, nenin 7 “Inspektimet dhe Testimet”, pika 7.2 e këtij neni, ku cilësohet se: “Autoriteti Kontraktor (NJSHML në rastin konkret si përfaqësues i AK konform pikës 7.1 të po këtij neni) do të kryejë për agregatet e rinovuar, provat në lokomotiva”. Sa më sipër, vlera e investuar prej 11,208,000 lekë, përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>-Kreu II, Organizimi i Prokurimit Publik, nenin 12, Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006. -Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. -Neni 7, “Inspektimet dhe Testimet” i kontratës me nr.501/2 Prot., datë 24.06.2019 me objekt “Rinovim Agregatësh për Lokomotiva”.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Ulje e të ardhurave të shoqërisë.
<b>Shkaku:</b>	Mos argumentim real i nevojave për kryerjen e procedurës.
<b>Rëndësia:</b>	E Lartë
<b>Rekomandim:</b>	Këshilli Mbikëqyrës i Hekurudhës Shqiptare SHA, të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive nga Strukturat Drejtuese lidhur me kryerjen e procedurave të prokurimit pa argumentuar më parë nevojat reale të shoqërisë duke sjellë pasojë negative financiare për buxhetin e shtetit.





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

**Rekomandim:**

Strukturat Drejtuese të shoqërisë, të marrin masa që në të ardhmen, përpara zhvillimit të një procedure prokurimi, të argumentohet dhe dokumentohet nevoja reale që ka institucioni dhe në vijim të kryhet prokurimi për mallra, shërbime apo punime, konform ligjeve dhe rregullave në fuqi.

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 109/519 Prot., datë 04.07.2023 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, nga Drejtuesi i Njësisë, N. K., (nr. 45/3 Prot., datë 19.05.2023 HSH SHA), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:**

1-“.....Lokomotiva e difektuar hyn në Repartin e Shërbimeve me raport pune ku përcaktohen punimet që duhen kryer. Pas çmontimit nga mjeti, mbahet procesverbali mbi gjendjen teknike të tij dhe njëkohësisht bëhet hyrje në magazinë rikupero si agregat”.

2-“Në rastet e investimeve Rinovim agregatesh për lokomotiva, bëhet dalje nga gjendja rikupero e magazinës në momentin e zhvillimit të procedurës.”

3-“Pra citimi i bërë nga audituesit “grupi i auditimit ka dyshime të arsyeshme se agregatet nuk janë çmontuar nga asnjë lokomotivë dhe se njëkohësisht as nuk janë montuar në ndonjë lokomotivë por mund të kenë qenë gjendje në magazinën rikupero të NJSHML-së”, nuk qëndron”.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Referuar pretendimeve të mësipërme, sqarojmë:

Pretendimet tuaja, nuk merren në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Auditimi. Dokumentacioni i sjellë me observacionin tuaj, është ë i njëjti me observacionet e sjella nga ana juaj mbi akt-konstatimet e mbajtura nga grupi i auditimit dhe janë trajtuar një herë në hartimin e Projekt Raportit të Auditimit. Gjithsesi, po ju përsërisim argumentat tona mbi mos marrjen në konsideratë të këtyre observacioneve në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Konkretisht, dokumentacioni që ju keni paraqitur, nuk vërteton absolutisht atë që ju pretendoni. Procesverbalet që keni dërguar, kanë vetëm nënshkrime dhe datë dhe asnjë element tjetër që të faktohet ajo që cilësoni. Lokomotivat dhe çdo mjet i transportit hekurudhor dhe jo vetëm, duhet të ketë një librezë shërbimesh ku të duket në mënyrë progresive çdo shërbim apo shënim lidhur me defektet e mundshme. Përpara çdo hyrje p.sh të një mjeti në repartin e shërbimeve, duhet të ketë një kërkesë me datë dhe numër protokoll drejtuar përgjegjësit ose drejtorit të njësisë ku të vërtetohet data dhe arsyeja e hyrjes së një mjeti për shërbim. Edhe procesverbalet e dorëzimit që keni sjellë, janë vetëm me datë dhe pa numër protokoll. Fatura që keni sjellë, nuk vërteton aspak shërbimin e kryer por vetëm likuidimin e kryer. Fletë Hyrjet apo Fletë daljet që keni sjellë, janë të paqarta dhe konfuze. Nuk dallohet fare nëse janë pjesë të një blloku fletë hyrjeje ose fletë daljeje pasi nuk kanë numra serial të dokumentit. Termi juridik “*Dyshime të arsyeshme*” është përdorur si rezultat i mangësive që grupi i auditimit ka evidentuar në auditimin e kryer në institucionin ku ju punoni. Akti i mbajtur është shumë i qartë dhe ju me observacionet që keni sjellë, vetëm sa certifikoni dyshimet e arsyeshme që ka pasur grupi i auditimit. Konkretisht keni paraqitur: Dokumentin nr. 45/3 Prot., datë 19.05.2023 (2 fletë); Dokumentin pa firmë dhe datë dhe me titull Kopje Praktike nga NJSHML (1 fletë); Raport dalje lokomotive me datë 17.11.2021 (1 fletë); Raport Pune me datë 04.11.2021 (1 fletë); Procesverbal me datë 05.11.2021 (1 fletë);



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Urdhër Pune datë 08.11.2021 (1 fletë); Matjet e kryera në lokomotivën nr. 1041 (1 fletë); Fletë blloku magazine që nuk dallohet nëse është hyrje apo dalje ose data apo numri serial (1 fletë); Fletë blloku magazine që nuk dallohet nëse është hyrje apo dalje ose data apo numri serial (1 fletë); Fletë blloku magazine që nuk dallohet nëse është hyrje apo dalje ose data apo numri serial (1 fletë); Fletë dalje nr. 5, datë 11.11.2021 (1 fletë); Urdhër dorëzimi pa numër dhe datë 11.11.2021 (1 fletë); Kërkesë për tu furnizuar me agregatët nga Z.,SHPK me datë 04.07.2019 (1 fletë); Urdhër i brendshëm nr. 202/1, datë 04.07.2019 për ngritjen e komisionit për dorëzimin e agregatëve (1 fletë); Procesverbal Dorëzimi (1 fletë); Fletë dalje nr. 78, datë 05.07.2019 (1 fletë); Faturë tatimore shitje me datë 05.07.2019 por pa numër serial (1 fletë); Procesverbal dorëzimi me datë 05.07.2019 (1 fletë); Fletë dalje nr. 79, datë 05.07.2019 (1 fletë); Faturë shitje me datë 05.07.2019 (1 fletë). Në total keni sjellë 21 fletë me observacionet tuaja të shoqëruara nga shkresa që keni dërguar këto observacione tek HSH SHA, atë me nr. 109/45 Prot., datë 15.06.2023 ku cilësoni se janë të njëjta me ato që keni dërguar në hartimin e projekt raportit por dokumentacioni juaj ka shumë mangësi pasi nuk ka numër protokolli, nuk ka datë në shumë raste por mbi të gjitha as ndonjë kartelë shoqëruese ku të cilësoheshin fletët dhe objekti i tyre sic janë listuar më lart në këtë përgjigje.

#### **7 Mbi realizimin e kontratës me objekt “Riparim vepra arti (mbrojtja e urës hekurudhore të Rrogozhinës)”.**

-Kontrata midis BOE “M .,” SHPK & “V. K.,” SHPK & “E.K.,” SHPK & “N.-G.,” SHPK dhe HSH SHA, është me nr. 110/4 Prot., datë 03.11.2022 dhe objekt “Riparim vepra arti (mbrojtja e urës hekurudhore të Rrogozhinës)”. Është me afat 45 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit nga AK të kontratës, sipas nenit 5 “Realizimi i punimeve” të kontratës së mësipërme me nr. 110/4 Prot., datë 03.11.2022. Vlera e plotë e kontratës është 37,799,726.4 lekë me TVSH.

-Kontrata midis Mbikëqyrësit të punimeve “F. S.,” SHPK, përfaqësuar nga drejtuesi ligjor z. S.B. me nr. licence MK.3429/1 dhe HSH SHA, është me nr. 110/5 Prot., datë 03.11.2022.

-Akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, është mbajtur në datën 03.11.2022 dhe nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe HSH SHA Durrës, përfaqësuar nga G.L. (Nr.10 në inventarin e dosjes teknike).

-Akti i piketimit të objektit, është mbajtur me procesverbalin e datës 03.11.2022 dhe është nënshkruar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi. (Nr.11 në inventarin e dosjes teknike).

-Njoftimi për fillimin e punimeve është me datë 03.11.2022 dhe i nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve. (Nr.12 në inventarin e dosjes teknike).

-Sa më sipër, punimet kanë filluar në datën 03.11.2022 dhe përfundojnë pas 45 ditësh kalendarike sipas nenit 5 “Realizimi i punimeve”, i kontratës së lidhur midis HSH SHA dhe sipërmarrësit dhe data e përfundimit të tyre (pas 45 ditësh) është data 17.12.2022.

-Njoftimi për përfundimin e punimeve, mban datën 16.12.2022 dhe njëkohësisht dita e fundit e punimeve sipas ditarit të punimeve është data 16.12.2022.

-Nga auditimi në terren për verifikimin e zbatimit të punimeve, grupi i auditimit pasi verifikoi disa herë zërat e punimeve të kryera pa praninë e mbikëqyrësit në periudhën 17.04.2023 deri 25.04.2023 pasi mbikëqyrësi e kishte të pamundur prezencën në terren, prezencë e cila u realizua nga ana e mbikëqyrësit në datën 26.04.2023, konstatoi në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve z. S.B., se kishte diferencë në zëra punimesh që paraqiten në vijim.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Nr.	Nr.anal	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera
<b>I</b>	<b>Punime Prishje, Devijim dhe Rrugë aksesi të përkohshme të kanalit</b>					
1	3.2	Prerje bimë të vogla Ø 10 cm	m <sup>2</sup>	2,450	14	34.300
3	An.NG.1	Shkulje/Këputje pilash ekzistuese druri të vjetra	copë	125	9,520	1,190,000
6	3.161/1	Rrafshim i skarpatës për ndërtim argjinature	m <sup>2</sup>	1405	35	49.175
<b>Totali</b>						<b>1,273,475</b>
<b>TVSH</b>						<b>254,695</b>
<b>Totali me TVSH</b>						<b>1,528,170</b>

-“Prerje bimë të vogla Ø 10 cm”. Në situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 2450 m<sup>2</sup> sipërfaqe e pastruar. Në librezën e masave po ashtu njësoj. Nga verifikimi në terren (foto në vijim), u konstatua se ky zë punimesh nuk është ekzekutuar për më tepër që punimet kanë përfunduar afro 3 muaj më parë dhe duhej të ishte evidente sipërfaqja e pastruar nga bimët. Nuk janë mbajtur fotografi gjatë procesit të pastrimit të bimëve. Si rezultat, në situacionin përfundimtar është pasqyruar më tepër vlera 34.300 lekë për prerje bimësh.

-“Shkulje/Këputje pilash ekzistuese druri të vjetra”. Në situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 125 copë pilash të shkullura. Nga verifikimi në terren (foto në vijim), u konstatua se ky zë punimesh nuk është ekzekutuar për më tepër që ura e Rrogzhinës nuk mbështetet mbi pila druri por mbi kollona betoni. Nuk janë mbajtur fotografi gjatë procesit të shkulljes së pilave të drurit gjithsesi. Si rezultat, në situacionin përfundimtar është pasqyruar më tepër vlera 1,190,000 lekë për shkullje pilash ekzistuese.

-“Rrafshim i skarpatës për ndërtim argjinature”. Në situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 1405 m<sup>2</sup> sipërfaqe e rrafshuar. Në librezën e masave po ashtu njësoj. Nga verifikimi në terren (foto në vijim), u konstatua se ky zë punimesh nuk është ekzekutuar për më tepër që punimet kanë përfunduar afro 3 muaj më parë dhe duhej të ishte evidente sipërfaqja e rrafshuar e skarpatave të lumit. Nuk janë mbajtur fotografi gjatë procesit të rrafshimit të skarpatave. Si rezultat, në situacionin përfundimtar është pasqyruar më tepër vlera 49.175 lekë për Rrafshim i skarpatës për ndërtim argjinature.

-Sa më sipër, vlera në total e punimeve të pakryera është 1,528,170 lekë. Kjo vlerë është efekt financiar në dëm të buxhetit të shtetit.

-Lidhur me zërin “F.V. Mbushje me gurë kave” u konstatua si në vijim.

Nr.	Nr.anal	Përshkrimi i punimeve	Njësia	sasia	Çmimi	Vlera
<b>II</b>	<b>Ndërtim strukture mbrojtëse e shtratin të lumit me pritë betoni dhe gurë të mëdhenj kave</b>					
4	3.352	F.V. Mbushje me gurë kave të mëdhenj D>70 cm për mbrojtje të këmbëve të urës dhe stabilizim dhe uljen e gërryerjes së mëtejshme, t=2ton/m <sup>3</sup> .	m <sup>2</sup>	4121.516	1790	7,377,514
<b>Totali</b>						<b>7,377,514</b>
<b>Totali me TVSH</b>						<b>8,853,016</b>

-Zëri “F.V. Mbushje me gurë kave të mëdhenj D>70 cm për mbrojtje të këmbëve të urës dhe stabilizim dhe uljen e gërryerjes së mëtejshme, t=2ton/m<sup>3</sup>”. Nga auditimi në terren, u konstatua se ishte e pamundur për grupin e auditimit që të mund të verifikonte sasinë e deklaruar prej 9254 m<sup>3</sup> gurë të hedhur në shtratin e lumit. Edhe nga fotografitë e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ishte e pamundur që të evidentohej kjo sasi e deklaruar. Gjithsesi, nga fotot duket një shtresë guri kave e hedhur mbi shtratin e lumit por jo sipas projektit pra të duket se është gërmuar shtrati i lumit deri në thellësinë e këmbëve të urës ku të dukej dhe guri i kavës i hedhur. Sipërfaqja e shtratin të lumit ku është punuar sipas projektit të azhornuar, rezulton të jetë afro



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

3666.06 m<sup>2</sup>. Nëse gurët janë me dimensione 70x70 cm dhe nëse supozojmë se janë hedhur dy shtresa guri kave dhe jo një siç duket në ato pak foto, rezulton se në total janë hedhur:  $(3666.06 \text{ m}^2 * 0.7 \text{ m}) * 2 = 5132.484 \text{ m}^3$  gurë kave dhe jo 9254 m<sup>3</sup> sa dhe deklarohet në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar. Si rezultat, sasia në m<sup>3</sup> e gurëve që nuk evidentohet dot nëse janë hedhur ose jo në shtratin e lumit poshtë urës së Rogozhinës në themelet e këmbëve të urës, është  $(9254 \text{ m}^3 - 5132.484 \text{ m}^3) = 4121.516 \text{ m}^3$ . Kjo sasi ka vlerën e 8,853,016 lekë, vlerë e cila konsiderohet si efekt financiar në dëm të buxhetit të shtetit deri në momentin që HSH SHA në bashkëpunim me institucionet shtetërore përkatëse për menxhimin dhe mbrojtjen e lumenjve, duke angazhuar specialistë të fushës me paisje skanimi të lumenjve, të verifikojnë nëse sipërmarrësi BOE “M.” SHPK & “V.K.” SHPK & “E.K.” SHPK & “N.-G.” SHPK, ka hedhur sasinë prej 4121.516 m<sup>3</sup> gurë kave në shtratin e lumit Shkumbin, në këmbët e urës Thanasaj në Rogozhinë, të evidentuar nga grupi i auditimit mbi dyshime të arsyeshme se ky zë punimesh në këtë sasi, mund të mos jetë ekzekutuar duke u përfituar padrejtësisht vlera 8,853,016 lekë nga BOE “M.” SHPK & “V. K.” SHPK & “E.K.” SHPK & “N.-G.” SHPK, vlerë e cila duhet të kërkohet për arkëtim nga HSH SHA nëse rezulton se dyshimet e grupit të auditimit, kthehen në fakte të pakundërshtueshme.

-Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve, është nënshkruar në datën 27.12.2022 me shkresën me nr.110/15 Prot., nga komisioni i marrjes në dorëzim me përbërje M.K., L.S., dhe P.D., nga sipërmarrësi përfaqësuar nga A.M., dhe mbikëqyrësi S.B.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	<b>Pamundësi verifikimi në terren i disa zërave punimesh për arsye të mungesës së dokumentacionit teknik në dosjen e zbatimit të punimeve dhe prezencës së theksuar të ujit në lumin Shkumbin.</b>
<b>Situata:</b>	Midis kontraktorit “M.” SHPK & “V.K.” SHPK & “E.K.” SHPK & “N.-G.” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, është lidhur kontrata nr.110/4 Prot., datë 03.11.2022 dhe objekt “Riparim vepra arti (mbrojtja e urës hekurudhore të Rogozhinës)”, me afat 45 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit dhe vlerë kontrate 37,799,726.4 lekë me TVSH. Nga auditimi në terren për verifikimin e zbatimit të punimeve, rezultoi se për zërin “F.V. Mbushje me gurë kave të mëdhenj D>70 cm për mbrojtje të këmbëve të urës dhe stabilizim dhe uljen e gërryerjes së mëtejshme, t=2ton/m <sup>3</sup> ”, ishte e pamundur për grupin e auditimit që të verifikohet realizimi i këtij zëri, për sasinë e deklaruar e gurëve të hedhur në shtratin e lumit prej 9,254 m <sup>3</sup> , sa deklaruar në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar, për arsye të prezencës së ujit në lumin Shkumbin.
<b>Kriteri:</b>	-Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	-Vështirësi në kryerjen e verifikimeve në terren të punimeve të kryera. -Risk për dëmtim të mundshëm të urës në të ardhmen e afërt.
<b>Shkaku:</b>	Mos respektimi i specifikimeve teknike të kontratës dhe Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

<b>Rëndësia:</b>	E Lartë
<b>Rekomandim:</b>	Hekurudha Shqiptare SHA, në bashkëpunim me institucionet shtetërore përkatëse për menaxhimin dhe mbrojtjen e lumenjve, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, duke angazhuar specialistë të fushës me pajisje përkatëse për skanimin e lumenjve, të verifikojnë nëse sipërmarrësi BOE “M.,” SHPK & “V.K.,” SHPK & “E.K.,” SHPK & “N.-G.,” SHPK, ka hedhur sasinë prej 4121.516 m <sup>3</sup> gurë kave, me dimensione D>70 cm, në shtratin e lumit Shkumbin, poshtë urës Thanasaj në Rrogozhinë.
<b>Rekomandim:</b>	“Hekurudha Shqiptare” SHA, në bashkëpunim me institucionet shtetërore përkatëse për menaxhimin dhe mbrojtjen e lumenjve, të verifikojnë nëse kontraktori “M.,” SHPK & “V.K.,” SHPK & “E.K.,” SHPK & “N.-G.,” SHPK, kanë realizuar zërin e punimeve të mësipërme. Në rast se nuk kryhet ky verifikim vlera 8,853,016 lekë, do të konsiderohet dëm ekonomik.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	<b>Zëra punimesh të pa kryera.</b>
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i zbatimit të kontratës të lidhur me objekt “Riparim vepra arti (mbrojtja e urës hekurudhore të Rrogozhinës)” midis kontraktorit “M.,” SHPK &amp; “V.K.,” SHPK &amp; “E.K.,” SHPK &amp; “N.-G.,” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr.110/4 Prot., datë 03.11.2022, me afat 45 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit nga AK të kontratës dhe vlerë 37,799,726.4 lekë me TVSH, nga auditimi në terren për verifikimin e zbatimit të punimeve grupi i auditimit konstatoi, se kishte diferenca në zëra punimesh. “Prerje bimë të vogla Ø 10 cm”. Në librezën e masave dhe situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 2,450 m<sup>2</sup> sipërfaqe e pastruar. Nga verifikimi në terren, u konstatua se ky zë punimesh nuk është.</p> <p>Për zërin “Shkulje/Këputje pilash ekzistuese druri të vjetra”, në situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 125 copë pilash të shkultura. Nga verifikimi në terren, u konstatua se ky zë punimesh nuk është ekzekutuar.</p> <p>Për zërin “Rrafshim i skarpatës për ndërtim argjinature”, në librezën e masave e situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 1,405 m<sup>2</sup> sipërfaqe e rrafshuar. Nga verifikimi në terren, u konstatua se ky zë punimesh nuk është ekzekutuar.</p> <p>Sa më sipër, vlera në total e punimeve të pakryera është 1,528,170 lekë.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mangësi në kryerjen me cilësi të punimeve me pasojë dëm ekonomik.
<b>Shkaku:</b>	Mos pasqyrimi me korrektësi i volumeve të kryera.
<b>Rëndësia:</b>	E Lartë
<b>Rekomandim:</b>	Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 1,528,170 lekë, nga kontraktori “M.,”



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

	SHPK & “V.K.,” SHPK & “E.K.,” SHPK & “N.-G.” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer nga kontraktori, bazuar në kontratën nr.110/4 Prot., datë 03.11.2022.
--	--

*Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 109/519 Prot., datë 04.07.2023 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, nga sipërmarrësi i punimeve (nr. 109/48 Prot., datë 27.06.2023), “BOE “M.” SHPK & “V. K.,” SHPK & “E.K.,” SHPK & “N.-G.” SHPK, përfaqësuar nga znj. A.M., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

#### **Pretendimi i subjektit:**

1 (faqe 1)-“.....Zëri i punimeve ‘Prerje bime të vogla ø-10 cm’. Referuar këtij zëri punimesh..... Ky zë punimesh është ndjekur dhe verifikuar hap pas hapi, ..... Sa i takon akt konstatimit nr. 14, ku shprehet se ....., kjo nuk qëndron”.

2 (faqe 5)-“.....Zëri i punimeve ‘Shkulje/këputje pilash ekzistuese druri të vjetra’. Referuar këtij zëri punimesh..... Ky zë punimesh është ndjekur dhe verifikuar hap pas hapi, ..... Sa i takon akt konstatimit nr. 14, ku shprehet se ....., kjo nuk qëndron”.

3 (faqe 8)-“.....Zëri i punimeve ‘Rrafshim i skarpatës për ndërtim argjinature’. Referuar këtij zëri punimesh..... Ky zë punimesh është ndjekur dhe verifikuar hap pas hapi, ..... Sa i takon akt konstatimit nr. 14, ku shprehet se ....., kjo nuk qëndron”.

4 (faqe 10)-“..... Zëri i punimeve ‘F.V. Mbushje me gurë kave të mëdhenj  $D > 70$  cm për mbrojtje të këmbëve të urës dhe stabilizim dhe uljen e gërryerjes së mëtejshme,  $t=2\text{ton/m}^3$ ’. ....., qëllimi kryesor i kontratës ka qenë rehabilitimi i tabanit të dy palankolave metalike të urës. .... Theksojmë që jemi të gatshëm dhe në dispozicion në çdo kohë për çdo lloj verifikimi për këtë zë punimesh edhe pse në dijeninë tonë nuk ka institucion kompetent me instrumentat përkatëse që mund të realizojë një gjë të tillë”.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Referuar pretendimeve të mësipërme, sqarojmë:

Lidhur me pretendimet e pikës 1, 2 dhe 3: Pretendimet tuaja, nuk merren në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Auditimi. Dokumentacioni i sjellë me observacionin tuaj, është i jëjtë me atë që keni sjellë në hartimin e Projekt Raportit të Auditimit. Argumentat tuaja për këto pika, janë trajtuar njëherë në fazën e hartimit të Projekt Raportit të Auditimit.

Lidhur me pretendimet e pikës 4: Pretendimet tuaja, nuk merren në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Auditimi. Pikërisht sepse cilësoni se në dijeninë tuaj nuk ka institucion që të kryejë veprimet e verifikimit të punimeve për këtë zë, ndaj dhe KLSH ka shprehur dyshime të arsyeshme për mos kryerjen e këtij zëri dhe ka propozuar verifikimin e ekzekutimit të këtij zëri nga instancat kompetente. Ju për më tepër, duhej të kishit paraqitur foto të hapjes së gropës në thellësinë e gjatësisë së pilotave të urës sic paraqitet në projektin tuaj të kryer nga një anëtar i BOE. Referuar ligjit për disiplinimin e punimeve të ndërtimit sic ju cilësoni, pikërisht tek i njëjti ligj, kërkohet që gjatë zbatimit të punimeve, të mbahen dokumentacionet e nevojshme vërtetuese të kryerjes/ekzekutimit të punimeve me qëllim shmangien e ngritjes së dyshimeve të arsyeshme si në rastin konkret që pikërisht mungesa e dokumentacionit fotografik të hapjes së gropës poshtë urës, është arsyeja e dyshimeve të arsyeshme që ngre grupi i auditimit. Për këtë arsye nuk kemi



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

rekomanduar kthimin e shumës së përmendur pra duke mos e klasifikuar si dëm ekonomik por si vlerë që duhet verifikuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU).

#### **8. Mbi realizimin e kontratës me objekt “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Shkozet-Kavajë”. (Km 32+400 – 34+000)**

-Kontrata midis “C.” SHPK dhe HSH SHA, është me nr. 581/2 Prot., datë 29.07.2019 dhe objekt “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Shkozet-Kavajë” Km 32+400 – 34+000. Është me afat 3 muaj kalendarik nga dita e nënshkrimit të kontratës midis palëve, sipas nenit 4 “Kryerja e punimeve”. Vlera e plotë e kontratës është 10,0047,172 lekë me TVSH. Përfaqësuesi i AK për ndjekjen e zbatimit të kontratës, është Njësia e Biznesit dhe Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, Durrës, sipas nenit 2 të kontratës së punimeve “Komunikimi dhe përfaqësimi”.

-Kontrata midis Mbikëqyrësit të punimeve “D.” SHPK, përfaqësuar nga Z. V.T., me nr. licence MK.1676/8 dhe HSH SHA, është me nr. 581/3 Prot., datë 29.07.2019.

-Njoftimi për fillimin e punimeve është me datë 30.07.2019 dhe i nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve.

-Me shkresën nr. 581/11 Prot., datë 25.10.2019, është nënshkruar midis HSH SHA dhe OE “C.” SHPK, amendamenti i kontratës bazë i cili zgjat afatin e zbatimit të punimeve deri në datën 28.11.2019.

-Punimet kanë përfunduar në datën 18.02.2020, sipas njoftimit të nënshkruar nga sipërmarrësi OE “C.” SHPK.

-Punimet kanë përfunduar me vonesa dhe HSH SHA, ka mbajtur penalitete nga OE “C.” SHPK për vonesat në ekzekutimin e kontratës.

#### **9. Mbi realizimin e kontratës me objekt “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Shkozet-Kavajë”. (Km 6+500 – 7+500 dhe 11+000 – 12+000)**

-Kontrata midis “C.” SHPK dhe HSH SHA, është me nr. 582/3 Prot., datë 08.08.2019 dhe objekt “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Shkozet-Kavajë” Km 6+500 – 7+500 dhe 11+000 – 12+000. Është me afat 3 muaj kalendarik nga dita e nënshkrimit të kontratës midis palëve, sipas nenit 4 “Kryerja e punimeve”. Vlera e plotë e kontratës është 14,883,272 lekë me TVSH. Përfaqësuesi i AK për ndjekjen e zbatimit të kontratës, është Njësia e Biznesit dhe Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, Durrës, sipas nenit 2 të kontratës së punimeve “Komunikimi dhe përfaqësimi”.

-Kontrata midis Mbikëqyrësit të punimeve “D.” SHPK, përfaqësuar nga Z. V.T., me nr. licence MK.1676/8 dhe HSH SHA, është me nr. 582/4 Prot., datë 08.08.2019.

-Njoftimi për fillimin e punimeve është me nr. 582/9 Prot., datë 09.08.2019 dhe i nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve.

-Me shkresën nr. 582/15 Prot., datë 21.10.2019, është nënshkruar midis HSH SHA dhe OE “C” SHPK, amendamenti i kontratës bazë i cili zgjat afatin e zbatimit të punimeve deri në datën 06.12.2019.

-Punimet kanë përfunduar në datën 18.02.2020, sipas njoftimit të nënshkruar nga sipërmarrësi OE “C.” SHPK.

-Punimet kanë përfunduar me vonesa dhe HSH SHA, ka mbajtur penalitete nga OE “C.” SHPK për vonesat në ekzekutimin e kontratës.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

#### **10. Mbi realizimin e kontratës me objekt “Punime për mbrojtjen e linjës”. (Km 49+197 – 49+380 perigoni Peqin-Elbasan, L=135 ml)**

-Kontrata midis “C.” SHPK dhe HSH SHA, është me nr. 582/3 Prot., datë 08.08.2019 dhe objekt “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Shkozet-Kavajë” Km 49+197 – 49+380 perigoni Peqin-Elbasan, L=135 ml. Është me afat 60 ditë kalendarik nga dita e nënshkrimit të kontratës midis palëve, sipas nenit 4 “Kryerja e punimeve”. Vlera e plotë e kontratës është 4,126,417 lekë me TVSH. Përfaqësuesi i AK për ndjekjen e zbatimit të kontratës, është Njësia e Biznesit dhe Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, Durrës, sipas nenit 2 të kontratës së punimeve “Komunikimi dhe përfaqësimi”.

-Kontrata midis Mbikëqyrësit të punimeve “H.E.” SHPK, përfaqësuar nga Z. E.Q., me nr. licence MK.3730/1 dhe HSH SHA, është me nr. 57/7 Prot., datë 12.07.2021.

-Njoftimi për fillimin e punimeve, dorëzimin e sheshit të ndërtimit dhe akt piketimin, është me nr. 57/11 Prot., datë 13.07.2021 dhe i nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve.

-Punimet kanë përfunduar brenda afatit, në datën 10.08.2021, sipas njoftimit të nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve.

#### **11. Mbi realizimin e kontratës me objekt “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Milot-Lezhë”. (Km 58+700 – 59+380; Km 63+200 – 64+500; Km 66+800 – 67+100, 300 ml Ishull Lezhë)**

Kontrata midis “B.” SHPK dhe HSH SHA, është me nr. 580/2 Prot., datë 02.09.2019 dhe objekt “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Milot-Lezhë”, Km 58+700 – 59+380; Km 63+200 – 64+500; Km 66+800 – 67+100, 300 ml Ishull Lezhë. Është me afat 90 ditë kalendarik nga dita e nënshkrimit të kontratës midis palëve, sipas nenit 4 “Kryerja e punimeve”. Vlera e plotë e kontratës është 14,400,376 lekë me TVSH. Përfaqësuesi i AK për ndjekjen e zbatimit të kontratës, është Njësia e Biznesit dhe Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, Durrës, sipas nenit 2 të kontratës së punimeve “Komunikimi dhe përfaqësimi”.

-Kontrata midis Mbikëqyrësit të punimeve “A.S.” SHPK, përfaqësuar nga Z. E.D., me nr. licence MK.2692/1 dhe HSH SHA, është me nr. 580/3 Prot., datë 02.09.2019.

-Njoftimi për fillimin e punimeve, dorëzimin e sheshit të ndërtimit dhe akt piketimin, është me datë 03.09.2019 dhe i nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve, sipërmarrësi dhe HSH SHA përfaqësuar nga Administratori A.D.

-Me shkresën me nr. 580/13 Prot., datë 25.11.2019, është nënshkruar midis OE “B.” SHPK dhe HSH SHA, amendamenti i kontratës bazë që zgjat afatin e ekzekutimit të punimeve deri në datën 23.12.2019.

-Punimet kanë përfunduar brenda afatit, në datën 23.12.2019, sipas njoftimit të nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve dhe protokolluar në HSH SHA me nr.581/16 Prot., datë 23.12.2019.

#### **2.7 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të MFK si dhe Auditit të Brendshëm.**

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në Hekurudhën Shqipëtare sha, grupi auditues kreu verifikimet mbi implementimin dhe plotësimin e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

kërkesave mbi funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale dhe realizimin e objektivave të vendosura për komponentët e mëposhtëm:

1. *Mjedisin e kontrollit*
2. *Menaxhimin e riskut*
3. *Aktivitetet e kontrollit*
4. *Informimin dhe komunikimin*
5. *Monitorimin*

Ky auditimi u krye për vlerësimin, nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaria dhe kontrolli, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare të Institucionit është efektiv dhe eficient, duke i adresuar drejt risqet pontenciale, për të dhënë garanci të mjaftueshme në realizimin e misionit dhe objektivave të vendosura nga HSH-ja.

Hekurudha Shqiptare sha, është ndërmarrje publike, me kapital tërësisht shtetëror. Ajo organizohet dhe vepron në formën e një shoqërie anonime, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”. HSH sha, ka për detyrë administrimin e infrastrukturës hekurudhore dhe nëpërmjet fondeve shtetërore, realizon investime në infrastrukturë për rinovimin, modernizimin, mirëmbajtjen, zgjerimin e saj si dhe për administrimin e sistemeve të drejtimit e të sigurisë.

HSH sha, e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; ligjin nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

Drejtimi dhe administrimi i Shoqërisë realizohet nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë.

Këshilli Mbikëqyrës vëzhgon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga Administratori i Shoqërisë. Administratori i Shoqërisë ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të Shoqërisë dhe kryen të gjitha veprimet e Administrimit të Shoqërisë.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është transporti i udhëtarëve dhe mallrave, ngarkim, shkarkim dhe shërbime të tjera hekurudhore. Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e Shoqërive të reja, si edhe pjesëmarrjen në kapitalin e Shoqërive të tjera jashtë vendit.

**1. Mjedisi i Kontrollit.** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se: Mjedisi kontrollit përbën bazën ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit dhe përfshin vendosjen e objektivave që sigurojnë përmbushjen e misionit të institucionit, etikën personale dhe profesionale, strukturën organizative, filozofinë dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Institucioni ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) me Urdhërin e Administratorit të Shoqërisë nr.112, datë 28.07.2022, në përputhje me UMF nr.10359, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar” dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2.4.

Struktura e HSH sha, ka pësuar ndryshime të shpeshta dhe si rrjedhojë në moment të caktuara ka pasur mospërputhje mes strukturës dhe rregullores së brendshme të funksionimit të saj. Me ndryshimet e fundit të Rregullores së miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, me Vendimin nr.15, datë 23.12.2022, janë zgjidhur këto problematika. Shoqëria ka një rregullore për rekrutimin e





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

punonjësve e miratuar me Vendimin nr.1170, datë 15.11.2018, e cila vazhdon të zbatohet në cdo rast.

a) Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Në referencë të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nevojitet që punonjësit të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjelltë, mbështetur në krijimin e një Kodi të Brendshëm Etik. Nga auditimi u konstatua se, Institucioni ka hartuar kodin etik me Vendimin nr.10, datë 01.12.2022.

b) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Në Rregulloren e brendshme janë të përcaktuara qartë struktura organizative e HSH Sha, funksionet dhe detyrat e funksioneve të larta të drejtimit, funksionet e drejtorive dhe sektorëve, si dhe marrëdhëniet midis tyre, kanalet dhe mënyrat e komunikimit.

c) Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve.

Për vitet objekt auditimit, u konstatua se ky Institucion ka paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, referuar Manualit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kap.II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafët “Politikat dhe praktikrat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”. Institucioni ka kryer trajnime të ndryshme gjithë përfshirëse.

d) Politikat dhe praktikrat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën 01.06.2019- 31.12.2022, nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve pasi punonjësit e administratës së HSh-së janë pranuar me Kodin e Punës, pra nuk është e nevojshme vlerësimi i tyre.

**2. Menaxhimi i riskut.** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se: ky institucion ka miratuar regjistrin e riskut dhe ka bërë vlerësimin dhe kontrollin e risqeve. U konstatua se në regjistrat e riskut janë të gjitha pasqyrat e plotësuara me objektivat vjetore të aktivitetit.

**Grupi i menaxhimit strategjik i ngritur me Urdhërin nr.112, datë 28.07.2022, nuk ka të dokumentuar mbledhjet e zhvilluara të cilat duhet të jenë minimalisht 4 herë në vit.**

**Kordinatori i menaxhimit të riskut nuk përputhet me pozicionin e punës pasi është punonjës IT.**

Për sa më lart, drejtuesit e HSH, në cilësinë e nëpunësit autorizues, për periudhën objekt auditimi, nuk ka zbatuar detyrimin e përcaktuar në nenin 10, “Përgjegjshmëria menaxheriale e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut”, pika 1, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 të MFK, ku përcaktohet se:

**Neni 10/1.** Kordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike.

Nga ana e Auditit të Brendshëm janë lënë rekomandime për ngritjen e grupit të menaxhimit të riskut.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

**3. Aktivitetet e kontrollit.** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se: Planet e e veprimtarisë janë hartuar në përputhje me planin kombëtar të zhvillimit të transportit.

Nga auditimi është konstatuar se nuk janë hartuar gjurmët e auditimit sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, neni 16, “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”, pika 2, ku përcaktohet se: *“Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”*, si dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Vendimin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, anekset 2, 3 dhe 4 Projekt Raportit të Auditimit.

**4. Informimi dhe komunikimi.** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi: HSH ka hartuar programin e transparencës, bazuar në të drejtën e informimit, i cili zbatohet dhe është publikuar në faqen zyrtare të Hekurudhës Shqipëtare sha. Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është bërë në formën dhe kohën e duhur, për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisë. Titullari është informuar nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, nëpërmjet relacioneve dhe raporteve rreth këtyre mbledhjeve. Sektori i Financës, ka raportuar tek nëpunësi autorizues me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, duke hartuar raporte monitorimi mujore, apo tremujore. Punonjësit brenda instiucionit vijojejnë të komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtëme, pa përjashtuar komunikimin elektronik.

**5. Monitorimi.** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se: Është hartuar një manual monitorimi, i cili zbatohet nga punonjësit sipas niveleve përkatëse.

- Nga auditimi konstatohet se në vijim të përcaktimit në pikën 23/1, të nenit 4, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin: *“Nëpunës autorizues i nivelit të dytë”*, dhe /ose të niveleve të tjera, janë nëpunës të administratës publike në secilën nga njësitë e vartëse, me buxhet më vete të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues...” u konstatuan se për 4 (katër) vitet objekt auditimi janë përpiluar planet vjetore të auditit të brendshëm.

**Titulli i Gjetjes:** Grupi i menaxhimit strategjik i ngritur me Urdhërin nr.112, datë 28.07.2022, nuk ka të dokumentuar mbledhjet e zhvilluara të cilat duhet të jenë minimalisht 4 herë në vit. Kordinatori i menaxhimit të riskut nuk përputhet me pozicionin e punës pasi është punonjës IT.

#### Situata:

Sistemi i kontrollit të brendshëm i HSH-së vlerësohet jo efektiv dhe me mangësi në lidhje me funksionimin e të pese komponentëve që veprojnë së bashku në një mënyrë të integruar, duke ndikuar drejtpërdrejt në mosfunksionimin e plotë të sistemit të kontrollit të brendshëm të kësaj njësie.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

<b>Kriteri:</b>	Nga auditimi rezultoi se “Hekurudha Shqiptare” SHA ka përcaktuar koordinator të menaxhimit të riskut një specialist IT, ndërkohë që koordinator i menaxhimit të riskut duhet të jetë Nënpunësi Autorizues. Grupi Menaxhimit Strategjik nuk kishte të dokumentuar mbledhjet e zhvilluara, të cilat duhet të jenë minimalisht 4 herë në vit, e përcaktuar në UMF nr.16 datë 20.07.2016, pika 2.2.4, “Roli i Grupit të Menaxhimit Strategjik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 10.
<b>Shkaku:</b>	UMF nr.16, datë 20.07.2016 pika 2.2.4, “Roli i Grupit të Menaxhimit Strategjik”.
<b>Rëndësia:</b>	Mos efektivitet në menaxhimin e procesve të punës.
<b>Rekomandime:</b>	Neglizhencë e strukturave drejtuese. E mesme Nga ana e Hekurudha Shqiptare sha, të merren masa që Grupi Menaxhimit Strategjik të mblidhet minimalisht 4 herë në vit, duke dokumentuar diskutimet dhe vendimet e marra. Nga ana e Hekurudha Shqiptare sha, të merren masa që koordinatori i menaxhimit të riskut të jetë nënpunësi autorizues.

**Titulli i gjetjes:** Nga auditimi u konstatua Shoqëria Hekurudha Shqiptare sha, për periudhën objekt auditimi, titullari i saj nuk ka dhe miratuar gjurmët standarte të auditimit.

<b>Situata:</b>	“Hekurudha Shqiptare” SHA, për periudhën objekt auditimi nuk ka të hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit, e cila detajon procedurat kryesore dhe siguron që të gjitha operacionet e njësisë publike të dokumentohen në formën që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoritetit mbikëqyrës të kuptojnë mjedisin e kontrollit, veprim jo në përputhje me ligji nr.10296, datë 08.07.2010, ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, Kapitulli II, “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010, ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, Kapitulli II, “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Nuk jep siguri në dokumentimin e operacioneve të njësisë publike dhe nuk j'u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoritetit mbikëqyrës të kuptojnë mjedisin e kontrollit.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatim i akteve ligjore dhe nënligjore të fushës prej strukturave drejtuese.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandim:</b>	Nga ana e Hekurudha Shqiptare sha, Administratori i shoqërisë, të miratojë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoritetit mbikëqyrës të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

kuptojnë mjedisin e kontrollit.

#### **Mbi vlerësimin e auditimit të brendshëm.**

**Veprimtaria e Auditit të Brendshëm (AB):** Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor të auditimit nga ana sasiore dhe analiza sipas llojeve dhe zbulimeve, si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit, bazuar në auditimin e përputhshmërisë, sipas kërkesave të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”.

Për arsye të ristrukturimit të Hekurudhës Shqiptare sha, në bazë të ligjit nr. 90/2021, datë 01.07.2021, “Për ndarjen e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sha”, kjo shoqëri është ndarë në 4 shoqëri aksionere.

- Struktura e AB është e organizuar si sektor dhe përmban në organikën e saj 3 auditues (1 përgjegjës sektori dhe dy specialistë). Gjatë vitit 2019, 2020, 2021, 2022 struktura ka funksionuar sipas organikës. Struktura është e plotë dhe nuk cënon procesin e auditimit dhe reflektohet në performancën e këtij sektori, pasi nuk ka sjellë në uljen e numrit të auditimeve dhe gjithashtu në mungesën e kontrollit të cilësisë nga strukturat përgjegjëse të auditimit.

*Nga auditimi i dosjeve të personelit të Sektorit të AB, rezultoi se 2 audituesit e sektorit disponojnë “Certifikatën e Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik”.*

Shefi i sektorit është me profesion ekonomist me vjetërsi pune në profesion mbi 30 vjet, i certifikuar në vitin 2009 si auditues në sektorin publik dhe me një stazh pune si audit prej 6 vitesh. Dy specialistët e auditimit janë punonjës të diplomuar si ekonomistë. Njëri prej tyre ekonomist me një përvojë pune në profesion me mbi 30 vjet, ndërsa në strukturat e auditimit 9 vjet e certifikuar në vitin 2009. Auditues tjetër i kësaj strukture është diplomuar në administrim biznes me përvojë pune prej 3 vjetësh.

**Misioni i Sektorit të AB (SAB):** Misioni i SAB është:

- të japë siguri të arsyeshme për titullarin e HSH sha në mënyrë të pavarur dhe objektive, këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në HSH sha.

- kryerjen e çdo angazhim auditimi në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, standartet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të pranuar dhe të shpallura nga MFE;

- realizimin e planit të konsoliduar strategjik e vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në njësitë e HSH sha;

- të asistojë të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre, nëpërmjet analizave të pavarura, vlerësimeve, këshillimeve dhe rekomandimeve, lidhur me veprimet e ekzaminuara.

**Objektivat kryesore:** Qëllimi i Sektorit të AB të HSH-së, është që nëpërmjet veprimtarisë së tij të pavarur të japë siguri objektive dhe të ofrojë këshilla për drejtimin, me qëllim shtimin e vlerës dhe përmirësimin e veprimtarisë së HSH sha, në përmbushjen e objektivave të veta si dhe të ndihmojë për vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit të riskut me qëllim rritjen e efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm në këtë Institucion dhe të njërive vartëse të tij.

**Kuadri ligjor** në bazë të të cilit SAB është mbështetur gjatë realizimit të misionit të saj është si më poshtë:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

- Ligji nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me UMFE nr.100, datë 25.10.2016;
- Kodi i Etikës për Audituesit e Brendshëm miratuar me UMFE nr.56, datë 10/12/2015;
- Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar;
- Ligji nr.142/2016, datë 22/12/2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.
- Statuti i HSH sha;
- Rregullorja e shfrytëzimit teknik të hekurudhës (RSHT);
- Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të HSH;
- Si dhe çdo dispozitë tjetër që rregullon mardhëniet e këtij subjekti.

**Objektivat kryesore** të Sektorit të Auditimit për periudhën objekt auditimi janë:

- a) Të ndihmojë njësitë për të qënë të përgjegjshëm ndaj publikut, duke vlerësuar zbatimin e ligjit, rregulloreve, kontrolleve të vendosura, si dhe duke siguruar dobinë, frytshmërinë dhe kursimin e burimeve (ekonominë, eficientën dhe efektivitetin).
- b) Të japë siguri objektive për titullarët, mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës, të përgatitura nga strukturat e menaxhimit.
- c) Të ndihmojë menaxhimin e njësisë në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të tyre, duke përmirësuar sistemet e kontrollit dhe shërbimet e njësisë.
- d) Të pengojë mundësinë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim.
- e) Të ndihmojë punonjësit të përmirësojnë performancën e tyre të punës dhe në respektimin e kontrolleve të vendosura.

#### ***Sigurimi i brendshëm i cilësisë***

Sigurimi i brendshëm i cilësisë është miratuar nëpërmjet programit me nr. 888.prot, datë 22.08.2018, nga Administratori.


**Sigurimi i brendshëm i cilësisë** përbëhet nga këto komponentë: Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë; Vetëvlerësimi periodik; Reagimet e subjektit të audituar (jo e detyrueshme); Raportimi; Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së auditimit të brendshëm; Vetëvlerësimi; Ky monitorim kryhet për çdo mision auditimi nga vetë audituesit, nga kryetari i grupit të auditimit dhe nga shefi i sektorit të auditimit kur ai e gjykon.

**Vetëvlerësimi** kryhet sipas anekseve të miratuara në këtë program për audituesit, kryetarin e grupit të auditimit dhe për shefin e sektorit të auditimit. Këto anekse bëhen pjesë e dosjes së angazhimit të auditimit.

Vetëvlerësimi periodik, kryhet nga shefi i sektorit të auditimit sipas një aneksi të miratuar. Ky vetëvlerësim kryhet një herë në vit, pas realizimit të planit vjetor dhe bëhet pjesë e dosjes së raportimit vjetor të sektorit të auditimit.

**Plani vjetor:** Janë planifikuar të auditohen subjektet në lidhje me: funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut; sistemin e të ardhurave dhe shpenzimeve; të kontabilitetit; të investimeve; i arkëtimit dhe pagesave; të evidentimit, ruajtjes dhe administrimit të aseteve; dhënia e objekteve me qera; evidentimi dhe ndjekja e detyrimeve të prapambetura.

Konkretisht në: Njësia e Biznesit të Udhëtarëve, Për Njësinë e Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës; Njësia e Biznesit të Udhëtarëve; Njësia e biznesit të Mallrave; Njësia e Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse; Njësia Ekonomike; Njësia e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

Njësia e Zbatimit të Projekteve. Janë planifikuar dhe realizuar sipas viteve objekt auditimi sa vijon:


Viti	plani	fakti	diferenca	Lloji i auditimeve
2019	6	6	0	Përputshmërie dhe Financiar
2020	6	6	0	Përputshmërie dhe Financiar
2021	7	5	-2	Përputshmërie dhe Financiar
2022	7	5	-2	Përputshmërie dhe Financiar

Janë përdorur auditime të kombinuara pasi auditimi i një njësie, përmban auditimin e disa sistemeve, dhe përmban në vetvete auditimin e përputshmërie, performancës dhe auditimin financiar. Pritshmëritë ishin që që plani të mbyllet me sukses deri në fund të vitit.

#### ***Prioritetet e auditimit janë:***

- Hartimi e planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planet e miratuara.
- Vlerësimi e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe kontrolleve të brendëshme, duke u fokusuar në:
  - Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut nga titullari i njësisë publike.
  - Përputhshmëria e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator.
  - Ruajtja e aseteve të njësisë publike.
  - Besueshmëria dhe gjithë përfshirjen e informacionit financiar dhe operacional të njësisë publike.
  - Kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.
  - Përmirësimin e detyrave dhe arritjen e objektivave të qëllimeve.
  - Dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë.
- Ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

#### IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

##### A- MASA ORGANIZATIVE

**1- Gjetje nga auditimi:** Në shkresën nr. 415/7 prot., datë 13.11.2019, të Kontrollit të Lartë të Shtetit, “Hekurudha Shqiptare” SHA, i janë lënë për zbatim 36 masa organizative, 5 masa për shpërblim dëmi, 1 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike, për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike si dhe 2 masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar gjithsej:

A. 36 masa organizative: janë pranuar 35 prej tyre, ose 97.3%, nga të cilat, 14 masa janë zbatuar plotësisht (40%), 3 masa janë në proces zbatimi (8.6%), 14 masa nuk janë zbatuar (40%), 4 masa zbatuar pjesërisht (11.4%).

B. 5 masa për shpërblim dëmi: nga të cilat, 2 masa janë zbatuar plotësisht (40%), 3 masa nuk janë zbatuar (60%).

C. 1 masë për eliminimin e efekteve të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, e cila nuk është zbatuar.

D. 2 masa disiplinore rekomanduar gjithsej, të cilat janë zbatuar.

Moszbatimi i masave të rekomanduara nga KLSH në auditimin e mëparshëm është jo në përputhje me ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", duke sjellë mos eficiencë në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për “Hekurudha Shqiptare” SHA.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 17 - 39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **ri kërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të zbatuara pjesërisht, të pa zbatuara.

**Menjëherë**

**2- Gjetje nga auditimi:** Në “Hekurudha Shqiptare” SHA, konstatohet një planifikim dhe realizim jo i duhur i programit ekonomik, fakt që flet për planifikim jo të saktë dhe mos rishikim të programit fillestar. Performanca e treguesve ekonomiko-financiar që lidhen me realizimin e buxhetit faktik të shoqërisë, nuk është e kënaqshme dhe ka vend të përmirësohet, pasi për çdo lekë të shpenzuar, sipas viteve objekt auditimi është përfituar një e ardhur: 2019 prej 0.89 lekë, 2020 prej 0.79 leke, 2021 prej 0.94 lekë dhe për vitin 2022 një e ardhur prej 0,99 lekë. Raporti i detyrimeve afat shkurtër/kapitalit për vitin 2019, paraqitet 1.5 % , për vitin 2020 paraqitet 1.22%, për vitin 2021 paraqitet 1.31% dhe për 2022 në 1.45%. “Hekurudha Shqiptare” SHA, ka riskun e gjendjes së pamjaftueshme të likuiditeteve. Në qoftë se shoqëria do të llogariste penaltitetin e hekurudhave të huaja si dhe nuk do të çelej subvencion nga buxheti i shtetit, do të çonte në rezultat negativ akoma më të lartë për vitet ushtrimore. Duke zbritur nga pasqyrat financiare





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

subvencionin si e ardhur, raporti të ardhura/shpenzime do të ndryshojë duke thelluar në mënyre të ndjeshme rezultatin financiar (humbje). Veprimet sa më sipër janë jo në përputhje me ligjet nr.115/ 2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ndryshuar; nr.137/ 16.11.20, “Për buxhetin e vitit 2021”, ndryshuar; nr.88/ 18.12.19, “Për buxhetin e vitit 2020”, ndryshuar; nr.99/ 2018, “Për buxhetin e vitit 2019” si dhe UMFE nr.9, datë 20.03.18, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 43 – 66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1 Rekomandimi:** Nga ana e organeve drejtuese të bëhet një analizë e detajuar e investimeve kapitale dhe shpenzimeve, etj., të planifikuara për t`u realizuar gjatë vitit dhe të merren veprimet e nevojshme që këto projekte të realizohen sipas programit.

**Menjëherë**

**3- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se nga ana e MFE, me shkresat përkatëse, është miratuar detajimi i planit për shpenzimet korrente, ndërkohë që emërtimi i produktit është “rrjet hekurudhor i subvencionuar”. Në opinionin e grupit të auditimit emërtimi “Rrjet hekurudhor i subvencionuar” është në kundërshtim me pikën 26, 58 dhe 63, të nenit 5, të ligjit nr.142/2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se rrjeti nuk është veprimtari por objekt. Nga auditimi i dokumentacionit, për përdorimin/ realizimin e subvencionit sipas shkresave dërguar MIE-s dhe Degës së Thesarit Durrës, subvencioni ka numër artikulli 603000 “Subvencione për transportin hekurudhor” (sipas nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik) dhe jo artikullin përkatës për të cilin është kryer shpenzimi faktik. Nga sa rezulton, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), Dega e Thesarit Durrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar), me veprimet apo mosveprimet e tyre, kanë krijuar një situatë të paqartë për alokimin dhe përdorimin e subvencionit nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, duke i krijuar kësaj shoqërie mundësinë që ta përdor këtë subvencion për paga dhe sigurime shoqërore, duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi të akorduar po nga MFE. MIE dhe MFE, e kanë përdorur subvencionin si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë HSH sha.

Pas miratimit të programit ekonomik nga MFE, nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, janë përgatitur kontrata për marrëveshjen financiare shtetërore e cila i është dërguar MIE-s. Këto marrëveshje janë firmosur në mënyrë të njëanshme vetëm nga “Hekurudha Shqiptare” SHA dhe në asnjë rast nuk janë firmosur nga MIE.

Ecuria e treguesve ekonomiko-financiare për vitet e fundit 2019, 2020, 2021 dhe 2022, pasqyron një krizë likuiditeti “Hekurudha Shqiptare” SHA, si dhe ka detyrime të prapambetura ndaj të tretëve si kredi afatshkurtër e afatgjatë, për principial dhe interesa, fatura për blerje etj., në vlerën 3,870,023 mijë lekë (totali i detyrimeve afatshkurtra 1.096.943 mijë lekë + totali i detyrimeve afatgjata 2.773.080 mijë lekë). Në opinionin e grupit të auditimit “Hekurudha Shqiptare” SHA, është në gjendje falimentimi.

Veprimet sa më sipër janë jo në përputhje me ligjet nr.115/ 2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ndryshuar; nr.137/ 16.11.20, “Për buxhetin e vitit 2021”, ndryshuar; nr.88/ 18.12.19, “Për buxhetin e vitit 2020”, ndryshuar; nr.99/ 2018, “Për buxhetin e vitit 2019” si dhe UMFE nr.9, datë 20.03.18, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 72 -91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1 Rekomandimi:** Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës, ti kërkojnë në rrugë institucionale Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e monitoruesit dhe hartimit të politikave, që të ndërmarrin veprime urgjente ligjore, për korrigjimin e menjëhershëm të veprimtarisë së kësaj shoqërie, dhe konkretisht për subvencionin, që të përputhen kërkesat e ligjeve me kushtet dhe specifikat në të cilat ndodhet kjo shoqëri.

#### Menjëherë

**4- Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2022, huatë afatgjata dhe detyrimet e tjera afatgjata, paraqiten në vlerën 1,438,887 mijë lekë, kjo bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit nr. 37, në fuqi. Objektivi i SNK 37 është të sigurojë se janë zbatuar kriteret e duhura të njohjes dhe bazat e matjes për provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara. Në këtë vlerë, Shoqëria nuk ka përfshirë vlerat për interesa dhe kamatëvonesa të arritura sipas marrëveshjeve të huave. Shoqëria ka njohur në vitin 2000 provizionet afatgjata në vlerën 237,250 mijë lekë, që lidhen drejtpërdrejt me detyrimet e mundshme të huave dhe detyrimeve. Me shkresën nr. 48 prot., datë 19.01.2023, HSH sha, i është drejtuar MFE<sup>së</sup>, për të krijuar kushtet e nevojshme për likuidimin e borxheve të huaja. Duke marrë në konsideratë shumën e penaliteteve të pa llogaritura, pretendimet e hekurudhave të huaja dhe kostot potenciale për zgjidhjen e marrëveshjeve, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë mbi shumën e nevojshme të provizioneve shtesë që duhet të krijohen dhe efektet që kjo do të kishte në pasqyrat financiare. Shoqëria nuk ka pasur një politikë koherente të njohjes së provizioneve për borxhet e këqija dhe të dyshimta. Mungesa e një rregulloreje për provizione si dhe mungesa e një analize për vjetërsinë dhe vlerësimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta, mund të këtë ndikim në rritjen e rrezikut për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, dhe marrjen e vendimeve të gabuara lidhur me to.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4/b e d, faqe 72 -91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1 Rekomandimi:** Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, duhet të ndërmerren veprimet e nevojshme për hartimin e një rregullore për trajtimin e provizioneve dhe borxheve të këqija, të bazuar në politika të qarta dhe në harmoni me Standardet e kontabilitetit.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**5- Gjetje nga auditimi:** Gjendja debitore dhe kreditore për “Hekurudha Shqiptare” SHA është shumë e rënduar, pavarësisht se nga organet drejtuese të saj është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre. Gjendja debitore për vitin 2022 është në vlerën 594,825,000 lekë. Peshën kryesore të llogarive të arkëtueshme, e mbajnë aktivet korrente në vlerën 369,000,000 lekë ose 67 %. Pjesë tjetër e cila është e rëndësishme, është TVSH me saldo debitore, në vlerën 36,129,000 lekë. Ndërsa në llogarinë 4671, e cila është në vlerën 68,464,784 lekë, janë detyrime të cilat nuk mblidhen prej vitesh dhe janë të ndjekura nga sektori juridik. Në llogarinë 411, të arkëtueshme, e cila ka vlerën 15,966,000 lekë, janë të viteve të fundit dhe mendohet se do jenë të arkëtueshme nga Njësia Biznes Mallit dhe Njësia e Menaxhimit të Infrastrukturës. Sa trajtuar janë në mospërputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, ligjit nr. 9901, datë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, situatë e cila sjell ndikim në rezultatin financiar të Shoqërisë në fund të vitit ushtrimor.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4/b e d, faqe 72 -91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1 Rekomandimi:** Organet Drejtuese të Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” SHA, (Administratori, Këshilli Mbikëqyrës, Asambleja e Përgjithshme), të marrin masa për analizimin, shqyrtimin dhe reduktimin e humbjeve të shoqërisë.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**6- Gjetje nga auditimi:** “Hekurudha Shqiptare” SHA, pasqyrimin në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, bëhet vetëm për vlerën e detyrimit (borxhit). Deri më 31.12.2022, detyrimi ndaj hekurudhave të huaja është në vlerën 1,976,747 euro ose 225,803,918 lekë, nga të cilat 518,483 euro (59,221,332 lekë) penalitete, kryesisht detyrimet janë ndaj Hekurudhës Serbe dhe Hungareze. Mos likuidimet në kohë janë jo në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, si dhe ndikojnë në mos pasqyrim të saktë të rezultetit financiar të shoqërisë. Këto detyrime i përkasin periudhës 2009-2022, të cilat përfshijnë orë/qëndrimet e vagonëve të huaj në territorin shqiptar. Gjatë kësaj periudhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, e ka patur të pamundur likuidimin e tyre për shkak të gjendjes së rëndë financiare. Hekurudha Serbe (Serbia Carko) i ka kërkuar gjatë gjithë periudhës detyrimet e tyre madje kane kërkuar dhe interesa. Shoqëria ka vënë në dijeni dhe Ministrinë e Financave për detyrimin që ka “Hekurudha Shqiptare” SHA ndaj hekurudhave të huaja.

Detyrime të tjera në këtë llogari paraqitet dhe detyrimi ndaj hekurudhave të huaja (të vjetra “deri në vitin 1990-1992”) në vlerën 781.465.000 lekë. Theksojmë se “Hekurudha Shqiptare” SHA nuk disponon dokumente ligjor, për ndarjen e detyrimeve të ish Hekurudhës Jugosllave, sipas shteteve që aktualisht janë, pra në pasqyrat financiare disponohet detyrimi i trashëguar që nga periudha 1990-1992 si Hekurudhë Jugosllave. Nga ana e “Hekurudha Shqiptare” SHA nuk janë llogaritur interesa ndër vite për këto detyrime afatgjata.

Veprimet sa më sipër janë jo në përputhje me ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4/b e d, faqe 72 -91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Përgjithshëm, Njësia Ekonomike dhe Sektori i Marketingut, të merren masa për të bërë evidentimin dhe regjistrimin e penaliteteve të shkaktuara nga mos likuidimi i kamatë vonesave për orë qëndrimet e vagonëve të hekurudhave të huaja, duke bërë në këtë mënyrë raportim të saktë dhe të besueshëm të detyrimeve financiare, si dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**7- Gjetje nga auditimi:** “Hekurudha Shqiptare” SHA, në sistemin kontabël që përdor për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarive të njësive ekonomike nuk përdor bartësit informatikë, duke shfaqur rritje të riskut të gabimeve si dhe të vështirësive për monitorim të sistemit, mungesën e të dhënave financiare në kohë reale për t’u reflektuar në vendim-marrjen e organeve drejtuese të shoqërisë. Ky fakt



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

ndikon në mos kontroll për sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave për të gjitha veprimet dhe ngjarjet ekonomike, mundësi për ndryshim të tyre nga përdoruesit dhe rezulton mos vlerësim sa dhe si duhet i programeve informatike bashkëkohore.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4/b e d, faqe 72 -91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1 Rekomandimi:** Nga ana e shoqërisë të merren masa që në sistemin e saj kontabël, evidence mbështetëse, dokumentet bazë, dokumentet plotësues dhe regjistrat kontabël, të implementojë bartësit informatikë, që janë autorizuar nga organet përkatëse, të shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pa-manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.

#### Menjëherë

**8- Gjetje nga auditimi:** Në “Hekurudha Shqiptare” SHA, mbajtja e llogarive të aktiveve jashtë kontabilitetit është në shumën 2,441,739,656 lekë, në të cilat paraqiten vlera e aktiveve afatgjata materiale që priten t'i transferohen bashkive Tiranë, Mirditë, Klos, Laç, Elbasan dhe Durrës, procedurë e cila ka mbetur përgjysmë. Si rrjedhojë, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë efektin që do të kishin patur në pasqyrën e performancës, si edhe në pozicionin financiar, nëse kjo procedurë e nisur nuk do të realizohet, bazuar në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në fuqi.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4/b e d, faqe 72 -91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1 Rekomandimi:** Shoqëria të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të vlerës 2,441,739,656 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me aktivet afatgjata materiale, të cilat janë në proces transferimi ndaj bashkive Tiranë, Mirditë, Klos, Laç, Elbasan dhe Durrës, në zbatim të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.

#### Menjëherë

**9- Gjetje nga auditimi:** Të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, me përjashtim të 4 prej tyre, nuk janë regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, (Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme), veprime në kundërshtim me ligjin nr.111/2018, “Për Kadastrën” dhe ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, fakt i cili ndikon në keq menaxhim të aktiveve të Shoqërisë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4/b e d, faqe 72 -91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**9.1 Rekomandimi:** Nga Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” SHA, të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorinë Vendore, Durrës, të gjitha objektet që janë regjistruar në zërin “troje” në kontabilitet.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në terren lidhur me punimet e kryera, sipas kontratës së lidhur midis kontraktorit “E.B.,” SHPK & “V.-E.,” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 984/2 prot., datë 18.11.2019, objekt “Punime për mbrojtjen e linjës”, grupi i auditimit, nuk mundi të verifikonte disa zëra punimesh, konkretisht, në km 75 +050, L=35 ml, perigoni Lushnje-Fier, pasi hasi në vështirësi për të evidentuar me saktësi segmentet e deklaruara (km) nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, si segmente që duheshin riparuar. Mungonin gurët kilometrikë e si rezultat nuk ishte e mundur të evidentohesh saktësisht nëse punimet ishin kryer në segmentet/kilometrat e deklaruara nga “Hekurudha Shqiptare” SHA. U konstatuan mangësi të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

theksuara të sinjalistikës hekurudhore si ajo që nevojitet për makinistët e trenave por edhe sinjalistika e domosdoshme për këmbësorët ose automjetet që kalojnë kryqëzimet hekurudhore. Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA nuk është marrë asnjë masë për saktësimin e gjatësisë kilometrike të linjave hekurudhore shqiptare, duke vështirësuar kryerjen e verifikimeve në terren, lidhur me investimet e deklaruara për kilometrat respektiv. Veprimet sa më sipër janë jo në përputhje me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7 dhe Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të “Hekurudha Shqiptare” SHA, nenet 112, 114, 149 dhe neni 152.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 164 -203 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1 Rekomandimi:** Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të merren masa për vendosjen e sinjalistikës hekurudhore me qëllim garantimin e sigurisë në trafikun hekurudhor dhe vendosjen e gurëve kilometrikë të paktën për çdo 100 km gjatësi të linjës hekurudhore, me qëllim lehtësimin e kryerjes së verifikimeve në të ardhmen të zërave të punimeve për rikonstruksionet e segmenteve të ndryshëm të linjës hekurudhore.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**11. Gjetje nga auditimi:** Midis kontraktorit “M.,” SHPK & “V.K.,” SHPK & “E. K.,” SHPK & “N.-G.,” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, është lidhur kontrata nr.110/4 Prot., datë 03.11.2022 dhe objekt “Riparim vepra arti (mbrojtja e urës hekurudhore të Rrogozhinës)”, me afat 45 ditë kalendrike nga dita e nënshkrimit dhe vlerë kontrate 37,799,726.4 lekë me TVSH. Nga auditimi në terren për verifikimin e zbatimit të punimeve, rezultoi se për zërin “F.V. Mbushje me gurë kave të mëdhenj  $D > 70$  cm për mbrojtje të këmbëve të urës dhe stabilizim dhe uljen e gërryerjes së mëtejshme,  $t = 2 \text{ ton/m}^3$ ”, ishte e pamundur për grupin e auditimit që të verifikohet realizimi i këtij zëri, për sasinë e deklaruar e gurëve të hedhur në shtratin e lumit prej  $9,254 \text{ m}^3$ , sa deklaruar në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar, për arsye të prezencës së ujit në lumin Shkumbin.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 164 -203 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1 Rekomandimi:** “Hekurudha Shqiptare” SHA, në bashkëpunim me institucionet shtetërore përkatëse për menaxhimin dhe mbrojtjen e lumenjve, të verifikojnë nëse kontraktori “M.,” SHPK & “V.K.,” SHPK & “E.K.,” SHPK & “N.-G.” SHPK, kanë realizuar zërin e punimeve të mësipërme. Në rast se nuk kryhet ky verifikim **vlera 8,853,016 lekë, do të konsiderohet dëm ekonomik.**

#### Menjëherë

**12- Gjetje nga auditimi:** Në procedurat e prokurimit publik të kryera nga AK, për periudhën objekt auditimi, pothuajse në të gjitha procedurat e audituara, nga ana e APP është dhënë asistencë teknike për kërkesat e veçanta për kualifikim. Pavarësisht se rekomandimet e dhëna nga APP janë zbatuar sipas shtojcave të modifikimit të DST<sup>ve</sup>, kjo ka sjellë shtyrjen e afatit të procedurës së prokurimit.

Në përbërjen e njësisë së prokurimit nuk ka specialistë të fushës, por ato janë me profesion jurist dhe vetëm në tre raste është inxhinier elektrik, por që nuk është i fushës konkrete, kërkesë kjo e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 57,





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

“Njësia e prokurimit”, pika 1 dhe 2, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 74, pika 4, neni 78.

Nisur nga fakti se projektet, preventivat dhe specifikimet teknike hartohen nga Njësia e Infrastrukturës, bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim mbikëqyrje dhe kolaudim”, neni 3, “Shërbimet dhe tipologjitë”, pika 5, ku janë përcaktuar tipologjitë e shërbimit, kriteret e veçanta teknike duhet të ishin hartuar nga njësia e cila paraqet projektet, preventivat dhe specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 102-164, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1 Rekomandimi:** AK, “Hekurudha Shqiptare” SHA, të marrë masa që hartimi i kriterëve teknike për kualifikim të kryhet nga specialisti i fushës së njësisë së prokurimit ose nga struktura të posaçme, Njësia e Infrastrukturës.

**Menjëherë**

**13- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se projektet nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat përgjegjës për realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Grupi i projektimit duhet jetë i përbërë minimumi nga: inxhinieri gjeodet për plan rilevimin dhe azhurnimin topografik, projektuesi arkitekt, projektuesi konstruktor, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi i instalimeve hidrosanitare, projektuesi i instalimeve ngrohje ftohje ventilim, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri, inxhinieri sizmolog, inxhinieri gjeolog, eksperti mjedisor, veprim jo në përputhje me VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 102-164, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**13.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” SHA, të merren masa për të operuar vetëm me projekte të zbatimit të hartuara nga projektues, të pajisur me licencat përkatëse.

**Menjëherë**

**14- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për përlllogaritjen e fondit limit nga komisionet përkatëse rezultoi se: Nuk ka të dhëna mbi çmimet bazë të kontratave të mëparshme të vetë AK. Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, nuk liston asnjë çmim të kontratave të mëparshme për të lënë gjurmë auditimi, por kërkojmë nga njësia e prokurimit dhe strukturat juridike pranë saj të bëjnë verifikimin ligjor të procedurës së ndjekur për hartimin e fondit limit dhe nëse del ndonjë problem të referohet për ndryshimet e nevojshme, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, neni 74/4, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, neni 76, “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, pika 3. Nga ana e këtij komisioni përcaktohet se: “Vlerat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve do të mbulohen nga ulja në procedurën e prokurimit”, veprim jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 1, “Përgjegjësia e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

autoritetit/entit kontraktor”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 113 -221, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**14.1 Rekomandimi:** AK, “Hekurudha Shqiptare” SHA, të marrë masa të argumentojë përlllogaritjen e fondit limit sipas detyrës së caktuar nga titullari. Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit të mos tejkalojë kompetencat e caktuara, duke përcaktuar fondet për mbikëqyrje e kolaudim nga përlllogaritja e fondit limit të procedurës së urdhëruar.

**Menjëherë**

**15- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit kryesisht për blerje traversa druri apo rikonstruksione të linjave rezultoi se në specifikimet teknike, komision nuk ka përcaktuar llojin e standardit të KE në fuqi si dhe është kërkuar certifikatë cilësie e prodhuesit, pa përcaktuar numrin e saj, certifikatë garancie të prodhuesit pa përcaktuar afatin e garancisë së traversave, veprim jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, neni 27, Kontratat e mallrave, pika 1. Ndërsa në arsyetimin për nevojën e prokurimit për blerje traversa druri hekurudhore (kjo e vlefshme edhe për rikonstruksionin e linjave), jepet arsyetimi i gjendjes se rënduar hekurudhore, por në lidhje me rezultatet e kontrollit teknik periodik të kryer në linjën hekurudhore nuk jepet asnjë e dhënë mbi rezultatet se sa janë kërkuar dhe për kë linja janë kërkuar këto traversa. Sa më sipër është jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit”, pika 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 102-164, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**15.1 Rekomandimi:** AK, “Hekurudha Shqiptare” SHA, të marrë masa të arsyetojë në mënyrë të drejtë domosdoshmërinë e kryerjes së procedurës së prokurimit. dhe hartimi i specifikimeve teknike të jetë në përputhje me objektin e kontratës.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**16- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit publik në të gjitha rastet rezultoi se preventivat nuk shoqërohen me analizë teknike të çmimeve për ato raste kur këto çmime nuk janë pjesë e manualeve teknike të çmimeve, veprim jo në përputhje me VKM nr.514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat: 9, 10, 11 dhe me Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe nr. 1, datë 16.6.2011.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 102-164, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**16.1 Rekomandimi:** AK, “Hekurudha Shqiptare” SHA, të marrë masa që të hartojë preventiva, ku çmimet e reja që nuk përfshihen në manualin teknik të çmimeve të bëhen me analizë, duke u bërë pjesë e dosjes së procedurës së prokurimit.

**Menjëherë**

**17-Gjetje nga auditimi:** Sistemi i kontrollit të brendshëm i HSH<sup>së</sup> vlerësohet jo efektiv dhe me mangësi në lidhje me funksionimin e të pese komponentëve që veprojnë së bashku në një mënyrë të integruar, duke ndikuar drejtpërdrejt në mosfunksionimin e plotë të sistemit të kontrollit të brendshëm të kësaj njësie. Nga auditimi rezultoi se “Hekurudha Shqiptare” SHA ka përcaktuar





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

koordinator të menaxhimit të riskut një specialist IT, ndërkohë që koordinatori i menaxhimit të riskut duhet të jetë Nëpunësi Autorizues. Grupi Menaxhimit Strategjik nuk kishte të dokumentuar mbledhjet e zhvilluara, të cilat duhet të jenë minimalisht 4 herë në vit, e përcaktuar në UMF nr.16 datë 20.07.2016, pika 2.2.4, “Roli i Grupit të Menaxhimit Strategjik”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 203 - 210, të Raporti Përfundimtar të Auditimit)*

**17.1 Rekomandimi:** Nga ana e “Hekurudha Shqiptare” SHA, të merren masa që Grupi Menaxhimit Strategjik të mbledhet minimalisht 4 herë në vit, duke dokumentuar diskutimet dhe vendimet e marra.

**17.2 Rekomandimi:** Nga ana e “Hekurudha Shqiptare” SHA, të merren masa që koordinatori i menaxhimit të riskut të jetë nëpunësi autorizues.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**18-Gjetje nga auditimi:** “Hekurudha Shqiptare” SHA, për periudhën objekt auditimi nuk ka të hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit, e cila detajon procedurat kryesore dhe siguron që të gjitha operacionet e njësive publike të dokumentohen në formën që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoritetit mbikëqyrës të kuptojnë mjedisin e kontrollit, veprim jo në përputhje me ligji nr.10296, datë 08.07.2010, ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, Kapitulli II, “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 203 – 210, të Raporti Përfundimtar të Auditimit)*

**18.1 Rekomandimi:** Nga ana e “Hekurudha Shqiptare” SHA, Administratori i shoqërisë, të miratojë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoritetit mbikëqyrës të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## B- MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

### 1- Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i kontratës së lidhur me objekt “Punime për mbrojtjen e linjës”, midis BOE “E. B.” SHPK & “V.-E.” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 984/2 prot., datë 18.11.2019, me afat 90 ditë kalendarike nga dita e dhënies së lejes së sheshit të ndërtimit, me vlerë 21,338,017 lekë me TVSH, rezultoi se kontraktori “E. B.” SHPK & “V.-E.” SHPK, ka aplikuar për leje për lëvizje në portalin e-Albania, në datën 31 mars 2020, pas daljes së Urdhrit nr.1434 prot., datë 12.03.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për kufizimin e lëvizjeve të mjeteve të transportit, aplikim pas mbarimit të afatit të kontratës shtesë, 23.03.2020. Punimet kanë vazhduar pa një kontratë e si të tilla, zërat e punimeve të kryera jashtë afateve ligjore, janë zëra punimesh të kryera me vonesë nga kontraktori. Sipas ditarit të objektit zërat e punimeve të kryera jashtë afateve ligjore, janë nga data 07.04.2020 - 17.04.2020 dhe përfshijnë punimet e kryera në segmentin Lushnje – Fier km 75 + 0.50. Vlera e zërave të punimeve, të kryera jashtë afatit të përfundimit të kontratës (12 ditë vonesë), është 1,300,320



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

lekë. Në këto kushte, Njësia e Biznesit e Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore Durrës, e ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës sipas nenit 2, “Komunikimi dhe përfaqësimi”, pika 2.5 e saj, duhej të njoftonte HSH SHA, për vonesa në kryerje të punimeve, duke u aplikuar në vazhdim, neni 7, “Dëshmipërblimet për vonesat”, i kontratës më nr. 984/2 Prot., datë 18.11.2020, pika 7.1, për 12 ditë vonesë kryerje punimesh me vlerë 1,300,320 lekë, është:  $4/1000 * 12 * 1,300,320 = 62,415$  lekë.

-Nga auditimi në terren lidhur me punimet e kryera, u konstatua se jo në përputhje me kontratën e lidhur, nuk është ekzekutuar zëri nr.5, An-9, “Mbushje me zhavorr mbrapa murit”, me vlerë 285,994.8 lekë me TVSH, për segmentin hekurudhor Rrogozhinë-Lushnje, km 74+850 deri km 75+000 dhe km 75+700 deri 75+765, me vlerë të punimeve të pa kryera në shumën **285,995 lekë**.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 161 -167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 62,415 lekë**, nga kontraktori “E. B.” SHPK & “V.-E.” SHPK, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 984/2 prot., datë 18.11.2019.

**Menjëherë**

**1.2 Rekomandimi:** Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 285,995 lekë**, nga kontraktori “E., B.” SHPK & “V.,-E.” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar dhe likuiduar por të pa kryer nga kontraktori sipas kontratës nr. 984/2 Prot., datë 18.11.2019.

**Menjëherë**

**2-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratës së lidhur me objekt “Rikonstruksioni i Linjës Budull - Gjorëm”, midis kontraktorit “E.” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 52/5 prot., datë 02.07.2021, me afat 3 muaj kalendarikë duke filluar nga data e lidhjes së kontratës (deri në datën 29.09.2021), me vlerë 9,724,178 lekë me TVSH, rezultoi se: me shkresën nr. 1001/2 Prot., datë 19.07.2021 protokolluar pranë “Hekurudha Shqiptare” SHA, është lidhur Akt-Marrëveshje për kryerjen e punimeve ndërtimore pa ndërprerje të trafikut hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve, me qëllimin e ruajtjes së sigurisë së qarkullimit të trenave gjatë kryerjes së punimeve në linjën hekurudhore. Kontrata bazë, (lidhur datë 02.07.2021) ka afatin 3 muaj nga data e nënshkrimit të saj, ndërkohë që Akt-Marrëveshja është lidhur vetëm, për përcaktimin e kohës ditore të punës me qëllim mos ndërprerjen e trafikut hekurudhor. Nga auditimi rezultoi se është ndryshuar afati i ekzekutimit nga 90 ditë kalendarike i përcaktuar në kontratën bazë, në 135 ditë kalendarike. Në vazhdim, është nënshkruar me shkresën nr. 52/21 Prot., datë 04.10.2021, një amendament kontrate, e cila zgjat afatin e kontratës bazë (sipas nenit 4, pika 1 të saj) deri në datën 15.11.2021. Nëse i referohemi nenit 4 të kontratës bazë, rezulton se kontrata bazë fillon në datën e nënshkrimit të saj pra në datën 02.07.2021 dhe përfundon pas 90 ditësh kalendarike ose në datën 29.09.2021. Si rezultat:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

1. Kontrata shtesë është nënshkruar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në kontratën bazë e cila e ka humbur fuqinë e saj ligjore në datën 29.09.2021. Kontrata shtesë i referohet një neni të shfuqizuar e si e tillë, është e pavlefshme juridikisht.

2. Argumentimi i cilësuar në kërkesën e mbikëqyrësit të punimeve, drejtuar “Hekurudha Shqiptare” SHA lidhur me mos disponueshmërinë e stafit të një operatori tjetër ekonomik me të cilin bashkëpunon “E.” SHPK, fitues i procedurës së prokurimit dhe nënshkruar i kontratës, nuk qëndron pasi në procedurën e prokurimit, OE “E.” SHPK, nuk ka dorëzuar gjatë fazës së konkurrimit, nuk ka deklaruar nënkontraktim. Njoftimi për përfundimin e punimeve, është me datë 08.11.2021 dhe punimet kanë përfunduar me vonesë, nga data 29.09.2021, ka tejkaluar afatet e përcaktuara në kontratë me 40 ditë vonesë. Referuar ditarit të objektit në dosjen teknike, me numrin rendor 38 sipas inventarit të dosjes i cili ka 117 fletë, konstatohet se nga data 30.09.2021 deri në datën 08.11.2021, janë ekzekutuar zërat e punimeve në vlerën 720,000 lekë. Në këto kushte, duhej të aplikohesh neni 7, “Dëmshpërblimet për vonesat”, i kontratës, pika 7.1. Vlera e penaltetit për 40 ditë vonesë që duhet mbajtur nga kontraktori “E.” SHPK për kryerje punimesh me vlerë 720,000 lekë, është:  $4/1000 * 40 * 720,000 = 115,200$  lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 167 -174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1 Rekomandimi:** Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 115,200 lekë**, nga kontraktori “E.” SHPK, si vlerë që i përket penaltetit që duhet mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 52/5 prot., datë 02.07.2021.

**Menjëherë**

**3-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në terren për punimet e kryera, sipas kontratës midis “E.” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, nr. 52/5 Prot., datë 02.07.2021 dhe objekt “Rikonstruksioni i Linjës Budull-Gjorëm”, u konstatuan diferenca në zëra punimesh të pa ekzekutuara, por të situacionuara dhe faturuara. Punimet kanë filluar në Km 38+050 deri tek ura mbi kanalën vaditës. Për një gjatësi prej 70 m, ose mbi të gjithë gjatësinë e urës, nuk është kryer asnjë punim. Pjesa e shinave mbi urë është tejet e amortizuar dhe e pa kalueshme pasi ka dëmtime të shumta dhe çarje të urës. Janë vendosur 672 copë traversa betoni. Traversat e betonit janë me dimensione (26\*16\*240) cm dhe e shprehur në vëllim, një traverse është afro 0.11 m<sup>3</sup>. Për 672 traversa, vëllimi total i traversave të montuara është:  $672 \text{ copë} * 0.11 \text{ m}^3 = 73 \text{ m}^3$  dhe jo 672 m<sup>3</sup> sa është deklaruar në situacionin përfundimtar dhe librezën e masave. Në situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 3575 orë pune për vendosjen e 672 m<sup>3</sup> traversa betoni. Në fakt janë vendosur 73 m<sup>3</sup> traversa betoni dhe respektivisht për këtë vëllim, nevojiten  $(73*3575)/672=388$  orë pune. Vlera totale e punimeve të pa kryera është **6,362,304 lekë**.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 167 -174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1 Rekomandimi:** Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 6,362,304 lekë**, nga kontraktori “E.” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer nga kontraktori, sipas kontratës nr. 52/5 prot., datë 02.07.2021.

**Menjëherë**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

**4-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës të lidhur me objekt “Rikonstruksioni i linjës hekurudhore Shkozet-Kavajë”, midis “E.,” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021, me afat 3 muaj kalendarik nga dita e nënshkrimit të kontratës midis palëve, me vlerë 8,879,149.92 lekë me TVSH, rezultoi se: nuk u konstatua asnjë dokument apo argument lidhur me vonesën për rifillimin e punimeve nga data që ARRSH ka dhënë lejen për të kryer punimet pra nga data 06.12.2021 sipas shkresës me nr. 9672/2 Prot., datë 06.12.2021 deri në datën që kontraktori ka njoftuar “Hekurudha Shqiptare” SHA për rifillimin e punimeve pra në datën 15.12.2021. Kjo vonesë prej 9 ditësh, nuk është e justifikuar as nga kontraktori dhe as nga “Hekurudha Shqiptare” SHA. Referuar edhe ditarit të punimeve, punimet janë pezulluar në datën 28.10.2021 dhe kanë rifilluar në datën 15.12.2021. Kjo vonesë prej 9 ditësh është rikuperuar nga OE pasi ka përfunduar punimet 5 ditë përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në amendamentin e dytë. Referuar nenit 7 të kontratës bazë me nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021, “Dëmshtëpërblimet për vonesat”, HSH SHA duhej të kalkulonte penalitetin për 4 ditë vonesë të vlerës së punimeve të kryera për 494,854.2 lekë, që korrespondon me vlerën e punimeve të kryera jashtë afateve të përcaktuara në kontratë, penalitet i cili është:  $4/1000 * 4 * 494,854.2 = 7917.7$  lekë. Meqenëse kjo vlerë është më pak se 25% e vlerës së kontratës të mbetur pa u zbatuar, atëherë aplikohet formula:  $25% * 494,854.2$  lekë = 123,713.55 lekë në dëm të “Hekurudha Shqiptare” SHA.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 176 -181 të Raportit të Auditimit)*

**4.1 Rekomandimi:** Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 123,714 lekë**, nga kontraktori “E.,” SHPK, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021.

**Menjëherë**

**5-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës të lidhur me objekt “Riparime vepra arti”, midis “Rr.G.,” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021, me afat 45 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës midis palëve dhe me vlerë 9,231,016 lekë me TVSH, rezultoi se: punimet (duke marrë në konsideratë vonesat për shkak të përmbajtjeve të lumit Kir) duhej të përfundonin në datën 29.05.2022 dhe jo në 04.07.2022. Referuar edhe ditarit të punimeve, punimet janë pezulluar në datën 20.12.2021 dhe kanë rifilluar në datën 23.05.2022. Punimet kanë përfunduar me 35 ditë vonesë. Referuar nenit 7, të kontratës bazë, me nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021, “Dëmshtëpërblimet për vonesat”, “Hekurudha Shqiptare” SHA duhej të kalkulonte penalitetin për 35 ditë vonesë, kryerje punimesh, e cila është:  $4/1000 * 35 * 9,231,016 = 1,292,342$  lekë. Meqenëse kjo vlerë është më pak se 25% e vlerës totale, atëherë aplikohet formula  $25% * 9,231,016 = 2,307,754$  lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 181 -184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1 Rekomandimi:** Nga Hekurudha Shqiptare SHA, Durrës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 2,307,754 lekë**, nga kontraktori “Rr.G.,” SHPK, si vlerë që i përket penalitetit



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021.

**Menjëherë**

**6-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës të lidhur me objekt “Riparim vepra arti (mbrojtja e urës hekurudhore të Rrogzhinës)” midis kontraktorit “M.” SHPK & “V.K.” SHPK & “E.K.” SHPK & “N.-G.” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr.110/4 Prot., datë 03.11.2022, me afat 45 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit nga AK të kontratës dhe vlerë 37,799,726.4 lekë me TVSH, nga auditimi në terren për verifikimin e zbatimit të punimeve grupi i auditimit konstatoi, se kishte diferenca në zëra punimesh. “Prejje bimë të vogla Ø 10 cm”. Në librezën e masave dhe situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 2,450 m<sup>2</sup> sipërfaqe e pastruar. Nga verifikimi në terren, u konstatua se ky zë punimesh nuk është.

Për zërin “Shkulje/Këputje pilash ekzistuese druri të vjetra”, në situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 125 copë pilash të shkulura. Nga verifikimi në terren, u konstatua se ky zë punimesh nuk është ekzekutuar.

Për zërin “Rrafshim i skarpatës për ndërtim argjinate”, në librezën e masave e situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 1,405 m<sup>2</sup> sipërfaqe e rrafshuar. Nga verifikimi në terren, u konstatua se ky zë punimesh nuk është ekzekutuar.

Sa më sipër, vlera në total e punimeve të pakryera është **1,528,170 lekë**.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 194 -200 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*


**6.1 Rekomandimi:** Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 1,528,170 lekë**, nga kontraktori “M.” SHPK & “V. K.” SHPK & “E.K.” SHPK & “N.-G.” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer nga kontraktori, bazuar në kontratën nr.110/4 Prot., datë 03.11.2022.

**Menjëherë**

## C- MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

**1-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratës së lidhur midis OE “Z.” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr.501/2 Prot., datë 24.06.2019, me objekt “Rinovim agregatesh për lokomotiva”, me vlerë 11,208,000 lekë me TVSH, me afat 60 ditë kalendarike, me datë përfundimi 22.08.2019, rezultoi se: në dosjen e zbatimit të kontratës nuk u gjet fletë-dalje dhe as akt-dorëzimi të agregateve nga NJSHML tek kontraktori “Z.” SHPK. Në dosje gjendet një fletë-hyrje me nr.02 dhe datë 11.10.2019. Tek kjo fletë-hyrje, nuk janë Takografët por vetëm agregatet ashtu siç përshkruhen në deklaratat doganore. Referuar kontratës së lidhur, neni 3, pika 3.1, në fillim, përpara se agregatet e rinovuar, ti dorëzoheshin “Hekurudha Shqiptare” SHA, NJSHML duhej të dokumentonte veprimin e dorëzimit të agregateve tek OE. Në dosjen teknike të dorëzuar pranë grupit të auditimit, nuk u gjet relacioni teknik i mbajtur nga nëpunësit përkatës të “Hekurudha Shqiptare” SHA sipas detyrave dhe përgjegjësi të





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

përcaktuara në Rregullore. NJSHML nuk ka ndjekur procedurat ligjore për menaxhimin me korrektësi të aktiveve duke mos dokumentuar me saktësi lëvizjen e tyre, pasi nuk ka mbajtur procesverbal lidhur me arsyet e klasifikimit të agregateve si agregate me probleme ose agregate me defekte. Nuk u konstatua asnjë fletë-dalje nga magazina e NJSHML-së (edhe pse në fakt agregatët janë dërguar për riparim) për çdo aktiv (agregat) ku të nënshkruhej edhe nga kontraktuesi dhe të vërtetohej se aktivet janë bërë dalje nga “Hekurudha Shqiptare” SHA dhe janë transportuar me mjetin përkatës nga kontraktori. Procedura e prokurimit ka mangësi lidhur me nevojat për riparimin e lokomotivave që kanë pasur defekt. NJSHML, nuk ka kryer procedurat e duhura ligjore për marrjen në dorëzim të shërbimeve duke vepruar në kundërshtim me kontratën, nenin 7 “Inspektimet dhe Testimet”, pika 7.2 e këtij neni, ku cilësohet se: “Autoriteti Kontraktor (NJSHML në rastin konkret si përfaqësues i AK konform pikës 7.1 të po këtij neni) do të kryejë për agregatet e rinovuar, provat në lokomotiva”. Sa më sipër, vlera e investuar prej **11,208,000 lekë, përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.**

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 181 -221 të Raportit të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës i “Hekurudha Shqiptare” SHA, të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive të Strukturave Drejtuese, lidhur me kryerjen e procedurave të prokurimit pa argumentuar më parë nevojat reale të shoqërisë duke sjellë pasoja negative financiare për buxhetin e shtetit.

**Menjëherë**

**1.2 Rekomandimi:** Strukturat Drejtuese të shoqërisë, të marrin masa që në të ardhmen, përpara zhvillimit të një procedure prokurimi, të argumentohet dhe dokumentohet nevoja reale që ka institucioni dhe në vijim të kryhet prokurimi për mallra, shërbime apo punime, konform ligjeve dhe rregullave në fuqi.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2- Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, si rezultat i largimeve nga puna pa shkaqe të arsyeshme, “Hekurudha Shqiptare” SHA, është penalizuar me vlerën prej 2,371,590 lekë. Pavarësisht ndjekjes në të gjitha shkallët e gjykimit dhe kontestimeve nga HSH SHA të vendimeve të gjykatave, për dëmshpërblimet si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës konstatohet se vendimet në shumicën e rasteve janë në favor të punonjësve të larguar. Në vitin 2022, janë marrë 4 vendime të formës së prerë me vlerë totale dëmshpërblimi për punonjësit e larguar padrejtësisht në **2,371,590 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar në dëm të buxhetit të shtetit** dhe në të ardhmen shkakton rëndim të situatës financiare duke cenuar zhvillimin normal të aktivitetit ekonomiko-financiar të “Hekurudha Shqiptare” SHA, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 101 -113, të Raportit të Auditimit)*

**2.1 Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës i “Hekurudha Shqiptare” SHA, të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive lidhur me largimet e padrejta nga puna të punonjësve nga Strukturat Drejtuese.

**Menjëherë**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

**2.2 Rekomandimi:** Strukturat Drejtuese të shoqërisë dhe Dega e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për rekrutimin e punonjësve bazuar në kërkesat e vendit të punës, me qëllim shmangien e efekteve negative financiare që shkaktohen nga dëmshpërblimi si pasojë e vendimeve gjyqësore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3- Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i kryer në regjistrin e borxhit publik të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “Regjistri i Garancive Shtetërore”, rezultoi për llogari të “Hekurudha Shqiptare” SHA. është kredia italiane, (Artigiancassa, Itali), për projektin “Rehabilitimi i Hekurudhës së Durrësit, me datë nënshkrimi 08.05.1995, shuma e kredisë në vlerën 3,098,741.39 euro, me datë fillimi 17.01.2008, datë mbarimi 17.07.2025. Shoqëria kryen rakordimet e duhura me departamenti përkatës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për sqarimin e situatës debitore. Në lidhje me kredinë italiane shoqëria dispononte planin e amortizimit të kredisë si dhe ka marrë njoftime periodike nga B. që funksionon si bankë ndërmjetëse në lidhje me detyrimet, por megjithëse nuk ka paguar këstet e principalit dhe interesat duhet të krijonte një llogari provizionit për këto këste dhe interesa të cilat janë paguar nga llogaria e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Këto vlera të likuiduara nga ana e MFE janë të kontabilizuara si detyrim në llog.4672/2.

Vlera e cila llogaritet deri në fund të periudhës ushtrimore 2022 është në shumën 2.657.170,76 Euro ose në vlerën 303,529,000 lekë. Situata e vështirë ekonomike e shoqërisë është thelluar akoma më shumë në vitet e fundit duke e bërë të pamundur kthimin e detyrimit duke lënë këtë barrë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. **Vlera prej 2,657,170.76 euro është efekt financiar negativ për “Hekurudha Shqiptare” SHA.**


*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4/b dhe d, faqe 75 -101, të Raportit të Auditimit)*

**3.1 Rekomandimi:** Nisur nga gjendja e rëndë financiare dhe situata përpara ndarjes së shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” SHA, “Hekurudha Shqiptare” SHA në bashkëpunim me MFE në cilësinë e aksionarit të vetëm dhe që ka shlyer detyrimet e kësaj kredie që nga viti 2008, të marrin masat e duhura për sistemimin e detyrimit nga pasqyrat financiare të HSH sha në likuiduesin e kësaj kredie.

**Menjëherë**

**4- Gjetje nga auditimi:** “Hekurudha Shqiptare” SHA, për vitet periudhën objekt auditimi, ka paguar gjoba në lidhje me kryerjen me vonesë të pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pagesa përmbarues privat detyrime të cilat kanë lindur si rrjedhojë e mos likuidimit në afatet e përcaktuara në kontratat e lidhura me sipërmarrësit, pagesa tatimi në burim etj. Për periudhën e auditimit, shuma e paguar nga ana e Shoqërisë është **30,787,598 shumë e cila është efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.** Shoqëria nëpërmjet subvencioneve të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë (MFE), ka likuiduar detyrimet fiskale të ndryshme, likuidime të tjera të kërkuara nga zyrat përmbarimore, si shkak mos likuidim në kohë të kontratave të ndryshme. Sa trajtuar është jo në përputhje me “Kodi i procedurës civile” , i ndryshuar; Ligji i Prokurimit Publik nr. 162, datë 23.12.2020, RRPP nr.285 datë 19.05.2021, i ndryshuar “Zbatimi i detyrimeve të Kontratave”; ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA

shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligji nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4/a, faqe 68 – 75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1 Rekomandimi:** “Hekurudha Shqiptare” SHA, të marrë masat e nevojshme që në ta ardhmen të eliminojë efektet financiare negative. Shoqëria duhet të marr në konsideratë që mos shlyerja në kohë e detyrimeve të ndryshme ndaj punonjësve si (derdhja e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat personale etj.) si dhe zgjidhja e kontratave me të tretët në gjykatë do të rëndonte akoma më shumë financat e shoqërisë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **D- MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, kontratat individuale të punës, kërkojmë nga Administratori i “Hekurudha Shqiptare” SHA, referuar gjetjeve të auditimit, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe në varësi të tyre të japë masat disiplinore për ata punonjës që atakohen në këtë Raport Auditimi.

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT